

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 91-të i botimit
Tetor-Nëntor 2023 / Nr.7



FA, e sotmja dhe e ardhmja e sigurt e kombit shqiptar

DREJTOR I QKMBMMFA

ARBEN SKËNDERAJ

Shefe e Sektorit të Botimeve & Kryeredaktore

ANJEZA MUSOLLARI

GAZETARË:

MIMOZA GOLIKJA

GRAPHIC DESIGNER

AFËRDITA HYSAJ

REDAKTORE / KORREKTORE

SUELA HODA

BASHKËPUNËTORË

KOLONEL HYSNI GJERGJI

N/KOL (R) MSC. KANAN HIMAJ

GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë revistë nuk mund të riprodhohen elektronikisht apo fizikisht e të përdoren për qëllime përfitimë, pa marrë autorizim nga botuesit e saj.

Botues:

*Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes*

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

Revista mund të gjendet në formatin elektronik (pdf) në adresën:

<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikimet/revista-mbrojtja>



07

Ministri Peleshi:
Shqipëria, solidaritet
të plotë me popullin
e Ukrainës, angazhim
maksimal në forcimin
e deterencës dhe
mbrojtjes së Kosovës

16

Gjeneralmajor
Arben Kingji
merr pjesë në
Konferencën e
11-të të Iniciativës
së Bashkëpunimit
në Fushën e
Mbrojtjes (DECI)

33

"Yjet e
Pashuar
të Fekenit"

Mbrojtja

- Kryeministri Rama: Baza e re detare e NATO-s në Porto Romano, një tjetër akses i Europës 4
- Ministri Peleshi: Shqipëria, solidaritet të plotë me popullin e Ukrainës, angazhim maksimal në forcimin e deterencës dhe mbrojtjes së Kosovës 7
- Ministri Peleshi: Shqipëria, kontributore për stabilitetin dhe paqen në rajon, përmes dialogut dhe fqinjësisë së mirë 10
- Ministri Peleshi: 428 vende pune, mundësi për të rinjtë që duan të aderojnë në FA 11
- Përfundon stërvitja multinacionale "Strong Balkan 23" 12
- Ministri Peleshi: Po punojmë me AFA-në të hapim Masterin e ri të Inteligjencës Artificiale 14
- SHSHP të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji, vizitë zyrtare në Kosovë 15
- Gjeneralmajor Arben Kingji merr pjesë në Konferencën e 11-të të Iniciativës së Bashkëpunimit në Fushën e Mbrojtjes (DECI) 16
- Zëvendës shefi i SHPFA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, në konferencën "Women in Uniform Association": Të fuqizojmë rolin e femrave në uniformë 18
- Forca Detare shqiptare, pjesë e stërvitjes "Neptune Strike 23" 23
- Starton "Strong Balkan 23", me pjesëmarrjen e forcave speciale të tetë vendeve të Ballkanit 24
- Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, pjesë e takimit ushtarak dypalësh me Gardën Kombëtare të New Jersey-it, SHBA 25
- Studentët e AFA-së marrin pjesë në "Leadership Seminar", Livorno, Itali 28
- "Yjet e Pashuar të Fekenit" 33
- Kërcënimi terrorist në një dimension të ri, kohë për reflektim 36
- Strategjia e sigurisë kombëtare, dimension i sigurisë dhe mbrojtjes kolektive 40
- Oponencë Presidentit të Ukrainës: Gjithsesi nuk do të ketë luftë në Ballkan! 42
- Forcat Speciale, heronjtë e heshtur të Forcave të Armatosura 44
- "Jeta jote rezulton më interesante nëse përdor roba që kanë identitet" 48
- "Lufta e përjetshme për tokën e shenjtë" 50
- Gratë e forta kërkojnë respekt, jo vëmendje 52
- Ç'do të thotë të jesh grua?! 54
- Si ndikojnë teknologjia dhe mediat sociale në shëndetin mendor 55
- Vendet më të sigurta nëse ndonjëherë shpërthen lufta bërthamore 57
- ANO, fidanishtja e përgatitjes së drejtuesve të rinj 59
- Arma e Kimisë, shërbimi elitë i FA-së 61
- "Sikur ta dija", ish-koloneli Baki Bala, përtej sfidave të jetës 65
- Të shohësh veten përmes kujtimeve të miqve 68
- Muzetë, kujtesa jonë historike 70
- Arsimi, arma më e fuqishme për të ndryshuar botën 74
- Ora 11, e datës 11, e muajit të 11-të, të vitit 1918, bota mori frymë 78
- 74 vite art, botime, shtyp periodik, rrugëtimi në dekada i QKMBMMFA 80
- "ASSOCIATION of SKËNDERBEJ USA" në NY feston Shqiptarisht festat e bekuara të pavarësisë 85
- Një fundjavë ndryshe me një ambasador ndryshe 86
- Artur Lekbello, portier i shquar i futbollit shqiptar 88
- Gjaku i antifashistëve shqiptarë në venat e Spanjës 92
- Kongresi i Manastirit, tempulli i gjuhës shqipe 97

Kryeministri Rama: Baza e re detare e NATO-s në Porto Romano, një tjetër akses i Europës

Kryeministri Edi Rama mori pjesë në takimin e liderëve të pesë vendeve anëtare të NATO-s nga Europa Juglindore, me pjesëmarrjen e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg, mbajtur në Shkup, Maqedonia e Veriut, më 22 nëntor 2023. Në nisje të takimit, Kryeministri Rama u drejtua me një përshëndet...



Forcat Speciale, heronjtë e heshtur të Forcave të Armatosura

Njësia speciale e Forcave të Armatosura nuk vepron vetëm në territorin shqiptar, por edhe në rajon, ajo është konsideruar nga NATO si njësia më elitare e Ushtrisë Shqiptare si dhe një nga njësitë më të mira të operacioneve speciale...

Faqe 44



“Lufta e përjetshme për tokën e shenjtë”

Çdo epokë ka kohën e vet të marrëzisë, sindromë që racën humane e ka shoqëruar qysh në formën e saj primitive, atë të homosapiensit, dhe deri sot në zhvillimin maksimal të kapaciteteve të inteligjencës. Lufta e nisur për mbijetesë dhe e sjellë në ditët tona, si një “grykësi” e pa limit, një oreks që sa vjen dhe shtohet. 11 nëntori 1918...

Faqe 50





KRYEMINISTRI RAMA:
Baza e re detare e NATO-s në Porto
Romano, një tjetër akses i Europës

Kryeministri Edi Rama mori pjesë në takimin e liderëve të pesë vendeve anëtare të NATO-s nga Europa Juglindore, me pjesëmarrjen e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg, mbajtur në Shkup, Maqedonia e Veriut, më 22 nëntor 2023. Në nisje të takimit, Kryeministri Rama u drejtua me një përshëndetje në gjuhën shqipe: “Së pari dëshiroj që në gjuhën shqipe t’u uroj të gjithë shqiptarëve këtu në Maqedoninë e Veriut ditën e bekuar të Alfabetit. Nga ana tjetër, më vjen shumë mirë që sot mbledhemi këtu në këtë moment jo të lehtë për të gjithë, një moment luftërash dhe krizash të rënda, që kanë potencialin të rrezikojnë drejtpërdrejtë edhe anën tonë, një moment kur këtu në rajon të gjithë duhet të fokusohemi tek mbrojtja dhe ruajtja e asaj që kemi arritur, që është jo pak, një paqe e brishtë e përgjithshme, po sidoqoftë një paqe, dhe të vëmë të gjitha forcat për ta bërë këtë paqe përfundimtare dhe të qëndrueshme”, - tha kryeministri.

Baza e re detare e NATO-s në Porto Romano, një tjetër akses i Europës

Pas takimit mes tyre, liderët pjesëmarrës, Kryeministri Edi Rama, Kryeministri i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Presidenti i Republikës së Kroacisë, Kryeministri i Republikës së Malit të Zi dhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg dhanë një konferencë të përbashkët për shtyp. Mes të tjerash Kryeministri shqiptar Edi Rama u shpreh se: “Falënderoj Kryeministrin Kovačevski për ftesën dhe Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s për angazhimin dhe mundësimin e këtij takimi, i cili është i pari i këtij lloji në përfundim të turit të Sekretarit të Përgjithshëm në rajonin tonë dhe dëshiroj të bëj me dije që Sekretari i Përgjithshëm e priti me interes propozimin për të ndërtuar një format të një Samiti të NATO-s me Ballkanin Perëndimor, ku të jenë të pranishëm, jo vetëm vendet anëtare të NATO-s në këtë rajon, por edhe vendet partnere të NATO-s, pra faktikisht vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor që këtu sot nuk janë të pranishme, si edhe pjesa tjetër e vendeve anëtare që janë në kufi me rajonin meqë kanë një

“Ne jemi të bindur që Kosova duhet të ndihmohet që të përshpejtojë integrimin e saj në NATO. Dua ta falënderoj Presidentin e Kroacisë, i cili në mënyrë te përsëritur i ka bërë jehonë këtij opinionin në të gjitha tryezat e NATO-s dhe pa diskutim që unë ndaj me të bindjen absolute që është absurde që Kosova të pengohet në këtë proces, ndërkohë që të gjithë së bashku në NATO jemi jo vetëm të vëmendshëm, por edhe të angazhuar në Kosovë aktualisht”.

interes të drejtpërdrejtë për stabilitetin dhe për progresin demokratik të rajonit.

Nga ana tjetër, dëshiroj të theksoj se jam i keqardhur për faktin që pavarësisht thirrjeve të përsëritura për të shtuar në mënyrë të ndjeshme, jo vetëm vëmendjen, por edhe trupat, të cilat duhet të garantojnë stabilitet dhe paprekshmëri absolute të Kosovës, ka ndodhur një ngjarje tragjike, e cila duhet konsideruar një paralajmërim dhe jo një ngjarje sporadike, e cila duhet me çdo kusht të mos përsëritet. Për këtë arsye theksova edhe sot në takim domosdoshmërinë e rritjes së numër të forcave të NATO-s në Kosovë dhe domosdoshmërinë për të garantuar kufirin mes Kosovës dhe Serbisë, i cili faktikisht është jashtë kontrollit dhe i cili është në shërbim të aktiviteteve ilegale të trafikut të armëve, të trafikut të drogës, të aktiviteteve, të cilat pastaj ngatërrohen siç e dimë të gjithë, edhe me aktivitetin politik, me sfond ultra nationalist që shkakton devijime të rënda, siç ishte devijimi në Banjaskë, ku humbi jetën në krye të detyrës një punonjës i policisë së Republikës së Kosovës dhe ku qartësisht doli në pah rrezikshmëria e lartë për destabilizim dhe përshkallëzim të një konflikti, që siç e tha Sekretari i Përgjithshëm ka vetëm një vend, për t’u trajtuar, në tryezën e dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Europian mes Kosovës dhe Serbisë.

Nga ana tjetër, dëshiroj të theksoj edhe kërkesën që aplikimi i Shqipërisë për të bashkë-financuar me NATO-n bazën e re detare të NATO-s në Porto Romano të procedohet sa më shpejt sepse ne besojmë shumë që çdo gjë që ndodh hap pas hapi, e përforcon vlerën strategjike të një investimi të tillë, jo thjeshtë për Shqipërinë, as thjeshtë për krejt rajonin tonë, por edhe për vetë NATO-n, e cila

do të fitojë një tjetër akses të shpejtë në këtë anë të Europës, për çdo rast dhe për qëllimet strategjike të mbrojtjes së përbashkët.

Edhe njëherë faleminderit i dashur Dimitër, faleminderit i dashur Jens për këtë mundësi që të ndajmë së bashku këto shqetësime, ndërkohë që Shqipëria ka përmbushur me buxhetin e vitit 2024, edhe objektivin e financimit të mbrojtjes me 2 %, siç është shtruar nga tryeza e NATO-s për të gjitha vendet anëtare dhe ne do të vazhdojmë të jemi shumë të angazhuar dhe shumë të përkushtuar për të forcuar kapacitetet tona, për të rritur efikasitetin e forcave tona të armatosura dhe njëkohësisht mbetemi në frontin e vendeve të NATO-s, një anëtar i përgjegjshëm dhe i palëkundur në të gjitha sfidat e përbashkëta.”

Sfidat e reja të së tashmes kërkojnë më shumë unitet dhe vështrim strategjik

Gjatë konferencës së përbashkët për shtyp Kryeministrin Edi Rama iu drejtua pyetja lidhur me situatën në veriun e Kosovës, e cila ka rikthyer edhe një herë çështjen e sigurisë në Ballkanin Perëndimor dhe se çfarë shikon ai si zgjidhje konkrete për këtë, veçanërisht pas atyre që komunikoi gjatë fjalës së tij. Kryeministri Edi Rama theksoi edhe njëherë qëndrimin e tij dhe të qeverisë që ai drejton në raport me “domosdoshmërinë që NATO të jetë më e pranishme në Kosovë dhe posaçërisht e angazhuar me më shumë trupa për të siguruar kufirin mes Serbisë dhe Kosovës, i cili është burim i shumë të këqijave dhe prej të cilit penetrojnë edhe individë, grupe, forca që synojnë të destabilizojnë Kosovën”, - tha z. Rama. “Nga ana tjetër, është e padiskutueshme dhe jo më kot besoj, - tha ai, - se Sekretari i Përgjithshëm e nënvizoi, pavarësisht se nuk është një

instrument i drejtpërdrejtë i NATO-s, por është një instrument i Bashkimit Evropian, që e vetmja rrugë për të trajtuar të gjitha problemet, që duhen zgjidhur drejt paqes përfundimtare mes Serbisë dhe Kosovës, është rruga e dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja. Dhe në këtë pikë, - tha Kryeministri Rama, - besoj që jo vetëm të gjithë jemi dakord, por kemi edhe siç e dëgjuat, një dëshirë, tanimë të përbashkët këtu, që formati i ardhshëm i këtij formati të kësaj natyre të zhvillohet me praninë edhe të vendeve të tjera të BP që nuk janë anëtare të NATO-s, por që me NATO-n kanë marrëveshje të niveleve të ndryshme të partneritetit”.

Z. Rama tha se: “Është jashtëzakonisht e rëndësishme por dhe nuk duhet harruar për asnjë moment se paqja që kemi në këtë rajon është jashtëzakonisht e çmuar edhe pse ka brishtësinë e vet dhe se forcimi i paqes është një objektiv strategjik i të gjithëve dhe duhet të jetë i tillë, patjetër në çdo hap dhe për të gjitha arsyet, aq më tepër sot kur jo shumë larg nesh, po zhvillohen disa luftëra. S’kemi vetëm një luftë në dyert e Evropës, në Ukrainë, por kemi dhe një luftë tjetër në vijimin e konfliktit mes Izraelit dhe Hamasit dhe mos harrojmë që jemi një rajon, jo

vetëm multietnik, por edhe multifetar dhe ndikimet negative të atij konflikti nuk janë të përjashtuara nga rajoni ynë”, - tha ai. “Prandaj këtu, në rajonin tonë, ne të gjithë së bashku duhet të bëjmë gjithçka është e mundur për të mos bërë asnjë hap mbrapa se vijmë nga një e shkuar, jo shumë e largët me shumë gjak, me shumë plagë, me shumë dhembje dhe asnjëherë s’kemi qenë më mirë sesa sot, por natyrisht, nesër duhet të jemi shumë më mirë se sot nëse s’duam që

“Kahja euroatlantike e Kosovës është jashtë çdo lloj diskutimi, ndërsa hezitimet për ta njohur Kosovën nga vende të BE-së, nga vende të NATO-s, janë jehonë e një të shkuare, që është gjithmonë e më pak relevante, në krahasim me të tashmen, që ka sjellë kaq shumë sfida te reja dhe që kërkon shumë më tepër unitet dhe shumë më tepër vështrim strategjik”.

e nesërmja të jetë e djeshmja”, - tha ai. Lidhur me pyetjen meqenëse Shqipëria është një vend anëtar i NATO-s dhe si e tillë a do të kërkojë ajo nga vendet e tjera aleate mbështetjen e rrugëtimit të Kosovës në Aleancën e Atlantikut të Veriut edhe pse Spanja dhe Hungaria duken skeptike, kryeministri Rama tha se: “Ne jemi të bindur që Kosova duhet të ndihmohet që të përshpejtojë integrimin e saj në NATO. Dua ta falënderoj Presidentin e Kroacisë, i cili në mënyrë te përsëritur i ka bërë jehonë këtij opinionin në të gjitha tryezat e NATO-s dhe pa diskutim që unë ndaj me të bindjen absolute që është absurde që Kosova të pengohet në këtë proces, ndërkohë që të gjithë së bashku në NATO jemi jo vetëm të vëmendshëm, por edhe të angazhuar në Kosovë aktualisht”, - tha ai.

Z. Rama theksoi se: “Kahja euroatlantike e Kosovës është jashtë çdo lloj diskutimi, ndërsa hezitimet për ta njohur Kosovën nga vende të BE-së, nga vende të NATO-s, janë jehonë e një të shkuare, që është gjithmonë e më pak relevante, në krahasim me të tashmen, që ka sjellë kaq shumë sfida te reja dhe që kërkon shumë më tepër unitet dhe shumë më tepër vështrim strategjik”, - tha Kryeministri.





Ministri Peleshi: Shqipëria, solidaritet të plotë me popullin e Ukrainës, angazhim maksimal në forcimin e deterencës dhe mbrojtjes së Kosovës

Në kuadër të punimeve të Ministrisë së Mbrojtjes të NATO-s, një vëmendje të veçantë mori Takimi i Këshillit NATO - Ukrainë, i zhvilluar për herë të parë në nivel të ministrave të mbrojtjes, me qëllim afrimin e saj me Aleancën, duke shënuar një kapitull të ri në marrëdhëniet NATO - Ukrainë. Në fjalën e tij, ministri Peleshi rikonfirmoi se Shqipëria do të vazhdojë ndihmën e saj politike, ushtarake dhe humanitare për Ukrainën: “Ne qëndrojmë në solidaritet të plotë me qeverinë dhe popullin e Ukrainës dhe mbështesim aspiratat e tyre për t’u anëtarësuar në NATO”, - u shpreh ministri Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi u takua në Bruksel, me ministrin e Mbrojtjes të Ukrainës, z. Rustem Umierov. Gjatë këtij takimi, z. Peleshi dhe z. Umierov biseduan mbi situatën aktuale në Ukrainë dhe rëndësinë e mbështetjes nga Aleanca, si një element thelbësor në rezistencën

ndaj luftës me Rusinë. Ministri Umierov, shprehu mirënjohjen ndaj vendit tonë dhe falënderoi për mbështetjen e gjithanshme që Shqipëria i ka ofruar Ukrainës, qysh prej fillimit të luftës. Lufta në Ukrainë ishte fokus kryesor i Takimit të Ministrave të Mbrojtjes, të mbledhur në selinë e NATO-s në Bruksel.

Vijimi i mbështetjes së vendeve të Aleancës ndaj Ukrainës, në zbatim të vendimeve të Samitit të Vilnius-it, u diskutua fillimisht në një takim të veçantë të Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes për Ukrainën, që u mbajt në fillim të Takimit formal të Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s, ku morën pjesë mbi 50 vende të ndryshme aleate dhe partnere të NATO-s. Gjatë këtij takimi u theksua nevoja imediate për mbështetjen e Ukrainës me kapacitete ushtarake si: sisteme armatimi, artileri dhe municione të kalibrave të ndryshëm me qëllim mbrojtjen e infrastrukturës kritike të saj, nga

agresioni rus. Gjatë takimit, vendet aleate mbajtën qëndrim të unifikuar për vijimin e kontributeve, si dhe ruajtjen e solidaritetit dhe kohezionit në mbështetje të popullit ukrainas dhe luftës së tij. Gjithashtu, mbështetjet të palëkundur në rrugëtimin e Ukrainës drejt integritetit euroatlantik.

Zhvillimet në Veri të Kosovës patën gjithashtu një rëndësi të madhe në Takimin e Ministrave të Mbrojtjes së vendeve të NATO-s. Si pjesë e këtij takimi, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi shprehu angazhimin e vendit tonë për zbatimin e vendimeve të marra në Samitin e Vilnosit mbi zhvillimin e planeve rajonale dhe strukturën e re të forcave, si dhe theksoi rëndësinë që ka realizimi i të gjithë familjes së planeve të shkujrimit dhe mbrojtjes, për të garantuar Aleancën nga kërcënimet e mundshme. Në zbatim të modelit të ri të forcave të NATO-s, është miratuar struktura e re e Forcave të Armatosura, si dhe do të

kontribuojmë në zbatimin e planeve duke përshtatur praktikat tona dhe vendosur në dispozicion infrastrukturën kritike si ajo e Bazës së Kuçovës, Portin e Porto Romanos dhe ndërtimi i Korridorit VIII.

Sipas ministrit Peleshi, “Shqipëria ka një vullnet politik të qartë dhe do të vijojë të mbështesë me një qasje gjithëpërfshirëse masat për forcimin e deterencës dhe mbrojtjes, duke rritur edhe më tej kontributin në operacione dhe në misione si në Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë, Irak, në Vigjilencën e Përforuar të NATO-s në Bullgari, Rumani dhe në detin Mesdhe”. Duke u fokusuar në situatën mbi Ballkanin Perëndimor, ministri Peleshi gjatë fjalës së tij dënoi me ashpërsi sulmin e sofistikuar terrorist në Veri të Kosovës, si një tentativë për destabilizimin e rajonit. “Për më tepër, - shtoi ai, reagimi i Beogradit duke heroizuar sulmuesit e 24 shtatorit në Banjska si dhe dërgimi i trupave dhe kapaciteteve ushtarake afër kufijve të Kosovës janë ngjarje të papranueshme dhe të dënueshme, prandaj BE-ja veçanërisht duhet të mbajë një qëndrim të prerë ndaj akteve të tilla dhe të shprehet hapur ndaj qeverisë serbe”. Ministri Peleshi theksoi se NATO dhe BE duhet të bëjnë më tepër për Ballkanin. Gjuha dhe mesazhet që përcillen nga i gjithë komuniteti perëndimor duhet të jenë të qarta dhe të balancuara, edhe nën dritën e dinamikave të fundit.

Zoti Peleshi theksoi se vendi ynë mbështet plotësisht mandatin e KFOR-it dhe është i angazhuar intensivisht me aleatët për të parandaluar një përshkallëzim të situatës, duke kontribuar në të njëjtën kohë për lehtësimin e dialogut Prishtinë-Beograd. Gjithsesi, sipas ministrit Peleshi, shikohet si e nevojshme një vendimmarrje politike për të përmirësuar dhe maksimizuar angazhimin e KFOR-it në Kosovë, duke përmirësuar bashkëpunimin me palët kryesore të interesuara. “KFOR duhet të intensifikojë patrullimet përgjatë kufirit Kosovë-Serbi në sinkronizim me Policinë e Kosovës, e cila mbetet reaguesi parë i sigurisë në tërë territorin e Kosovës, si dhe me EULEX-in”, - u shpreh z. Peleshi.

Në vëmendje të Ministerialit të Ministrave të Mbrojtjes të vendeve të NATO-s ishte edhe mbështetja e palëkundur për Ukrainën, në përpjekjet e saj kundër agresionit rus. Aleatët shprehën solidaritetin e tyre me Izraelin, duke dënuar njëzëri sulmet, pengmarrjen dhe vrasjen e civilëve për shkak të sulmeve të Hamasit. Ministri i Mbrojtjes së Kroacisë, z. Mario Banožić,



në emër edhe të ministrave të Mbrojtjes së Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut shprehu qëndrimin e vendeve tona në solidaritet të plotë me Izraelin. Ai dënoi sulmet terroriste dhe vlerësoi të drejtën e vendit për t'u mbrojtur në proporcionalitet kundër këtyre akteve të pajustificueshme të terrorit. Vendet tona do të kenë gjithmonë të njëjtën mbështetje sikundër dhe Aleanca kundrejt akteve të tilla të cilat cenojnë sigurinë euroatlantike.

Gjatë punimeve të këtij takimi, nga disa nga vendet aleate u nënshkrua dhe Letra e Qëllimit, lidhur me iniciativën shumëkombëshe për lehtësimin e kufizimeve ndërkufitare në hapësirën ajrore të vendeve aleate, për aktivitetet ajrore të NATO-s. Të gjitha vendet angazhohen në kuadër të masave për rritjen e operacionalitetit dhe zbatimit të planeve të mbrojtjes për krijimin e lehtësirave procedurale në përdorimin e hapësirës ajrore.



Ministri Peleshi: Rrugëtimi juaj është ai i sakrificës, vetëmohimit, ndaj ne do të investojmë ta mbajmë elitare këtë forcë

Në Repartin e Zall-Herrit u kremtua 25-vjetori i krijimit të Batalionit të Forcave Speciale, pjesë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

Të pranishëm në ceremoni ishin Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, njëherësh Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, si dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral-major Arben Kingji.

Në fjalën e tij, ministri Peleshi vlerësoi arritjet e këtij Batalioni, që sipas tij tashmë është i mirë pajisur me mjete moderne dhe që mbart me vete eksperiencën në operacione ushtarake jo vetëm brenda vendit tonë, por edhe në misionet e NATO-s, BE-së e Kombeve të Bashkuara, jashtë vendit.

Teksa kujtoi një prej heronjve të kësaj force, Feti Voglin, z. Peleshi tha se: “Ky rrugëtim ka pasur shumë dërsë, shumë mund, shumë sakrificë, por në thelb ka qëndruar dashuria juaj për atdheun, dashuria për flamurin, vetëmohimi. Ky është thelbi, që e ka bërë këtë batalion të jetë sot modern, i ndërveprueshëm dhe dinjitoz krahas aleatëve tanë të NATO-s”.

“Stërvitja më e madhe në Ballkan e Forcave Speciale “Strong Balkan 2023”, që do të organizohet në vendin tonë, është tregues i qartë i pjekurisë dhe arritjeve që ky batalion së bashku me kompanitë e tjera të regjimentit kanë arritur në vite. Ne jemi të vendosur që ta mbajmë elitare këtë forcë, të investojmë më tepër, ta bëjmë atë më atraktive, ta rritim në numër, të rritim shpërblimin jo vetëm material, por edhe



atë moral, duke rritur prestigjin e saj”, - theksoi ministri Peleshi.

Duke sjellë në vëmendje situatën e krijuar në rajon e Evropë, ministri i Mbrojtjes u angazhua para efektivëve të Batalionit të Forcave Speciale për shtimin e numrit të këtyre forcave, ashtu sikundër edhe për rritjen e mbështetjes financiare dhe vijimin e modernizimit të FA-së.

Në fjalën e tij, presidenti i RSH-së Bajram Begaj tha se: “Ky batalion ishte përpjekja jonë e parë për t’u bërë aso kohe pjesë e Aleancës më të suksesshme ushtarake në botë dhe rezultoi me sukses”. Më tej ai shtoi: “Roli dhe kontributi i Forcave të Armatosura në ruajtjen e paqes dhe të sigurisë është i një rëndësie të jashtëzakonshme. Prandaj investimi te ju, është investim direkt te siguria e vendit, tek e ardhmja jonë e përbashkët”.



Ministri Peleshi: Shqipëria, kontributore për stabilitetin dhe paqen në rajon, përmes dialogut dhe fqinjësisë së mirë

Shqipëria do të vijojë të kontribuojë për stabilitetin, sigurinë dhe paqen në rajon, të cilat arrihen duke promovuar dialogun politik, fqinjësinë e mirë si dhe adresimin e çështjeve të nxehta dypalëshe ose shumëpalëshe.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në Ministerialin e Mbrojtjes në kuadër të Iniciativës rajonale SHBA - Karta e Adriatikut (A5), që u kryesua nga Maqedonia e Veriut.

Në fokus të diskutimeve ishin çështjet aktuale të sigurisë dhe mbrojtjes së rajonit të Ballkanit dhe më gjerë. Në një sesion të dedikuar iu kushtua një rëndësi e veçantë, angazhimit në kuadër të kësaj iniciative, implementimit të konceptit të rivitalizimit të Kartës së Adriatikut, angazhimit të përbashkët në misionet e NATO-s për ruajtjen e sigurisë dhe mbështetjen e paqes, bashkëpunimit rajonal në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes si dhe kontributit në sigurinë globale.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, gjatë fjalës së tij u shpreh se Shqipëria do të vijojë të kontribuojë për stabilitetin, sigurinë dhe paqen në rajon, të cilat arrihen duke promovuar dialogun politik, fqinjësinë e mirë si dhe adresimin e çështjeve të nxehta dypalëshe ose shumëpalëshe, bazuar dhe në respekt të marrëveshjeve dhe legjislacionit ndërkombëtar, pasi rajoni i Ballkanit Perëndimor



është një faktor kyç gjeostrategjik për NATO-n dhe Bashkimin European.

Duke qenë se kryesimin e A5-ës për vitin 2024 do ta marrë Shqipëria, ministri Peleshi, u garantoj vendeve pjesëmarrëse se Ministria e Mbrojtjes do të jetë tërësisht e angazhuar që të përbushë të gjitha detyrimet ndaj kësaj iniciative, të rrisë vizibilitetin dhe rëndësinë e Kartës së Adriatikut, të promovojë “Politikën e Dyerve të Hapura”, si një nga principet themelore të këtij angazhimi rajonal. Në këtë perspektivë, ministri Peleshi u kërkoi vendeve anëtare të A5-ës të pranojnë kërkesën e Kosovës për t'u anëtarësuar me të drejta të plota në këtë iniciativë.





Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi mori pjesë në përrurimin e Zyrës së Rekrutimit në Elbasan si dhe në Ditën e Hapur të organizuar nga FA-të me këtë rast. Në fjalën e tij, ministri Peleshi falënderoi Ambasadën e SHBA-së dhe Zyrën e Bashkëpunimit, për mbështetjen që ka dhënë në hapjen e këtyre zyrave. Sipas z. Peleshi, deri më tani këto zyra kanë qenë në vende aspak atraktive, por tashmë ato po hapen në qendrat kryesore të qarqeve të vendit, si një mënyrë për t'i dhënë dinjitetin e merituar punës së FA-së.

“Do të ndërtojmë banesa për ushtarakët, që një i ri nga Elbasani, apo nga qytete të tjera që do të vijë me detyrë në Tiranë, të ketë shtëpi. Duam të ndërtojmë rreth 200 apartamente dhe do vazhdojmë më pas deri në plotësimin e nevojave të të gjithë ushtarakëve. Po kompletohet një paketë tjetër sociale, sipas të cilës, çdo ushtarak që shërben në mënyrë patriotike të ketë edhe kushtet e nevojshme, përmend këtu hapjen e një laboratorit mjekësor dhe një qendër dentare”, - u shpreh z. Peleshi. Ministri vuri në dukje se janë 428 vende pune, të cilat janë mundësi për të rinjtë. Po ashtu, sipas

Ministri Peleshi: 428 vende pune, mundësi për të rinjtë që duan të aderojnë në FA

ministrit Peleshi, zyrat e rekrutimit do të jenë qendra edhe për rezervistët, të cilët do të me-

rren kryesisht me emergjencat civile, gjë që do të nisë zbatimin sapo të miratohet ligji.



Përfundon stërvitja multinacionale “Strong Balkan 23”

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji, morën pjesë në ceremoninë e “Ditës së Vizitorëve të shquar”, në kuadër të stërvitjes së koduar “Strong Balkan 23”, me pjesëmarrjen e Forcave Speciale të 9 shteteve të Ballkanit. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, të pranishëm ishin edhe ambasadorë e ambasade ushtarake të vendeve të Ballkanit, komandantë forcash, deputetët e Komisionit për Sigurinë Kombëtare etj.

Në fjalën e tij përshëndetëse, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi u shpreh se stërvitja “Strong Balkan 2023” është një nga stërvitjet më të rëndësishme multinacionale të këtij viti, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për rajonin e Ballkanit. Ministri Peleshi vlerësoi angazhimin dhe përkushtimin e efektivëve të Forcave Speciale, të cilat i cilësoi forca elitë. “Është një materializim i shkëlqyer i vullnetit për të forcuar mbrojtjen multilaterale dhe bashkëpunimin ushtarak mes vendeve për të adresuar sfidat e sigurisë rajonale në mënyrë koherente”, - u shpreh Peleshi.

Sipas Ministrisë të Mbrojtjes: “Sfidat e sigurisë, me të cilat përballemi në këtë botë komplekse, nuk mund të përballohen vetëm. Vetëm së bashku mund të përballojmë sfidat e një mjedisi të paqëndrueshëm. NATO ka hyrë në një epokë të re të mbrojtjes kolektive. Ajo që duhet të bëjmë është të harmonizojmë planet tona kombëtare të mbrojtjes për të përshpejtuar përmbushjen e detyrimeve dhe kërkesave sipas modelit të Aleancës”. Gjatë fjalës së tij ministri Peleshi evidentoi mbështetjen e qeverisë shqiptare për ushtarakët, sa i përket rritjes historike të pagave, por edhe politikave sociale. Ai kërkoi nga vendet pjesëmarrëse që të vijojnë bashkëpunimin e



"Stërvitja "Strong Balkan 2023" është një nga stërvitjet më të rëndësishme multinacionale të këtij viti, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për rajonin e Ballkanit. Ministri Peleshi vlerësoi angazhimin dhe përkushtimin e efektivëve të Forcave Speciale, të cilat i cilësoi forca elitë. "Është një materializim i shkëlqyer i vullnetit për të forcuar mbrojtjen multilaterale dhe bashkëpunimin ushtarak mes vendeve për të adresuar sfidat e sigurisë rajonale në mënyrë koherente".



përbashkët për të zgjidhur problemet me të cilat përballen rajoni. Ndërsa SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji, pasi falënderoi gjithë pjesëmarrësit në këtë stërvitje të përbashkët dhe shumë të rëndësishme, u shpreh ndër të tjera: "Siguria e vendeve të Ballkanit është e rëndësishme dhe e domosdoshme për një Evropë të sigurt. Bashkëpunimi ushtarak dhe stërvitjet si kjo e sotmja shërbejnë që të rrisim ndërveprimin, zhvillojmë kapacitetet dhe mbrojmë vendet tona nga një gamë e gjerë kërcënimesh".

Në vijim, gjeneralmajor Kingji vlerësoi rolin e pazëvendësueshëm të forcave të operacioneve speciale dhe efektin shkurrësues të tyre, duke theksuar af-

tësinë për të realizuar me precizion dhe efektivitet operacione të rrezikut të lartë dhe për të arritur objektiva në nivel operativ dhe strategjik.

Në përfundim të fjalës së tij, gjeneralmajor Kingji falënderoi ministrin Peleshi për mbështetjen e palodhur në interes të organizimit të kësaj stërvitjeje, dhe përfaqësuesit e vendeve pjesëmarrëse për angazhimin dhe kontributin në materializimin e kësaj stërvitje të shkëlqyer. Stërvitja "Strong Balkan 23" është një stërvitje e cila zhvillohet për herë të parë në Shqipëri, ku marrin pjesë Forcat Speciale të vendeve të Ballkanit si, Shqipëria, Bosnje - Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Maqedonia e Veriut,

Mali i Zi, Turqia dhe Rumania. Nga këto shtete vetëm shtatë prej tyre marrin pjesë me trupa speciale dhe elementë të shtabit për forca speciale SOTG, ndërsa Bosnje - Hercegovina merr pjesë vetëm me dy vëzhgues. Ceremonia e "Ditës së Vizitorëve të Shquar", e stërvitjes së koduar "Strong Balkan 23", u përmbyll me një demonstrim klasik të trupave pjesëmarrëse me operacione speciale nga toka dhe ajri, dhe në përfundim të demonstrimit u realizua hedhja me parashutë me përfaqësues nga secili shtet, të shoqëruar me flamujt përkatës të tetë vendeve të Ballkanit, pjesëmarrës në stërvitje.

Ministri Peleshi: Po punojmë me AFA-në të hapim Masterin e ri të Inteligjencës Artificiale

“Siguria kibernetike-sfidë për mbrojtjen dhe sigurinë” ishte tema e Konferencës së organizuar nga Akademia e Forcave të Armatosura dhe Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak. Pjesë e kësaj konference ishte edhe ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi.

Duke sjellë në vëmendje sulmet kibernetike të vitit të kaluar që goditën Shqipërinë, Ministri Peleshi foli edhe për mësimet që shteti dhe institucionet nxorën nga kjo ngjarje.

“Koha tregoi se nuk ka rëndësi nëse je vend i madh apo i vogël, por duhen zhvilluar kapacitetet në këtë domein. Kërcënimin në këtë domein ne e kemi të provuar nga viti i kaluar. Ne jemi nga vendet e para për shërbimet online, krahasuar edhe me vende të zhvilluara se ne në Evropë. 95% e shërbimeve publike janë online. Por kjo sjell me vete rrezikun dhe kërcënimin e sigurisë. Jemi akoma në hapat e parë, ndonëse pas sulmeve të vitit të kaluar kemi bërë një ristrukturim të kapaciteteve kombëtare të sigurisë kibernetike, kemi bërë investime edhe në infrastrukturë teknologjike, kemi bërë dhe në sektorë civilë. Megjithatë sado të investosh në infrastrukturë, nëse nuk plotësohet i gjithë ekosistemi nuk mund të kemi sukses. Krahas investimeve në infrastrukturë duhet të kemi nevojë edhe për kapacitetet njerëzore”, - u shpreh gjatë fjalës së tij në këtë konferencë Ministri i Mbrojtjes.

Z. Peleshi tha se ky është viti i tretë që në Akademinë e FA-së vijon Masteri në Siguri Kibernetike, ndërsa foli për rishikimin e pagave të specialistëve të lartë të teknologjisë së informacionit, për të qenë më konkurrues në treg.

Gjatë fjalës së tij z. Peleshi foli edhe për një risi. Sipas tij po mendohet për zhvillimin edhe në fushën e inteligjencës artificiale. “Edhe në fushën e inteligjencës artificiale nuk kemi pse mendojmë se nuk na ka ardhur radha. Unë inkurajoj stafin që do të punojë në Qendrën e Inovacionit, që të identifikojmë temat tona të kërkimit shkencor, të ngremë grupet e kërkimit shkencor rreth



këtyre temave. Ne po punojmë me Akademinë e FA-së të hapim edhe një Master të ri të Inteligjencës Artificiale”, - theksoi ministri Peleshi. Pjesë e konferencës shkencore ishte edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, komandantë dhe drejtorë të FA-së, përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Akademia e Sigurisë, Universiteti i Tiranës dhe Universiteti “Luarasi”.



SHSHP të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji, vizitë zyrtare në Kosovë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji zhvilloi një vizitë zyrtare në Republikën e Kosovës.

Në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës, gjeneralmajor Arben Kingji u prit nga ministri i Mbrojtjes i RSK, z. Ejup Maqedonci dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari.

Në takimin e përbashkët me dy autoritetet e larta, gjeneralmajor Arben Kingji vlerësoi me nota maksimale bashkëpunimin e deritanishëm midis Forcave tona të Armatosura dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke konfirmuar gatishmërinë dhe vendosmërinë për ta çuar përpara këtë bashkëpunim me qëllim ngritjen dhe zhvillimin e aftësive operacionale të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Nga ana e tij, Ministri Maqedonci falënderoi gjeneral Kingjin, dhe theksoi rëndësinë e mbështetjes së Ministrisë së Mbrojtjes të RSK dhe FARSH-së për procesin e transformimit dhe rritjes së kapaciteteve operacionale të FSK-së, si dhe për mbështetjen e dhënë në proceset e integritimit në nismat rajonale dhe më gjerë. Më tej gjatë takimit bashkëbiseduesit vunë theksin në rëndësinë e rritjes së bashkëpunimit ushtarak e fokusuar kryesisht në stërvitje, trajnim, arsimim dhe logjistikë, si dhe u ndalën dhe diskutuan edhe mbi zhvillimet e situatës së sigurisë në Kosovë.

Më pas SHSHPFA u prit në një takim të veçantë nga Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Özkan Ulutas, ku fokus i bisedimeve ishte kryesisht situata e sigurisë në Kosovë.

SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji gjatë takimit adresoi një falënderim të veçantë për kontributin e KFOR-it në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë, si dhe u shpreh se edhe Shqipëria po ndjek me interes të veçantë zhvillimet e aktualitetit të situatës në veri të Kosovës, duke dënuar aktin terrorist të 24 Shtatorit, në Banjskë, si dhe personat përgjegjës pas këtij sulmi. "Shqipëria mbështet dialogun mes Prishtinës dhe Beogradit, në funksion të vetë stabilitetit dhe integritetit të Kosovës si dhe integritetit të saj në organizmat ndërkombëtare, po ashtu dhe në funksion të vetë paqes dhe sigurisë në rajon. Në këtë aspekt, vlerësojmë dhe mbështesim rolin e KFOR-it dhe jemi të angazhuar të



rrisim kontributin tonë në këtë mision", - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Arben Kingji.

Gjeneral Ulutas, falënderoi kontributin e FARSH-së në misionin e KFOR-it, dhe vlerësoi profesionalizmin dhe disiplinën e lartë të kontingjenteve tona. Gjatë fjalës së tij gjeneral Ulutas u ndal dhe në situatën në veri, duke e siguruar SHSHPFA gjeneralmajor Arben Kingjin për vendosmërinë e KFOR-it për të përmbushur me përpikëri rolin dhe misionin tij në ruajtjen e paqes dhe garantimin e lirisë së lëvizjes për të gjithë shtetasit, në koordinim me institucionet e Sigurisë në Kosovë.





Gjeneralmajor Arben Kingji merr pjesë në Konferencën e 11-të të Iniciativës së Bashkëpunimit në Fushën e Mbrojtjes (DECI)

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji mori pjesë në Konferencën e 11-të të Iniciativës së Bashkëpunimit në Fushën e Mbrojtjes (DECI), në Zagreb, Kroaci, e cila kryesohet nga Italia dhe ka në përbërje të saj Shqipërinë, Austrinë, Kroacinë, Hungarinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Përveç përfaqësuesve të vendeve anëtare, në nivel Shefash Shtabi, në këtë konferencë morën pjesë gjithashtu komandanti i Forcës së Bashkuar të NATO-s në Itali, admiral Munsch, komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Ristuccia, komandanti i EUFOR-it, gjeneralmajor Hambermayer si dhe drejtori i RACVIAC. Në këtë konferencë u diskutuan një sërë çështjesh që përfshijnë stabilitetin dhe sigurinë rajonale, zhvillimin e kapaciteteve, trajnimeve dhe mundësive për bashkëpunimin, si dhe përfshirja e iniciativës DECI në organizata ndërkombëtare.

SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji, në fjalën e tij, pasi falënderoi homologun kroat për organizimin e kësaj konference, theksoi rolin dhe rëndësinë e kësaj iniciative për zhvillimin e bashkëpunimit rajonal.

Më tej, gjatë fjalës së tij, gjeneralmajor Kingji u ndal në përkeqësimin e situatës së sigurisë si rezultat i luftës në Ukrainë dhe shtrirjen e efektit negativ të saj në Ballkanin Perëndimor.

Gjithashtu gjeneralmajor Kingji solli në vëmendje përshkallëzimin e situatës në veri të Kosovës, ku dhe dënoi dhunën e përdorur ndaj forcave të KFOR-it, Policisë së Kosovës si dhe aktin terrorist kundër kësaj të fundit, më datë 24 shtator 2023.

“Dialogu i mbështetur nga Bashkimi Evropian është zgjidhja më e mirë dhe afatgjatë e kësaj krize dhe në këtë kontekst vlerësoj përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar për mos përshkallëzimin e situatës”, - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Kingji.

Në lidhje me projektet e përbashkëta dhe avancimin e mëtejshëm të bashkëpunimit rajonal, gjeneralmajor Kingji, pasi vlerësoi rolin proaktiv të Italisë si vend kryesues i kësaj iniciative, solli në vëmendje disa nga angazhimet e FARSH-së në struktura shumëkombëshe dhe vullnetin për të rritur prezencën në krahun lindor të NATO-s, si dhe në KFOR dhe EUFOR.

Në përfundim të fjalës së tij, SHSHPFA vuri theksin në rëndësinë që ka integrimi Euro-Atlantik i vendeve aspirantë dhe prezenca e NATO-s dhe BE-së, si elemente kyç për stabilitetin dhe sigurinë në rajon. Pas përfundimit të Konferencës së 11-të të Iniciativës së Bashkëpunimit në Fushën e Mbrojtjes, SHSHPFA, gjeneralmajor



Arben Kingji zhvilloi një takim dypalësh me komandantin e Komandës së Bashkuar të NATO-s, në Napoli, Itali, admiral Stuard Minsch. Gjeneralmajor Kingji, pasi e njohu atë me zhvillimet më të fundit në FARSH, vuri theksin në përmirësimet strukturore, zhvillimin e infrastrukturës, hartimin e planit kombëtar të mbrojtjes dhe harmonizimin e tij me planin rajonal në kuadër të planeve të NATO-s.

Nga ana e tij, admiral Munsch vlerësoi pozitivisht rolin e FARSH-së në strukturat e NATO-s, ambiciet për modernizimin, si dhe rëndësinë e Bazës Ajrore në Kuçovë dhe portin e ri të Porto-Romano, për mbështetjen e Aleancës si dhe bëri me dije se së shpejti do të fillojë plani rajonal i Ballkanit Perëndimor, i cili do të shërbejë në integrimin më të miri të planeve kombëtare të mbrojtjes me planet e NATO-s.



Betohen studentët e rinj të AFA-së

Në Akademinë e Forcave të Armatosura u zhvillua ceremonia e betimit të studentëve të rinj.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, zëvendëskomandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, Bardhyl Nuredinaj, komandantë forcash, drejtorë, si dhe familjarë e të afërm të studentëve.

Në fjalën e tij përshëndetëse, gjeneral brigade Arben Kingj tha: “Betimi ushtarak është një premtim solemn dhe një ngjarje e shënuar në jetën e çdo ushtaraku për t’i qëndruar besnik Atdheut, detyrës dhe ligjit. Mirënjohës dhe krenar për të gjithë ju studentë që zgjidhët të jeni pjesë e Forcave të Armatosura dhe mbi të gjitha është një nder dhe privilegj mbrojtja e interesave më të larta të kombit.

Të vetëdijshëm se të qenit ushtarak nuk e bën dot çdokush, por ai që ka vullnetin, moralin dhe motivacionin për t’i shërbyer popullit dhe atdheut.”

Në fund të ceremonisë studentët bënë betimin e tyre nën flamurin shqiptar.



SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji priti në takim ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar, sh.t. z. Alastair King-Smith

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji priti në një takim të veçantë ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar, sh.t. z. Alastair King-Smith, i cili shoqërohej nga atasheu ushtarak në vendin tonë, nënkolonel Timothy Wight Boycott. Gjeneralmajor Kingji në fjalën e tij vlerësoi bashkëpunimin ushtarak midis dy vendeve, veçanërisht në fushat e trajnimit, arsimit dhe stërvitjes, duke nënvizuar rolin aktiv të Zyrës së Atasheut Ushtarak të Britanisë në Tiranë.

Më tej, gjatë fjalës së tij, gjeneralmajor Kingji adresoi një falënderim dhe vlerësim për kontributin e Mbretërisë së Bashkuar në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, si dhe rolin aktiv në rajon dhe kryesisht në Kosovë, në interes të paqes, stabilitetit dhe inkurajimin e mëtejshëm të rajonit.



Nga ana e tij, ambasadori King-Smith, pasi vlerësoi rolin e Shqipërisë në rajon dhe më gjerë, shprehu angazhimin e Mbretërisë së Bashkuar për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ushtarak mes dy vendeve.





Zëvendësshefi i SHPFA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, në konferencën “Women in Uniform Association”: Të fuqizojmë rolin e femrave në uniformë

Në Tiranë u zhvillua Konferenca “Women in Uniform Association”, në kuadër të fuqizimit të rolit të gruas nën uniformë. Konferenca u zhvillua nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë, me iniciativë të Atasheut Ushtarak Britanik në Tiranë, në kuadër të programit “Women in Uniform Association”. Në konferencë mori pjesë edhe Ambasadori Britanik në Mal të Zi, zoti Dawn McKen dhe znj. Mia Marzouk, zëvendës ambasadore e Britanisë së Madhe në Shqipëri.

Qëllimi i zhvillimit të kësaj konference të rëndësishme për barazinë gjinore në Shqipëri ishte diskutimi mbi fuqizimin e rolit të grave të përkushtuara që punojnë në Forcat e Armatosura dhe Policinë e Shtetit në mënyrë që ato të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Në këtë aktivitet dyditor merren pjesë rreth 250 gra dhe vajza nën uniformë nga strukturat e Policisë së Shtetit, Doganave dhe Forcat e Armatosura shqiptare, si dhe përfaqësues të niveleve të larta drejtuese nga vende të ndryshme të rajonit si: Kosova, Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut, të cilat ndanë eksperiencat e tyre personale dhe treguan rolin që ato kanë patur në fuqizimin e rolit të gruas në institucionet e tyre.

Nga Forcat e Armatosura shqiptare morën pjesë, zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, Gjeneralmajor Manushaqe Shehu, përfaqësues nga Drejtoria e Bashkëpunimit Civilo - Ushtarak në SHPFA, Kapiten Tereza Matraku dhe rreth 50 femra nga komandat e forcave dhe ato mbështetëse.

Objekti i këtij aktiviteti ishte: të ndihmohen gratë në këto struktura të kuptojnë më mirë rolet dhe aftësitë e homologëve të tyre në organizata/struktura të ngjashme si në nivel lokal ashtu edhe në rajon; Të ndihmohen gratë të krijojnë kontakte të reja në këtë fushë të punës; Të ndihmohen gratë për të përmirësuar besimin e tyre dhe për të demonstruar/treguar se çështjet me të cilat përballen janë ndërkombëtare; Për t'u dhënë mundësinë pjesëmarrësve femra të dëgjojnë nga gra më me eksperiencë dhe detyra më të larta, për udhëtimin e tyre në karrierë.



Konferenca u zhvillua në dy panele:

Paneli i Parë: “Sfidat e të qenit grua për mbrojtjen dhe sigurinë, duke përfshirë mënyrën se si të jesh një aleat efektiv”.

Në këtë panel diskutuan gjeneralmajor Manushaqe Shehu, gjeneralmajor Irfete Spahiu, Atasheu Ushtarak britanik, nënkolonel Timothy Wight-Boykot, etj.

Paneli i Dytë: “Sfidat dhe sukseset e të qenit grua në forcat e rendit”. Në këtë panel diskutuan kolonel Florie Hajra, Kristina Jozic, Luljeta Ismalukaj, Vjosana Neziri, etj.

Konferenca u zhvillua në formën pyetje-përgjigje, por duke bërë edhe një hyrje rreth karrierës ushtarake apo civile të secilës pjesëmarrëse.

Në panelin e parë diskutoi edhe gjeneralmajor Manushaqe Shehu. Në fjalën e saj, pasi falënderoi ambasadën britanike për organizimin e kësaj konference dhe të gjitha femrat përfaqësuese të vendeve të rajonit, por edhe të institucioneve të ndryshme për sigurinë dhe mbrojtjen, u ndal te roli i femrave në uniformë

në Forcat e Armatosura, duke vënë theksin se në zbatim të Planit të Veprimit Kombëtar dhe atij të Ministrisë të Mbrojtjes janë bërë hapa të rëndësishëm për rolin dhe rëndësinë që kanë femrat në uniformë dhe për mbrojtjen e dinjitetit të tyre krahas burrave në uniformë.

Në këtë panel gjeneralja dha përvojën e Forcave të Armatosura shqiptare në zbatimin e Barazisë Gjimore, u ndal në Planin Kombëtar të Barazisë Gjimore dhe në Planin e Veprimit të Ministrisë së Mbrojtjes, hartuar në mbështetje të rezolutës 1325 të OKB-së “Gruaja, Paqja dhe Siguria”. Ajo theksoi me forcë se roli i femrës ushtarake është rritur ndjeshëm si në arsimim, trajnim, në promovim në detyra e gradë. Femrat ushtarake sot i gjen në misionet paqeruajtëse jashtë vendit, në përfaqësitë tona në NATO, atashe ushtarake, në kryerjen e detyrave operacionale e mbështetëse brenda vendit, të barabarta me kolegët e tyre burra.

Gjithashtu i njohu pjesëmarrësit në panel edhe me hartimin e dokumentit mjaft të rëndësishëm që lidhet me mbrojtjen e femrave ushtarake ndaj dhunës dhe ngacmimeve në pozicionin e punës, dokument i cili është përgatitur disa vite më parë me asistencën e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri.

Në fjalën e saj përmendi edhe disa shifra që tregojnë rritjen e pjesëmarrjes së femrave në FA. Aktualisht përfaqësimi i femrave ushtarake në FA është 15.07%. Nga këto oficerë femra 20.84%, nënoficerë femra 13.44 %, ushtarë femra 11.37% të numrit të përgjithshëm të femrave ushtarake. Ndërsa numri i punonjësve civil përbëjnë 37.03 % dhe në total numri i femrave ushtarake dhe civile në FA përbëjnë 20.12%. Po kështu ndjeshëm është rritur rekrutimi i femrave për t'u bërë oficerë. Aktualisht në Akademinë e Forcave të Armatosura vetëm në bachelor dhe kursin e përgatitjes së oficerëve kemi 50 femra, nga këto 4 janë nga Kosova.

Në fund Gjenerale Shehu dha mesazhin se të gjitha si femra në uniformë, jo vetëm në nivel kombëtar, por në nivel rajonal dhe global duhet të ngremë fuqishëm zërin që femrat ushtarake të jenë të vlerësuara dhe të meritojnë vendin që u takon.

Secila diskutante në panel, por edhe në pyetjet e komentet e bëra, ndanë me auditorin eksperiencën e tyre personale si femra në uniformë, por edhe punën e bërë nga institucionet dhe vendet që përfaqësonin. Ajo që binte në sy ishte se, disa nga vendet e rajonit, kanë krijuar shoqatat “Për mbrojtjen e femrave në uniformë nga diskriminimi dhe ngacmimet e ndryshme”. Këto shoqata funksionojnë në mënyrë vullnetare pa kosto financiare e drejtohen nga femra me gradë të lartë ushtarake. “Një eksperiencë e tillë mund të aplikohet edhe në Forcat e Armatosura nëse nuk ka pengesë ligjore. Duke u mbështetur në ligjin ligjit nr. 9970, datë, 24.7.2008, “Për barazinë gjimore në shoqëri” dhe gjithë aktet e tjera nënligjore në fuqi si: “Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjimore 2021-2030” dhe “Planin e Veprimit”, miratuar me VKM nr. 400, datë 30.06.202, “Planin e Veprimit për Barazinë Gjimore 2022-2030 në FA”, miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 651, datë 06.05.2022, të përgatitura në zbatim të Rezolutës 1325 të Këshillit të Kombeve të Bashkuara “Mbi Gruan, Paqen dhe Sigurinë”, janë një bazë e shëndoshë për mbështetjen e femrës shqiptare në uniformë



në Forcat e Armatosura, por gjatë punimeve dyditore të kësaj konference diskutantët sollën mjaft përvoja dhe praktika në vendet e institucionet e tyre, për të cilat – shprehet Gjenerale Shehu - një pjesë e tyre mund të merren në konsideratë në të ardhmen nga strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, me qëllim rritjen akoma më shumë të rolit dhe përgjegjësisë femrës ushtarake në jetën ushtarake, që zëri i tyre të jetë më i fuqishëm. Konkretisht, në të gjitha komisionet e karrierës mund të jetë një femër ushtarake sipas gradave që e kërkon ligji. Një gjë e tillë nuk kërkon ndryshim ligji, por vetëm dakordësi dhe përfshirje në urdhrat e Ministrit të Mbrojtjes; Në grupet e ndryshme të punës që ngrihen për çështje të ndryshimit të ligjeve, VKM-ve, që kanë si objekt arsimimin, përparimin në gradë, trajtimin shëndetësor, social, dhënie kredish, etj., të jetë patjetër një femër ushtarake; Emërimin e femrave ushtarake në poste komanduese e drejtuese, sidomos në nivelin operacional e strategjik, ku nuk kemi asnjë femër; Të krijohet shoqata e femrave ushtarake aktive në Forcat e Armatosura, duke marrë përvojën dhe eksperiencën e vendeve të rajonit e më gjerë që kanë shoqata për mbrojtjen e femrave në uniformë nga diskriminimi dhe ngacmimet e ndryshme. Kjo është edhe një kërkesë e Rezolutës 1325 të Këshillit të Kombeve të Bashkuara “Mbi Gruan, Paqen dhe Sigurinë”. Mendoj se këto masa do ta përmirësojnë dhe ngrenë në një nivel më të lartë rolin dhe përgjegjësinë femrës ushtarake në Forcat e Armatosura”, - përfundon zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Manushaqe Shehu.



Gjeneralmajor Manushaqe Shehu, mbi “Gruan, Paqen dhe Sigurinë”



GJENERALMAJOR MANUSHAQE SHEHU
ZV/SHEFI I SHPFA-së

5 vjet nga hartimi i planit të parë të veprimit për barazinë gjinore në kuadrin e rezolutës 1325 të Këshillit të Kombeve të Bashkuara mbi “Gruan, Paqen dhe Sigurinë”

Në zbatim të Rezolutës 1325 të Këshillit të Kombeve të Bashkuara mbi “Gruan, Paqen dhe Sigurinë”, vendi ynë ka bërë përpime të rëndësishme në krijimin e kornizave përkatëse institucionale dhe të politikave për arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave, në përputhje me standardet dhe detyrimet ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare për barazinë gjinore.

Duke qenë një nga personat më aktivë të ndjekjes së problemit të barazisë gjinore në Forcat e Armatosura, pjesëmarrëse në grupin e punës për hartimin e Planit Kombëtar të barazisë gjinore 2018-2020 dhe kryesuese e grupit të punës për hartimin e planit të veprimit të Ministrisë së Mbrojtjes për barazinë gjinore 2022-2030, si dhe pjesëmarrëse në shumë veprimtari të këtij karakteri brenda e jashtë vendit, dëshiroj të kujtoj disa nga momentet e kësaj pune në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të FA-së.

Po mbushen 5 vjet nga hartimi i Planit Kombëtar për zbatimin e rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi “Gruan, Paqen dhe Sigurinë 2018-2020”, miratuar me VKM nr. 524, datë 11.09.2018. Gjithashtu po mbushen 5 vjet nga që Ministria e Mbrojtjes ka hartuar Planin e Parë të Veprimit për Barazinë Gjinore në Forcat e Armatosura 2018-2020. Këto dy dokumente i kanë dhënë një vëmendje dhe dimension të ri çështjes së barazisë gjinore në Forcat e Armatosura, duke mos e lënë si dëshirë të drejtuesve, por duke patur objektiva dhe detyra të veçanta për t’u realizuar. Kjo ka bërë që nga viti në vit pjesëmarrja e femrës ushtarake në vendimmarrje, por edhe në drejtim të rritet. Gjithashtu si rezultat i kësaj politike kemi pjesëmarrje më të gjerë të tyre në stërvitje, trajnim e në misione jashtë vendit, duke e bërë gjithmonë e më shumë si të barabartë me ushtarakët meshkuj, kjo edhe si meritë e vetë femrave në uniformë.

Në drejtim të njohjes së femrave me këto plane veprimi

kombëtare, por edhe të Ministrisë së Mbrojtjes gjatë vitit 2022, por edhe në këtë vit në vijim, janë organizuar shumë takime me femrat ushtarake, sidomos me ato të reparteve të largëta si në Vaun e Dejës, Bunavi, Pashaliman, Poshnjë, Zall-Herr, Forcë Ajrore, Forcë Detare e Komandë Mbështetëse, nga zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe sektori i përkujdesjes në Ministrinë e Mbrojtjes. Femrat ushtarake, por edhe ato civile që punojnë në Forcat e Armatosura, janë një forcë e vlerësuar. Shembujt të femrave që kanë bërë dhe bëjnë karrierë të suksesshme në çdo pozicion që i është dhënë mundësia të kontribuojë në zhvillimin e Forcave të Armatosura ka plot.

Qëllimet e këtyre takimeve

E para, për t’u njohur me punën që bëhet për zbatimin e Rezolutës 1325 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi “Gruan, Paqen dhe Sigurinë”, “Planit të Veprimit të Barazisë Gjinore në FA 2022-2030”, “Politikat dhe procedurat për eliminimin e dhunës, ngacmimit dhe ngacmimit seksual në mjedisin e punës të strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura” dhe dokumente e tjera, dalë për këtë qëllim në shkallë kombëtare dhe nga Ministria e Mbrojtjes.

E dyta, nëpërmjet takimit të lirë me femrat ushtarake, për të diskutuar e ndarë me to mendime e probleme të punës së përditshme me qëllim rritjen e rolit të femrës në realizimin me sukses të detyrave në pozicionet e tyre të punës.

E treta, për të ndarë mendime e probleme që sot shqetësojnë femrat në punën e tyre të përditshme, në mënyrë krejt të lirshme, larg çdo lloj zyrtarizmi.

Sot femrat ushtarake i gjen në fushat e poligonet e stërvitjes, në mbështetjen e furnizimit e reparteve, i gjen pranë anijeve luftarake e pranë mjeteve ajrore (ku tani kemi edhe piloten e parë femër), i gjen në patrullim në detyrat policore, në kryerjen e shërbimit të rojës, në auditorët e Akademisë së Forcave të Armatosura, në Shtabin e Përgjithshëm dhe në shtabet e Komandave të Forcave, e kudo tjetër ku është nevoja dhe ku e kërkon funksioni organik, siç jeni edhe ju në këtë batalion të rëndësishëm të FT-së, duke mos neglizhuar për asnjë çast e moment nga kryerja e detyrave. Ato i gjen, jo vetëm nëntogore, togore, kapitene e majore, por edhe me grada të larta si nënkolonele e kolonele e deri gjeneralmajore. Ato i gjen komandante strukturash të ndryshme ushtarake, pedagoge, me grada shkencore, atashe ushtarake etj.

Duke marrë pjesë në Forumin Ndërkombëtar për “Gratë, Paqen dhe Sigurinë”, i zhvilluar në Prishtinë, “Gratë në Sektorin e Sigurisë: Sfidimi i stereotipeve gjinore në sektorin e sigurisë”, ku unë si zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, mora pjesë, në fjalën time veç të tjerash dhashë përvojën e Forcave të Armatosura shqiptare në zbatimin e Barazisë Gjinore, u ndala në Planin Kombëtar të Barazisë Gjinore dhe në Planin e Veprimit të Ministrisë së Mbrojtjes, hartuar në mbështetje të rezolutës 1325 të OKB-së “Gruaja, Paqja dhe Siguria”. Theksova me forcë se roli



i femrës ushtarake është rritur ndjeshëm si në arsimim, trajnim, në promovim në detyra e gradë. Femrat ushtarake sot i gjen në misionet paqeruajtëse jashtë vendit, në përfaqësitë tona në NATO, atashe ushtarake, në kryerjen e detyrave operacionale e mbështetëse brenda vendit, të barabarta me kolegët e tyre burra. Gjithashtu i njohja pjesëmarrësit në panel edhe me hartimin e dokumentit mjaft të rëndësishëm që lidhet me mbrojtjen e femrave ushtarake ndaj dhunës dhe ngacmimeve në pozicionin e punës, dokument i cili është përgatitur dy vite më parë, me asistencën Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri. Aktualisht, po punohet në Forcat e Armatosura për zbatimin e “Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2022-2030 në FA”, miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr.651, datë 06.05.2022, i cili është në zbatim e përputhje me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 dhe Planit të saj të Veprimit, miratuar me VKM nr. 400, datë 30.06.2021. Në të dyja këto dokumente që janë në zbatim dhe mbështetje të Rezolutës 1325, janë parashikuar një sërë masash, të cilat bëjnë të mundur mbështetjen dhe dhënien e rolit që i takon gruas në jetën ushtarake. Në planin e veprimit janë parashikuar shumë masa, ku mund të theksojmë, Masat për rritjen e përfaqësimit të grave në FA, ku janë parashikuar masa për përmirësimin e akteve ligjore si: Rishikimin e Strategjisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore; Rishikimin e udhëzimit për politikën dhe procedurat e rekrutimit të kandidatëve për oficerë, nënoficerë, ushtarë profesionist, ku femrat të kenë përqindjen e tyre; Marrje eksperience në vendet e NATO-s; Organizimi i takimeve, seminareve dhe workshopëve për njohjen e akteve ligjore e nënligjore të barazisë gjinore.

Fuqizimi dhe rritja e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në vendimmarrje dhe promovimi i tyre në detyra komanduese: Promovimi i ushtarakeve femra në pozicione komanduese në të gjitha nivelet. Aktualisht nuk kemi një ushtarake komandante batalioni a njësie; Evidentim dhe promovim i liderëve të ardhshme në nivel hierarkie; Promovim të femrave në pozicione pedagogu në AFA dhe instruktor në ANO; Përfaqësimi i femrave në komisionet e karrierës; Rishikim i strukturave të misionëve për vendosjen pranë komandantëve të këshilltareve gjinore; Rishikim i TOP-it për vendosjen e funksionit të specialistit të barazisë gjinore në rang force; Rritja e përfaqësimit të femrave në shtabet e NATO-s dhe në misionet jashtë vendit; Përparsi në dhënien e fletëve të kampit e të medaljeve; Përparsi në dhënien e kredive për strehim; Mundësi në përmirësimin e uniformës ushtarake të femrave; Vizita mjekësore, mamografi falas; Po kështu në Planin e veprimit ka një sërë masash për propagandimin e rolit të femrave në FA në

median e shkruar dhe vizive.

Si është sot gjendja e femrave në FA?

Aktualisht përfaqësimi i femrave ushtarake në FA, është 881, të cilat përbëjnë 15.07% të numrit të përgjithshëm të personelit ushtarak.

- Oficerë femra 358, të cilat përbëjnë 20.84%
- Nënoficerë femra 352, të cilat përbëjnë 13.44 %
- Ushtarë femra 171, të cilat përbëjnë 11.37.68%
- Punonjëse civile femra 647, të cilat përbëjnë 37.03 %
- Numri i femrave ushtarake dhe civile në FA 1528, të cilat përbëjnë 20.12%

Duke iu referuar këtyre shifrave dhe duke i krahasuar me vitin 2018, ku femrat ushtarake përbënin 13.1% të gjithë personelit ushtarak, në këtë periudhë femrat ushtarake përbëjnë 15.07% mund të themi se nga viti në vit femrës ushtarake i është dhënë vendi që meriton në hierarkinë ushtarake.

Miratimi nga Ministri i Mbrojtjes, në vitin 2019, të dokumentit “Politikat dhe procedurat për eliminimin e dhunës, ngacmimit dhe ngacmimit seksual në mjedisin e punës të strukturave të Ministrisë Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura”, është një mbrojtje akoma më e fuqishme institucionale që i bëhet femrës në përgjithësi.

Femrat ushtarake janë pjesëmarrëse në një sërë veprimtarish për barazinë gjinore, zhvilluar në vendin tonë nga ambasada holandeze, britanike, nga UNDP, MSHMS, Shoqatat e grave, përfaqësues nga “Women” etj., si dhe pjesëmarrëse në trajnime të ndryshme jashtë vendit ofruar nga NATO, duke i bërë ato më të ndërgjegjshme për rolin e tyre në Forcat e Armatosura.

Çfarë kërkohet nga vetë ne si femra?

- Rritja e ndërgjegjësisë tonë që vlejme shumë më tepër
- Rritja e kualifikimit dhe vetëzhvillimit
- Njohja e gjuhës së huaj
- Rritja e aftësive fizike
- Rritja e pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme të barazisë gjinore
- Rritja e kërkesës ndaj eprorëve, kushdo qofshin për zbatimin në praktikë të Planit të Veprimit të miratuar
- Mosnënshtrimi ndaj askujt dhe për asgjë

Përvoja e fituar në vite në rritjen e përfaqësimit gjinor nga nënshkrimi i Planit të Veprimit Kombëtar dhe të Ministrisë së Mbrojtjes në vitin 2018 e deri tani, mund të konsiderohet histori suksesi dhe vlerë e shtuar për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura.

Puna jonë të ardhmen le të synojë zbatimin e planit të veprimit të miratuar nga Ministri i Mbrojtjes për Barazinë Gjinore 2022-2030 në Forcat e Armatosura.

Forca Detare shqiptare, pjesë e stërvitjes “Neptune Strike 23”

Forca Detare shqiptare, pjesë e stërvitjes “Neptune Strike 23”, mes 20 vendeve aleate të NATO-s.

Anija “Oriku” dhe ekuipazhi i saj ndërvepruan në detin tonë territorial me aeroplanmbajtësen spanjolle “Juan Carlos” dhe fregatën “Numancia”.

Pjesë e stërvitjes ishin dhe 3 helikopterë dhe 2 avionë, të cilët mbështesnin nga ajri operacionet speciale të trupave në det dhe ishullin e Sazanit.

“Neptune Strike 23”, ka për qëllim zbatimin e ligjshmërisë në det dhe koordinimin e veprimeve gjatë kryerjes së operacioneve të përbashkëta midis vendeve të NATO-s.



Anija “Butrinti” me mision në detin Egje shpëton 34 emigrantë

Anija “P - 134 Butrinti”, pjesë e misionit “Sea Guardian” në detin Egje, gjatë lundrimit konstatoi një gomone me 34 emigrantë, në mes tyre 10 gra dhe 1 fëmijë. Emigrantët ishin nga Jemeni, Sudani dhe Siria.

Anija Butrinti ishte e para në vendngjarje që zbuloi mjetin e paligjshëm dhe më pas komunikoi me Rojën Bregdetare greke dhe turke, të cilat iu përgjigjën thirrjes operative. Roja Bregdetare turke ka marrë në bord mjetin tip gomone dhe personat që ndodheshin në të për të ndjekur procedurat e mëtejshme.



Anija P-134 “Butrinti” zhvilloi stërvitje të përbashkët me anijen flamurtare gjermane “Frankfurt A1412”

Anija P-134 “Butrinti”, pjesë e misionit të NATO-s në detin Egje, zhvilloi një stërvitje të përbashkët me anijen flamurtare Gjermane “Frankfurt A1412”, në ujërat ndërkombëtare.

Gjatë stërvitjes, komandanti i Grupit Detar të aktivitetit të NATO-s në detin Egje zhvilloi një vizitë në bordin e anijes P-134, gjatë së cilës u diskutua mbi udhëzimet në lidhje me ecurinë e misionit, fluksin e emigrantëve në zonën tonë të përgjegjësisë, taktikat e përdorimit të emigrantëve për kalimin e kufirit, monitorimin e rajonit dhe raportimin te anija flamurtare.

Gjatë stërvitjes u zhvilluan disa seriale që lidhen me procedurat e komunikimit, furnizimit në det, operacionet e ndalimit detar, sipas standardeve të manualeve të NATO-s.

Bashkëpunimi koordinues me aleatët është një kontribut i vyer për sigurinë detare të Aleancës. Në një periudhë të shkurtër kohore, për 3 muaj pjesëmarrje



në mision, anija “Butrinti” iu ka ardhur në ndihmë një numri të lartë emigrantësh, të cilët ndodheshin në rrezik për jetën.

Në përfundim të stërvitjes komandanti i anijes Komandë dhe Task Forcës shprehën falënderimet e tyre për zhvillimin me sukses të stërvitjes dhe profesionalizmit të treguar duke iu uruar një mision të mbarë, në detin Egje kontingjentit II.

Përmbillet me sukses stërvitja më e madhe e Forcës Detare, “Flotex 2023”

Stërvitja Flotex është stërvitja vjetore kryesore e Forcës Detare, e cila shërben për vlerësimin dhe certifikimin e aftësive dhe kapaciteteve të Flotiljes Detare në realizimin e misionit dhe detyrave të saj themelore.

E veçantë në stërvitjen e këtij viti ishte realizimi i qitjeve detare me armatimin e anijeve, bazuar në skenarë të supozuar.

Qëllimi i stërvitjes është rritja e ndërveprueshmërisë midis mjeteve detare dhe Grupit të Bordingut të Flotiljes Detare, si dhe testimi i procedurave të zbatimit të ligjshmërisë detare për operacionet e Ndalimit Detar dhe Kërkim-Shpëtimit (SAR).

Stërvitja u ndoq nga afër dhe nga komandanti i Forcës Detare kundëradmiral Adnand Agastra, i cili në përfundim të

stërvitjes përshëndeti pjesëmarrësit për realizimin me sukses të stërvitjes si dhe përmbylljen e një sezoni turistik shumë të suksesshëm.



Starton “Strong Balkan 23”, me pjesëmarrjen e forcave speciale të tetë vendeve të Ballkanit

Në Forcën Tokësore u zhvillua ceremonia e fillimit të stërvitjes kryesore “Strong Balkan 23”, që zhvillohet në kuadër të marrëveshjes së 9 (nëntë) Shefave të Shtabeve të Përgjithshëm të vendeve të Ballkanit (CHODs), për të zhvilluar çdo vit një stërvitje të përbashkët në nivelin e forcave speciale. Kjo stërvitje do të zhvillohet me pjesëmarrjen e 8 vendeve ballkanike.

Në këtë ceremoni ishte i pranishëm komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia dhe përfaqësues nga Shtabi i Përgjithshëm i FARSH.

Ceremoninë e hapi komandanti i Regjimentit të Operacioneve Speciale, nënkolonel Ajet Jata, i cili theksoi se: “Sfidat e kërcënimeve globale ashtu në mjedisin ku ne jetojmë kërkojnë reagim të shpejtë, përgatitje dhe qasje shumë dimensionale për të parandaluar këto rreziqe dhe për të rritur sigurinë ndaj vendeve tona. Kjo stërvitje do të shërbejë si urë lidhëse midis ushtrive tona. Dua të inkurajoj të gjithë pjesëmarrësit që të përfitojnë sa më shumë nga kjo stërvitje”. Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia pasi përshëndeti efektivat pjesëmarrës në këtë stërvitje u shpreh se stërvitja e përbashkët “Strong Balkan - 23”, është një stërvitje e përvitshme e iniciuar nga Shefat e Shtabit të 9 vendeve të Ballkanit e mbështetur nga Forca Tokësore në bashkëpunim të ngushtë me Regjimentin e Operacioneve Speciale. Kjo është një dëshmi e fuqisë sonë, me besimin se forca jonë mbështetet jo vetëm në kapacitetet tona por gjithashtu në përpjekjet tona të përbashkëta. Unë besoj se eksperiencia dhe kontributi i ofruar nga secili shtet do të jenë vlerë e shtuar duke siguruar një ekspertizë profesionale të pakrahasueshme”.

Kjo stërvitje e përvitshme ka si qëllim kryesor: Forcimin e bashkëpunimit shumëpalësh ushtarak midis vendeve të Ballkanit në nivel të forcave speciale për të përballuar së bashku sfidat komplekse që paraqet sot mjedisi i sigurisë.

Disa nga objektivat për t'u përmbushur janë: Rritja e bashkëpunimit rajonal nëpërmjet kontributeve të përbashkëta midis forcave speciale; Ngritja e nivelit profesional, aftësimi taktik, operacional e strategjik i tyre për të përballuar sfidat asimetrike e hibride që po ndeshen sot në mjedisin e sigurisë; Shkëmbim eksperiencie në spektrin e operacioneve speciale etj.

Kjo stërvitje do të zhvillohet në dy faza, ku faza e parë do të zhvillohet në rajonin e Zall-Herrit me planëzim të stërvitje kolektive të përbashkët të grupeve speciale, kurse faza e dytë do të zhvillohet në rajonin e Bizës, ku do të vijojë me qitjet speciale e me snajper.



Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, pjesë e takimit ushtarak dypalësh me Gardën Kombëtare të New Jersey-it, SHBA

New Jersey, SHBA, ishte vendi pritës i ekipit të Komandës Forcës Tokësore, i kryesuar nga komandanti i kësaj force, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, i cili mori pjesë në aktivitetin “LIBG FY24 Planning Workshop (ALBODCCE)”. Ky aktivitet u zhvillua në bazë të zbatimit të Planit të Bashkëpunimit Dypalësh Ushtarak me Gardën Kombëtare të New Jersey-it, për vitin 2023.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte zhvillimi i bisedimeve me përfaqësues të Gardës Kombëtare të New Jersey-it për të identifikuar dhe planëzuar aktivitetet kryesore të bashkëpunimit për vitin 2024 si dhe draft-aktivitetet për vitin 2025-2027 me qëllim arritjen e objektivit kryesor të certifikimit GBKL, për të qenë i gatshëm që prej 2027 (FOC) të disloketohet në operacionet ushtarake në kuadër të NATO-s apo marrëveshjeve bilaterale me palën amerikane.

Aktiviteti ishte planëzuar dhe organizuar në një afat kohor prej 5 ditësh, ku ishin gërshtuar mbledhjet e punës, takimet njohëse mbi trajnimet që ofron garda kombëtare e New Jersey-it, takime pune të komandantit të FT-së.

Mbledhja e punës drejtohej nga drejtori i programit të partneritetit (State Partnership Program/SPP), nënkolonel Kevin Murphy dhe ishte organizuar dhe koordinuar me pjesëmarrje të të gjithë ekspertëve që garda mund të ofrojë me qëllim identifikimin dhe vendosjen e pikave të kontaktit për fushat e mundshme, trajnimin dhe bashkëpunimin në interes të GBLK. Në këtë mbledhje midis dy ekipeve u diskutuan në nivel ekspertësh të gjithë elementet që shërbejnë për operacionalitetin e GBLK.

Gjithashtu ekipi shqiptar vizitoi bazën ajrore të Gardës së New Jersey-it, në Atlantic City, ku u pritën nga komandanti i kësaj baze, gjeneral brigade Lisa J. Hou dhe u njohën me misionin dhe angazhimet e saj në kontrollin ajror nga toka, qendrën e simulimit etj. Aty u diskutua dhe për pajisjet EOD që FT-ja do të kompletohet në vijimësi, duke përfunduar me demon-



strimet e ndryshme për të evidentuar mundësitë për trajnime të përbashkëta në të ardhmen. Në vazhdim, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia u prit në një takim të veçantë nga gjeneral brigade Lisa J. Hou, ku u diskutua ecuria e deritanishme dhe rrugët që do të ndiqen për rritjen e bashkëpunimit midis dy vendeve në fushën e mbrojtjes dhe

modernizimit të Forcave të Armatosura shqiptare. Realizimi i këtij takimi me ekspertë të fushave të GKNJ (Gardës Kombëtare të New Jersey-it) mundësoi krijimin e një pamjeje më të qartë të detyrave që dalin për krijimin e një plani sa më eficient për vitet në vijim me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve operacionale të GBLK.



Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia merr pjesë në Forumin e 9-të të Valencias

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia mori pjesë në Forumin e 9-të të Komandantëve të Forcave Tokësore Evropiane që u zhvillua në Valencia, Spanjë, ku morën pjesë 30 delegacione nga komandat e forcave tokësore të Europës.

Në këtë forum vëmendja kryesore u përqendrua në analizimin e përdorimit të forcave tokësore për përballimin e kërcënimeve 360 gradë, mënyrën e trajtimit të sfidave të përbashkëta me të cilat përballemi sot, mësimet e nxjerra nga lufta në Ukrainë, rolin e forcave tokësore dhe përdorimin e teknologjive të reja në zhvillimin e veprimeve luftarake.

Ky forum u zhvillua në dy sesione, ku në sesionin e parë u diskutua për luftën e tanishme tokësore, ku teknologjitë e reja kanë “një ndikim të madh” në organizimin e një-sive, doktrinën taktike dhe përzgjedhjen e personelit. “Teknologjia po ofron armë të reja dhe mund të përfaqësojë një pikë kthese, duke i bërë të vjetruara jo vetëm disa nga armët tona, por edhe mënyrën se si luftojmë dhe ndoshta mënyrën se si organizohemi për luftim”, - u theksua nga ligjëruesit në këtë forum.



Sfidë kryesore, u theksua aty, është ndryshimi i vetë mentalitetit, i cili kërkon një përshtatje të thellë në një mjedis operativ shumë më kompleks siç janë operacionet multi-domain.

Në sesionin e dytë diskutuan përdorimin e forcave tokësore në mjedisin operativ të tanishëm dhe të ardhshëm. Kështu, ata vlerësuan se cili mund të jetë kontributi i forcave tokësore dhe si do të jenë në gjendje të luftojnë në një mjedis të Operacioneve Multi-Domain (MDO). Këto do të përfaqësojnë aspekte të tilla si komandim -

kontrolli, integrimi i komponentëve të ndryshëm dhe si të përfitojnë nga teknologjitë e reja në zhvillim për t'u marrë me këtë koncept të, ri apo si të sinkronizohen me organizmat jo ushtarake.

Në përfundim u vendos që aplikimi i teknologjive në projektimin e forcave tokësore të së ardhmes do të rishikohet.

Ky panel do të kërkojë të marrë një qasje gjithëpërfshirëse ndaj pasojave që do të kenë aplikimet e teknologjive të kundërshtarit mbi të ardhmen e forcave tokësore evropiane.

Trupat shqiptare, pjesë e “Baltic Warrior”

Trupat shqiptarë në grup-batalionin e NATO-s në Letoni morën pjesë në garën e përvitshme “Baltic Warrior” në Camp Adazi përkrah 200 kolegëve të tyre, duke testuar gjendjen fizike dhe atë psikologjike.

Gara aspak e lehtë përmbante 17 km marshim i ngarkuar me pajime, 1 km transport në krah i mjetit lundrues, 13 km vozitje me kanoe dhe në fund 1 km vrap deri në finish.



Regjimenti i Këmbëorisë së Veriut, struktura e re e FA-së

Në kuadër të ndryshimeve strukturore të Forcave të Armatosura, u zhvillua në Vaun e Dejës, ceremonia e krijimit të Regjimentit të Këmbëorisë së Veriut, pjesë e Forcës Tokësore, si dhe emërimi i komandantit të këtij regjimenti, nënkolonel Ali Mali.

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, drejtorë drejtorish në SHP, komandantë të reparteve të varësisë të Forcës Tokësore, etj.

Në përshëndetjen e tij, gjeneralmajor Arben Kingji, duke e cilësuar krijimin e Regjimentit të Këmbëorisë së Veriut ditë të shënuar në historinë e kësaj njësie, si një nga strukturat më të reja që i shtohen FARSH-së, e cila do të bëjë të mundur rritjen e mëtejshme të kapaciteteve ushtarake në zonën e veriut të vendit, duke gjeneruar më shumë forca, mjete dhe mbështetje operationale, u shpreh ndër të tjera: “Në vijim të fazës së implementimit të strukturës së re të Forcave të Armatosura, sot, formësohet një njësi e re e Forcës Tokësore, Regjimenti i Këmbëorisë së Veriut, i cili përbëhet nga tri batalione, i Vaut të Dejës, Kukësit dhe Burrelit. Projektet e modernizimit dhe rikonceptualizimi i përdorimit të forcave në mënyrë sa më efektive dhe të përqendruar në drejtim e organizim, i hapi rrugë ndryshimeve të reja në strukturë. Këto ndryshime strukturore janë produkt i qasjeve të reja të mjedisit rajonal dhe global të sigurisë, i dokumenteve strategjike dhe vendimeve më të fundit të Aleancës për një mbrojtje moderne, që përfshin të gjithë spektrin e operationeve në kohë paqe, krize dhe lufte...”, - u shpreh gjeneralmajor Kingji.

Më tej, gjatë fjalës së tij gjeneralmajor Arben Kingji solli në vëmendje se procesi i transformimit dhe zhvillimit të Forcave të Armatosura do të mundësojë arritjen e niveleve më të larta të operacionalitetit dhe ndërveprueshmërisë: “Aktualisht janë duke u zhvilluar projekte ambicioze në drejtim të modernizimit të Forcës Tokësore, Detare dhe Ajrore, të cilat do të rrisin ndjeshëm kapacitetet e forcave



të luftimit dhe atyre mbështetëse. Jam i bindur se të tre regjimentet e reja të Forcës Tokësore që përmenda më lart, do të jenë një histori suksesi në procesin e transformimit të Forcave tona të Armatosura, për shkak se ngrihen mbi themele të konsoliduara të batalioneve, tek të cilat kanë spikatur gjithmonë profesionalizmi dhe përkushtimi për përmbytjen me sukses

të detyrave...”, - u shpreh gjeneralmajor Arben Kingji. Në përfundim të fjalës së tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji u shpreh besimplotë se Regjimenti i Këmbëorisë së Veriut do të përmbytë me sukses detyrat e ngarkuara, duke lartësuar dhe më tej emrin dhe arritjet e Batalionit të Parë të Këmbëorisë.



Panair 2023: AFA, mundësi punësimi dhe karrierë e sigurt

U zhvillua në ambientet e Piramidës në Tiranë, panairi i edukimit, trajnimit dhe punësimit.

Interesi i të rinjve për t'u njohur me mundësitë që ofrohen nga universitetet, bizneset, për arsimimin personal dhe profesional, për të siguruar të ardhmen e tyre.

Edhe Forcat e Armatosura patën përfaqësitë e tyre në këtë panair, për të treguar se dyert e këtij institucioni janë të hapura për të gjithë ata të rinj dhe të reja që duan të kenë një të ardhme të sigurt.

Akademia e Forcave të Armatosura shpallosi alternativën e saj, si mundësi e shkëlqyer studimi për të rinjtë e të rejtat që dëshirojnë një karrierë të sigurt dhe të mirë-paguar në FARSH.



Studentët e AFA-së marrin pjesë në “Leadership Seminar”, Livorno, Itali

Dy studentë të ciklit të parë të studimeve Bachelor, dega Navigim dhe Komandim detar, viti III, Fakulteti i mbrojtjes dhe Sigurisë, në Akademinë e Forcave të Armatosura morën pjesë në seminarin “Leadership Seminar” (Naval seminar), në Akademinë “Marina Militare”, Livorno, Itali.

Në këtë seminar u zhvilluan konferenca të ndryshme me temë për Leadership-in detar dhe Detarinë, ku pjesëmarrës ishin vende anëtare të NATO-s, si Polonia, Gjermania, Spanja, Danimarka, Turqia etj., Afrika dhe kadetë të vitit të fundit akademik në shkollën e marinës, Itali.



Studentët e vitit të 2 Bachelor, të degës Navigim dhe Komandim detar në fushën e Mbrojtjes, zhvilluan në praktikë kalimin e pengesave ujore në terren, konkretisht në liqenin e Çakallës. Kjo i shërben studentëve në familjarizimin e tyre në situata të tilla dhe profesionalizimin në profilet e tyre të përgjithshme ushtarake.



Studentët e ciklit të parë Bachelor, viti II Navigim dhe Komandim Detar në Akademinë e Forcave të Armatosura, zhvilluan metodat e (ECDI-s) të lundrimit elektronik në Portin e Durrësit.



Trupat e Policisë Ushtarake, pjesë e stërvitjes “Limani - 23”

Trupat e Policisë Ushtarake demonstruan nivel të lartë përgatitjeje gjatë stërvitjes njëjavore “Limani-23” në Bazën Detare të Pashalimanit. Efektivët praktikuan taktikat dhe teknikat që përdoren në ngritjen e pikave të kontrollit dhe operacionet e patrullimit në zonat urbane, duke testuar kapacitetet e deklaruara me qëllim mbajtjen e gatishmërisë operationale.



Gjeneral brigade Ferdinand Dima në Konferencën “Fuqia e Përbashkët Ajrore dhe Hapësinore”, e mbajtur në Esen, Gjermani

Gjeneral brigade Ferdinand Dima mori pjesë në Konferencën “Fuqia e Përbashkët Ajrore dhe Hapësinore” e mbajtur në Esen, Gjermani. Fokusi i kësaj konference ishte zhvillimi i parandalimit dhe mbrojtjes nëpërmjet fuqisë së përbashkët ajrore.

Konferenca u hap me fjalimin e mirëseardhjes nga gjeneral Xhejms Heker, komandant i Forcës Ajrore për Europën dhe Afrikën, komandant i Komandës Ajrore Aleate si dhe drejtori i Qendrës së Kompetencës të Fuqisë së Përbashkët Ajrore i ndjekur nga fjala e admiralit Rob Bauer, kryetar i Komitetit Ushtarak të NATO-s.

Në ditën e parë u diskutua rreth ndryshimeve aktuale të ambientit të sigurisë dhe si besueshmëria, kapacitetet dhe disponueshmëria e fuqisë ajrore dhe hapësinore, mund të ndikojnë në parandalimin dhe mbrojtjen në të gjitha fushat, shërbimet dhe kombet. Më pas u fol për sfidat e zhvillimit të gatishmërisë, disponueshmërisë dhe ngulmimit të fuqisë ajrore dhe hapësinore me qëllim përgatitjen për operacione me intensitet të lartë dhe shumë komplekse.

Dita e dytë u hap me fjalën e gjeneralit James H. Dickinson, komandant i Komandës Hapësinore Amerikane. Më pas u vijua me diskutime në lidhje me zhvillimin në të ardhmen të kapaciteteve të fuqisë ajrore dhe hapësinore në mbështetje të mbrojtjes së përbashkët me fokus mbi bashkëpunimin me teknologjinë dhe industrinë e së



nesërmes. Këtu u theksua rëndësia e logjistikës, kapaciteteve industriale për të furnizuar me armatim, pjesë këmbimi dhe municion si dhe zinxhirin funksional e mbështetës përtej kufijve kombëtare në rast

konflikti. Konferenca u mbyll me një vizitë tek stendat treguese të prodhimeve teknologjike të firmave më të mëdha të botës si “Lockheed Martin”, “Northrop Grumman”, “Boeing”, “Airbus” dhe “DIEHL”.

EOD vazhdon operacionin e radhës në bashkinë Librazhd

Ekipi EOD i Batalionit të Xhenios (bxh) u angazhua në kryerjen e operacionit EOD për heqjen e një predhe luftarake të gjetur në fshatin Dardhë, njësi administrative Hotolisht, bashkia Librazhd. Predha e gjetur është cilësuar si një predhë artilerie shpërthyesë 75 mm, pa markerime.

Municioni u vlerësua i sigurt dhe i lëvizshëm dhe u transportua për magazinim në depon e Batalionit të Xhenios, duke respektuar të gjitha masat teknike të sigurimit.



Ekipi EOD në një tjetër operacion në bashkinë Mat, Dibër

Ekipi EOD i Batalionit të Xhenios u angazhua në kryerjen e operacionit EOD për heqjen e municioneve të rrezikshme, të gjetura në fshatin Selicë, bashkia Mat, Dibër.

Pas kryerjes së rikonicionit në terren është bërë i mundur zbulimi dhe identifikimi i municioneve të rrezikshme të pa shpërthyer. Municionet pasi janë vënë në siguresë (RSP) u transportuan për magazinim në depon e Batalionit të Xhenios, duke respektuar të gjitha masat e sigurimit teknik.



Batalioni i Xhenios përfundon me sukses operacionin e kontrollit të ish-poligoneve të asgjësimit të municioneve

Batalioni i Xhenios me specialistët e tij EOD, realizoi me sukses kontrollin vizual të ish-poligoneve të asgjësimit të municioneve, identifikimin, pastrimin, transportin dhe asgjësimin e municioneve të gjetura në këto poligone.

Gjatë kësaj periudhe u kontrolluan 9 poligone në zonat e Elbasanit, Librazhdit, Burrelit, Pukës, Bizës, Beratit, Skraparit, Tepelenës e Këlcyrës, me një sipërfaqe rreth 215 000 m² dhe u evidentuan rreth 116 elementë municionesh të lëna në terren. Për municionet e gjetura në terren u bë vlerësimi i tyre



për shkallën e rrezikshmërisë, duke bërë asgjësimin në vend ose transportimin e tyre në depot e Batalionit të Xhenios.

Në të gjithë ish-poligonet e asgjësimit të municioneve, pas kontrollit vizual u vendosën tabela sinjalizuese si dhe u bë kufizimi i poligoneve me shirit kufizues, me qëllim orientimin dhe paralajmërimin e komunitetit për rrezikshmërinë që paraqesin këto vende. Operacioni përfundoi me sukses.



Stërvitja “EOD Activity” me ekipin EOD të nëntë shteteve të Ballkanit

Në Batalionin e Xhenios u zhvillua stërvitja “EOD Activity” në kuadër të iniciativës BCHOD (Balkan Chiefs of Defense).

Në këtë aktivitet përveç Shqipërisë morën pjesë dhe ushtarakë nga: Bosnje-Hercegovina, Greqia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Rumania.

Ky aktivitet u zhvillua në mjediset e Batalionit të Xhenios, ku fillimisht të gjithë pjesëmarrësit u pritën nga komandanti Batalionit të Xhenios, kolonel Shkëlzen Mhillaj.

Më tej në ceremoninë e rastit u mbajt dhe një fjalë përshëndetëse nga drejtori i SHP, kolonel Aleksandër Pando.

Komanda Mbështetëse u përfaqësua nga shefi i Shtabit, kolonel Arben Dhuli.

Në këtë aktiviteti u paraqitën 3 prezantime dhe përkatësisht njëra rreth Shqipërisë si vend pritës dhe organizues i aktivitetit BCHOD, një rreth Batalionit të Xhenios dhe i fundit rreth kompanisë EOD.

Më tej u vijua me një paraqitje dhe demonstrim të pajisjeve EOD/IEDD që janë në posedim nga kompania EOD.

Aktiviteti vijoi me vizitën te vendi i trajnimit



(CTA Close Training Area) i kompanisë EOD, ku pjesëmarrësit u njohën me terrenet stërvitore të kompanisë EOD, më tej aktiviteti vazhdoi në poligonin EOD që gjendet në repartin 1060 të FT-së.

Specialistët e kompanisë kishin planëzuar dhe organizuar disa prej incidenteve të shkallës më të lartë të kompleksitetit dhe vështirësisë si: neutralizimi dhe asgjësimi i një pajisjeje të improvizuar eksplozive brenda një makine (VBIED Vehicle Born Improvised Explosive Device).

Gjatë aktivitetit u realizuan dhe 4 incidente të tjera për asgjësimin e municioneve konvencionale me metodën e shmangies së detonimit.

Në nder të pjesëmarrësve, zëvendëskomandanti, Komandant në detyrë i KM priti përfaqësuesit dhe u dhuroi “monedhën” e KM-së.

Zhvillohet stërvitja “Panariti-23”

U zhvillua stërvitja “Panariti-23”, qëllimi i së cilës ishte testimi dhe integrimi i kapaciteteve operacionale të strukturave të Komandës Mbështetëse, Batalionit të Xhenios dhe Batalioni të Furnizimit. Në këtë stërvitje u arrit kompaktësimi i kompanisë së punimeve xheniere si dhe trajnimi i manovratorëve të rinj në përdorim të mjeteve të rënda.

Kjo stërvitje i shërben përmirësimit të infrastrukturës rrugore prej 7 km që lidh fshatrat Panarit - Treskë, në Bashkinë Korçë, i cili i vjen në ndihmë komunitetit të zonës për të mundësuar lidhjen me shkollat dhe qendrat shëndetësore. Gjithashtu, ky segment rrugor lehtëson



detyrën e Forcave të Armatosura për përballimin e Emergjencave Civile.

Forcat xheniere u falënderuan për rezultatin e arritur nga zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, kryetari i Bashkisë Korçë Sotirajq Filo si dhe përfaqësues nga pushteti lokal, prefekti i Korçës, Nertil Jole.



"Yjet e Pashuar të Fekenit"

Një ngjarje e rëndë si pasojë e një orteku dëbore, rreth tri dekada e gjysmë më parë, u mori jetën 11 oficerëve e studentëve të Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve.... Mes tyre, në këtë tragjedi humbën jetën dhe 5 skënderbegas... 6 shkurti i vitit 1981. Kjo ditë do të përkujtohet si ngjarja më dramatike në historikun e shkollës së oficerëve, por edhe si dita e solidaritetit dhe burrërisë heroike që tregoi efektivit i kësaj shkolle, për të shpëtuar jetën e njëri - tjetrit, burrëri që duke iu afruar kufijve të legjendës, u shndërrua vit pas viti në burim të pashtershëm frymëzimi për breza të tërë ushtarakësh.

Po çfarë ndodhi atë 6 shkurt të vitit 1981?

Shkolla e Oficerëve kish dalë në fushimin dimëror. Ai që nuk ka qenë ndonjëherë në ato vende, pra ai që malin impozant të Dajtit, e sheh si një dekor piktoresk e tërheqës në sfondin e kryeqytetit, as që mund ta përfytyrojë se ç' ashpërsi, ç' ftohtësi e ç' thyerje e konfiguracionit të terrenit e pret atje. Pas butësisë së Dajtit, fshihet një botë tjetër, aty nis shtrirja e pafund e kodrave e maleve që palë - palë shkojnë drejt veriut. E ja, këtë mal me pjerrësi herë - herë 75°, ndërsa frynte një erë e marrë me shpejtësi 40m/s, kish zgjedhur për të ngjitur nënreparti që udhëhiqej nga pedagogu Mark Mici. Papritur një heshkje kërcënuese, e cila sikur paralajmëronte diçka të keqe pllakosi anë e mbanë. Nuk vonoi shumë dhe një masiv i madh dëbore me zhurmë filloi të rrëshqasë poshtë. Pedagog Marku e dinte, se pamje të tilla ishin interesante po t'i shikoje në televizor, se në të vërtetë ajo paraqiste një rrezik të madh për jetën "Orteku!".

Qenë të rinj dhe dikush mendonte për të dashurën, e dikush kish të drejtë të ëndërronte. Por s'qe e thënë, bora pasaka, si çdo gjë, dhe anën tjetër të saj, atë të tmerrshme, atë të papërballueshme, atë vrastaren që mbuloi gjithçka.... U dëgjuan urdhra e komanda të prera. Por dhe pa ato, ata do të ngjiteshin përpjetë malit, pa



ndalur asnjë çast, mjaft të fitonin edhe një sekondë të vetme. Dashuria për shokët u jepte forcë. Në krye udhëhiqnin oficerët, Çlirimi, Dushani, Nikollaqi, Petrit Murzaku, Abaz Çipini, Sali Zhakupi, Muzafer Kambo. Filloi lufta për jetën. Luftonte vëllai për të shpëtuar vëllain. Bora 'vrastare' nuk kurseu askënd, ata mbetën aty, në atë faqe mali, për t'i dhënë emrin e tyre "Dëshmorët e Fekenit".

Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura kanë përkujtuar në një ditë të veçantë komandant Dushan Shametaj, eshtrat e të cilit do të prehen mes qindra të rinjve që dhanë jetën e tyre për lirinë e atdheut.

Në ceremoninë e organizuar për këtë rast, zëvendës shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, në fjalën e saj do të shprehej:

"Nga sot eshtrat e dëshmorit të atdheut, Dushan Shametaj, do të prehen pranë varrezave "Dëshmorët e Kombit", ku prehen edhe gjithë dëshmorët e atdheut, që dhanë jetën për çlirimin e vendit. Në emër edhe të ministrit të Mbrojtjes, zotit Niko Peleshi dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-

së, gjeneralmajor Arben Kingji, ju sjell juve, familjarëve, ngushëllimet më të thella dhe mirënjohjen për aktin sublim të dëshmorit të Atdheut Dushan Shametaj.

Dyzetë e dy vite më parë, në dimrin e acartë, në malin e Meçekut, në një stërvitje dimërore të studentëve të Shkollës së Bashkuar të Oficerëve, më 6 shkurt 1981, në një ditë tragjedi, heroizmi dhe solidariteti ushtarak, dhanë jetën në lulen e rinisë 11 ushtarakë, midis tyre, komandanti i batalionit, Dushan Shametaj, shefi i Planëzimit, Çlirim Pulaj, pedagogu i taktikës, Nikollaq Bero dhe studentët: Aleko Gjoni, Besnik Shehu Bilbil Pashaj, Ilir Gramatikoi, Bujar Ago, Pëllumb Rrapo, Qemal Lika, Nexhip Çoba, të cilët me vendim nr. 2506/2, datë 01.09.1999, të Komisionit Qendror të Statusit "Dëshmor i Atdheut", u shpallën "Dëshmorët e Atdheut". Familjet e të rënëve, prindërit, bashkëshortet, fëmijët, ashtu si edhe familja e komandant Dushanit përjetuan momente tepër të vështira. Bashkëshortes, Donikës iu desh të përballonte me kurajë jetën me dy fëmijët e saj të mitur, Doljanin dhe Elvanën, por duke qenë krenar për sakrificën sublime të bashkëshortit dhe babait të tyre të paharruar,



komandant Dushanit. Komandanti i batalionit 3-vjeçari nga fshati Dorëz i Tepelenës, Dushan Fejzi Shameti, së bashku me oficerët Çlirim Pulaj e Nikollaq Bero dhe plot studentë të tjerë, edhe pse nuk ishin në momentin e rënies së ortekut të parë, shkuan në ndihmë të shokëve të tyre studentë dhe në përpjekje për të shpëtuar jetë, dhanë jetën e tyre nga orteku i dytë, më i forti, më i tmerrshmi dhe më tragjiku.

Kanë kaluar vite e do të kalojnë edhe të tjerë, por 11 “Dëshmorët e Fekenit” do të mbeten të paharruar në memorialin tonë si ushtarakë, në kujtesën tuaj e të çdo familjari. Emri i tyre sot është lartësuar në emra shkollash e rrugësh, skalitur në libra me poezi, proza e poema”.

Në lulishten kryesore të Gamizonit Ushtarak “Skënderbej”, është ngritur Memoriali, ku është vendosur një copë shkëmb nga Mali i Meçekut dhe skalitur 11 emrat e tyre. Ndërsa ish-studenti e bashkëmoshatari i tyre, Agron Zerani, njëri nga të mbijetuarit e kësaj ngjarje, në kujtim të tyre, më 6 shkurt të këtij viti, mbolli 11 selvi pranë liqenit të Farkës që simbolizojnë jetën e

11 dëshmorëve. Ata do të mbeten burim frymëzime për brezat e ardhshëm. Fjalë zemre, malli dhe dhimbjeje do të shprehnin dhe shokë e miq të tyre, ashtu si këto vargje poezie:

Komandant Dushani
Lis me tre kurora
Nuk i dilka xhani
Pa zënë bijt` nga dora.

“Kujtimi i dëshmorit Dushan Shametaj do të ngelet i paharruar në kujtesën Tuaj dhe tonën. Ai tani do të prehet akoma më i qetë përkrah dëshmorëve të tjerë të atdheut. Qoftë i paharruar kujtimi dhe akti heroik i dëshmorit Dushan Shametaj! Lavdi dëshmorëve të Fekenit! Lavdi Dëshmorëve të Atdheut!”, - do të mbyllte fjalën e saj gjeneralmajor Manushaqe Shehu.



BALADA E TË NJËMBËDHJETËVE

(Kujtimet të dëshmorëve skënderbegas që u vranë nga orteku)

AGIM BAJRAMI

Klith` një er` e ftohtë
Në rrëz` të Meçekut
Sikur do t'i zgjojë
Shokët posht` ortekut.

Netëve të gjata
Nën një hën` që qan
Njëmbëdhjet` balada
Shtrirë pran` e pran`.

Njëmbëdhjet` balada
Gatuar me djej
Me zjarre nga vatra
Shkolla "Skënderbej".

Ku u nisët bij
Atë dit` mortore,
Qieilit ngjyrë gri
Me sy prej dëbore.

Flokëshprishur nga era
Pabesi e shtegut
Me këmb` mbi humnera
Dhe grack` e ortekut.

Nën vështrim të malit
Mbështjellë prej murrilanit
Se nuk din` të ndalen
Bijt` e partizanit.

Ballet mbushur yje
Poezi rinie
Dimri nëpër pyje
Shfryn mllëf xhelozie.

Shfryn mllëf xhelozie
Ndaj dhe ngrihka leqe
Ah ju bij lirie
Ç`ju zu or` e keqe.

Në mal të Meçekut
Ç`tmerr ju panë sytë
Nën klithm` të ortekut
Sulmuan stuhitë.

Sulmuan stuhitë
Me kthetra mizore
Feken si s`t`u dhimbs
Nikua që na more.

Kur rrëmbeve Limon
Si se pyete zemrën
Mbi gjoks bashk` me yllin
Kish një vjersh` për nënën.

Po Qemalin bir
Me vështrim si dele
Sa kish ndar` për shokët
Një grusht karamеле.

Karamеле morti
Të verdha si ftua
Në mosh` të mëngjesit
I dhe vdekjen grua.

Krisma ngre kushtrimin
Gjaku skuq mbi tokë
Dyqind kryetrima
Për njëmbëdhjetë shokë.

Jeta sfidon vdekjen
Me sy dashurie
Sa zbulojn` Alekon
Një shok` tjetër bie.

Na iku Bujari
Me shpirt prej poeti
Në sup të Bilbilit
Çast` i mbaram` e gjeti.

Komandant Dushani
Lis me tre kurora
Nuk i dilka xhani
Pa zënë bijt` nga dora.

Si t'i mbroj nga vdekja
Nga bora me gurë
E çfarë bën` më tepër
Vëllezërit Dioskurë?

Nën këng` elegjie
Prehet monopati
Trimi Nexhip Çopa
Që u ngrit prej shtratit.

S`mund të rrinte brenda
E si mund të rrinte?
Kur vdekja tinzare
Shokët radhë i shtrinte.

Ilir Gramatiko
Pëllumbi, Besniku
Vdekjen vun` përpara
Pa dridhje qerpiku.

Mben` të gjith` atje
Me vështrim nga prita
T'i tregojn` mëngjesit
Shtigjet nga vjen drita.

Në mal të Meçekut
Në buz` të humnerës
Njëmbëdhejtë balada
Frymojnë prej pranverës.

Kërcënimi terrorist në një dimension të ri, kohë për reflektim



KOLONEL HYSNI GJERGJI



Të rejat teknologjike të gjendura lehtësisht në treg, po përdoren gjerësisht, profesionalisht dhe lehtësisht nga terroristët e Hamasit në Gaza. Teknologjia bashkëkohore dhe metodat ekskluzive të shërbimeve sekrete, janë në zbatim dhe implementim nga organizatat terroriste.



duke e analizuar terrorizmin në optikën e ngjarjeve të fundit në Gaza, vihet re se ky kërcënim ka marrë një dimension dhe një formë të re në metodë, mjete dhe operacionalitet. Teknologjia smart, IA dhe digjitale e përdorur nga shtete dhe organizata të fuqishme të sigurisë, nuk

është më vetëm privilegj i këtyre shteteve. Të rejat teknologjike të gjendura lehtësisht në treg, po përdoren gjerësisht, profesionalisht dhe lehtësisht nga terroristët e Hamasit në Gaza. Teknologjia bashkëkohore dhe metodat ekskluzive të shërbimeve sekrete, janë në zbatim dhe implementim nga organizatat terroriste. Terrorizmi vazhdon të ekzistojë madje në forma dhe variante të ligjshme, siç janë krahët e armatosur në partitë politike, që në fillim nisin me protesta, duke u transformuar më vonë në takime dhe demonstrata, duke vazhduar në aktivitete të lehta dhune, dhe në fund përfundojnë në veprime intensive luftarake, sabotazhi, vrasje etj.

Lufta po zhvillohet në Tokën e Shenjtë të tre besimeve; është kisha e Varrit të Shenjtë, vendi i vdekjes, kryqëzimit dhe ringjalljes së Jezusit. Si është e mundur që Toka e Shenjtë të kthehet në tokë të përgjakur? Myslimanët në librin e shenjtë, Kuran, thonë: "Vrasja e një civili të pafajshëm është vrasje e gjithë botës. Lagjja Myslimane përmban faltoren e Kupolës së Shkëmbit, si dhe Xhaminë al-Aksa. Disa metra më larg, tempulli i Shkëmbit mban gurin, ku besimtarët besojnë se Muhamedi u ngjiti në qiell. Lagjja hebraike një mbetje e murit në të cilin dikur ishte Tempulli i Shenjtë. Hebrenjtë besojnë se ky ishte guri themelor nga u krijua bota.

Përveç sulmit të 7 tetorit 2023 HAMAS ka qenë përgjegjës për një fushatë të gjerë të bombave kamikazë, nga të cilat kanë gjetur vdekjen qindra vetë, përfshi qytetarë amerikanë dhe të huaj të tjerë. Hezbollah është një tjetër



grup që njihet si Xihadi Islamik, që filloi si degë libaneze e Partisë Dava në vitet 1982-1983, me objektiva të ngrejë një qeveri islamike Shia në Liban dhe të identifikohet me militantët islamikë të Ajatollah Khomeinit. Është në aleancë me Iranin dhe përgjegjëse për vdekjen edhe të shumë amerikanëve. Xihadi Islamik Palestinez (PIJ) ashtu si HAMAS, dhe Hezbollah, që vepron në rajon ka armikun kryesor Izraelin. PIJ-a ka përgjegjësinë për bombën kamikaze më 1996 jashtë qendrës Dizengoff në Tel Aviv, ku u vranë 20 vetë dhe u plagosën 75 të tjerë. Hamas, Hezbollah dhe organizata të tjera që veprojnë në rajon, kanë përdorur fenë myslimane dhe librat e shenjtë për të fituar mbështetës të bindur dhe të devotshëm, si qëllim parësor të kësaj lufte. 7 tetori 2023 risolli në vëmendjen e botës kërcënimin që mendohej sikur ishte minimizuar, apo “mundur” pas fushatave kundër “al qaida-s”, ISIS, etj., por duket qartë se terrorizmi vetëm se ka marrë një drejtim dhe përmasë të re, është perfeksionuar teknologjikisht dhe përshtatur më mirë me situatat gjeopolitike. Trajnimi i organizatave terroriste, po kryhet, po kopjon dhe përthith metodat policore edhe të shërbimeve të inteligjencës, duke krijuar një duel që vazhdon luftën e fshehtë, herë me fitoret e njëres palë dhe herë të palës tjetër.

Në fakt terroristët, sipas librit të shenjtë, janë dy herë terroristë duke përdorur fenë myslimane si arsye, një herë përballë popullsisë civile që vrasin dhe një herë tjetër përballë islamit që e keqpërdorin. “Justifikimi” i dhunës me ideologjitë mbështetëse dhe motivuese, është strategji e vjetër e luftërave të cilat kanë përdorur edhe komunizmin, fashizmin, nazizmin etj. Sipas Senekës: “Feja besohet verbërisht nga injorantët, nuk besohet fare nga

intelektualët, por përdoret plotësisht nga politikanët”.

Lufta moderne e nisur midis terrorizmit dhe inteligjencës i ka perfeksionuar metodat e gjetjes dhe transmetimit të informacionit përmes burimeve njerëzore, kamerave, sensorëve, satelitëve, gjurmuesve, IA dhe gjithçka tjetër që lidhet me digjitalizimin në përgjithësi. Shërbimet e inteligjencës jo vetëm në Izrael, por kudo në botë janë të parët që i përdorin këto teknologji të reja, por nga tjetër këtë e njohin dhe e bëjnë edhe organizatat terroriste. Sistemi i telekomandimit nga distanca ishte epërsi por kishte edhe një dobësi: ai gjithashtu mund të shkatërrohej nga distanca. Hamasi e përdori këtë dobësi duke dërguar dronë për të stakuar internetin në kullat celulare që transmetonin sinjale. Pa internet dhe sinjale celulare, sistemi mbrojtës kibernetik u bë i padobishëm. Dronët e teknologjisë së lartë shkatërruan sistemet dhe sensorët e telekomandimit në distancë të mitralozave që Izraeli kishte instaluar në mur, duke i hequr izraelitëve armën kyçe për të luftuar në frontin tokësor. Teknologjia “cyber” e bëri më të lehtë punën për sulmuesit e Hamasit që të afroreshin dhe të hidhnin në erë pjesë të gardhit kufitar, si dhe ta shpërthenin atë në disa vende me lehtësi, duke lejuar mijëra palestinezë të kalonin nëpër këto boshllëqe.

“Pushtimi” i menjëhershëm i më shumë se 20 qyteteve dhe bazave të ushtrisë izraelite në atë sulm ishte shkelja më e rëndë e mbrojtjes së Izraelit në 50 vjet, duke shkatërruar ndjenjën e sigurisë dhe besimin tek ushtria e kombit. Ushtria më e fortë në Lindjen e Mesme u shfaq e pafuqishme për të luftuar kundër një armiku shumë më të dobët, duke i lënë izraelitët të pambrojtur për pjesën më të madhe të ditës kundër skuadrave të terroristëve që vranë më shumë se 1400

izraelitë, duke përfshirë ushtarë në gjumë; rrëmbyen të paktën 150 persona; pushtoi të paktën katër kampe ushtarake; dhe u përhap në më shumë se 40 kilometër katrore të territorit Izraelit. Këto dobësi operacionale ushtarake ishin ndër një sërë gabimesh të tjera logjistike dhe inteligjente nga shërbimet izraelite të sigurisë. Këto dobësi e hapën rrugën për inkursionin e Gazës në Izraelin jugor.

Fshehtësia e planifikimit, përgatitjes dhe organizimit të operacionit, ka qenë një nga faktorët bazë të suksesit fillestar të Hamasit. Përgatitja për një kohë të gjatë për operacion masiv, ku do merrnin pjesë disa mijëra luftëtarë dhe mos rrjedhja e informacionit, ishte supremacia e kësaj organizate mbi shërbimet e inteligjencës më të paguar dhe më të vlerësuar në botë. Pasojat ishin katastrofike për sigurinë e Izraelit dhe reputacionin e tij në rajon si një partner i besueshëm dhe i fuqishëm ushtarak. Para 7 tetorit 2023, Izraeli ishte një shembull për shumë vende në rajon për çështjet e sigurisë, ndërsa tani Izraeli nuk është më një shtet i pathyeshëm, madje shumë i cenueshëm. Befasia, ishte elementi ushtarak i vjetër sa vetë lufta, e cila vendosi fatin e betejës. Rënia në grackën e operativëve të Hamasit, të cilët e dinin që përgjoheshin, vazhdonin të komunikonin mes tyre me mesazhe mohuese të një plani sulmi mbi Izrael, duke treguar një tjetër nga dështimet profesionale të inteligjencës së glorifikuar izraelite.

Grumbullimi i drejtuesve ushtarakë nga divizioni i Gazës, në një dislokim të vetëm përgjatë kufirit ishte një dështim ushtarak gjithashtu. Pasi baza u pushtua, shumica e oficerëve të lartë u vranë, u plagosën ose u morën peng. Përqendrimi i komandantëve në një bazë të vetme kufitare u godit në fazën e parë të sulmit, e cila pamundësoi komunikimin me pjesën tjetër të forcave të armatosura përgjatë murit të Gazës. Defekt tjetër ushtarak operacional ishte edhe fakti se sistemi izraelit i mbikëqyrjes kufitare mbështetej pothuajse tërësisht në kamera, sensorë madje dhe mitraloza që telekomandohen nga distanca. Ushtarakët izraelitë ishin të sigurt në pa përshkueshmërinë e sistemit mbrojtës. Ushtria izraelite filloi të reduktonte numrin e trupave nga kufiri me Gazën, duke i zhvendosur ato në Bregun Perëndimor.

“Asgjësimi” i komunikimit bëri që të duhen orë të tëra që forcat ajrore të arrinin në pjesën e goditur të zonës edhe pse Izraeli ka baza vetëm disa minuta larg Gazës. Ushtarët izraelitë, të vendosur në dhomat e kontrollit prapa murit, nuk morën alarme se gardhi që ndante Gazën nga Izraeli ishte thyer dhe nuk mundën të shikonin videot që tregonin vendet ku sulmuesit e Hamasit po shkatërronin murin. Pengesa me mur dhe mjete teknologjike rezultoi të ishte më e lehtë për t'u kapërcyer, duke bërë faktorin “njeri” të pazëvendësueshëm. Duke analizuar në këndvështrimin e ekspertit, Izraeli ngjan sikur ka neglizhuar metodat tradicionale të luftës midis këtyre aktorëve. Terroristët kërkojnë të përhapin frikë dhe pasiguri tek institucionet e sigurisë, kështu sulmet e para të Hamasit kundër Izraelit u panë nga bota përmes rrjeteve sociale dhe jo gjatë transmetimit të kanaleve zyrtare informative izraelite. Media duke e zmadhuar impaktin dhe duke deformuar qëllimisht mesazhin bën përhapjen e mesazheve dhe njëkohësisht rekrutim të mbështetësve të terrorizmit. Dezinformacioni është arma që

shtetet dhe aktorë të tjerë të interesuar po përdorin edhe në këtë konflikt të ri.

Shërbimet e inteligjencës duket se janë mbështetur verbërisht në teknologjinë më të re dhe të sofistikuar, duke injoruar faktorin njeri. Inteligenca dhe terrorizmi vazhdojnë të mbeten aktivitetet, të cilat kryhen nga organizata apo dhe individë që “luajnë në të njëjtën fushë të lojës”. Si të tilla ato kanë shumë cilësi të përbashkëta, ku më kryesorja është fshehtësia. Të dy aktorët nuk veprojnë hapur, por në mënyrë të maskuar, ose me “flamur të rremë” dhe me rregulla strikte të mbajtjes së sekretit. Të dy palët ndërloftuese ndjekin lojën dhe përdorin mjetet që përdor kundërshtari dhe në funksion të kësaj, ndërtojnë taktika për të kundërvepruar dhe fituar. Infiltrimi në organizatën terroriste me burime informacioni nga ana e inteligjencës, është çelës i zbërthimit, kapjes dhe mundjes së kësaj organizate. Nga ana e tyre, terroristët i mbajnë radhët e tyre të shtrënguara, për të mos lejuar askënd të depërtojë nga jashtë ose të tradhetojë nga brenda. Kjo bëhet përmes celulave të vogla të copëzuara, ku një njeri i kapur, i infiltruar, apo i zbuluar nuk zbulon dot tërë rrjetin. Terroristët përmes dënimeve ekstreme makabre për tradhtarët dhe familjet e tyre, synojnë të minimizojnë aksesin e agjentëve të shërbimeve inteligjente në organizatë.

Në këtë “lojë të përgjakur” të dy lojtarët në fushë, kërkojnë avantazhin e përdorimit të mjeteve të duhura njerëzore dhe teknologjike, por nga ana tjetër synojnë të gjejnë dobësitë dhe hapësirat e zbuluara tek kundërshtari. Izraeli ka shërbimet më të më të mëdha dhe mirë financuara të kundërzbulimit në Lindjen e Mesme, pasi në të kaluarën, Mosad ka kryer atentate në kohën e duhur kundër liderëve militantë, duke ditur dhe monitoruar nga afër të gjitha lëvizjet e tyre. Ndonjëherë këto janë bërë edhe me sulme me dron, pasi agjentët i kanë vendosur gjurmues GPS në makinën e një terroristi të dyshuar, madje kanë përdorur edhe telefona celularë që shpërthejnë pas aktivizimit. Përgjatë murit midis Gazës dhe Izraelit ka patur shumë kamera, sensorë lëvizjeje që vëzhgonin pa ndërprerje 24/7. Megjithatë, militantët e Hamasit thjesht depërtuan nëpër të, hapën vrima në gardhin gjigand me tela me gjemba dhe hynë lehtësisht në Izrael nga toka, deti dhe ajri?!

Agjencitë kryesore të kundërzbulimit të Izraelit, përdorin një gamë moderne teknologjish spiunazhi dhe kundërspiunazhi, dhe sigurisht burime njerëzore, agjenturore brenda grupeve të armatosura palestineze për të mbledhur informacione. Nga sa ndodhi del se Hamasi nuk vlerësohej nga Izraeli i aftë për të nisur një sulm në një shkallë të tillë. Inteligenca izraelite duket se ishte e përqendruar tek Hezbollahu. Hamasi nënvleftësohej dhe cilësohej si një grup “xhepistash”; vlerëson një ekspert i vjetër i policisë izraelite, në Al khazira. Hamasi përfitoi nga ky perceptim i gabuar i Izraelit, të cilin me shumë kujdes dhe në fshehtësi të plotë, kjo organizatë e krijoi përmes dezinformacionit që përhapte në fshehtësi të padepërtueshme.

Sulmi ndodhi me rastin e 50-vjetorit të luftës arabo-izraelite

të vitit 1973, si mesazh i qartë që risolli jehonën e atij sulmi udhëhequr nga Egjipti dhe Siria. Cilat do që të jenë arsyet pse shërbimet e inteligjencës izraelite dështuan për të ndaluar sulmin e 7 tetorit, është e pamundur që Izraeli e ka lënë “thjesht të ndodhë”, thotë David Miller, studiues në Qendrën për Islamin dhe Çështjet Globale të Stambollit. Nëse kjo do jetë e vërtetë ky është operacioni “fals flag” më i madh në botë deri tani. Hamasi për t’u përgatitur dhe kryer një sulm të tillë të koordinuar, kompleks që përfshin grumbullimin e mijëra luftëtarëve dhe raketave, nën hundën e izraelitëve, duhet të jetë planifikuar dhe zbatuar nën masa të jashtëzakonshme të sekretit dhe sigurisë operative. Kjo tregon mirë planifikimin dhe mesazhin e qartë që donte të përcillte në një ditë historike për to. Sulmi i Hamasit nga ajri, toka dhe deti, ngriti gjithashtu pikëpyetje se pse agjencitë e inteligjencës mike amerikane dhe shteteve arabe si Egjipti, Jordania, Katari dhe Arabia Saudite nuk dinin gjë për sulmin që do të ndodhte. Izraeli ka aftësi të klasit botëror për mbledhjen dhe analizën e inteligjencës dhe pritej se do të kishte një parashikim mirë të asaj që po ndodh në oborin e shtëpisë së tij. Jam vërtet i habitur që diçka e kësaj përmase ka ndodhur dhe që izraelitët nuk kishin asnjë ide se kjo do të ndodhë.

Unë besoj se hakmarrja, është mjeti më i gabuar që përdoret nga shtetet në fushata kundër këtyre organizatave dhe konkretisht kundër Hamasit. Hakmarrja dhe thirrjet për hakmarrje izraelite vetëm se shton radhët e terroristëve duke rritur numrin e viktimave të pafajshme të cilat kanë arritur deri në 10 mijë, ndër to shumë gra, fëmijë si dhe mbi 30 gazetarë. Familjarët, të afërmit dhe të pafajshmit, të cilët humbin njerëzit e tyre të dashur pa arsye, do të revoltohen, zhgënjehen, radikalizohen dhe hakmerren, duke shtuar radhët e terroristëve dhe futur këtë luftë në një spirale që vetëm zgjatet dhe vetëm përhapet më shumë. ‘Paqja do të vijë atëherë kur palestinezët do të duan fëmijët e tyre më shumë se do na urrejnë neve, por ne kemi një armë të cilën arabët nuk e kanë; ne nuk kemi ku të shkojmë tjetër’, - thoshte Golda Meir, kryeministria e katërt e Izraelit para 60 vitesh.

Palestinezët nuk janë terroristë dhe terroristët nuk janë të gjithë palestinezë. Në këtë kontekst reflektimi që duhet të bëjmë, është pikërisht mos identifikimi i Hamasit me Palestinën dhe i besimtarëve me terroristët. Duhet të shqetësohemi sepse mbështetësit e Palestinës po ngrihen në demonstrime në të gjithë



botën arabe dhe perëndimore, duke bërë padashur sensibilizim pro Hamasit. Kjo jo vetëm nuk është një shenjë e paqes, por e një përhapjeje më të madhe të terrorit dhe mbështetësve të tij në rang global. Një studiues i universitetit të Columbias e krahasoi fenomenin e përhapjes së terrorizmit me përhapjen e zjarrit në pyll, i cili është vështirë të menaxhohet, ndalet apo të shuhet. Pak ditë pas sulmit, në gjithë botën kanë filluar protesta dhe u shfaq solidaritet pro Izraelit por nga ana tjetër ka protesta pro Palestinë në Uashington, Berlin, Paris, Stamboll, Moskë etj.

Irani ka gjasa të përfshihet direkt në luftën e Izraelit me Hamasin, pasi ministri i Jashtëm Iranian, Hossein Amirabdollahian ka paralajmëruar se Teherani nuk do të mbetet “spektator” në këtë situatë. Emmanuel Macron ka folur direkt me homologun e tij iranian, Ebrahim Raisi, më 15 tetor, dhe e ka paralajmëruar Teheranin kundër “zgjerimit të konfliktit, sidomos në Liban”. Presidenti Putin shkon në Pekin dhe bashkë me homologun kinez Xi Im Ping jo vetëm nuk dënojnë sulmet e Hamasit kundër Izraelit, por deklarojnë për një përhapje të konfliktit përtej rajonit. Një nga liderët politikë të Hamasit udhëton në Moskë më 27 tetor, duke deklaruar se nuk lirohen pengjet nëse nuk ndalin sulmet ajrore izraelite. Madje aleatë të NATO-s shfaqën qëndrime të kundërta lidhur me këtë çështje, duke përmbushur kështu një nga qëllimet e terrorizmit, përçarjen mes aleancave dhe qëndrimeve të shteteve të ndryshme. Pasojat që sjell kjo përçarje e opinionit ndërkombëtar është i rrezikshëm dhe me pasoja të paparashikueshme, duke përmbushur misionin e Hamasit, që është dhënia e ngjyrës së luftës fetare të konfliktit aktual. Frikë për hakmarrje të palëve raportohen, si në sinagogat ashtu edhe xhamitë më të mëdha në SHBA dhe vende të tjera.

Përplasjet mes grupeve që mbështesin palët, është e mundur, ka motivet dhe mjetet për të ndodhur. Ministria e Shëndetësisë së Palestinës raporton për 8,005 të vrarë përfshirë 3342 fëmijë, 2062 gra, 460 të moshuar, 20242 të plagosur dhe mbi 10000 palestinezë mbahen në burgjet izraelite.

Vrasjet e civilëve e bëjnë konfliktin pa zgjidhje dhe me urrejtjen që rritet sa më shumë gjatë luftës, rrisin mbështetësit e Hamasit, Hezbollah dhe grupet e tjera që përdorin islamin si ideologji. Fenomeni i luftëtarëve të huaj mund të përsëritet bashkë me pasojat në fushën e sigurisë, sociale etj., pasi ekzistojnë rrethanat e ngjashme me konfliktet e kaluara të së njëjtës natyrë dhe vënë në jetë nga të njëjtët aktorë. Kujdesi që duhet të trajtohet kjo çështje, është i lidhur gjithashtu edhe me leksionet që bota e qytetëruar ka marrë, po kështu edhe me pasojat dhe viktimat për 20 vite nga aktet e terrorizmit. Në Tiranë pati gjithashtu manifestim të tillë pro Palestinës, duke vënë një shenjë barazimi të rrezikshme, mes Hamasit dhe të drejtës së popullit palestinez për të krijuar shtetin e tyre. Shqipëria ka rezultuar të mos jetë immune dhe larg fenomenit të rekrutimit nga ISIS, të mbi 150 luftëtarë shqiptarë u rekrutuan nga 727 xhamitë në gjithë Shqipërinë. Shumë prej tyre u vranë, disa po vuajnë dënimin dhe shumë familje janë shkatërruar. Përvoja e Sirisë dhe leksionet e fundit nga Gaza duhet të jenë kambana alarmi edhe për institucionet tona të sigurisë kombëtare, po kështu edhe nga media në kujdesin për mesazhet që përcjell.



Strategjia e sigurisë kombëtare, dimensioni i sigurisë dhe mbrojtjes kolektive



N/KOL (R) MSC. KANAN HIMAJ

Strategjia e Sigurisë së Republikës së Shqipërisë është dokumenti themelor i politikës sonë të sigurisë dhe një kornizë referimi për strategjitë dhe politikat e tjera që lidhen me sigurinë tonë. Ai përcakton parimet dhe drejtimit thelbësore të politikës sonë të sigurisë që janë të detyrueshme për të gjitha organet e shtetit dhe të administratës publike. Rishikimi i Strategjisë të Sigurisë shërben si udhërrëfyes për vendimet strategjike si dhe për punën e përditshme në të gjitha nivelet e sistemit tonë të sigurisë, duke përfshirë ato shumë themelore. Zbatimi i tij rishikohet rregullisht në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse.

Strategjia e Sigurisë është dokumenti i Qeverisë i hartuar në konsultim me stafin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Qëllimi është të kërkohej qasje jopartiake për çështjet e sigurisë. Gjithashtu, autorët marrin të dhëna nga komuniteti shqiptar i sigurisë, duke përfshirë sektorët joqeveritar si dhe ata qeveritarë. Kornizat

kryesore të referencës janë Koncepti Strategjik i NATO-s, 2022 dhe dokumente Strategjike të BE-së. Ajo ndërtohet në përputhje me Kornizën Strategjike të Republikës së Shqipërisë 2030, një dokument që përcakton një vizion të përgjithshëm strategjik dhe synime për zhvillimin e Shqipërisë në planin afatgjatë.

Strategjia jonë e Sigurisë bazohet në vlerat dhe standardet ligjore të parashikuara në legjislacionin tonë kushtetues: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Karta e të Drejtave dhe Lirive Themelore, Akti Kushtetues (për sigurinë e Shqipërisë), dhe legjislacioni tjetër që zbaton standardet kushtetuese. Për më tepër, Strategjia e Sigurisë pasqyron angazhimet tona ndaj aleatëve tanë dhe angazhimet e tjera ndërkombëtare që rrjedhin nga anëtarësimi i Shqipërisë në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), synimi për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE), Kombet e Bashkuara (OKB) dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

Koncepti Strategjik i Aleancës është dokument referues për Procesin e Planifikimit të Mbrojtjes NATO (NDPP), i cili në thelb është dokumenti që përcjell formën, përmbajtjen, axhendën, kapacitetet dhe qëndrimet themelore të strategjisë së sigurisë kolektive (NATO, BE, etj.).

Në këtë kuadër, rishikimi i dokumenteve kryesore të sigurisë dhe mbrojtjes duhet të bazohen fort në atë çka përcjellin dokumentet e organizmave të sigurisë ndërkombëtare. Në momentet më të rëndësishme për sot dhe në të ardhmen mbetet që në thelb të procesit të rishikimit është Strategjia e Sigurisë Kombëtare. Si e tillë, ajo do të përcjellë mesazhe domethënëse për sigurinë, vendin dhe shoqërinë shqiptare. Burimi kryesor i kërcënimeve është situata shumë e përkeqësuar ndërkombëtare me ndikime edhe për vendin tonë. Është për t'u vlerësuar situata, Lufta e Rusisë kundër Ukrainës, e cila i ka dhënë fund periudhës së paqes, stabilitetit dhe bashkëpunimit pas përfundimit të Luftës

së Ftohtë. Mbetet e rëndësishme të kuptohet që Rusia vepron qëllimisht kundër stabilitetit politik, ekonomik dhe social të rajonit dhe përkatësisht me ndikime edhe për Shqipërinë. Pra, kjo përbën një kërcënim për sigurinë tonë.

Shqipëria punon së bashku me aleatët e saj për sigurinë e vendit, e cila do të investojmë në çdo aspekt të sigurisë sonë. Rusia dhe Kina ndajnë të njëjtin interes – të dobësojnë ndikimin dhe unitetin e vendeve demokratike. Kjo konkurrencë sistematike është e një natyre afatgjatë.

Në këtë kuadër, Shqipëria duhet të jetë në gjendje t'i rezistojë ndikimeve armiqësore në sferën kibernetike, informative, ekonomike dhe të inteligjencës. Shqipëria duhet të përgatitet tërësisht për mundësinë që ajo të përballojë një konflikt të armatosur së bashku me aleatët.

Gjithashtu, ajo duhet të jetë e përgatitur për t'u përballur me emergjencat dhe situatat e krizës, duke përfshirë krizat afatgjata, të shkaktuara nga ndryshimet klimatike ose ngjarje të jashtëzakonshme të shkaktuara nga njeriu.

Siguria jonë është e ndërlidhur me sigurinë dhe stabilitetin në fqinjësinë. Anëtarësimi në NATO dhe rruga për në BE është i një rëndësie kritike për Shqipërinë. Një kërcënim për një aleat është një kërcënim për Shqipërinë.

Strategjia e Sigurisë më së shumti respekton strukturën e krijuar të paraardhësve të saj të miratuar në 2014. Logjika është vlerësimi i interesave tona relativisht të qëndrueshme të sigurisë në kontekstin e mjedisit të sigurisë që ndryshon në mënyrë dramatike. Konfrontimi na tregon se cila strategji është më e përshtatshme për të promovuar interesat tona të sigurisë këtu dhe tani; dhe strategjia, nga ana tjetër, na tregon në terma të përgjithshëm se cilat mjete duhet të përdorim. Duke u larguar nga dokumentet e mëparshme, autorët përfshijnë një kapitull të ri mbi fushat me interes strategjik, ku do të nevojitet punë e mëtejshme për politikën.

Kryefjala e kësaj Strategjie të Sigurisë është një qasje e të gjithë qeverisë dhe e gjithë shoqërisë. Secili prej nesh duhet të bëjë pjesën e tij ose të saj për sigurinë tonë. Me këtë në mendje, autorët bënë përpjekje për ta bërë këtë Strategji të Sigurisë të drejtpërdrejtë dhe të lehtë për t'u lexuar.

Mbrojtja e vendit tonë varet nga pjesëmarrja jonë në sistemin e mbrojtjes kolektive të NATO-s, si e vetmja organizatë e gatshme dhe e aftë për të mbrojtur territoret, sovranitetin dhe integritetin territorial të anëtarëve të saj. Ne marrim pjesë aktive në përpjekjet për të forcuar qëndrimin parandalues dhe mbrojtës të Aleancës kundër çdo kundërshtari në të gjitha fushat operacionale në tokë, në det, në ajër, si dhe në hapësirën kibernetike. Ne e shohim objektivisht forcimin e aftësisë mbrojtëse në mënyrë që të jemi aleatë të përgjegjshëm dhe të besueshëm, duke kontribuar në pjesën e duhur në mbrojtjen kolektive të NATO-s. Për shkak të vendndodhjes së saj gjeografike, Shqipëria ka një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe mbrojtjen kolektive në kontekstin e operacioneve të mbrojtjes kolektive në pjesën e rajonit tonë të Ballkanit Perëndimor.

Në këtë kontekst, ne vlerësojmë mjedisin e sigurisë në zonën euroatlantike, duke nxjerrë në evidencë edhe kontributet e BE-së për sigurinë e vendit tonë në kuptimin e gjerë, duke qenë një aktor i fortë politik dhe i sigurisë. Në këtë kuadër vendi ynë mbështet organizmat e sigurisë, sidomos Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes të BE-së dhe, brenda kornizës së saj, duke respektuar qasjen ndaj rolit kyç të NATO-s në mbrojtjen kolektive. Shqipëria promovon një rritje të vazhdueshme të bashkëpunimit BE-NATO, si dhe zhvillimin e dialogut të sigurisë BE-Shtetet e Bashkuara.

BE-ja është platforma jonë kryesore për parandalimin dhe reagimin e koordinuar ndaj një game të gjerë kërcënimesh të sigurisë si ndryshimi i klimës dhe migrimi i paligjshëm. Shqipëria

merr pjesë aktive në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të BE-së dhe mbështet përpjekjet për të reduktuar rrezikun nga fatkeqësitë.

Ajo që është e rëndësishme për sigurinë e Shqipërisë në kontekstin global është që rregullat ndërkombëtare, standardet dhe institucionet e bazuara në bashkëpunim duhet të mbahen në fuqi dhe se komuniteti ndërkombëtar duhet të përgjigjet me forcë, kur dhuna përdoret në shkelje të Kartës së OKB-së. Vendi ynë punon vazhdimisht për të mbrojtur paqen dhe sigurinë, për të nxjerrë pasoja politike dhe të tjera nga shkeljet e ligjit ndërkombëtar dhe për të mbrojtur demokracinë, të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës.

Shqipëria merr pjesë aktive në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit. Ne kontribuojmë në aktivitetet kundër-terroriste të organizatave ndërkombëtare, mbi të gjitha të NATO-s dhe BE-së, duke shkëmbyer informacione, duke ndërtuar aftësitë e nevojshme, duke marrë pjesë në operacione dhe misione dhe duke promovuar bashkëpunimin me partnerët.

Vendi ynë ndihmon vendet e saj partnere në zhvillimin e aftësive të tyre për t'u përballur me kërcënimet e terrorizmit dhe radikalizmit në terren, për të adresuar shkaqet rrënjësore dhe, më e rëndësishmja, për të promovuar qeverisjen e mirë dhe zhvillimin socio-ekonomik në rajonet e cënueshme. Ndihma jonë ndihmon në parandalimin e rritjes së rrezikshme të terrorizmit dhe radikalizmit, duke përfshirë ndikimet e mundshme në shoqërinë tonë. Shqipëria ka miratuar masa parandaluese dhe legjislative në të gjithë sistemin kundër terrorizmit në përputhje me strategjinë e vendeve partnere. Ne kemi marrë hapa për të mbrojtur njerëzit, infrastrukturën kritike dhe objektivat e tjerë të cënueshëm ndaj sulmeve terroriste. Ne kemi vendosur të përmirësojmë shkëmbimin e informacionit me aleatët tanë në NATO, mbrojtjen tonë të kufijve dhe luftën tonë kundër financimit të terrorizmit dhe përdorimit të terrorizmit të teknologjive të reja. Shqipëria ka rregullime të nevojshme për pjesëmarrje aktive në misionet e NATO-s, BE-së dhe OKB-së dhe koalicionet e njëhershme që merren me një gamë të gjerë krizash në fazat para konfliktit dhe pas konfliktit. Ne i përmbushim këto angazhime në përputhje me qasjen tonë të integruar ndaj operacioneve të menaxhimit të krizave. Ne ndihmojmë në ndërtimin e kapaciteteve të sigurisë dhe mbrojtjes në vendet tona partnere, siguria dhe qëndrueshmëria e të cilave është e rëndësishme për interesat e sigurisë së Shqipërisë. Për këtë qëllim, ne zhvillojmë aftësinë për të vendosur forcat tona të armatosura dhe ekspertët civilë në misionet dhe operacionet e ndërtimit të kapaciteteve, të fokusuar në ndërtimin e aftësive të sigurisë dhe mbrojtjes, veçanërisht në kryerjen e misioneve stërvitore dhe furnizimin me materiale.

Kur parandalimi i krizës dhe zgjidhja paqësore dështojnë, Shqipëria bashkohet me masat shtrënguese në përputhje me angazhimet e saj në NATO, BE dhe me parimet e Kartës së OKB-së. Për më tepër, aty ku lejojnë kapacitetet tona, ne mund të kontribuojmë me burime civile dhe ushtarake në operacione të tjera paqeje që janë në përputhje me interesat tona, edhe nëse ato mbeten jashtë fushëveprimit të angazhimeve tona të bazuara në traktat dhe/ose nëse ato nuk adresojnë një kërcënim për Shqipërinë. Vendi ynë do të jetë i gatshëm të kontribuojë në masat shtrënguese të bashkësisë ndërkombëtare që synojnë të parandalojnë shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut dhe mbi të gjitha gjenocidin dhe krimet e tjera kundër njerëzimit. Në këtë drejtim, Republika e Shqipërisë mbështet zhvillimet dhe të drejtat e Kosovës. Procesi i planifikimit të dekametrave të rëndësishme të sigurisë dhe mbrojtjes do të jenë rezultat i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve qeveritare dhe jo qeveritare. Institucionet kërkimore dhe shkencore kanë një rol të veçantë për të sjellë në vëmendje problemet e reja dhe qasjet më të përshtatshme për sigurinë e vendit dhe shoqërisë sonë.

Oponencë Presidentit të Ukrainës: Gjithsesi nuk do të ketë luftë në Ballkan!



GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ

Mbetet ende i freskët, ndoshta i frikshëm për disa, paralajmërimi i Presidentit të Ukrainës, Volodymyr Zelensky: “Rusia po përgatit luftë mes vendeve të Ballkanit!”. Ndoshta me të drejtë, por në gjykimin tim pa një analizë të thelluar, kjo deklaratë e dhënë në një intervistë për mediat Afrikane, bëri xhiron e globit si dhe u komentua nga pothuaj të gjitha kryeqytetet me peshë në sigurinë globale. Po ashtu, natyrshëm që ky koment vijon të mbetet “top-news” nga institucionet, faktorët, media dhe opinioni publik në vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshi në Tiranë dhe Prishtinë. Si në çdo zhvillim, që çmoj se ka impakte mbi interesat kombëtare, sigurisht e kam ndjekur me vëmendje të shtuar, i konsultuar me ekspertë/kolegë në Uashington, Bruksel, etj., si dhe e kam analizuar me përgjegjësi shtesë edhe këtë deklaratë dhe qëndrimet që e pasuan, por kam zgjedhur me vetëdije të mos jap “opinion të nxituar” ndaj interesimit të mediave kryesore, jo vetëm brenda vendit. Arsyeja pse kam heshtur, ka qenë se përtej “masës së shpërdorimit mediatic të komentit të Presidentit Zelenski”, e gjej ndoshta të konsumuar dhe “jo shumë të gjetur”, edhe pse gjithsesi ka për qëllim të mbajë të ndezur kohezionin dhe mbështetjen Euro-Atlantike në përballjen stoike të Ukrainës ndaj agresionit të Rusisë Putiniste. Nga ana tjetër, që në fillim të herës më duhet ta qartësoj se, në asnjë rrethanë dhe për asnjë arsye nuk do të doja kurrsesi që sa gjetjet në këtë opinion të merren si debat me Presidentin Zelenski, aq më pak me një personalitet që 600 ditë dhe net po mban peshën e një kombi martir në luftë. Thënë këtë, në formatin e “një replike shumë dashamirëse”, po paraqes disa këndvështrime dhe oponencë strategjike rreth kësaj deklarate, ose më shkurt, “pse Rusia e ka tërësisht të pamundur të hapë, ndezë apo përfshihet në një front të ri Luftë?”, ose më konkretisht të adresojë disa mesazhe profesionale, por optimiste nëse mundet t’i quaj kështu: “pse nuk do të ketë luftë në Ballkan?”.

Së pari, e thënë më drejtpërdrejt, në rrethanat aktuale gjeopolitike, gjykoj që Rusia Putiniste e ka tërësisht të pamundur të ndërmarrë me vete (jo e jo), të ndezë fitilat, apo edhe mbështesë ushtarakisht një luftë, ose një përlëshje ushtarake mes vendeve të rajonit të Ballkanit. Skeptikët, apo qoftë dhe egocentrikët, mund të kujtojnë ndoshta me të drejtë, që pikërisht në grahamat e fundit

të “perandorisë Staliniste”, Kremli dërgoi një detashment të motorizuar në Aeroportin e Prishtinës (mbi 2700 km distancë!!), për t’i dhënë një mesazh fitimtarëve të luftës në Kosovë, USA, NATO-s dhe Perëndimit: “Ariu rri i strukur në shpellat polare, por ende nuk ka ngordhur”. Po me të drejtë edhe racionalët mund të kujtojnë se jo rastësisht, kjo ndodhi në qershor 1999, pra vetëm 2 muaj para se Putini të pushtonte si Car i ri Kremlinin (9 gusht 1999). Protagonistët e NATO-s (fitimtarët e luftës), përkundër Gjeneralëve të kohës, e kanë çmuar si një “gabim të arsyetuar/justifikuar që e lejuan këtë demonstrim force të Rusisë në Prishtinë”, por që në fakt gjithsesi rezultoi një “tolerim i padobishëm” për balancat si dhe të ardhjen e interesave gjeopolitike të aleancës Euro-Atlantike. Në fakt historia sigurisht i dha të drejtë Gjeneralëve, por ky është një diskutim, që siç thotë populli: “pa bereqet tashmë”. Nga ana tjetër, duhet theksuar se edhe për shkak të peshës së diskreditimit gjeopolitik që po përballlet Rusia Putiniste mbas ndërmarrjes neo-Naziste ndaj sovranitetit të Ukrainës, përfshirja në një front të ri lufte në Ballkan (pra në Europë, jo në Afrikë....) do të ishte një aventurë vetëvrasëse, pasi në këtë rast jo vetëm që kurrsesi nuk do tolerohej, por jam i bindur që do të ndëshkohej në mënyrë shembullore nga fuqia ushtarake e Aleancës së Atlantikut të Veriut (NATO/USA). Së dyti, është edhe një fakt tjetër, pra meqenëse Kremli nuk e pushtoi dot as me lule, as me valle, as me tanke, as me raketa, as me bajoneta Ukrainën, por pas 21 muajsh po zvarritet si terroristët e Hamasit në tunelet dhe llogoret e Zaporizhjas, Oblastes, Bakhmutit, etj.; pra jo vetëm ka humbur në mënyrë turpëruese luftën me Ukrainën, por edhe betejën për të sfiduar rendin e sigurisë globale dhe fuqinë ushtarake të aleancës trans-atlantike (US/UK/NATO/BE)”. Kështu nuk ka mbetur asnjë dilemë, as për mendjet e ndryshkura, jo vetëm në Beograd, që Rusia Putiniste, kryesisht për shkak të agresionit ndaj Ukrainës gjendet sot më e izoluar dhe më e diskretituar se asnjëherë më parë në historinë e saj. Nga 195 (përfshi Kosovën) vetëm 4 shtete (Koreja e Kim-Jong-ut dhe 3 shtete terroriste të Afrikës) e njohën këtë aventurë neo-naziste. Po për shkak të kësaj lufte rrezikon potencialisht përjashtimin nga 5-shja vendimmarrëse e Këshillit të Sigurimit/OKB si dhe nga Gjykata Ndërkombëtare është lëshuar “urdhër arresti për krime lufte” ndaj Putinit dhe për të gjithë listën e Gjeneralëve dhe oborrtarëve zullumqare rreth tij. Pra të lerë, apo dalë nga transhetë e Ukrainës, dhe përfshihet në një luftë në Ballkan me perëndimin (mbi 2700 km distancë), do ishte një aventurë perverse!

Së treti, për ta parë nga një këndvështrim më relaksues këtë deklaratë dhe disa nga ato që e kanë pasuar, duhet konsideruar gjithashtu se pavarësisht “temperaturës mediatike” nuk gjej pothuajse asgjë të re në deklaratën e Presidentit Zelenski, pasi është e njohur nga të gjithë faktorët se Rusia për interesat (përfshi krenarinë dhe ëndrrat) e saj gjeopolitike, si historikisht por veçanërisht 24 vitet e fundit (nën sundimin e Putinit), ka bërë gjithçka që ka mundur që ta mbajë të destabilizuar dhe jashtë axhendës euroatlantike vendet e Ballkanit. Por po ashtu duhet nënvizuar se fatmirësisht Rusia ka dështuar, pasi në mos të gjitha vendet e rajonit, shumica dërrmuese janë tashmë anëtare të NATO-s, ndër-



sa Kosova dhe Bosnja, aspirojnë zyrtarisht anëtarësimin. Kështu mbetet vetëm Serbia që “do të pijë nga tre nena”, pra edhe nga Moska edhe nga Brukseli dhe Uashingtoni! Pra aktualisht në Ballkan janë faktorë, aktorë, marrëdhënie, rreshtime, interesa dhe ambicie gjeopolitike tërësisht të tjera nga ato të para viteve 1990. Pra të ndërmarrësh një aventurë ushtarake apo të përfshihesh/ndezësh luftë në këto rrethana, do të rezultonte pa mëdysheje edhe më keq se sa mision i pamundur. Së katërti, e kam theksuar edhe në disa vlerësime të tjera me këtë subjekt, që Rusia mbasi dështoi “për të ndaluar me çdo çmim” (edhe me grusht shteti) integrimin e Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi në NATO, karta e fundit ose arma e vetme për ta mbajtur të destabilizuar rajonin, apo qoftë edhe për një aventurë ushtarake mbetet Beogradi. Por në rrethanat aktuale, edhe Serbia që në mbi 24 vjet po vijon të paguajë shtrenjtë pasojat e një lufte me vendet e Ballkanit dhe NATO-n, e ka tërësisht të pamundur t’i kthehet aventurës gjakatare të Milloshevicit. E parë kështu, shpresoj se edhe Serbia gjithsesi nuk do të lejojë “të përdoret pa fund si mish për top” për interesat gjeopolitike të Kremlinit! Jo vetëm Presidenti Zelenski, me shumë të drejtë risjellin në vëmendje se riciklimi i konfliktit të përgjakshëm në Lindjen e Mesme, është produkt i Kremlinit, ku edhe arriti që nëpërmjet grupeve terroriste të prodhonte disa pikëpyetje të përgjakshme afatshkurtra mbi kundërofensivën e Ukrainës. Nga ana tjetër, kujtojmë që askush dhe në asnjë rast Serbia nuk është konsideruar si shtet terrorist, apo z. Vucic, si Bin Ladeni, apo si Kreu politik i Hamasit. Në të kundërt, është “përkëdhelur si faktor i moderuar nga Perëndimi”, ndërsa janë përsëritur thirrjet për Beogradin zyrtar përfshi edhe për kolegët e fushës së Sigurisë Strategjike, që të mos harxhojë më kot miliarda euro për armatime; të mos vazhdojë qasjen si shtet terrorist (Koreja e Kim Jong-ut) në zonën ndërkufitare mes dy shteteve sovraane (Kosovë/Serbi); të mos drejtohet nga interesat e grupeve kriminale; por të c’ militarizojë kufirin me Kosovën si dhe t’i ri-kthehet pa kushte negociatave dhe masave të mirëbesimit reciprok mes dy vendeve dhe axhendës së integritit euroatlantik të rajon, etj. Nga ana tjetër, theksojmë, se Serbia nuk ka gjithsesi fuqi të përballet ushtarakisht as me NATO-n, por as me të gjitha vendet e Rajonit, edhe nëse nuk do ishin anëtare të NATO-s. Kujtojmë që Kroacia, Sllovenia, Maqedonia e Veriut, e kanë mundur makinerinë e përgjakshme të Milloshevicit mbas viteve 1990, ndërsa sot kanë zhvilluar kapacitete kritike për ta përballur dhe mposhtur çdo aventurë të Beogradit qoftë më vete apo qoftë të mbështetur nga Moska. Për rrjedhojë, Serbia jo vetëm nuk është e kërcënuar nga askush, por askënd nuk tremb dot më, përveçse minon interesat dhe axhendën e integritit të vetvetes/Serbisë. Si përmbledhje. Thënë sa më sipër, duhet theksuar se sigurisht që ka ende delirantë të

(mbi) pushtetshëm, interesa të krimit të organizuar dhe mendje të ndryshkura në Moskë, Beograd dhe jo vetëm, që mbajnë ndezur fitilat e një lufte Ballkanike. Po ashtu besoj se nuk ka më as nevojë të përsërisim se Rusia Putiniste, është, le të themi, “në të drejtën e saj” për të rikthyer Moskën te lavdia, interesat, apo qoftë edhe ëndrrat gjeopolitike të para viteve 1990.

Nga ana tjetër, jo vetëm Zelenski por edhe strategjisti i mirënjohur i Ballkanit, Janusz Bugajski, e sheh ende Serbinë si peng i Rusisë në Ballkan, kur nënvizon se: “Për të rritur peshën gjeopolitike në Europën Juglindore, Moska mund të përdorë serbët për të nisur një luftë të re me fqinjët e saj”. Prandaj, për aleatin e vetmuar strategjik të Rusisë në rajon, pra Serbinë, ashtu si çdokush kemi të drejtë të adresojmë disa pikëpyetje për Beogradin zyrtar: 1. Përse shpenzon (në fakt shpërdoron) më shumë se 1 miliard € në vit për mbrojtjen?; Përse armatoset deri në dhëmbë (kryesisht nga Rusia) me Tanke, Mig-29, Helikopter luftimi Mi-35, raketa Pantsir-S dhe Kineze FK-3?; Nga kush rrezikohet (askush) dhe kë vend sovran kërcënon Serbia (në fakt Kosovën)?! 2. A nuk është marrëzi delirante që për interesat e Moskës, apo grupeve kriminale, Beogradi të kërcënojë tërësinë territoriale të Kosovës dhe trupat NATO-s/ KFOR me mision atje!? A nuk është (vetë) diskredituese edhe diplomatikisht kur Ambasadori Rus në Beograd inspekton njësitë e ushtrisë serbe në kufijtë e një shteti sovran/Kosovës!? Ndërsa Beogradi akuzon Kosovën se kërcënon “ekzistencën e pakicës Serbe në veri”, krejt të ngjashme me ato të Rusisë ndaj Gjeorgjisë (2008); në 2014 dhe mbas shkurtit 2022 ndaj Ukrainës!; 3. Për më tepër, e përsëris se krahas raskapitjes turpëruese që sigurisht e pret këtë dimër në Ukrainë, Rusia Putiniste e ka humbur edhe betejën për të ndezur një front të ri lufte në Ballkan, duke frymëzuar grupet kriminale, axhendën e politikanëve të korruptuar apo ekstremistë të tipit Dodik...!? Përkundër këtij paralajmërimi, demonstrohen edhe mesazhet e forta nga Uashingtoni: “USA mbeten të përkushtuara për të mos lejuar një luftë në Rajon”. Ndërsa vetëm dy ditë më parë, gjatë vizitës në rajon, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg përsëriti, se: “Ne nuk shohim ndonjë kërcënim ushtarak që do të vinte nga Rusia ndaj ndonjë vendi anëtar të NATO-s, apo rajonit, por gjithsesi ne jemi të kujdesshëm dhe po vëzhgojmë nga afër”, si dhe një mesazh shpresëplotë edhe nga BE: “Kjo situatë, na tregon edhe më shumë që përparimi në rrugën e BE-së është ekstremisht i rëndësishëm për stabilitetin dhe paqen e rajonit të Ballkanit Perëndimor”. Në shtesë, përtej kësaj deklarate si dhe përkundër riciklimit të luftës dhe shpërdorimit të Beogradit për interesat e Rusisë Putiniste, 24 vjet mbas çlirimit të Kosovës, besoj edhe më fort se paqja mbetet opsiioni dhe misioni i vetëm, në mënyrë që siguria të konsumohet përtej historisë së përgjakshme, në interes të sigurisë së jetës, pronës, prosperitetit të qytetarëve të Kosovës dhe Serbisë si dhe perspektivën Euroatlantike për 6 vendet e Ballkanit Perëndimor. Nga ana tjetër, theksoj edhe njëherë se humbja turpëruese e luftës, kolapsi ekonomik dhe diskreditimi ndërkombëtar, përfshi në Ballkan që e pret Rusinë Putiniste mbas Ukrainës, mbetet një rrethanë (por jo dhuratë) e favorshme gjeopolitike në dobi të faktorizimit të RSH në tavolinat e dialogut dhe vendimmarjeve të mëdha (SHBA/ NATO/UN) si dhe për të mbrojtur dhe zhvilluar interesat mbarëkombëtare në Rajon, Mesdhe, etj.! Thënë sa më sipër, e çmoj në kohën e duhur që në kapacitetin e një Eksperti (besoj jo të panjohur) me eksperiencë në çështjet e sigurisë kombëtare, rajonit, NATO-s etj., do t’i këshilloja publikisht dhe vëllazërisht faktorët dhe aktorët në Tiranë dhe Prishtinë: “Të përuken në gjunjë para historisë së përgjakshme dhe përgjegjësi shtetërore, për t’i dhënë jetë Platformës së Partneritetit Strategjik: Dy Shtete sovraane një Komb i vetëm”, duke konfirmuar në Uashington, Bruksel, etj., se “edhe pse e vonuar” kjo qasje nuk kërcënon asnjë vend, përfshi Serbinë, përkundrazi do të kontribuojë si balancë racionale për paqen afatgjatë dhe Integrimin Euroatlantik të popujve dhe vendeve të rajonit”.



Komandanti
i Batalionit
të Forcave
Speciale,
nënkolonel
Bledar Lama

Forcat Speciale, *heronjtë e heshtur të* Forcave të Armatosura

INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI

Njësia speciale e Forcave të Armatosura nuk vepron vetëm në territorin shqiptar, por edhe në rajon, ajo është konsideruar nga NATO si njësi më elitare e Ushtrisë Shqiptare si dhe një nga njësitë më të mira të operacioneve speciale. Kjo njësi është e ngarkuar me operacione të posaçme në kohë lufte dhe para së gjithash me kundër-terrorizmin në kohë paqeje. Për punën dhe përkushtimin e djemve dhe vajzave të kësaj njësie, që prej krijimit të saj dhe misionet në të cilat na kanë bërë krenar, për shtypin ushtarak, në këtë 25-vjetor, komandanti i Batalionit të Forcave Speciale, nënkolonel Bledar Lama sjell punën, sakrificën dhe përkushtimin deri në vetëmohim të kësaj njësie speciale.

Nënkolonel Lama, me kontribut të çmuar në këtë njësi elitë të Forcave të Armatosura, në këtë rrugëtim ka ushtruar dhe detyra të rëndësishme si: Zv/Komandant i Batalionit të Forcave Speciale; Shef Shtabi në Batalionin e Forcave Speciale; Komandant në Kompaninë e Parë të Batalionit të Forcave Speciale; Negociator dhe Psikolog në shtabin e Batalionit të Forcave Speciale; Specialist për Përpunimin e Informacionit në shtabin e Batalionit të Forcave Speciale; Specialist për Stërvitjen në shtabin e Batalionit të Forcave Speciale; Komandant Grupi në trupën e batalionit të Forcave; Komandant Kontingjenti në mision e KFOR-it, Pejë, Kosovë; Specialist Zbulimi në Shtabin e Kontingjentit "Eagle 3" (Mision Luftarak Eagle) Kandahar, Afganistan; Specialist Zbulimi në Shtabin e Kontingjentit "Eagle 6", (Mision Luftarak "Eagle") Kandahar, Afganistan; Komandant grupi në Misionin "Liria Irakut", Mosul, Irak.

Kur është krijuar Batalioni i Operacioneve Speciale?

Batalioni i Forcave Speciale është krijuar me Vendim të Këshillit të Mbrojtjes nr.2, datë 16 tetor 1998. Qëllimi kryesor i krijimit të kësaj njësie ishte që të krijohet një forcë elitë e kombit që të përballonte turbulencat politike, ekonomike e ushtarake që po

kalonte vendi pas viteve '90, siç ishte rasti i pa precedentë i sulmit të organizuar ndaj repartit të Pëshkëpisë, ku humbën jetën disa ushtarakë, apo ngjarjet e 97-ës, ku destabilizuan vendin.

Kjo njësi u krijua pikërisht me qëllimin e vetëm të kalonte vijën e operacioneve klasike konvencionale, duke patur në gjirin e saj operatorë specialë të aftë të vepronin me grupe të vogla në fshehtësi të plotë por me efekt të madh për interesat e vendit. Kjo njësi do të operonte brenda dhe jashtë vendit në luftën kundër terrorizmit dhe formave të tjera të kërcënimeve kur lypset nevoja dhe të përdorej si aset i rëndësishëm i FA-së për të kryer detyra direkte, zbulim special apo asistencë ushtarake, gjë që forcat e tjera konvencionale nuk i përbushnin dot.

BOS, si u krijua njësi e operacioneve speciale në Ushtri?

Vendi i dislokimit të Forcave Speciale fillimisht ishte në rajonin e Farkës dhe momentalisht ndodhet i dislokuar Zall-Herr, Tiranë. Aktivitetin repartit e ka filluar më datë 24.02.1999 dhe ishte i përbërë nga Shtabi dhe 4 grupe speciale.

Komandanti i parë i Batalionit Special ka qenë kolonel Hysen Ymeri, një nga zbuluesit më të mirë të ushtrisë, i cili ka dhënë një kontribut mjaft të çmuar në ngritjen dhe zhvillimin e kësaj njësie.

Krijimi i Forcave Speciale u konsiderua i një rëndësie të veçantë, pasi për herë të parë Forcat tona të Armatosura kishin në gjirin e vet një njësi elitë e aftë të vepronin në tre dimensionet tokë-ajër-det për t'i paraprirë çdo lloj forme kërcënimi apo rreziku me një shpejtësi dhe aftësi të jashtëzakonshme.

Cila është rëndësia e Forcave Speciale?

Rreziqet kombëtare po afirmohen gjithnjë e më shumë si modele asimetrike e hibride dhe se përballja ndaj tyre kërkon metoda të veçanta që kalon përtej koncepteve konvencionale. Të gjitha këto ndryshime në qasjen me sigurinë dhe format hibride që po përdorin vendet si Rusia kryesisht ndaj vendeve Baltike dhe Ballkanit perëndimor na dikton nevojën për të patur Forca Speciale të afta t'i përgjigjen në çdo kohë këtyre ndryshimeve. Mjedisi i sotëm strategjik karakterizohet, si kurrë ndonjëherë më



parë, nga e panjohura dhe nga e paparashikuara. Skena e sigurisë botërore influencohet, përditë e më tepër nga shtete autokrate dhe organizata terroriste, të cilat po arrijnë të krijojnë rrezeqe e kërcënime për sigurinë e përgjithshme në mbarë botërore. Konflikti i fundit mes Izraelit dhe organizatës terroriste të Hamas apo ai Rusi-Ukrainë kanë nxjerrë në pah domosdoshmërinë e zhvillimit dhe integritetit të Forcave Speciale në këtë mjedis, duke përqafuar metodat, konceptet dhe teknologjitë e fundit të përdorura në këto luftime.

Si është i organizuar ky batalion?

Forcat Speciale sipas doktrinės së NATO-s, SOF-së dhe kushteve e kërcënimeve në mjedisin e sigurisë rajonale e globale konsiderohen asete strategjike të një vendi.

Ato janë njësi të specializuara, të mirë organizuara, të mirë trajnuara dhe të kompletuara me personel të përzgjedhur në bazë të një trajnimit të gjatë taktik-psikologjik dhe të aftë për t'u përshtatur me metodat jo-konvencionale në qasjen me objektivin. Këto operacione mund të kryhen në një spektër të plotë në një mjedis të përbashkët operacional, të pavarura ose me forcat konvencionale, për të ndihmuar të arrijë gjendjen e dëshiruar.

Batalioni special është i organizuar e strukturuar në bazë të reformimit të fundit të gjithë FA-së dhe është pjesë e Regjimentit të Operacioneve Speciale, (ROS) duke pasur në organikë kompani të operacioneve speciale me drejtim tokë-ajër-det e aftë të planëzojë e zhvillojë operacione speciale me spektër të plotë në një mjedis të përbashkët operacional. Batalioni special zotëron aftësi dhe kapacitetet e nevojshme të përmbushë me sukses tre detyra bazë që janë aksionet Direkt (AD), Asistencë ushtarake (AU) dhe Zbulim Special (ZS).

Batalioni Special zotëron teknologjinë e fundit të pajisjeve dhe modernizimit si mjete të shikimit natën, shënjestër lazer për armët, kamera termale dhe mjete motorike ujore të gjeneratës së fundit që mundësojnë këtë njësi të përmbushë të gjitha detyrat specifike që i ngarkohen.

Batalioni special është njësi unike në llojin e vet pasi operon në tre drejtimet si tokë-ajër-det në një konceptim krejtësisht ndryshe nga kapacitetet konvencionale. Kjo nënkupton që batalioni special duhet të balancojë dhe modernizojë të gjitha këto kapacitete në të tre drejtimet. Por mbetet sfida akoma për t'u zhvilluar kapaciteti ajror, pasi në konceptet dhe doktrinat e NATO-s SOF-së, çdo njësi e Forcave Speciale duhet të zotërojë asetet e veta ajrore të dedikuara për operacionet speciale. Kjo njësi aktualisht nuk i ka në dispozicion kapacitetet ajrore por ka planifikuar t'i ketë në të ardhmen e afërt. Por, gjithsesi ky kapacitet mund të ofrohet edhe nga vendet aleate nëse kërkon nevojë për t'u dislokuar në komandat e SOCC-së të operacioneve speciale. Gjithashtu në rekomandimet e komandës së SOFCOM në NATO SHAPE apo në doktrinat bazë të SOF si AJP3.5, Forcat Speciale duhet të kenë komandim-kontroll të shkurtër dhe të qartë në mënyrë që të sigurohet pavarësia dhe të mos dekonspirohet operacioni. Pra rekomandohet që varësia e Forcave speciale të jetë direkt nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm. Misionet e forcave speciale ndryshojnë nga ato klasike konvencionale nga metoda e qasjes me objektivin. Në mjedisin e sotëm të sigurisë po gjenerohen gjithnjë e më shumë metoda asimetrike të luftës dhe kjo situatë kërkon medoemos përdorimin e forcave speciale pasi misionet klasike konvencionale nuk mund të jenë efektive në këtë mjedis. Misionet e forcave speciale janë më pak të kushtueshme pasi vetëm një grup i vogël operatorësh mund të kryejnë detyra me efekt operacional-strategjik për vendin.

Konsideratat politiko-ushtarake mund të kërkojnë operacione klandestinë ose teknikat e fshehta dhe pranimin e një shkalle të



lartë rreziku politik apo ushtarak që nuk mund të realizohet me operacione nga forcat konvencionale.

Cilat janë karakteristikat dhe cilësitë që i bëjnë operacionet speciale të jenë unike?

Operacionet speciale janë unike, sepse ofrojnë zgjidhje strategjike të problemeve ose i shërbejnë nivelit operacional dhe plotësimi të objektivave politike. Forcat speciale janë, nga natyra, bashkëpunuese dhe të gjithanshme.

Forcat speciale (FS) janë organizuar në mënyrë të tillë që të bashkëpunojnë me forcat ajrore, forcat detare dhe tokësore nga vendet kontribuuese të trupave (TCNs), që përbëjnë një direktivë speciale të veçantë për misionin dhe komandën e komponentëve të operacioneve (SOCC), me një staf të përbashkët për të planifikuar dhe drejtuar operacione speciale.

Forcat speciale të NATO-s konsiderohen asete strategjike për t'u përdorur dhe menaxhuar për arritjen e objektivave strategjike dhe në disa raste të zhvillojnë detyra në nivel operativ.

FS-të janë të organizuar përmes një SOCC që së bashku me komandat e komponentëve të forcave tokësore, ajrore dhe detare qëndron në gatishmëri për misione të ardhshme.

Operacionet speciale zhvillohen në një zonë të përbashkët operacionesh (JOA) me forcat e tjera ajrore, tokësore dhe detare. Në këtë kontekst një komandanti të nivelit operativ i krijohet efekt i madh sinergjik me unitetin e komandës, integrim në nivel operacional të forcave dhe siguron mbështetje për forcat e tjera të NATO-s. Operacionet speciale zakonisht kryhen me risk të lartë pasigurie në mjedis krejtësisht armiqësor dhe sensibilitet të lartë politik, duke krijuar efekte që mbështesin arritjen e objektivat gjithëpërfshirëse strategjike-operacionale. Këto operacione zhvillohen duke përdorur aftësitë dhe teknikat të fshehta infiltruese dhe kërkojnë pjekuri dhe trajnim maksimal për shkak se dështimi ka efekte politike. Operacionet speciale mund të zhvillohen në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me forcat konvencionale dhe mund të përfshijnë bashkëpunim dhe planëzim të përbashkët ndërinstitucional si me forcat tona po ashtu edhe forcave indigjene ose ato rezervë.



Nga ndryshojnë misionet konvencionale nga ato speciale?

Operacionet speciale ndryshojnë nga operacionet konvencionale për vetë shkallën e rrezikut politik, teknikat operacionale, mënyrat si bëhet qasja me objektivin, varësia nga intelijenca e detajuar operacionale dhe përdorimi i faktorëve indigjenë. Operacionet speciale janë unike në llojin e vet sepse varen shumë nga cilësitë, aftësitë taktike-fizike e psikologjike të operatorëve specialë që mund të krijojnë kushte shumë të favorshme për faktorin konvencional në një komandë të bashkuar operacionale. Operacionet speciale zhvillohen në thellësi të prapavijës së kundërshtarit dhe veprojnë në fshehtësi të plotë, duke i shkaktuar dëme psikologjike atij.

Operacionet speciale karakterizohen nga disa parime si: Tempo e lartë operacionale, ku shpejtësia dhe objektivi janë të lidhura pazgjidhshmërisht, pasi mund të gjendesh nën presionin e kohës për neutralizimin apo eliminimin e objektivit të kërkuar. Forcat speciale duhen integruar që në gjenezën e një konflikti pasi janë të afta të ndihmojnë leadershipin ushtarak me këshilla operacionale e strategjike për të analizuar faktorët politik, ekonomik e ushtarak që ndikojnë në një konflikt.

Operacionet speciale zakonisht merren me forcën e rëndësës së kundërshtarit dhe si objektiva mund të jenë VIP-a civil ose ushtarak. Operacionet speciale udhëhiqen nga parimet si fleksibilitet, zhdërvjelltësia dhe përshtatshmëria në mjedisin operacional. Ato zakonisht kryhen me risk të lartë pasigurie në mjedis krejtësisht armiqësor dhe sensibilitet të lartë politik, duke krijuar efekte që mbështesin arritjen e objektivat gjithëpërfshirëse strategjike-operacionale. Këto operacione zhvillohen duke përdorur aftësitë dhe teknikat të fshehta infiltruese dhe kërkojnë pjekuri dhe trajnim maksimal për shkak se dështimi ka efekte politike.

Operacionet speciale mund të zhvillohen në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me forcat konvencionale, të cilat përfshijnë bashkëpunim dhe planëzim ndërinstitucional si me forcat tona po ashtu edhe forcave indigjene ose ato rezervë. Operacionet speciale janë unike në llojin e vet sepse varen shumë nga cilësitë aftësitë taktike-fizike e psikologjike të

operatorëve specialë që mund të krijojnë kushte shumë të favorshme për faktorin konvencional në një komandë të bashkuar operacionale. Operacionet speciale zhvillohen në thellësi të prapavijës së kundërshtarit dhe veprojnë në fshehtësi të plotë duke i shkaktuar dëme psikologjike atij.

Disa prej operacioneve ku Forcat Speciale të ushtrisë shqiptare kanë qenë të pranishme?

Që nga krijimi, Forcat Speciale kanë marrë pjesë në shumë operacione dhe misione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Operacionet e para kanë filluar gjatë konfliktit të Kosovës në vitin 1999. Gjatë kësaj kohe prej gjashtë muajsh grupet speciale të Batalionit Special kanë marrë pjesë aktive në monitorimin e kufirit. Në vitin 2001- 2002 grupet Speciale të FS-së morën pjesë në bashkëveprim me forcat e policisë së Shtetit për vendosjen e Rendit Kushtetues dhe qetësisë publike në rrethin e Tropojës, duke kryer shumë shërbime Speciale. Në vitin 2001 në kohën e konfliktit me armë kundër shqiptarëve të Maqedonisë katër grupe speciale kanë marrë pjesë në monitorimin e kufirit shtetëror në Republikën e Maqedonisë, si dhe kanë kryer detyra të ndryshme zbulimi. Në vitin 2003-2004 Batalioni i Forcave Speciale ka marrë pjesë në shumë misione, ku detyrat kryesore kanë qenë monitorimi i gjithë vijës bregdetare, lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, drogës, armëve në bashkëveprim me forcat e kundër-terrorit të Ministrisë së Brendshme, duke bërë të mundur realizimin me sukses të plotë të gjitha misionëve të ngarkuara. Por Forcat speciale kanë zhvilluar disa misione jashtë vendit si në Irak, Afganistan, Kosovë konkretisht: Në gusht të vitit 2002 deri në shtator të vitit 2004, batalioni i Forcave Speciale ka marrë pjesë në 4 misione paqeruajtëse në Kabul të Afganistanit nën komandën e ISAF. Nga viti 2005 deri në vitin 2008 batalioni i Forcave Speciale ka marrë pjesë me dy grupe speciale në operacionin "Liria e Irakut", Mosul, Irak. Misionet e forcave speciale arritën kulmin e tyre me pjesëmarrjen në misionet luftarake "Eagle" nga viti 2010 deri në vitin 2014, duke zhvilluar gjithsej 8 misione luftarake.

Misioni juaj në mbrojtje të jetës patjetër ka dhe 'koston' e vet, a kemi jetë të humbura, në emër të jetës?

Me të gjitha angazhimet e suksesshme në misionet luftarake apo në ato të paqes, Batalioni Special ka patur edhe humbje jete, ku vlen të përmendet heroizmi i Kapiten Feti Voglit, i cili sakrifikoi gjithçka për paqen e sigurinë në botë. Vepra dhe lavdia e tij janë tashmë pjesë e pandarë e aktivitetit tonë të përditshëm si brenda dhe jashtë vendit, duke na shërbyer si frymëzim e krenari për të vijuar plotësimin e ëndrrës së tij për patur sa më shumë paqe e harmoni në botë.

Forcat speciale sot kanë një vizion të qartë për zhvillimin e rezistencës dhe qëndrueshmërisë kombëtare, duke qenë para-rojë e ndryshimeve në mjedisin e sigurisë. Sulmet hibride me strategjitë e fshehura, miksimi i taktikave konvencionale me ato jo-konvencionale, sulmet kibernetike, dezinformimi, lufta psikologjike, na bën të vetëdijshëm mbi rolin e forcave speciale në ngritjen e strategjive të rezistencës kombëtare, shumëzimin e forcave, forcimin e partneritetit publik-privat, komunikimin strategjik dhe qasjen gjithëpërfshirëse me të gjithë aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë.

Jemi të bindur dhe të përgatitur për të përmbushur të gjitha detyrimet tona në kuadër të mbrojtjes së vlerave të padiskutueshme të aleancës sonë NATO, duke u përballur direkt me sfidat dhe kërcënimet asimetrike për të siguruar lirinë e prosperitetin e popujve tanë.

“Jeta jote rezulton më interesante nëse përdor rroba që kanë identitet”



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Traditë, doke apo shprehi”, thënë ndryshe në morinë e fjalëve të huazuara që tashmë janë kthyer në ‘trendin’ e fundit të përdoruesve të gjuhës shqipe, ‘etikë’. Fjala etikë vjen nga fjala greke ‘ethos/ethikos’, e cila është tregues i një degëzimi të posaçëm të shkencës së filozofisë që merret me vlerat themelore të marrëdhënieve ndër-njerëzore, si një tregues i një disipline që ka të bëjë me të mirën e të keqen, detyrimet morale, si një tërësi e parimeve dhe vlerave morale që e qeverisin një individ ose grup.

Por, si administrohet ‘etika’ në institucionet shqiptare?

Vlera të tilla janë pjesë e shoqërisë dhe natyrshëm reflektohen në çdo aspekt të shfaqjes së veprimtarisë njerëzore, përfshirë këtu edhe punën. Madje, do të thosha që në marrëdhëniet e punës pritet që vlerat etike të jenë edhe më shumë të pranishme.

Sektori publik është krijuar dhe funksionon mbi bazën e disa rregullave të pranuar, është krijuar për t’i shërbyer sa më shumë personave, duhet të reflektojë besim, transparencë, llogaridhënie, etj. Qytetarët presin që punonjësit në administratën publike t’i shërbejnë atyre me ligjshmëri, paanësi, korrektësi, integritet, transparencë, lehtësi, pa kosto. Pra, qytetarët presin që ndërkohë që marrin shërbimin nga administrata e tyre publike, ta marrin atë të shërbyer edhe në mënyrën e duhur, me etikë.

Historia ka treguar se mendje të mençura kanë bërë revolucione të mëdha siç është dhe Zhan Zhak Rusoi, i cili theksonte se “urtësia e pushtetit, veprimi i ligjeve, ndershmëria e shefave, besimi i popullit, janë në themel të institucioneve”.

A është etika vetëm rregulla morale?

Ajo që mund të thuhet është se lidhja me moralin është e padiskutueshme dhe madje themeli i së tërës, ndërkohë që shndërrimi në kategori juridike e vendos etikën në shtratin e të detyrueshmes.

Etika, si tipar themelor i administratës publike, është çështje morali dhe vlerash, por edhe kategori juridike e pranuar dhe promovuar në nivele të ndryshme legjislativore.



Në ambientet e punës, kryesisht në Administratën Shtetërore, për punonjësit është parashikuar një kod pune, që ndryshe mund të përkthehet edhe kodi i seriozitetit, e nga viti në vit imazhi i punonjësve ka ardhur duke u kuruar.

Kështu, shapkat me gisht, minifundet, dekolletë, bluzat transparente apo fustanet ekstravagante, për femrat, si dhe pantallonat e shkurtra, bluzat me mbishkrime, për meshkuj, janë rreptësisht të ndaluara për punonjësit e administratës.

E thënë me fjalë të thjeshta, punonjësit, si femrat ashtu edhe meshkujt, duhet të kenë një veshje serioze, të mos zbulojnë pjesë të trupit, si dhe të jenë të kujdesshëm me përzgjedhjen e ngjyrave apo aksesoreve shoqëruës.

Por si është realiteti?

Dëshira shqiptare për t’iu përngjarë deri në detaje ‘sjelljeve europiane’, ka marrë përmasa të mëdha. Emancipimi ynë po vihet re gjithnjë e më tepër në sjelljet tona, botëkuptimi dhe sidomos mënyra e të veshurit.

Kjo tendencë nxitet nga dëshira e brezave të sotëm për të qenë sa më shumë modernë, trendi dhe ekstravagantë. Megjithatë pjesa më e madhe janë të bindur se ky stil veshjeje i unifikon me vendet perëndimore, ky perceptim është i gabuar, jashtë realitetit dhe nuk bën gjë tjetër veçse na bën të dukemi jo seriozë në sytë e Europës dhe të tjetërsojmë, dashur-padashur, elementet e kulturës së zhvilluar perëndimore në kulturën shqiptare.

Shqipëria po aspiron gjithnjë e më tepër që të përfshihet në familjen e madhe të Bashkimit Europian si në aspektin politik, ekonomik, ashtu edhe në atë social e kulturor.

Këto tendenca përbëjnë një problem akoma më serioz pasi ato tashmë janë bërë pjesë e jetës së përditshme, duke mos bërë dallim në varësi të ambienteve ku ndodhen. Përveç ambienteve të argëtimit siç mund të jenë: lokalet, restorantet dhe pub-et, femrat e sotme paraqiten më të njëjtën veshje aspak të përshtatshme dhe në shkolla, universitete, institucionet e administratës publike, vendet e punës, trajnimet si dhe në praktikatat shkollore.

Nxënës të shkollave 8-vjeçare e të mesme, studente, e madje jo rrallëherë mësuese, pedagoge dhe zyrtare të institucioneve të administratës shtetërore paraqiten në vendet ku studiojnë apo ushtrojnë profesionin më të njëjtën mënyrë veshjeje provokuese dhe të ekzagjeruar, duke shkelur Kodin e Etikës. Është e vërtetë se çdo person ka të drejtën dhe lirinë të ndërtojë modelin e jetës së tij në përputhje me kënaqësitë shpirtërore individuale, por jashtë ambientit institucional dhe në përputhje me Kodin e Etikës, i cili sqaron në mënyrë shumë të qartë se: “Veshja dhe paraqitja e nëpunësit duhet të jetë serioze për të përfaqësuar denjësisht administratën publike. Veshja e nëpunësve meshkuj, sidomos në takimet zyrtare duhet të jetë më kostum, këmbishë e kravatë, ndërsa për nëpunëset femra veshja duhet të jetë serioze dhe jo ekstravagante. Nëpunësit duhet të tregojnë kujdes për higjienën personale, modelin e flokëve, të mos e teprojnë me makijazhin dhe aksesorë të tjerë në mënyrë që të jenë në përshtatje me detyrën dhe funksionin e nëpunësit të lartë të shtetit.

Në kundërshtim me realitetin shqiptar jeta e përditshme e europianëve është krejt e kundërt.

Është paradoksal fakti që pikërisht modeli perëndimor i lirisë së tepëruar në veshje, i cili frymëzon shoqërinë shqiptare, nuk përputhet me rutinën e jetës së përditshme të bashkëqytetasve europianë. Stili i veshjes nga të rinjtë europianë është sa më shumë praktik, komod dhe në përputhje me ambientin ku ndodhen.

Shumica e të rinjve europianë preferojnë veshje sa më të rehatshme, të gjëra, makijazh të përshtatshëm me moshën, jetën e përditshme dhe ambientet arsimore, duke i kushtuar luksin dhe ekstravagancën ambienteve të argëtimit zakonisht në fundjavë. Sindroma e të qenit sa më shumë tërheqëse, duke ekspozuar pjesët joshëse të trupit, është nxitur në shoqërinë shqiptare pas viteve '90, duke u shfrenuar gjithnjë e më tepër me kalimin e viteve.

Më rënien e sistemit diktatorial komunist, i cili diktonte deri në detaj sjelljen, veshjen, pamjen e jashtme të individit, ashtu si çdo aspekt tjetër në jetën e tij, solli lirinë e individit me vendosjen e demokracisë në shoqërinë shqiptare. Pas të kaluarës së dhunimit të të drejtave dhe dëshirave individuale, kjo liri e shfrenuar u përhap me shpejtësi brenda dy dekadave, duke marrë për bazë modelin perëndimor të emancipimit që shfaqet në median masive vizive, por që në realitet nuk është i tillë.

Tendencë apo ‘degjenerim’

Kjo tendencë nxitet nga një mungesë vlerësimi i vlerave të brendshme dhe të vërteta morale. Sipas tyre këta persona vuajnë nga një paafësi për të organizuar hierarkinë e vlerave të tyre personale, duke mos ditur të vendosin theksin aty ku rëndësia është më e madhe. Për këtë kategori morali nuk ekziston, ose nëse ekziston ai është i parëndësishëm. Ata mendojnë si të moralshëm çdo veprim të tyre individual dhe moraliteti njehsohet me sjelljen e shumicës, pra tendencën për t’u “zhveshur”.

Kjo lloj sjelljeje shpesh vihet re tek femrat që vijnë nga vendet rurale apo periferitë drejt vendeve të zhvilluara. Si pasojë e një ndrydhje të vazhdueshme që këto të reja hasin në familjen e tyre patriarkale, dëshirat dhe instinktet e tyre janë të shtypura për sa kohë ato jetojnë në një ambient të tillë, pra nën një kontroll të rreptë familjar. Kjo ndrydhje akumulohet gjatë viteve dhe rrezikon të shndërrohet në shfrenim, kur ato përballen më një kulturë tjetër të emancipuar, liri dhe mungesë të paragjyqimeve. Rasti më tipik është tek studentet e rretheve që ndjekin studimet e larta apo të mesme profesionale në Tiranë. Të gjendura në një ambient krejt të ndryshëm nga ai i cunguar në vendet ku kanë rritur, larg syve të prindërve dhe të afërmeve, këto të reja gjejnë terrenin dhe kushtet e përshtatshme për të realizuar dëshirat që i kanë munguar në një ambient të prapambetur.

Pasojë dhe reflektim

Ndër pasojat kryesore të kësaj “mode” të re që do rezistojë edhe për shumë kohë në shoqërinë shqiptare, nga pikëpamja kulturore shihet një devijim nga vlerat e traditës shqiptare. Historikisht shqiptarët janë mbajtur si popull fanatik dhe mbrojtës të flaktë të vlerave familjare. Institucioni familjar duket se është zbehur pas viteve '90, po të marrim parasysh statistikën që tregojnë një rritje të numrit të divorceve nga një dekadë në tjetrën dhe pranimin e veshjes aspak serioze të fëmijëve nga vetë prindërit. Kjo tendencë është më shumë e përhapur në kryeqytet, aty ku fryma e ndryshimit, emancipimit dhe burimet e të mirat materiale janë më të bollshme.

Fatkeqësisht në Shqipëri po përhapet koncepti se të vishesh bukur do të thotë të nxjerrësh në pah pjesët intime të trupit, format e rregullta, duke i konceptuar linjat joshëse si “vlera” në thelb. Por të vishesh bukur do të thotë të zgjedhësh diçka që shkon me fizikun tënd, karakterin, të dish të përshtatësh veshjen me ambientin, të dish të kombinosh. Vlerat e njeriut burojnë së brendshmi dhe disa studiues socialë bien dakord me thënien se veshja është pasqyrë e karakterit dhe personalitetit të individit. Mënyrën dhe stilin e sotëm të veshjes në Shqipëri, Europa e ka parë disa dekada më përpara dhe ky është një fakt që tregon se sa mbrapa është shoqëria shqiptare në perceptimin e saj mbi Europën dhe kulturën europiane. Por europianëve nuk iu desh shumë kohë për të kuptuar se “ecja mbi këto shina” nuk të çonte veçse në rrugë të gabuar, ose në rastin më të mirë nuk të çonte asgjëkund. Kështu ata



filluan të rimodelojnë mënyrën e jetesës, ku një pjesë të rëndësishme zuri dhe mënyra e veshjes.

Europianët iu rikthyen përsëri vlerave themelore të tyre

Ata filluan të nxjerrin nga gardërobat e tyre “petkat e pluhurosura të modestisë dhe thjeshtësisë” dhe i riveshën ato. Mënyra e tyre e të veshurit po riorientohet tek thjeshtësia dhe praktikiteti i përditshëm. Sigurisht që veshjet fine, me klas dhe pse jo sensuale nuk kanë se si të mungojnë, por ato janë të “rezervuara” vetëm për ambiente dhe raste të veçanta siç mund të jenë drekat apo darkat nëpër restorante luksi, ballo apo disko-klube. Por ajo çka dua të vë në dukje, është mënyra e të veshurit në pjesën më të madhe të ditës aktive (nuk përlllogaritet koha e qëndrimit në shtëpi), e cila është thjeshtësuar në maksimum.

Meqenëse këtë periudhë, të cilën me përkëdheli do ta quanim si periudhën e “të veshurit në mënyrë të zhveshur”, e kanë kaluar të gjitha shoqëritë moderne, kush më herët e kush më vonë, atëherë edhe shoqëria shqiptare si pjesë e shoqërisë moderne europiane nuk ka përse të bëjë përjashtim. Le të pranojmë atë çka Europa e ka pranuar disa dekada para nesh.

Dhe sot pas tre dekadash shtet demokratik le të përpiqemi të ecim mbi kode, norma dhe vlera që ‘Europa’ të na pranojë tashmë ‘pa kushte’.



“Lufta e përjetshme për tokën e shenjtë”

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Cdo epokë ka kohën e vet të marrëzisë, sindromë që racën humane e ka shoqëruar qysh në formën e saj primitive, atë të homosapiensit, dhe deri sot në zhvillimin maksimal të kapaciteteve të inteligjencës. Lufta e nisur për mbijetesë dhe e sjellë në ditët tona, si një “grykësi” e pa limit, një oreks që sa vjen dhe shtohet.

11 nëntori 1918, solli fundin e shumëdëshiruar të luftës së parë botërore. Por ai nuk solli fundin e dhimbjes. Privimet, varfëria dhe hidhërimi u zënë frymën njerëzve. Këtyre u shtohet edhe një ndjenjë si ajo që ishte luftuar më kot dhe e gjithë vuajtja ishte më kot. Por e gjitha kjo u kthye në mllëf, i cili me një ndjenjë helmuese e kthyer në terrenin ushqyes të ngjitjes politike të një ish-ushtari në front me emrin Adolf Hitler, çizmja e të cilit shkeli cep e më cep botën, për të marrë jetën e mijëra e mijëra njerëzve të pafajshëm.

Por ç’na ofron sot arena politike në këtë botë të induktuar nga dëshira për të gllabëruar atë që nuk ju takon. Dhe ‘marrëzia’ vazhdon në Europën e plakur luftërash mes Ukrainës dhe

barbarizmave ruse, për të vazhduar me luftimet midis Izraelit dhe Hamasit, që nisi një sulm të papritur, më 7 tetor, janë më të rejat në shtatë dekada luftë dhe konflikt midis izraelitëve dhe palestinezëve që kanë tërhequr vëmendjen e fuqive të jashtme dhe kanë destabilizuar rajonin më të gjerë të Lindjes së Mesme.

Njeriu, një qenie komplekse. Një qenie, e cila s’di të ndalet përpara vështirësive që i hasen rrugës së përmbushjes së synimeve të tij. Por shpesh herë, rruga që ndjekin këto synime është katastrofike. Dëshira e njeriut të pangopur për territore e pasuri natyrore, ka çuar në zhvillimin e luftërave. Kjo i ka fillesat qindra, e ndoshta mijëra vjet më parë.

Njerëzit ndër shekuj kanë luftuar ndërmjet tyre. E quanim veten, qenia më e zhvilluar në planet. Por ku shihet zhvillimi kur ti lufton kundër sojit tënd? Kur ti ke guximin të vrasësh një qenie pa asnjë ndryshim nga ty, a nuk mendon se po vret një pjesë të njerëzimit? Ndoshta edhe një gjeneratë të ardhshme që mund të sjellë ndryshimin në këtë botë. Por lakmia e dëshira për pushtet duket se ka pushtuar shpirtin e shumë prej nesh. E kur shohim dëmet katastrofike, të bëra me vetëdije, shpesh herë na shfaqet paqja. Duket se ajo është një mirazh në shkretëtirë, në aktualitetin e sotëm. Vetë historia e botës është krijuar nga luftërat e mëdha, i lexojmë nëpër libra dhe poezi i shohim nëpër piktura. Piktura që

ngjallin vuajtje, dëshpërim, ndjenja të përhumbura në një kohë ku e vetmja zgjidhje për jetën ishte të ngrije një armë dhe të luftoje. Nëse Tolstoi do të ishte mes nesh do të thoshte: “Miku im, luftëtari më i fuqishëm zotëron dy armë, durimin dhe kohën”. Nëse do ishte kështu, luftërat do të flisnin me gjuhën e mendjes dhe diplomacia do ishte zgjidhja e konfliktit.

Kujtimet tmerruese të dhembin më shumë sesa një plagë në trup

Lufta shihet si një “oqean i kuq”, ku mbi të fluskojnë armë dhe trupa të pajetë. Kjo “lojë”, e cila po merr jetë njerëzish të pafajshëm, nuk po ndalet në të gjithë botën.

Data e nisjes së ofensivës palestineze nuk është rastësore, pasi përkon me luftën e Yom Kipurit, e njohur gjithashtu si Lufta e Ramazanit, e Tetorit, Lufta e katërt Arabo-Izraelite, që ishte një konflikt i armatosur i zhvilluar nga 6 deri më 25 tetor 1973 midis Izraelit dhe një koalicioni shtetesh arabe, të udhëhequra nga Egjipti dhe Siria. Pjesa më e madhe e luftimeve midis dy palëve u zhvillua në Gadishullin Sinai dhe Lartësitë e Golanit, të dyja të pushtuara nga Izraeli më 1967. Objektivi fillestar i Egjiptit në luftë ishte të kapte një terren në bregun lindor të Kanalit të Suezit dhe më pas të përdorte këto përfitime për të negociuar kthimin e pjesës tjetër të Gadishullit Sinai të pushtuar nga Izraeli.

Për të udhëtuar edhe më tej në lashtësi, zanafilla buron nga pretendimi se cili popull është autokton apo më i lashti në tokën e shenjtë. Hebrenjtë pretendojnë se ata thjesht po kthehen në rrënjët e tyre, duke e zbrëthyer orën në kohët e Dhiatës së Vjetër. Madje izraelitët pretendojnë se kanë jetuar në atë territor të paktën 3700 vjet më parë, ndërsa janë detyruar të zhvendosen në vitin 70 pas Krishtit, sepse Romakët shkatërruan tempullin e dytë të tyre në Jeruzalem. Gjithashtu izraelitët besojnë se termi “Palestinë” besohet se rrjedh nga filistinët, një popull i Egjeut, i



cili, në shekullin e 12-të para Krishtit u vendos përgjatë fushës bregdetare të Mesdheut të asaj që tani është Izraeli dhe Rripi i Gazës.

E vërteta për Palestinezët është plotësisht ndryshe

Ata pretendojnë se kanë qenë aty që nga fillimet e njerëzimit dhe më pas janë përzierë më të gjitha formacionet e emigrimeve përgjatë shekujve, nga Mesdheu e deri të vendet arabe. Duke iu referuar po të njëjtit libër të shenjtë në të cilin besojnë vetë hebrenjtë, palestinezët besojnë se ky popull i përket një grupi skllëvërisht të dëbuar nga Egjipti i periudhës faraonike.

Dhe sa e vërteta të gjejë rrugën e saj, nënat do vazhdojnë të klithin vajtueshëm për humbjen e jetëve të fëmijëve të tyre. Gjithçka e ndërtuar me mund dhe sakrificë do të kthehet në shtëllunga të mëdha tymi. Dhe për brezat do të jetë: “Dhe historia vazhdon....”.



GRATË E FORTA KËRKOJNË RESPEKT, JO VËMENDJE

Oprah Winfrey thotë: “Bëj lëvizjen e duhur të radhës, e pastaj lëvizjen e duhur të radhës, sepse ti e di që jeta jote është shumë më e madhe se ai moment”. Harroje që duhet të arrish atë që të tjerët mendojnë se “duhet” ta arrish.”

Zgjidh të ndjekësh zemrën dhe intuitën tënde, të kuptosh lëvizjen e duhur të radhës do të thotë të lejosh mendjen tënde të forcohet, pa marrë kështu në konsideratë fare se çfarë është “e nevojshme” të bëhet apo të mos bëhet.

Përgatitu për “Momentin që do të vijë”

Pavarësisht asaj që mund të jetë perceptuar si një pengesë në jetë, të gjithë kemi aftësinë të shtyjmë përpara dhe të harrojmë paafësitë e të shkuarës.

Ata që besojnë tek fati do të lënë mënjatë pengesat e jetës dhe do të ecin përpara. Gjërat që kanë ndodhur në jetën tënde, të mira a të këqija, të kanë përgatitur pikërisht për atë që duhet të jesh, në momentin që je duke përjetuar. “Planifikimi” është një anomali për këtë mënyrë të menduari. “Ndërgjegjja” dhe vetëdijesimi janë avantazhe përgatitore; jo strategjia dhe përpikëria.

Harroji Gabimet

Harro çdo gabim që ke bërë ndonjëherë. E ardhmja nuk do të përcaktohet asnjëherë prej të shkuarës. Mos kufizo aftësitë e tua thjesht për shkak të ndonjë gabimi. Të gjithë bëjnë gabime. Është mënyra si zgjedh të reagosh ndaj tyre, që përcakton suksesin apo dështimin.

Mos mbaj mëri, dhe mos hiq dorë nga fuqia jote. Je më mirë se kaq... dhe vetëm ti vendos se çfarë ndodh.

Rreshtoji personalitetin dhe dhuntitë e tua me një qëllim real
E shohim përditë, pavarësisht nëse e kuptojmë ose jo; njerëzit janë fundosur prej trysnisë brenda vetes së tyre, shoqërisë, familjes, me qëllim që të kenë një mënyrë “normale” jetese (për shembull “një vend pune”), për të cilën s’kanë qenë asnjëherë të përshtatshëm.

Harrojeni këtë lloj marrëzie. Askush nuk do të sjellë ndonjëherë një person me aftësi që janë si të tuat. Fuqizojë veten, ndiq

“NJË GRUA E FORTË E DI SE KUSH ËSHTË DHE SE ÇFARË DËSHIRON. AJO KA GRUPIN E SAJ TË ËNDRRAVE DHE NUK DO TË LEJOJË QË DIKUSH TA MBAJË PENG ATË NGA ARRITJA E SYNIMEVE TË SAJ. ASGJË NUK MUND TA NDALE ATË!”

pasionin, harroje “destinimin”, dhe lejoi gjërat të shpalosen si të munden.

Mos shih kufizimet

Sado larg që kemi shkuar si shoqëri, gratë nuk perceptohen po aq “të afta” sa burrat. Mendojeni për një sekondë dhe kuptoni se sa i shpifur është ky fakt: SHBA-ja ka pasur 45 presidentë dhe asnjëra nuk ka qenë grua.

Gratë e suksesshme nuk munden të kufizohen prej çdo lloji “dobësie” apo kufizimi. Ja si e thotë Ursula Burns, një grua afro-amerikane dhe CEO e “Xerox”: “Të gjitha duhet të jemi më të paduruara me status quo-n... duhet ta zhvendosim theksin tek mënyra jonë e të menduarit... nga të menduarit përse uria, varfëria dhe padrejtësia ekzistojnë në botë, tek mënyra si ato mund të eliminohen... Me fjalë të tjera, të gjitha duhet të jemi pak më të paduruara”.

Gratë duhet të jenë këmbëngulëse kur përpiqen të arrijnë suksesin. Ato duhet të rrokin shanset që u paraqiten. Nuk është turp për ta bërë këtë gjë... burrat kanë shekuj që e bëjnë.

Qëndro me këmbë në tokë

Të gjithë kemi dhunti dhe kufizime, dhe të gjithë kemi aspirata të ndryshme. Madje kemi edhe një farë konfuzioni, për atë se çfarë duhet apo nuk duhet të jenë këto aspirata. Zgjidhja jo dhe aq e thjeshtë, është të mbetesh e vërtetë me vetveten.

Harroji gjithë të tjerët; harroje se si të perceptojnë ata që ke



përreth. Kupto çfarë është e rëndësishme për ty, vazhdo të jesh modeste, dhe mbaj në mendje edhe veten, edhe të tjerët.

Nëse arrin një farë suksesi, mos u mburr. Kupto rëndësinë e përlësisë, një tipar shumë fisnik që mungon në botën e sotme. Më e bukura është që, duke ruajtur këtë lloj sjelljeje, më shumë njerëz do të jenë të gatshëm të ndjekin udhëheqjen tënde.

Ka mijëra shtigje për të qenë një grua e suksesshme, megjithëse ka edhe mure dhe kufizime. Por ka edhe disa rregulla që një grua të arrijë atë që do, suksesin.

Gratë e forta kanë besim në vetvete

Një grua e fortë e di se kush është dhe se çfarë dëshiron. Ajo ka grupin e saj të ëndrrave dhe nuk do të lejojë që dikush ta mbajë peng atë nga arritja e synimeve të saj. Asgjë nuk mund ta ndalë atë!

Ajo nuk ka nevojë për mbështetje nga askush. Ajo gjithashtu nuk ka nevojë të kërkojë miratim nga askush. Gratë e fuqishme marrin vendimet e tyre me vetëbesim dhe nuk kanë frikë të përballen për zgjedhjet e tyre.

Gratë e forta kërkojnë respekt, jo vëmendje

Ju kurrë nuk do të shihni një grua të fortë duke kërkuar vëmendje. Ajo kurrë nuk do të jetë e interesuar të lypë as për dashuri. Kur një grua e fortë ndihet e padëshiruar, ajo thjesht e lë situatën dhe largohet.

Respekti është shumë më i vlefshëm se vëmendja. Ai zgjat më shumë se 15 minuta famë. Respekti është një nga çelësat thelbësorë të suksesit.

Gratë e forta nuk kanë kohë për marrëdhënie toksike, ku ajo bëhet e paarritshme. Mungesa është dhurata e saj për ata që nuk

e kuptojnë se çfarë do të thotë të jesh në praninë e saj.

Gratë e forta kurrë nuk e krahasojnë veten me të tjerët

Gratë e forta njohin kufijtë dhe aftësitë e tyre. Ato e dinë se janë të denja për respekt. Gratë e fuqishme nuk kanë nevojë ta krahasojnë veten me të tjerët.

Askush nuk është i përsosur dhe një grua e fortë është shumë e vetëdijshme për këtë. Megjithatë, ajo gjithashtu e di se secili ka dhuntinë e vet unike. Ajo pëlqen të mbështesë të tjerët.

Një grua e fortë nuk ka frikë të qajë

Ajo e di se të qenit e lëndueshme është në të vërtetë një shenjë e forcës. Ajo e di se ajo është mjaft e fortë për ta rimarrë veten. Ajo është gati të shërohet.

Një grua e fortë nuk heq dorë kurrë, ajo gjithmonë ka arsye të vazhdojë të luftojë.

Një grua e fortë gjithmonë do t'ju tregojë të vërtetën, pa marrë parasysh sa e vështirë është

Shpesh herë, të thënë të vërtetën mund të jetë një rrezik i madh dhe mund të përfundojë duke dëmtuar dikë. Sidoqoftë, gratë e forta besojnë se të treguarit të vërtetës është thelbësore. Ato e dinë se është një gjë e rrallë.

Gratë e forta janë të guximshme dhe kanë një zemër të mbushur me synime të mira. Ajo shkëlqen si një diamant i pagdhundur!

Nëse e njihni një grua të fortë, mbajeni afër zemrës! Mos kini frikë ta ndani me to këtë artikull dhe t'ia bëni të ditur vlerësimin që keni për të.

Gra të thjeshta me një buzëqeshje të zemrës, janë një burim frymëzimi që të gjithë i admirojnë.



Ç'do të thotë të jesh grua ?!

Fëmija i vogël e pyet nënën:

- Përse po qan?

- Sepse jam grua, - i thotë nëna.

- Nënë, nuk po të kuptoj, - iu përgjigj djali.

Nëna e afron nga vetja e përqafton dhe i thotë:

- As që do më kuptosh ndonjëherë, biri im...

Më vonë fëmija e pyet babanë e tij:

- Përse po më duket se nëna po qan pa arsye?

- Të gjitha gratë qajnë pa arsye, - kështu iu përgjigj i ati fëmijës.

Fëmija i vogël u rrit dhe u bë burrë, por nuk e kuptoi përse qajnë gratë. Në fund iu drejtua Zotit dhe kur Zoti iu lajmërua, e pyeti:

- O Zot, përse gratë qajnë aq lehtë? Zoti u përgjigj:

"Kur e krijova gruan, mu desh ta krijoj të mbinatyrshme. Ia kam dhuruar supet aq të forta që ta mbajë peshën e botës dhe njëkohësisht aq të buta që të krijojë rehati... Ia kam dhënë forcën e brendshme që të përballojë lindjen e fëmijës dhe mospranimin, të cilin shumë herë e përjeton nga vetë fëmijët e saj. Ia kam dhënë forcën, e cila e ndihmon që gjithmonë të shkojë përpara, edhe atëherë kur të gjithë të tjerët dorëzohen, të kujdeset për familjen e saj edhe atëherë kur është e sëmurë dhe e lodhur, gjithnjë pa u ankuar. Ia kam dhuruar ndjenjat që t'i dojë fëmijët e saj, pavarësisht se ata ndonjëherë e lëndojnë atë thellë në shpirt. Ia kam dhënë fuqinë që ta pranojë bashkëshortin me të gjitha mungesat që ka dhe e kam krijuar atë nga grindjet e tij që t'ia mbrojë zemrën.

Ia kam dhënë zgjuarsinë që ta dijë se bashkëshorti i mirë asnjëherë nuk e lëndon gruan e tij, por nganjëherë e provon

forcën dhe vendosmërinë e saj për të qëndruar pranë tij deri në kundërshtime.

Në fund ia dhurova lotin që derdh, i cili i përket vetëm asaj që ta shfrytëzojë sa herë që të ketë nevojë për t'i përballuar sfidat e jetës. Në këtë lot ka me të vërtetë të drejtë, sepse askush nuk mund të përballojë kaq shumë pa thënë asnjë fjalë, sa gruaja në të vërtetë është në gjendje të përballojë!

Të gjitha e meritojnë dashurinë, për durimin e tyre, forcën, zgjuarsinë, ndjenjën dhe qëndrueshmërinë. Por, të lutem mos harro që ta ndash këtë me të gjithë burrat që i njeh dhe të cilët "ende nuk e dinë përse qajnë gratë".

Unë, ti, ne...

Të jesh grua do të thotë të jesh dy herë njeri. Të vuash dy herë, të përpëlitesh në dhimbjen e ekzistencës dyfish, të ndjesh se mizoria e botës të ka ty në shënjestër të parën. Të jesh grua do të thotë të pozicionohesh përherë në mbrojtje, të kesh përherë dikë ndaj të cilit të rebelohesh, të durosh vetëdijen mbytëse se liria për ty është përjetësisht utopike. Të jesh grua do të thotë të të ngarkojnë me barrën e rëndë të dy dramave njëkohësisht; atë të qenit njeri, dhe atë të qenit grua.

Çdo gjë është ndryshe kur je grua. Çdo gjë

e cila mund të të falë ndjesinë e të qenit e lumtur që je, që ekziston, si flladi i freskët i një pasditeje vere, është aty për të të kujtuar historinë e një bote të uzurpuar nga të tjerët, e një bote që nuk të përket. Kur je grua, stinët shkojnë dhe vijnë për të shënuar lumturinë e atyre që zotërojnë stinët, tokën, oqeanin, deri dhe jetët e njerëzve. Të jesh grua, dhe e vetëdijshme që je grua, do të thotë të mbytesh çdo ditë në vetëdijen tënde, të qash çdo ditë për lirinë...lirinë që mirëpret dhe lëkund ëndërrimtare në prehrin e vet ata, të tjerët. Të jesh grua do të thotë të presësh dhe të përcjellësh nga kjo botë gra, të cilave u falet një grimcë nga ajo... dhe u këshillohet të falënderojnë për të, e ti të vuash për çdo grimcë bote të dhuruar kaq poshtërsisht, të ndjesh nën lëkurë dhimbjen e heshtur të të ngjashmeve me ty.

Kur je grua, gjithçka që të përket është e të tjerëve, vetë qenia jote nuk është e jotja, dhe padroni është dikush me të cilin duhet të bashkëjetosh. Të jesh grua do të thotë të shikosh shkëlqimin dhe rënien e dhjetëra teokracive, pa dëshmuar asnjëherë shkëlqimin tënd.

Gjithçka është ndryshe kur je grua.

Të jesh grua do të thotë të jesh dy herë njeri.

Ç'do të thotë të jesh GRUA?!

Si ndikojnë teknologjia dhe mediat sociale në shëndetin mendor

Përdorimi i teknologjisë ka shpërthyer vitet e fundit, me rreth 4.9 miliardë njerëz që përdorin internetin dhe mbi 5 miliardë përdorues aktivë të telefonave celularë në mbarë botën. Ndërsa teknologjia ka sjellë shumë përfitime dhe lehtësi në jetën tonë të përditshme, ajo ka sjellë edhe disa efekte të mundshme negative në shëndetin tonë mendor. Egzistojnë mënyra të ndryshme në të cilat teknologjia mund të ndikojë në shëndetin tonë mendor, pozitivisht dhe negativisht, por ka edhe strategji për menaxhimin e këtyre efekteve.

Një mënyrë që teknologjia ka ndikuar në pozitivitetin tonë të shëndetit mendor është lehtësia në procesin e komunikimit që ka krijuar nëpërmjet përdorimit të mediave sociale dhe platformave online. Për shembull, gjatë pandemisë COVID-19, shumë njerëz iu drejtuan mediave sociale dhe bisedës me video për të qëndruar në kontakt me të dashurit dhe ruajtën atë ndjenjë komuniteti dhe bashkimi pavarësisht politikës së distancimit social. Këto platforma kanë ofruar gjithashtu një ndjenjë mbështetjeje dhe mirëkuptimi, duke i lejuar individët të ndajnë përvojat dhe ndjenjat e tyre me të tjerët që mund të kalojnë sfida të ngjashme.

Një tjetër ndikim pozitiv që teknologjia ka pasur në shëndetin tonë mendor është përdorimi i aplikacioneve softuerike (të quajtura ndryshe aplikacione) dhe faqeve të internetit që ofrojnë burime dhe mbështetje për shëndetin mendor. Këto mund të përfshijnë mjete për gjurmimin e gjendjes shpirtërore, menaxhimin e stresit dhe ankthit dhe sigurimin e informacionit dhe burimeve për kushte të ndryshme të shëndetit mendor. Shumë nga këto mjete janë gjithashtu të disponueshme falas ose me një kosto të ulët, duke i bërë ato të aksesueshme për një gamë të gjerë individësh. Për shembull, tani ka aplikacione që ofrojnë meditim të drejtuar dhe ushtrime të vetëdijes, ose ofrojnë informacione rreth kushteve të ndryshme të shëndetit mendor dhe opsioneve të trajtimit. Këto burime mund të jenë veçanërisht të dobishme për ata që mund të mos kenë qasje në terapi ose mbështetje personale.

Mediat sociale kanë ndihmuar gjithashtu në uljen e ndjenjës së depresionit tek individët pasi ka shumë përmbajtje argëtuese që mund t'ju ndihmojnë të shpëtoni nga çdo stres psikologjik për disa momente.

Megjithatë, ashtu si çdo gjë tjetër ka një avantazh dhe disavantazh, është e rëndësishme të theksohet se teknologjia gjithashtu ka ndikuar negativisht në shëndetin tonë mendor.

Varësia ndaj mediave sociale është një efekt negativ me të cilin luftojnë shumë individë. Ata ndihen të shqetësuar dhe të dëshpëruar sa herë që nuk kanë akses në pajisjet e tyre teknologjike ose mediat sociale dhe kjo mund të ndikojë në shëndetin e tyre mendor.

Mediat sociale gjithashtu kanë ndikuar shumë në vetëvlerësimin e



përdoruesve të tyre. Studimet kanë treguar se përdorimi i tepërt i mediave sociale mund të çojë në ndjenja të pamjaftueshmërisë dhe të krijojë një dëshirë për t'u përshtatur me standardet joreale të bukurisë dhe suksesit. Kjo ka çuar në zhvillimin e vetëvlerësimit të ulët në shumë individë dhe kjo ka kontribuar në zhvillimin e kushteve të shëndetit mendor si depresioni dhe ankthi. Një tjetër ndikim negativ i teknologjisë në shëndetin mendor është efekti i shumë detyrave të vazhdueshme dhe mbingarkesës së informacionit. Me rrjedhën e vazhdueshme të njoftimeve dhe sinjalizimeve nga pajisjet tona, mund të jetë e vështirë të përqendrohesh plotësisht në vetëm një detyrë ose aktivitet. Rrjedha e vazhdueshme e informacionit dhe stimuljeve mund ta bëjë të vështirë përpunimin dhe prioritizimin e asaj që është më e rëndësishme dhe kjo mund të bëjë që individët të ndihen të mbingarkuar dhe të stresuar.

Si e kontrollojnë teknologjia jetën tonë?

Sipas studimeve, 47% e njerëzve kalojnë tre deri në tetë orë çdo ditë në kompjuterët e tyre dhe 1 deri në 3 orë shtesë në telefonat e tyre. Duke marrë parasysh që kemi rreth 16 orë zgjimi në ditë, shpenzimi i më shumë se 10 prej tyre në një pajisje teknologjike duket i ekzagjeruar.

Në vitin 2016, "The Guardian" shkroi një artikull për këtë fenomen. Ai deklaroi se mbikëqyrja e të dhënave që dikur ishte e padukshme tani është në mënyrë agresive në jetën tonë të përditshme. Interneti i gjërave krijon një rrjet të paprecedentë pajisjesh gjurmuese që kapin të dhënat tona dhe i përdorin ato për të krijuar profilet tona dixhitale për qëllime marketingu dhe politike. Ne e dimë se jemi duke u vëzhguar dhe është bërë normale.

Interneti ka pak kontroll mbi ne. Por bota që ne shohim në të



nuk është reale. Është një krijim i njerëzve që vendosin vetëm momentet e tyre më të shkëlqyera në internet. Megjithatë, ne ndonjëherë e harrojmë këtë fakt dhe e krahasojmë veten me versionin e lumtur të të tjerëve që shohim në internet. Si rezultat, shumë njerëz krijojnë një botë imagjinare ku të gjithë janë të lumtur përveç tyre.

Ndikimet negative të teknologjisë në shëndetin tonë mendor

Të gjithë e dimë se interneti mund të jetë një vend i rrezikshëm. Me kaq shumë informacion në majë të gishtave tanë, është e lehtë të humbësh në një det me faqe interneti, postime në media sociale dhe video.

Për disa njerëz, kjo mbingarkesë në internet mund të çojë në çrregullime njohëse dhe probleme të tjera të shëndetit mendor. Sipas një studimi, pesë efektet më të mëdha negative të teknologjisë në jetën tonë përfshijnë: Çështje psikologjike (50%); Probleme me gjumin (48%); Çështjet sociale (45%); Vështirësi në krijimin e marrëdhënieve në botën reale (42%); Vështirësi me fokus (41%).

Aspekti më i rëndësishëm që njerëzit vënë re janë problemet psikologjike. Çrregullimet njohëse më të përhapura të shkaktuara nga teknologjia që pjesëmarrësit e studimit njohën në vetvete ishin: Detyrimi për të mbushur çdo mërzitje momentale me përdorimin e një smartphone (47%); Duke pasur gjendje të sjelljeve mekanike, të rutinuara dhe të përsëritura në internet (38%); Konsumimi i lajmeve tragjike në internet pa përgjigje apo ndikim emocional ose psikologjik (34%); Kalojnë kohë në pajisjen e tyre kur janë me të dashurit e tyre dhe i kushtojnë më shumë vëmendje sesa njerëzve (32%).

Këto probleme prekin kryesisht të rinjtë që kalojnë më shumë kohë në internet sesa gjeneratat e vjetra.

Studimet e mëparshme tregojnë se të qenit tepër i lidhur shkakton probleme psikologjike si depresioni, pritshmëri jo të shëndetshme dhe probleme të përqendrimit. Teknologjia gjithashtu mund të ketë pasoja negative në shëndetin fizik. Përdorimi i tepërt i teknologjisë moderne mund të çojë në probleme me shikimin, humbje të dëgjimit dhe tendosje të qafës.

Përdorimi i shpeshtë i teknologjisë dixhitale madje mund të rrisë simptomat e ADHD dhe të ndërhyjë në inteligjencën emocionale dhe sociale. Kjo mund të çojë në sjellje të varura, rritje të izolimit

social dhe ndërhyrje në zhvillimin e trurit dhe gjumin. Por, disa mjete online ofrojnë ushtrime mendore që ofrojnë përfitime për shëndetin e trurit. Këto përfshijnë aktivizimin e qarkut nervor, përmirësimin e funksionimit kognitiv, reduktimin e ankthit dhe rritjen e gjumit të qetë.

Disa studiues argumentojnë se ndikimi më dramatik i teknologjisë në jetën tonë është reduktimi i sasisë së gjumit. Rreth 50 vjet më parë, një i rritur mesatarisht flinte rreth 8.5 orë në natë. Tani, kjo është mesatarisht rreth 7 orë në natë. Kjo është për shkak se drita e ndritshme redukton nivelet e melatoninës, një hormon që rregullon gjumin.

Studimi zbuloi se shumica e njerëzve (68%) janë të shqetësuar se si çrregullimet e shkaktuara nga teknologjia ndikojnë në jetën e tyre. Rreth 50% e të anketuarve mendojnë se ndryshimet teknologjike në botë janë normale, por shumë mendojnë se duhet të jemi të kujdesshëm për mënyrën se si po ndikon në sjelljen tonë.

Balancimi i përdorimit të teknologjisë dhe mediave sociale me aktivitetet e tjera të jetës sonë të përditshme është thelbësor për të mbajtur një gjendje të mirë të shëndetit mendor. Disa nga mënyrat se si mund ta arrijmë këtë janë:

Vendosni kufizime në përdorimin tuaj të teknologjisë. Është e rëndësishme të vendosni kufij rreth përdorimit tuaj të teknologjisë dhe të siguroheni që nuk po e përdorni tepër atë, gjithashtu përpikuni të kufizoni sasinë e kohës që shpenzoni duke lëvizur nëpër burimet e mediave sociale dhe duke e krahasuar veten me të tjerët. Mos harroni se ajo që shihni në mediat sociale është shpesh një version shumë i kuaruar dhe i filtruar i realitetit. Ju mund ta arrini këtë duke vendosur kufizime në sasinë e kohës që shpenzoni në mediat sociale ose aplikacione të tjera dhe duke bërë pushime të rregullta nga ekranet për t'i dhënë pushim syve dhe mendjes suaj. Merrni parasysh përdorimin e mjeteve si kufijtë e kohës para ekranit ose aplikacionet që gjurmojnë përdorimin tuaj të teknologjisë për t'ju ndihmuar të qëndroni në rrugën e duhur.

Kujdesuni për shëndetin tuaj fizik dhe mendor. Të siguroheni që po flini mjaftueshëm, të hani një dietë të shëndetshme dhe të angazhoheni në aktivitet fizik janë faktorë që të gjithë mund të kontribuojnë në shëndetin dhe mirëqenien tuaj të përgjithshme mendore. Ushtrimi, në veçanti, është treguar të ketë një sërë përfitimesh për shëndetin mendor, duke përfshirë reduktimin e stresit dhe ankthit dhe përmirësimin e humorit.

Kërkoni mbështetje nëse keni nevojë. Nëse jeni duke luftuar me shëndetin tuaj mendor dhe mendoni se keni nevojë për mbështetje shtesë, ka shumë burime në dispozicion për ju, duke përfshirë shërbimet e këshillimit dhe terapisë në internet, grupet mbështetëse dhe linjat telefonike. Mos kini frikë të kërkoni ndihmë nëse keni nevojë. Është e rëndësishme të mbani mend se kërkimi i ndihmës është një shenjë fuqie, jo dobësie, dhe se ka shumë njerëz dhe burime në dispozicion për t'ju mbështetur në udhëtimin tuaj drejt shëndetit më të mirë mendor.

Këto janë vetëm disa nga mënyrat që mund të përdorni për të kundërshtuar dhe zbutur efektet e teknologjisë. Të gjithë janë të ndryshëm dhe ju duhet të gjeni praktika që funksionojnë për ju.

Si përfundim, ne të gjithë duhet të kujtojmë se teknologjia është vetëm një aspekt i jetës sonë dhe është e rëndësishme t'i jepet përparësi vetëkujdesit dhe ekuilibrit për të ruajtur një shëndet të mirë mendor.



Vendet më të sigurta nëse ndonjëherë shpërthen lufta bërthamore

Frika nga lufta bërthamore

Ne e dimë se një luftë gjithëpërfshirëse bërthamore SHBA-Rusi do të ishte e rëndë. Por sa e rëndë, saktësisht? Sa janë shanset tuaja për t'i mbijetuar shpërthimeve, rrezatimit dhe dimrit bërthamor nga vendi ku jetoni?

Që nga pushtimi rus i Ukrainës dhe tensionet e mëvonshme gjeopolitike, frika e luftës bërthamore ka qenë në ajër, duke bërë që shumë njerëz të pyesin se çfarë do të thoshte një konflikt bërthamor për njerëzimin dhe planetin.

Ai kombinon modelimin e detajuar të synimeve bërthamore, trajektorët e raketave, shpërthimet dhe pulsën elektromagnetik, dhe se si tymi i zi i karbonit prodhohet, ngrihet dhe përhapet në të gjithë globin, duke ndryshuar klimën dhe duke shkaktuar urinë masive.

Qytetet e mëdha janë ato që shënjestrohen edhe sepse ato përmbajnë objekte ushtarake dhe për të penguar rimëkëmbjen e armikut pas luftës. Çdo goditje krijon një top zjarri po aq të nxehtë sa bërthama e diellit, e ndjekur nga një re radioaktive në formë kërpudhe. Këto shpërthime intensive avullojnë njerëzit aty pranë dhe shkaktajnë zjarre dhe verbëri më si pasojë. Zgjerimi i topit të zjarrit shkakton më pas një valë shpërthimi që

dëmton ndërtesat, duke shtypur ato pranë.

Fatkeqësisht, hulumtimet e rishikuara nga studiuesit sugjerojnë se shpërthimet, puls i elektromagnetik dhe radioaktiviteti nuk janë pjesa më e keqe: një dimër bërthamor shkaktohet nga tymi i zi i karbonit nga stuhitë bërthamore. Bomba atomike e Hiroshimës shkaktoi një stuhitë të tillë, por bombat e sotme me hidrogjen janë shumë më të fuqishme. Një qytet i madh si Moska, me pothuajse 50 herë më shumë njerëz se Hiroshima, mund të krijojë shumë më shumë tym dhe një stuhitë zjarri që dërgon shtëllunga tymi të zi deri në stratosferë, shumë më lart se çdo re shiu që përndryshe do të largonte tymin. Ky tym i zi nxehtë nga rrezet e diellit, duke e ngritur atë si një tullumbace me ajër të nxehtë deri në një dekadë.

Kjo bën që Toka të ngrijë në të ftohtë edhe gjatë verës, me tokën bujqësore në Kansas që ftohet me rreth 20 gradë celsius, dhe rajone të tjera ftohen pothuajse dy herë më shumë. Një punim shkencor i kohëve të fundit vlerëson se mbi 5 miliardë njerëz mund të vdesin nga uria, duke përfshirë rreth 99% të atyre në SHBA, Evropë, Rusi dhe Kinë, sepse shumica e tymit të zi të karbonit qëndron në hemisferën veriore ku prodhohet dhe për shkak se temperatura bie, dëmtojnë më shumë bujqësinë.



Pasojat shkatërruese

Çdo konflikt bërthamor do të kishte një gamë të madhe pasojash shkatërruese, nga vdekjet si pasojë e shpërthimeve të drejtpërdrejta deri te efektet e vazhdueshme të rrezatimit, ndotjes së mjedisit dhe urisë.

Të mbijetuar edhe në skenarin më të rëndë

Megjithatë, ka të ngjarë të ketë skuta të të mbijetuarve në mbarë planetin, madje edhe në skenarin më të rëndë, thonë shkencëtarët. Mundësia më e mirë për të mbijetuar

Dhe sigurisht, ata në vendet më elastike do të kishin shanset më të mira për të shmangur një kolaps para-industrial.

Australia: vendi më i sigurt ku mund të gjendesh...

Studiuesit kanë zbuluar se Australia, e ndjekur nga fqinji i saj Zelanda e Re, është vendi më i mirë pozicionuar për t'i mbijetuar një dimri bërthamor dhe për të ndihmuar në rinisjen e një qytetërimi njerëzor të shembur.

Islanda, ishujt Salomon dhe Vanuatu

Është zbuluar në një studim të botuar në revistën "Risk Analysis", i cili gjithashtu tregon Islandën, Ishujt Solomon dhe Vanuatu si vende të sigurta për t'i mbijetuar një apokalipsi bërthamor.

Vend i sigurt për një 'katastrofë të papritur që redukton rrezet e diellit'

Sipas studimit, vendet ishullore të lartpërmendura janë të afta të prodhojnë ushqim të mjaftueshëm për popullsinë e tyre pas një "katastrofë të papritur që redukton rrezet e diellit", siç është një luftë bërthamore, një super vullkan ose një goditje asteroidi.

Studimi krahasoi 38 vende ishullore

Autorët e studimit krahasuan 38 vende ishullore mbi 13 faktorë që ata thanë se mund të parashikonin suksesin si një gjendje



mbijetese pas apokaliptike. Faktorët përfshijnë prodhimin e ushqimit, vetë-mjaftueshmërinë e energjisë, prodhimin dhe efektin e fatkeqësisë në klimë, ndër të tjera.

Australia dhe Zelanda e Re, prodhues të mëdhenj bujqësorë

Australia dhe Zelanda e Re, të dyja prodhues të fuqishëm bujqësor dhe të izoluar nga vendet e mundshme të shpërthimit bërthamor të hemisferës veriore, kryesuan listën, me Australinë me performancën më të mirë në përgjithësi. Australia mund të ushqejë dhjetëra miliona të tjerë

"Kapaciteti i furnizimit me ushqim i Australisë është gjigant, - thotë studimi, - me potencial për të ushqyer dhjetëra miliona njerëz shtesë". Infrastruktura relativisht e mirë e Australisë, teprica e madhe e energjisë, siguria e lartë shëndetësore dhe buxheti i mbrojtjes, të gjitha ndihmuan në vendosjen e saj në krye të listës. Lidhjet me Mbretërinë e Bashkuar dhe SHBA-në e bëjnë atë më shumë gjasa të bëhet një objektiv. Pra Australia do të kishte një faktor kryesor që punon kundër saj: lidhjet e saj relativisht të ngushta ushtarake me Mbretërinë e Bashkuar dhe SHBA-në e bënë atë më shumë gjasa të bëhej një objektiv në një luftë bërthamore kundër Rusisë.

Statusi i Zelandës së Re pa armë bërthamore është një avantazh. Në këtë fushë, Zelanda e Re shfaq disa avantazhe, thanë autorët, me statusin e saj të gjatë pa disponuar armë bërthamore.

Si vend i mbrojtur nga temperatura ekstreme, elasticiteti i tij në rast të një rënie të menjëhershme të temperaturës globale të nxitur nga një periudhë errësire (kudo në Zelandën e Re është relativisht afër oqeanit, duke e mbrojtur atë nga temperatura ekstreme) gjithashtu do të ndihmonte.

Filipinet, Mauritius, Indonezi

Vende të tjera ishullore, si Filipinet, Mauritius dhe Indonezia do të jenë në gjendje të prodhojnë mjaftueshëm ushqim në një krizë të tillë, sipas studimit.

63% e popullsisë së botës do të vdisnin nga uria

Më shumë se 5 miliardë njerëz, afërsisht 63% e popullsisë aktuale të botës, do të vdisnin nga uria si pasojë e një lufte bërthamore në shkallë të plotë, sipas një studimi të vitit 2022.

Ulje 97% e prodhimit të ushqimit

Në fakt, do të kishte një reduktim 97% të prodhimit të ushqimit në Kinë, Francë, Rusi, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara.

Vetëmjaftueshmëria ushqimore: një faktor i rëndësishëm

Kjo është arsyeja pse vetëmjaftueshmëria ushqimore është një nga faktorët më të rëndësishëm, sipas autorëve të studimit, të cilët shpjegojnë se tregtia e ushqimit mund të ndikohet shumë nga një kolaps i përhapur teknologjik.

Kolapsi i përhapur teknologjik

"Kolapsi i shoqërisë teknologjike është i mundur edhe në vendet që konsiderohen më të mundshme për të mbijetuar. Kjo mund të pengojë seriozisht bashkëpunimin, koordinimin dhe prodhimin elastik të ushqimit", përfundojnë shkencëtarët.

ANO, fidanishtja e përgatitjes së drejtuesve të rinj

Akademia e Nënoficerëve formon, kualifikon e përgatit nënoficerët e të gjithë niveleve në FARSH-së dhe personelin e mesëm civil të administratës, ekuivalent të nënoficerëve, si dhe bashkëpunon me strukturat e FARSH-së për specializimin e nënoficerëve.

Trajnimi i trupës së nënoficerëve e ka filluesën e saj në vitin 1919, ku u hap për herë të parë shkolla dhe kurset e nënoficerëve, të cilët vijuan deri në vitin 1939.

Pas vitit 1945 dhe deri nga mesi i viteve '60, në ushtrinë shqiptare roli i nënoficerëve erdhi duke u rritur, duke u angazhuar kryesisht në stërvitjen e vogël. Por me heqjen e gradave ushtarake nga viti '60 deri në '90 numri i nënoficerëve ra ndjeshëm, dhe për më keq roli i tyre u kufizua në ruajtjen e depove dhe magazinave ushtarake. Kjo dukuri çoi në rritjen e numrit të oficerëve dhe në mos angazhimin e nënoficerit në stërvitje. Në repartet tankiste, detare u ruajt tradita e mëparshme e kryerjes së stërvitjes së vogël nga ana e nënoficerëve.

Në vitet 1950-1965 u hapën kurse të ndryshme të shërbimit për nënoficerë në komandat përkatëse. Gjatë kësaj periudhe arsimimi i nënoficerit ishte i veçantë sipas specialiteteve dhe shërbimeve pranë njësive dhe shkollave ushtarake, fokusuar në specialitete si Xhenio, Ndërlidhje, Artileri, Tanke etj., më tepër formim i përgjithshëm se funksional.

Pas viteve '60 nënoficerët merreshin në shërbim përmes një kontrate që nënshkruhej nga titullari i repartit përkatës dhe natyrisht pasi plotësonte disa kriterë që nuk ishte domosdoshmëri përfundimi më parë i një shkollë për nënoficer.

Pas viteve 1990, në kuadrin e transformimit dhe zhvillimit të Forcave të Armatosura, trupa e nënoficerëve zuri një vend të rëndësishëm në përgatitjen dhe stërvitjen e efektivave ushtarë në njësive, reparte dhe nënreparte. Në vitin 1991 me rivendosjen e gradave ushtarake, reformat e ndërmarra në Forcat e Armatosura, sollën domosdoshmërinë e krijimit, përgatitjes dhe konsolidimit të trupës së nënoficerëve. Arsimimi dhe trajnimi i kësaj trupe diktoi si nevojë ngritjen e institucionit arsimor të përgatitjes së tyre. Në datën 05.11.1993, me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë u krijua Akademia e Përgatitjes së Nënoficerëve të Forcave Tokësore.

Objekti i kryesor i punës në Akademinë e Nënoficerëve ishte përgatitja e nënoficerëve aktivë për të gjithë specialitetet e Forcave të Armatosura për të kryer detyrën e zëvendëskomandantit të togës. Fillimisht misioni i kësaj akademie ka qenë: "Akademia është institucion ushtarak mësimor edukativ që ka për mision të përgatisë nënoficerë të aftë për të drejtuar stërvitjen e togës". Më 08.04.1994 u organizua ceremonia e hapjes së Akademisë së Nënoficerëve në mjediset e Akademisë së Forcave Tokësore "Skënderbej", me 102 kursantë të ndarë në gjashtë grupe mësimore të specialiteteve të ndryshme. Me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 433, datë 14.08.1995 u krijua Akademia e Nënoficerëve. Objekti i punës së Akademisë së Nënoficerëve ishte përgatitja dhe kualifikimi i nënoficerëve aktivë e rezervistë për Forcat Tokësore, Detare dhe Ajrore. Pas vitit 2000 ndryshoi strategjia e arsimimit dhe trajnimit të nënoficerëve. Në bashkëpunim me vendet anëtare të NATO-s dhe me kompaninë SAIC filloi të realizohej përgatitja

dhe trajnimi i nënoficerëve sipas niveleve të kurseve në ANO dhe Shkollën e Trupës. Në vitin 2003, Qeveria Shqiptare i akordoi akademisë emrin e Kolonelit holandez Ludowik Thomson, duke u quajtur Akademia e Nënoficerëve 'Thomson', në vlerësim dhe në respekt të veprës së shquar për kontributin e dhënë në Shqipëri, për përmirësimin e trupës ushtarake gjatë viteve 1911-1915, ku dhe vdiq në vendin tonë në krye të detyrës.

Shkollat e Nënoficerëve në Shqipëri nga viti 1912 – 2002

Viti 1919, Shkolla e xhandarmërisë dhe aspirantëve për nënoficerë.

Viti 1925, Shkolla e Nënoficerëve në Durrës, e cila kishte 1 kurs çdo vit, 6 muaj kursi.

Në vitet '60, '70, '80, u hapën shkolla të përkohshme për Artilerinë, Tanket dhe Xhenion në Elbasan.

Më pas, shkolla të njëjta me kohë dhe programe të reduktuara për nënoficerë jo të karrierës, që përgatisnin nënoficerë jo me rrogë dhe që u ngritën pranë Korpuseve dhe Komandave të Forcës Detare, Mbrojtjes

Kundërajrore, pranë Grupimit në Elbasan.

Më 8 prill 1994, mbi bazën e Shkollës së Instruksionit në Zall Herr, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, më 5.11.1993, u hap Akademia e Nënoficerëve.

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr.156 datë 19.02.2020 "Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Forcave të Armatosura, si institucioni i vetëm Publik i Arsimimit të Lartë në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare", Urdhrit nr. 82, datë 19.06.2020 të Kryeministrit, "Për një ndryshim në urdhrin nr.157", datë 26.10.2016 "Për miratimin e Strukturës Organizative të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", urdhrin nr. 41 datë 27.08.2020 të Ministrit të Mbrojtjes "Për miratimin e tabelave të organizimit dhe pajisjeve të Qendrës së Arsimimit Profesional të nënoficerëve (Akademisë së N/Oficerëve), Akademia e Forcave të Armatosura "Thomson" emërtohet Qendra e Arsimimit Profesional të Nënoficerit (ANO).

Qendra e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve (ANO) është drejtuar nga komandantët: Kolonel Hysen Hodo 1994-1996, Kolonel Arjan Zaimi 1996-2000, Kolonel Zija Bahja 2000-2001, Kolonel Lulëzim Bllaka mars-shtator 2001, N/kolonel Jeronim Bazo 2001-2002, Kolonel Alfred Hajdini 2002-2007, Kolonel Simon Gega 2007-2009, Kolonel Arqile Kokëdhima 2009-2010, Kolonel Suzana Jahollari 2010-2011, Kolonel Selim Troci 2011-2012, Kolonel Arben Toska 2013-2014, Kolonel Ardian Bali 2014, Kolonel Ndrim Sallaku 2014-2016, Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu shtator - dhjetor 2016, Kolonel Albert Mullai 2016-2019, Kolonel Gaspër Lala qershor - tetor 2019, Kolonel Fatmir Lokaj nëntor 2019, Kolonel Elton Bregu shkurt - dhjetor 2020, Kolonel Arben Toska janar 2020 - tetor 2022, Kolonel Ardian Lilo nëntor 2022, dhe sot kjo akademi drejtohet nga zëvendëskomandant, nënkolonel Bedri Qoli.

Arma e Kimisë, shërbimi elitë i FA-së

Shërbimi Kimik i Ushtrisë gjatë gjithë kohës ka qenë shërbim elitë që përgjigjej para këshillit të Mbrojtjes, për vetë natyrën dhe rëndësinë e veçantë të detyrave që ai zgjidhte për Mbrojtjen e Forcave të Armatosura të popullit e të ekonomisë. Periudha 70-vjeçare e këtij shërbimi ka qenë një periudhë e gjatë pune vetëmohuese e përkushtimi nga qindra kuadro e mijëra ushtarë që kanë shërbyer në këtë armë, që me punën dhe sakrificat e tyre e çuan këtë shërbim në nivelet më të larta të mundshme, shërbim sa i vështirë aq dhe i nevojshëm, si për kohë lufte dhe për kohë paqeje, shërbim human që mbron dhe shpëton jetë njerëzish në çdo situatë. Kjo ka qenë dhe do të mbetet përherë detyra e mbrojtjes kundërkimike.

Nënreparti i parë i shërbimit të mbrojtjes kundërkimike, u krijua më 23 nëntor të vitit 1953. Komandanti i Nënrepartit të parë të shërbimit kimik (kështu quhej struktura e parë e krijuar) u emërua Shyqyri Kondi. Po në këtë kohë me urdhër të Këshillit të Mbrojtjes u krijua edhe Dega e Mbrojtjes Kundërkimike pranë Shtabit të Përgjithshëm.

Kuadrot e parë ishin ata të dalë nga lufta antifashiste dhe të përgatitur me kurse dhe kryesisht në shkollat ushtarake të ish-Bashkimit Sovjetik, dhe më vonë në Akademinë tonë të Mbrojtjes, si Shyqyri Kondi, Kristaq Haxhimiali, Thodhori Gjoni, Hamit

Murga, Uran Puto, Abdyl Dobi, Esat Xhepa, Guri Shyti, Lame Prifti, Qëndro Laba, Enver Lagji, Hysen Murtati, Sami Meçollari, Hysen Kola, Kristaq Mici, Pirro Begvarfi, Zija Liçi, Servet Muka e shumë e shumë të tjerë që dolën më vonë nga Shkolla e Lartë e Bashkuar e Oficerëve.

Në vitin 1954 pranë Shkollës së Bashkuar të oficerëve u hap edhe kursi i kimisë, që filloi të përgatiste kuadrot e parë të vendit, të cilët me ndjenjë të lartë dhe përkushtim rritën nivelin teknik dhe gatishmërinë luftarake të reparteve dhe njësive të Ushtrisë. Gradualisht, me rritjen e modernizimit të ushtrisë u shtua dhe u modernizua edhe shërbimi kimik, që ndonjëherë edhe e quanim Arma e Kimisë, dhe kjo për përmasat dhe rëndësinë që mori. Kështu në vitin 1961, kompania e kimisë u kompletua me teknikën e armatimit kimik, me teknikë zbulimi dhe përpunimi. Rëndësi e veçantë fillimisht, i kushtohej përvetësimit të teknikës dhe kompletimit të ushtrisë me mjetet e mbrojtjes kundërkimike. Në vitin 1964, pranë Akademisë së Shtabit të Përgjithshëm u hap dega e Mbrojtjes kundërkimike, me shef katedre N/kolonel Kristaq Haxhimihalin, prej ku filluan të dalin kuadrot e lartë ushtarakë.

Në vitin 1967 me vendim të Këshillit të Mbrojtjes u krijuan tre batalione, dy të mbrojtjes kundërkimike, njëri në Tiranë me komandant Koço Stojkun dhe tjetri në Berat me komandant Refat Shehatin, kurse batalioni i tretë ishte ai flakëdhës në Tiranë me komandant Ahmet Mehmetin, që të tre Rezervë të Shtabit të Përgjithshëm.

Po në këtë kohë pranë shtabeve të divizioneve u krijuan kompanitë e mbrojtjes kundërkimike dhe ato flakëdhëse, të cilat me kalimin e Ushtrisë në sistemin me Korpuse, kaluan në batalione kimie dhe flakëdhëse, të kompletuara me teknikë dhe armatim të plotë kimik. Po kështu, pranë korpuseve u krijuan edhe laboratorët e kimisë të korpuseve me shefa laboratorësh inxhinierë kimistë, që kishin në vartësi edhe ofiçinat e riparimit të teknikës dhe armatimit kimik të korpusit dhe, që kanë bërë një punë të lavdërueshme për rritjen cilësore teknike të këtij shërbimi.

Më 1969, pranë reparteve të kimisë në Brar, u krijua Shkolla e përgatitjes së kuadrove oficer rezervist, me komandant Muharrem Durmishin.

Zhvillimi i vrullshëm i shërbimit kimik bëri që edhe drejtimi të



kalonte nga degë në Drejtori të Mbrojtjes kundërkimike. Në këtë kohë, kur drejtues të saj ishin Enver Lagji dhe Muharrem Durmishi u bë një punë shumë e madhe në drejtim të studimit dhe prodhimit në vend të mjeteve të mbrojtjes kundërkimike dhe të likuidimit të pasojave të ndotjeve. Është pikërisht kjo kohë, kur u krijuan shumë grupe pune studimore me specialistët më të mirë, të cilët e kurorëzuan me sukses krijimin e uzinës së kimisë, që prodhoi kundërgazin shqiptar me parametra të matshëm me bashkëkohorët, u prodhuan paketa individuale kundërkimike, kompletet e degazimit e përpunimit, kostumet mbrojtëse e kompleti mbrojtës nr.1 e shumë të tjera.

Pranë ambienteve të kompanisë së kimisë, më 1 gusht 1965, u hap Laboratori Qendror i kimisë në FA, me kimistin e talentuar Kudret Meta dhe dy laborantë. Hapja e këtij Laboratori kishte si qëllim përgatitjen teknike të kuadrove të mesëm dhe të lartë të kimisë, kryesisht si një bërthamë studimore për aplikimin në ushtri të të rejave shkencore lidhur me ADM (Armët e Dëmtimit në Masë) dhe mbrojtjen prej tyre, sidomos në drejtim të armës së kimisë dhe mjeteve djegëse, për t'iu përgjigjur situatave të mundshme kimike, që mund të krijoheshin, duke e përqendruar vëmendjen fillestare në këto probleme: gjetja dhe aplikimi i metodave të analizave të lëndëve helmuese luftarake; kryerja e analizave të lëndëve ç' ndotëse, që mbahen në ruajtje; aplikimi i metodikave për përgatitjen dhe përdorimin e mjeteve ç' ndotëse; studimi i aftësisë mbrojtëse të mjeteve të mbrojtjes kundërkimike; përgatitja e përzierjeve djegëse për flakëdhësit.

Jo vetëm kaq, por prodhoi dhe furnizoi edhe industrinë me gypa indikatorë për gazrat e dëmshëm industrial, hoqi nga importi shumë kimikate dhe lëndë të tjera të domosdoshme për prodhimin e këtyre gypave.

Që nga viti 2007, me mbështetjen e qeverisë Amerikane dhe nën monitorimin e plotë të OPCW (Organizata për ndalimin e armëve kimike) u bë asgjësimi i plotë i të gjithë sasisë së LHL (Agjent kimik) që ka disponuar Shqipëria.

LHL (Agjentët kimikë) + Mjetet e përdorimit = Arma kimisë

Ushtria jonë ka pasur në dispozicion vetëm një nga dy komponentët që përbëjnë armën e kimisë LHL dhe nuk ka disponuar asnjëherë

mjete të përdorimit të tyre.

Shqipëria, deri në vitin 2007, ka trashëguar nga sistemi i kaluar komunist rreth 16 ton iprit mësimor, sasi të vogla të klorpikrinës – LHL ngacmuese – asfiktike, që është përdorur vetëm në Luftën e Parë Botërore për qëllime luftarake. Po ashtu, kemi pasur sasi të vogla (jo me ton dhe kuintal, por me kg) iprit luftarak, luizit dhe sarin, që janë përdorur për studime shkencore. Vonë janë sjellë sasi të vogla kloracetofeni.

Laboratori Kimik, në vitin 1969, arriti që me këmbëngulje të sintetizonte (prodhonte) pothuajse të gjitha llojet e LHL-së që njiheshin, përfshi sarinën, në sasi shumë të vogla dhe kjo është bërë për të pasur mundësi të studioheshin e prodhoheshin mjetet e zbulimit të tyre kimikë të mbrojtjes prej tyre dhe të mos ndotjes së tyre.

Laboratori prodhoi të gjithë gypat indikatorë të lëndëve helmuese. Sasitë e saj kanë qenë tepër të vogla dhe nuk është përdorur asnjëherë për qëllime luftarake, manovra apo stërvitje. Kur përmendet kjo armë, në kujtesë të vjen menjëherë kundërgazi. Te ne, fillimisht erdhën modele sovjetikë dhe kinezë, por më pas u arrit të prodhohet në vend nga Ndërmarrja e Prodhimeve Kimike të Ushtrisë në Tiranë. Kundërgazi eksperimental u prodhuan në vitin 1971, ndërsa në vitet '80, kur punohej me ritëm të plotë për të kompletuar të gjitha nevojat e ushtrisë, sasia vjetore arriti në 100 000 komplete në vit. Maska dhe gypi i kundërgazit prodhoheshin nga Ndërmarrja Gomë-Plastikë Durrës.

Ndërmarrja Kimike u nda me administratë më vete dhe u quajt "Rep.Ush.1190". Aty nisën të prodhoheshin karboni aktiv dhe katalitik për mbushjen e kundërgazeve, kutitë tymuese individuale dhe të tankeve (ku ngjeshja e kallëpit me lëndën përbërëse kryej me një presë me friksion 120 ton, të realizuar nga Kombinati Metalurgjik Elbasan), si dhe produkte të tjera për stërvitje. Karboni aktiv dhe katalitik prodhohej nga bërësitë e farave të ullirit. Përveç kundërgazit individual, ishin dhe filtrat e mbrojtjes kolektive, të cilët montoheshin në strehime apo objekte të tjera. Përveç këtyre, ishin dhe filtrat 50 dhe 100 m³/orë. Filtrat kanë të njëjtin konstruksion si të kundërgazit individual, pra një element filtrues prej letre të valëzuar dhe

një element filtrues prej karboni katalitik. Parafiltër, siç e thotë dhe emri, është i përbërë vetëm nga elementë filtrues prej letre me strukturë speciale. Për këto filtra u kryen studime për t'i prodhuar në vend dhe u arrit deri te prodhimi eksperimental i prototipave. Tepër i vështirë ishte realizimi në rrugë industriale i letrës së valëzuar (si fisarmonikë). Te parafiltër, kishte përmasat e një fizarmonike të vogël. Problem i kushtueshëm ishte dhe mbyllja e kapakut në po atë mënyrë siç mbyllet dhe kutitë e konservave. Te kundërgazi individual, këto probleme ishin zgjidhur, sepse kishte përmasa të vogla. Gati një industri e tërë e realizuar me mjeshtëri nga ushtarakët tanë.





IN MEMORIAM

**"Gjenerali" i Ansamblit të Ushtrisë
Shqiptare dhe Kombëtare
Gaqo Avrazi, gur themeli i
muzikës profesionale shqiptare**

Gaqo Avrazi, lindi më 16 mars 1915, në Korçë, dhe u nda nga jeta më 18 shkurt 1985. Ishte pjesëmarrës në Luftën ANÇ, ushtarak (kolonel), kompozitor dhe dirigjent, Artist i Popullit.

Lindi në Korçë në një familje artdashëse. Qysh herët mori pjesë në veprimtaritë artistike që organizoheshin nga shoqatat kulturore në Korçë, si “Rinia Korçare”, “Agroni” etj.

Në vitin 1932 filloi të studionte sistematikisht nën drejtimin e kompozitorëve Kristo Kono dhe Zisi Morcka. Mori pjesë në demonstratat antifashiste dhe u lidh me Lëvizjen ANÇ.

Çdo fushë e prodhimit material e shpirtëror të shoqërisë, si dhe çdo strukturë në fushën ushtarake përfaqësohet me personalitete të rangjeve të ndryshme, duke formuar plejadën e strategëve, të reformatorëve dhe gjeneralëve. Këtu nuk mund të lihet pa përmendur edhe organizatori, kompozitori dhe dirigjenti i muzikës, i këngës ushtarake shqiptare dhe i valleve popullore, gjenerali i Ansambli të Ushtrisë Shqiptare dhe Kombëtare, Gaqo Avrazi. Një formacion gjigand, kompleks dhe luftarak, siç ishte Ansambli i Ushtrisë, u lind e u lartësua me emrin, autoritetin dhe kontributet e tij të veçanta.

Që kur ishte 15 vjeç, Gaqo Avrazi u bë i njohur në veprimtaritë artistike të qytetit të tij. Ai ëndërronte të studionte në një shkollë jashtë vendit, por ambicia e tij dilte jashtë mundësive ekonomike, ndaj i duhej të radhitej mes punëtorëve të artizanatit korçar, ku mes tyre do të gjente edhe këngën. Shoqëritë “Agroni” e “Rinia korçare”, si dhe një orkestër që ngriti mësuesi i parë i tij, kompozitori Kristo Kono, i mundësuan atij njohjen e teorisë së muzikës. Kështu nisën këngët e para si “Mulliri”, “Për Mëmëdhenë”, “Marsejeza” etj., melodi patriotike që, për t’iu ruajtur censurës, mësoheshin në shtëpitë përdhese, pas mureve të larta ose bodrumeve të thella dhe shfaqeshin në veprimtaritë antifashiste. Për këtë arsye, në vitin 1941 Gaqo Avrazi u burgos. Këtu filloi edhe lidhja e tij me lëvizjen mbarë popullore antifashiste. Pasi hyri në radhët partizane u thirr nga udhëheqës të luftës e të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH-së për t’iu përveshur ngritjes së një “Brigade Sulmuese Shpirtërore”, për të frymëzuar me atdhetari e shpirt luftarak brigadat e vërteta luftarake. Kështu, këngëtari, kompozitori dhe dirigjenti diletant, plot pasion e talent të rrallë, ngriti korin e parë të ushtrisë antifashiste (Mokërr, në vitin 1943). Kori përfaqësonte trupën e parë artistike të ushtrisë, mbi të cilën do të rritej Ansambli i ardhshëm i Ushtrisë, për të shkuar nga 31 partizanë e partizane në rreth 300 artistë të punësuar, të aktivizuar pas çlirimit. Si fillim, për dekor shërbeu një parashutë, ndërsa si orkestër një kitare. Vit pas viti, ansambli u pajis me mjete artistike moderne, por tashmë për dekor do të kishte sallat luksoze të qyteteve të mëdha, brenda e jashtë Shqipërisë. Në kujtimet “Ditë të paharruara”, Gaqo shkruan: “Në Opar dhamë koncertin e parë, e kështu me radhë në Gorë, Mokër, Lozhan, Korçë, Berat, Tiranë e deri thellë në Prizren. Këngët ngritën peshë popullin, partizanët, të rinjtë që vraponin për në mal, si luftëtarë të lirisë. Kështu, edhe kënga e godiste armikun me plumba”. Krahas këngës, lindi teatri dhe, hap pas hapi, në vitin 1950 shtohet orkestra simfonike, si dhe grupi i valleve, për të arritur tek Ansambli madhështor i Ushtrisë.

Atë arritje e iniconte, e nxiste, e organizonte dhe e “komandonte” strategu i saj Gaqo Avrazi. Në atë kohë ansambli do të jehonte në të gjithë Shqipërinë. Ai nuk i përkiste si dikur malit dhe partizanëve, por një populli dhe ushtrie artdashëse të mbarë Shqipërisë së çliruar. Ansambli i Ushtrisë dhe dirigjenti i tij arritën nivele aq të larta, sa ai konkurronte dhe rivalizonte ansamblet e tjera prestigjioze të vendit. Atëherë, pak e nga pak, Gaqo ngjiti shkallët e gradimit “kolonel”, për t’u quajtur “gjenerali i këngës”.

Ansambli i Ushtrisë dhe Gaqo Avrazi janë binjakët e një shkolle të madhe edukimi, formimi dhe kualifikimi profesional i dhjetëra e dhjetëra punonjësve krijues të atij institucioni dhe gjithë institucioneve të tjera të jetës civile. Nën drejtimin e Gaqo Avrazit nisën karrierën, u profilizuan dhe u afirmuan talentet dhe mjeshtërit e artit e të kulturës, të muzikës, të valleve e të këngës shqiptare në mbarë vendin e në Kosovë. Njëloj si bijtë e popullit, që në ushtri mermin dëftesën e pjekurisë, pas mbarimit të shërbimit ushtarak, në ushtrinë e artistëve, me liderin Avrazi morën udhën e ngadhënjimit kompozitorët e rinj, si Çesk Zadeja, Nikolla Zoraci, Kozma Laro etj., por edhe këngëtarët virtuozë Avni Mula, Mentor Xhemali, Gaqo Çako, Hysen Pelingu, Ibrahim Tukiqi, Nevruz Yzeiri etj., këngëtarët e nderuara Pavlina Nikaj, Naile Vathi etj., si dhe baletmaestrat Gëzim Kaceli e Adriatik Metuli, kërcimtarë virtuozë, që kaluan nëpër duart e vështrimit ngulmues të Gaqos, të profesorit dhe kujdestarit, i cili i udhëhoqi në betejat artistike.

Ja si e shpreh dashurinë, respektin dhe mirënjohjen, për gjithçka që ansambli dhe Gaqo Avrazi dhanë për artistët, kompozitorët dhe dirigjentët e Shqipërisë, Gaqo Çako, i cili shkoi në konservator në Moskë me ndërmjetësinë e tij: “E ç’ mund të kishte bërë më tepër, babai im?!”. Ndërsa Artisti i Popullit, Avni Mula, thotë: “Ky Ansambël ishte universiteti im i parë muzikor, dhe jam krenar që kam pasur një mësues të shquar si Gaqo Avrazi. Ai s’ishte vetëm drejtues e dirigjent i shquar, por edhe një mësues i tillë”. Artistë dhe personalitete pasardhës, nxënës dhe bashkëpunëtorë të Gaqos, njëzëri pohojnë se, “Nën drejtimin virtuoz të Gaqo Avrazit, Ansambli i Ushtrisë u bë i njohur jo vetëm brenda vendit, por edhe në ato shtete ku mundi të shkojë në kohën e vet”. Arritjet e Ansambli madhështor Ushtarak, si ai shqiptar, dhe pikat kulmore të një personaliteti ushtarak në fushën artistike, si Gaqo Avrazi, përveç popullit të tij i vlerësoi edhe bota. Në Festivalin Ndërkombëtar të Rinisë në Berlin, në vitin 1951, Ansambli ynë meritoi çmimin e dytë, kurse në Bukuresht, në vitin 1953 fitoi çmimin e tretë. Të mahnitshme ishin edhe koncertet madhështore në Kinë. Në Hanxhou bënte shumë nxehtë. Ansambli ushtarak çek ishte larguar për arsye të nxehtësisë. Gaqo Avrazi nuk zgjodhi të njëjtën rrugë. Ai u vuri copa akulli mbi shpinë anëtarëve dhe shfaqja u dha me sukses. Në Vietnam ansambli përballoi nxehtësinë dhe luftën. Gjatë një shfaqjeje në stadium, me 20 mijë spektatorë, nisi një shi i pandërprerë. Njerëzit largoheshin dhe u dha shenja që të ndërpritej koncerti, por Gaqo nuk e ndali shfaqjen dhe spektatorët u kthyen në stadium. Ndërkohë, u dha një shfaqje në një zonë ku bëhej luftë. Vendasit u çuditën dhe thanë: “Veç jush, nuk e ka bërë ndokush tjetër”. Në Moskë shfaqja u dha në sallën “Çajkovski” dhe koncerti u mbyll me finalen e operës “Ivan Suzanjin”. Deri atëherë, asnjë kor burrash nuk kishte guxuar të jepte një koncert të tillë. Ndërkaq, në hollin e teatrit priste personaliteti i madh rus Aleksandrov. Krejt i befusuar, ai takoi Gaqo Avrazin dhe



i shprehu përshtypjet më të larta: “Si është e mundur që një kor kaq i vogël të arrijë një nivel kaq të lartë? Kemi ç’të mësojmë nga ju. Me një ansambël të tillë unë mund të shëtis gjithë botën”. Dhe koncerti i ushtarakëve shqiptarë, me një dirigjent si gjenerali dinjitoz, u shënua në Librin e Artë të Teatrit “Çajkovski”. Ja pra se në çfarë piedestalesh e lartësoi Ansambli i Ushtrisë shqiptare Gaqo Avrazi, i cili sfidonte gjithçka dhe kudo. Ambicioz, ai triumfoi dhe e ngrinte lart dinjitetin e një kombi e të një ushtrie.

Gaqo Avrazi ishte energjik, shpërthyes, i rreptë, i prerë për disiplinë ushtarake dhe artistike. Ai i ngjante një strategu që pa këto virtyte nuk mund të mbante nën drejtim një ushtri artistësh dhe të komandonte në betejë. Për temperamentin e tij të paepur e të përpiktë, për t’u shkuar deri në fund e me lavdi koncerteve të Ansambli të Ushtrisë, kompozitori Tonin Harapi shprehet: “Te Gaqua dallohej ndryshimi rrënjësor i dirigjentit nga ai interpretues. Kur ngjitej në pult, ai ishte i tëri në lëvizje, duke krijuar një atmosferë elektrizuese. Njëherë u ngjit në pult me një çiban tepër të acaruar në qafë. Ai nuk pushoi, siç i rekomanduan, por dirigjoi si ngaherë e me tërë qenien. Pas koncertit, ne u habitëm. Jaka e xhakëtës ishte përgjakur. Gjatë një koncerti, një anëtar u aksidentua dhe, sapo e çuan në spital ai dha shpirt. Në një çast ndërprerje të shfaqjes, ngjau ajo që i habiti spektatorët. Ansambli me dirigjentin e madh, kapëdanin e pakrahasueshëm të asaj fushe, qanin dhe këndonin këngën e Asim Zenelit. Ndërkaq, edhe të pranishmit lotonin. Prandaj Gaqo Avrazin do ta kujtojmë gjithmonë, me atë shpërthim total të emocioneve

të tij të pashtershme në pultin e dirigjentit, që elektrizonte trupën dhe sallën e dëgjuesve”. Vepra e Gaqo Avrazit, e barasvlershme me atë të personaliteteve të spikatura të gjeneralitetit shqiptar, meriton një studim kompleks, si një rast i rrallë në fushën shqiptare.

Themeloi grupin e parë artistik partizan të qarkut të Korçës dhe të gjithë Shqipërisë, me anën e të cilit përhapoi këngët mëmëdhetare, partizane dhe revolucionare të traditës dhe këngët e kompozitores Dhora Leka.

Ai drejtoi korin e UNÇSH-së që u krijua, më 25 korrik 1944, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë. Pas vitit 1945, mbi bazën e këtij kori, u krijua Ansambli Artistik i Ushtrisë, të cilin e drejtoi për shumë vjet me mjeshtëri.

Gaqo Avrazi krijoi shumë poema, kantata, muzikë dhomë, këngë, marshe, tablo muzikore. Ishte drejtues artistik i talentuar e me kulturë të gjerë profesionale. Është dekoruar me urdhra e medalje të luftës dhe të veprimtarisë artistike.

Çdo fushë e prodhimit material e shpirtëror të shoqërisë, si dhe çdo strukturë në fushën ushtarake përfaqësohet me personalitete të rangjeve të ndryshme, duke formuar plejadën e strategëve, të reformatorëve dhe gjeneralëve. Këtu nuk mund të lihet pa përmendur edhe organizatori, kompozitori dhe dirigjenti i muzikës, i këngës ushtarake shqiptare dhe i valleve popullore, gjenerali i Ansambli të Ushtrisë Shqiptare dhe Kombëtare, Gaqo Avrazi. Një formacion gjigand, kompleks dhe luftarak, siç ishte Ansambli i Ushtrisë, u lind e u lartësua me emrin, autoritetin dhe kontributet e tij të veçanta.



"Sikur ta dija",
ish-koloneli Baki Bala,
përtej sfidave të jetës



Nënkolonel (R)
Besnik Gjonbrataj

Panairi i Librit është një traditë e bukur dhe një ngjarje e veçantë në Tiranë që bën bashkë njerëz të moshave të ndryshme, të cilët mbushin ambientet e Pallatit të Koncerteve, duke vizituar standat e shtëpive të botuese, për të zgjedhur titujt e tyre të preferuar.

Unë jam një lexues i rregullt dhe e kam bërë zakon që të jem një prej vizitorëve të panairit të përvitshëm të librit, por ky vit ka qenë më i veçanti dhe më surprizuesi, dhe besoj kjo, jo vetëm për mua por edhe për shumë kolegë të mi ushtarakë e ish-ushtarakë dhe jo vetëm.

Habia ime ishte tepër e madhe teksa pashë në një prej standave të “Panairit të Librit 2023”, një libër me emrin e autorit të cilin e njihja, por, po kaq e madhe ishte dhe befasia e titullit që mbante ai libër. “Sikur ta dija”, autor Baki Bala, ish-koloneli, ish-ushtaraku me një karrierë të spikatur në Forcat e Armatosura e më tej, në jetën civile ish-prefekt, por tashmë në një gjendje tepër të veçantë, në një karrige me rrota me një sëmundje të rrallë në trup, por me një forcë të jashtëzakonshme e që del para lexuesit si një shkrimtar...

E papritura dhe emocioni që ndjeva më bëri të shkruaj këto rreshta për ish-kolonelin Baki Bala dhe t’ia dërgoj redaksisë së gazetës “Ushtria”, si për t’iu thënë të gjithëve në Forcat e Armatosura se çfarë është fuqia e ushtarakut, e shpirtit dhe e zemrës, e dashurisë për jetën për të mos u dorëzuar asnjëherë sa të jesh gjallë edhe në kushtet më ekstreme.

Kolonel (R) Baki Bala, gjatë karrierës së tij shërbeu në të gjitha nivelet, Brigadë, Divizion, Forca e Bashkuar, SHPPFA dhe në Ministrinë e Mbrojtjes. Disa nga detyrat e tij gjatë shërbimit në FA kanë qenë: komandant i Brigadës së Ndërlidhjes, drejtor i Drejtorisë të Ndërlidhjes, shef i Shtabit të Forcës së Bashkuar dhe drejtor i Drejtorisë së Modernizimit. Ai ka kryer studime në Shkollën e komunikimit të NATO-s Itali, në Akademinë e luftës në Turqi, kursin e menaxhimit në SHBA dhe Kolegjin rajonal të Mbrojtjes. Ish-koloneli Baki Bala përveç gradës ushtarake me të cilën mbylli karrierën në FA, mban edhe gradën shkencore PhD. Kurse karrierën në funksionin publik të Prefektit të Qarkut e mbylli nën një sëmundje të rrallë por që ajo s’mundi t’i mbyllë dritaren nga e cila t’i drejtohet njerëzve e s’mundi t’i përkulë shpirtin e tij luftarak të ushtarakut.

Ai vitet e fundit ka nxjerrë para publikut shkrimtarin brenda vetes, shkrimtarin që i shtohet Forcave të Armatosura. Baki Bala vjen si krijues letrar në gjininë ambicioze të romanit dhe na tregon se është një njeri i fortë, që diti të përballet me sëmundjen dhe ecën me forcë përpara, me optimizëm dhe dëshirë, krijues dhe me madhësi, duke u bërë një burim frymëzimi.

Përveç botimeve në Bibliotekën e FA-së që mbajnë emrin e tij, ish-koloneli Baki Bala ka botuar librin “Këndvështrim mbi Institucionin e Prefektit të Qarkut” në vitin 2019, librin “4P e Procesit të Blerjeve” në 2022, por edhe botime artistike si romanin “Marina” në vitin 2021 dhe këtë vit, romanin “Sikur ta dija”.

Vepërtaria e profesionit të tij ushtarak, teksa shërbeu si prefekt dhe së fundi në fushën e botimeve artistike, ishte befasuese për ata që e njohin dhe e habitshme për publikun e gjerë. Teksa e pyesim se si kanë bashkëjetuar këto tek ai si individ, ish-koloneli na thotë se edhe pse këto në pamje të parë mund të vlerësohen si “tre fusha guaskore, hermetike e të pa depërtueshme”, në këndvështrimin e ushtrisë kjo ndodh pasi në sytë e publikut “ushtaraku vlerësohet thjesht si qytetar me uniformë dhe jo si një profesion që karakterizohet nga cilësi të spikatura karakteriale”. Profesionin e ushtarakut është në përgjithësi i mbyllur për të qenë një shkrimtar apo një politikan, thotë ai. “Shkrimtar nuk të bën arsini që ke mbaruar. Ai të ndihmon dhe zhvillon imagjinatën. Historia ka treguar se ushtarakët kanë qenë historianë, romancierë, piktorë, muzikantë e studiues që kanë lënë gjurmë në fushën e artit dhe jo vetëm. Kjo shpjegohet me faktin që çdo individ ka të shfaqur apo të fshehur, për një farë kohe, dhunti të tjera jashtë profesionit, të cilat ndërthuren me të dhe krijojnë impulse të bukura. Ky është edhe rasti im”, - thotë shkrimtari. Ushtaraku është njohës i mirë i ambientit në këndvështrimin historik, politik, social, demografik, topografik, florës dhe faunës, të cilat ndihmojnë në përshkrimin e veçorive artistike të tij. Ai e sheh terrenin si një fotograf që në



të njëjtën kohë fikson funksionalitetin dhe veçoritë e tij. Më tej ai na shpjegon se funksioni i Prefektit nuk është profesion dhe se ai të ndihmon më shumë për të njohur njerëzit dhe problemet e kategorive të ndryshme sociale. “Kjo ka lenë gjurmë tek unë”, - thotë ai.

Individi për të shkruar një roman duhet të ketë përvojë jetësore, të ketë besim në vetvete, të ketë hobi në fushën e letërsisë apo artit dhe të dijë të analizojë ekuilibrat socio-psikologjikë në një mjedis të caktuar historik e politik. “Këto cilësi më kanë ndihmuar për të marrë iniciativën e disa botimeve. Shkrimtar është fjalë e madhe, por shkrimin e kam pasion që më jep kënaqësi më zhvillon imagjinatën dhe më bën të futem në karakterin e personazheve. Dëshira për të marrë iniciativën e shkrimit të veprës letrare komplekse si romani ka ardhur gradualisht”, - thotë ish-koloneli. Jetën ushtarake, pavarësisht për veçorinë e saj, ai e ka parë me idenë që në çdo rrethanë të krijojë ngjyrimin për kënaqësinë shpirtërore, duke krijuar ritmin për t’u zgjuar nga monotonia profesionale. Kjo ka shtuar dritëhijet në “peizazhin” jetësor për t’i bërë përjetimet të dallueshme. Njeriu edhe në shkretëtirë mundohet të krijojë oazën e tij. “Oazi im u mbështet në fantazinë dhe imagjinatën që të zhvillon profesionin i ushtarakut dhe në hobet e mia: piktura, fotografia dhe shkrimi. Piktura dhe fotografia më ka edukuar shijen e të veçantës për kapjen e momentit, që shfaqet vetëm një herë dhe fokusi tek detajet”, - thotë autori i romanit “Sikur ta dija...”.

Thelbi i një romani është një tregim apo ese, e cila shtjellohet, jo vetëm në një plan, por në shumë plane, ku personazhet krijojnë lidhje të ndryshme. Profesionin e ushtarakut dhe detyra e prefektit ka sa fije lidhëse aq edhe kundërshtuese me shkrimin letrar. Zhvillimi i imagjinatës, njohja e teknikës së shkrimit akademik, përvoja jetësore janë ingredientë për të “gatuar” një roman. Dhuntitë në fushën e artit dhe pasioni, i lidhin ato me njëra-tjetrën. Një nga faktorët pengues është impenjimi që kërkon jeta ushtarake.

Shkrimi profesional, sidomos për ushtarakët e gradave të larta, vjen natyrshëm nëpërmjet procesit “Lessons Learned”, hartimit të rregulloreve, procesit të mbrojtjes së gradës shkencore, botimit të artikujve në revista brenda dhe jashtë vendit. “Unë kam kaluar në të gjitha këto faza. Natyrisht duhet të kesh dhunti, të cilat kanë qenë brenda meje dhe janë zhvilluar”, - na tregon autori.

Megjithatë këto punime, në formën e prozës, nuk kanë ngjashmëri me shkrimin e një romani, pasi janë shkrime që dallohen nga terminologjia e ngurtë, me figura të pakta letrare, mungesa e emocioneve të shkruarit dhe ekzistenca e referencave të burimeve. Mungon lirshmëria e autorit.

Një lidhje e ngushtë e shkrimit akademik dhe letërsisë është shkrimi i një analize letrare. ‘Shkrimi akademik më ka ndihmuar për të

strukturuar dhe zhvilluar një ide, e cila është e përbashkët në çdo disiplinë letrare. Shkrimet dhe botimet e para janë dy monografi dhe libri profesional “Këndvështrim mbi prefektin e qarkut”. Romani “Marina” është si një shpërthim ndjenjash të fshehura brenda meje si në gjendje të përgjumur që donin një ngacmim emocional të fortë. Fillimisht bëra një tregim. Bashkëshortja dhe vajzat tona u emocionuan dhe në kor thirrën, “bëje roman”. Duke parë gjendjen time kritike për jetën nga një sëmundje e rrallë, që po më çonte drejt fatalitetit, mua më ushtuan veshët sikur thanë, “Babi duam të na lesh një roman si kujtim”. Pa u menduar gjatë thashë, “Po”. Ato më bënë dhuratë një kompjuter, të cilën unë e konsiderova si koncesion për romanin’, - tregon ish-koloneli për fillimet e tij si shkrimtar i letërsisë artistike.

“Një roman kërkonte më shumë ndjenjë, ngjyrim e harmoni rrethanash. Nuk do ishte me fjali standarde që fokusohen te kuptueshmëria e jo tek ndjenja. Ndoshta, mendova do më ndihmojë fakti që hobi im është piktura, fotografia dhe poezia. Secila prej tyre shikon përtej realitetit. Fokusojnë momentin e papërsëritshëm ashtu si përzjerja e bojërave në pikturë, të cilat kur i përsërit afrohen, por nuk janë identike. Unë shkrimin e një romani e mendoja një frymëzim e jo ‘Babi bëj një roman’. E kisha përfytyruar të shkoja në një vend të qetë, që i përshtatet subjektit, për shembull në verandën e shtëpisë në fshat, ku lulet, zogjtë, mjedisi i gjelbëruar, zgjimi me këngën e këndesit, lehja e qenit, troku i kalit e melodia zile-këmborë ishin një realitet dhe jo fantazi. E mendoja që herë pas here të ftoja miq që i doja me zemër në një gosti të thjeshtë dhe të këndshme para mishit mbi prushin e ‘barbeque’, një gote verë nën aromën e kulaçit që del nga afshi i furrës me dru. Nga të gjitha këto, unë thuajse nuk kisha gjë. Gjendja ime shpirtërore, pas diagnostikimit me një sëmundje fatale, gjendja fizike, e cila po shkonte drejt paralizës, ishin pengesa reale”, - thotë B. Bala. Ai thotë se krijoi një “buqetë” të përvojës jetësore, të cilën e projektoi të qartë në koshiencën e tij. Nga ushtria mori vullnetin dhe imagjinatën, hobia e tij, pikturën, fotografinë, poezinë dhe përvojën e gdhendur jetësore. Nga funksioni i prefektit ai mori këndvështrimin social dhe nga vendlindja karakteret e personazheve. Buqeta duket sikur i tregonte rrugën.

‘Jam falënderues për vlerësimin e Akademikut Ali Aliu, i cili vlerëson se “Zgjedhja fabulare në romanin “Marina”, është një dëshmi narrative e qëndrueshme dhe vjen në frymën e mëtimeve për të qenë sa më origjinale. Autori rrëfen pa menduar kufijtë e strukturës romanore si dhe është i shkompleksuar nga konvencat.



Është një roman që lexohet me ëndje deri në fund, me një histori dashurie që, transmeton vlerë duke u treguar si e një shkuar e mbyllur në dryn”. Romani “Marina” bazohet në histori të vërtetë. Ai mbështetet mbi analizën: “Të shkuarën që nuk e njohim, a duhet ta konsiderojmë?”, ku ndriçimi i të shkuarës zbuloi një situatë komplekse, e cila gradualisht shkon drejt acarimit të skajshëm të dashurisë së dy të rinjve. Ajo sjell ndryshime dramatike, gjithashtu mundëson jo vetëm njohjen e të shkuarës, por hedh dritë edhe mbi shpjegimin e sjelljes dhe karakterit të personazheve. “Në faqen e parë paraqita një gjendje emocionale të rënduar të personazhit kryesor, e cila u qartësua në faqet e fundit. Mendova për metodologjinë e ndërtimit të një romani, llojin e narrativës që do të zgjidhja, mënyrën e ngritjes së konfliktit zhvillimit dhe zgjidhjes, periudha historike dhe politike, vendet, mesazhin që do të jepja, dialektin e trevave dhe doket e zakonet. Pemën e informacionit, që kam përdorur në ushtri për të projektuar zgjidhje e shndërruara në Pemën e librit si një udhërrëfyes. E vendosa veten në rolin e personazhit kryesor, në fillim të shekullit të XIX dhe në psikologjinë e sjelljes së individit në kushtet ekstreme të presionit të sjelljes njerëzore”, - na tregon autori. Marina suksesin e ka në mënyrën e rreshtimit të ngjarjeve që krijojnë kërshtëri, emocion e dramacitet. Është një ngjarje e mbyllur në dry për tërë jetën. Dalja e saj prej “drynit” befason dhe përligj rëndësinë njohjes së të shkuarës për të kuptuar të tashmen.

Romani “Sikur ta dija”, lufto për jetën! Mos u dorëzo!

Romani “Sikur ta dija” bazohet në histori njerëzore, ku personazhet kryesorë, Roberti dhe Ana, përballen me një sfidë jetësore që u shkërmoq ëndrrat, por jo dashurinë. Romani ka një harmoni midis rrugëtimit profesional, dashurisë dhe sfidës familjare, duke përcjellë shpresë. Roberti, i ndodhur në qendër të vorbullës jetësore, bëri pjesë të tij mësimin: “Situata, mund të çojë në ndryshim dramatik të përjetimeve, por në çdo rrethanë lufto për jetën. Mos u dorëzo!”

Gjendja shëndetësore konsiderohet temë tabu dhe si sekreti më i madh. “Unë vendosa ta bëj publike me mendimin e mirë për të transmetuar disa mesazhe shprese. Pikërisht romani ‘Sikur ta dija’, përçon një realitet përballje, jo vetëm të pacientit, por së pari të familjes. Jeta është e bukur. Ia vlen të luftosh për të edhe kur ndodhesh në kryqëzimin e saj. E rëndësishme është të mbash shpresën zgjuar, ku pas tunelit të mendosh se ka dritë apo i ndodhur në një stuhitë detare, ka një far që orienton. Kjo është situata ime”. Romani “Sikur ta dija” është i veçantë jo vetëm për subjektin, por së pari për sfidën e të shkruarit. Ai është shkruar nga autori në kushtet ku rri shtrirë në krevat i paralizuar. “Kam shkruar 430 faqe në tastierën e telefonit vetëm me gishtin e madh të njëres dorë, pasi gishtat e tjerë janë të atrofizuar”, - na tregon ai sekretin e suksesit të tij. Shkrimi i një romani, një poezie apo hedhja në telajo e një pikturë në akrilik apo vaj është më shumë se një vepër artistike. Ajo ka të kristalizuar një histori të tërë apo një simfoni që i këndon sfidës dhe dashurisë për jetën. Njeriu në çdo rrethanë nuk duhet të ankohet për të pakthyeshmen, por të luftojë për të mundshmen. “Çdo njeri ka ose gjen një motiv për fillimin e ditës së re. Dikush shkon në punë, shkon në shkollë, në çerdhe e kopsht e të tjerët vrapojnë apo e nisin ditën me një kafe. Unë bëj atë që më ka mbetur. I gëzohem kur në jetë vjen një krijesë e re, mbesë apo nip, kur çel dita e re, një përqafimi të sprovuar në qëndrueshmërinë e tij, i gëzohem ciklit të një luleje, i gëzohem çdo dite. Shkruaj nga krevati apo karroka me ndihmën dhe kujdesin e bashkëshortes dhe frymëzimin e vajzave tona”.

Shkrimtari, ish-koloneli Baki Bala ka dhe një pasion tjetër. Poezia është nostalgji që e çon atë në moshën e adoleshencës me përjetime impulsive që kanë lënë gjurmë. “Poezia shkruaj edhe tani, sidomos fabula. Shpesh pyes veten: pse poezia ka filluar të bëhet gjini letrare e dashur për mua? Përpara syve më del poeti Petrit Ruka, sikur zbret nga yjet, i cili ka thënë se proza planifikohet të shkruhet, ndërsa poezia lind në mënyrë të beftë nga një brengë apo emocion i fortë. Poezia është frymëzim i çastit. Këtu unë e gjej veten për të përjetësuar në vargje emocionet. Botimi im i radhës do të jetë libër me poezi, i cili do shprehë më mirë botën time të brendshme. Poezia ime i ka të gjitha shijet dhe ngjyrat, e cila nuk të vel, pasi të fut në mendime”.

Të shohësh veten përmes kujtimeve të miqve



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

(Rreth librit "Pajtim Ribaj, personalitet, studiues dhe pedagog")

Nga fundi i muajt korrik, së bashku me dr. Zihni Goxhaj dhe dr. Albert Hitoaliaj, ndërmorëm një nismë për një ftesë me rastin e 75-vjetorit të prof. dr. Pajtim Ribaj, me mision "të shohësh vetveten përmes kujtimeve të miqve". Ftesa ishte e një lloji disi ndryshe nga ftesat e zakonshme. Ne kërkuam që, me miqtë dhe të afërmit e ngushtë të profesorit të bënim një bashkëbisedim miqësor të singërtë, të vërtetë e të vlerësuar në retrospektivë. Ideja e ftesës ishte për kujtimet që secili prej rrethit shoqëror, miqësor e kolegë të profesorit të silleshin dhe të bëheshin bashkë në një botim të shkurtër... Mirëpo botimi doli i gjatë... me titull "Pajtim Ribaj, personalitet, studiues dhe pedagog".


Filluam punën me besim tek të gjithë të njohurit se do të na përgjigjeshin me kujtime, mbresa dhe urime, të mbledhura e të bëra bashkë si në librin tashmë të publikuar. Në ide, ne donim të krijonim një "tryezë" miqsh, të cilët të jepnin vlerësime, të zgjonim nostalgji, të bënin shaka apo dhe kritika, por mbi të gjitha të shfaqej ana njerëzore e profesionale. Dhe materialet e para erdhën në dhjetëditëshin e dytë të gushtit... e para na shkroi profesore Flutura Xhabia, pastaj Hysen Sheh Hormova, i cili e bekoi librin dhe nismën... për të vijuar me të gjithë nga Shqipëria e deri nga Amerika... pothuajse rreth 100 shkrime.

Ftesa u bë realitet, sepse ishte dëshira e mirë dhe qëllimit u arrit, të gjithë bashkë u bëmë pjesë e këtyre kujtimeve... Skica e këtyre kujtimeve të sjella nga ju të nderuar miq e shokë, ka përfshirë mendime, ndjenja e opinione personale rreth ngjarjeve e periudhave të ndryshme të jetës së prof. Pajtim. Në këto kujtime, urime, mbresa, ese, janë përshkruar ngjarje, që nga vitet e rinisë së hershme e deri më sot, të cilat japin formimin dhe personalitetin e profesorit.

Nëpërmjet tyre ne shkojmë në data, në kohë, në individë dhe në vende specifike, të cilat për ne ishin shumë të dëshiruara, ku nëpërmjet dhe të një batute apo mendimi përshkruhet ngjarja e ndodhur.

Të gjitha shkrimet e ardhura na ndihmuan dhe na sollën portretin e profesorit, duke e pasqyruar saktë jetën e tij, ashtu siç ajo ishte në të vërtetë... shkrimet kanë të veçantën e tyre, sepse është një bashkëbisedim midis kolegut dhe profesorit, sepse janë fjalë zemre dhe mirësie të njerëzve që profesori i takoi në jetë dhe iu dha dije, e mori prej tyre respektin dhe dashurinë.

Të gjithë ne, një jetë e kemi lodhur profesorin për të marrë dije prej tij dhe i morëm, por edhe ne "u lodhëm" me kujtimet për të, sepse duket sikur janë të thjeshta kur i jep, por kur ulesh t'i shkruash ngec..., siç ka shkruar gjeneral Sula: "...Vura re se nuk ishte diçka



e lehtë", pra profesor na ke lodhur...

Librin e kemi nisur me një parathënie të shkruar nga gjeneralmajor Perlat Sula, pasi me profesorin ai ka njohje mbi gjysmëshekullore, por ishte dhe koha kur punoi me profesorin në KDS, i cili ishte në kulmin e tij. Pastaj kemi vazhduar me mendimet dhe sugjerimet e dhëna për profesorin, kur kërkonte të merrte gradën shkencore, për të vijuar me amerikanin Daniel F. Harrington, me përshtypjet e tij për figurën e oficerit shqiptar të prezantuar nga prof. Pajtimi. Vijuam me mendimet e dhëna për librin "Shkencëtari i Sigurisë" nga akademik Pëllumb Xhufi dhe prof. Gjergji Sinani, për të vazhduar librin me kujtimet me emrat sipas alfabetit të gjuhës shqipe. Kujtimet rrokin tërë jetën e profesorit, si dhe ka një lidhje midis tyre, ku profesori herë na paraqitet djallë i ri dhe herë burrë para auditorit, herë me mendje tek bistakët e rrushit që gjoja i mori rojës dhe herë tek leksioni i parë i paraqitur në PowerPoint, herë duke zbritur nga shkëmbi me litar dhe herë duke bërë debate për problemet e mbrojtjes dhe të reformimit të FA-së etj.

Tashmë kujtimet janë hedhur në libër dhe ka filluar bashkëbisedimi me profesorin... Ky libër është disi i veçantë dhe i ri në llojin e vet, ndaj edhe këtu profesori ka meritën, se solli diçka të re me përvojën e tij, atë të kujtimeve...

Ata që nuk iu përgjigjën ftesës, ju kemi lënë një hark kohor prej 5 vitesh dhe në 80-vjetorin e profesorit shkrimet e tyre të jenë bërë një mal me urime!

Arqile Lipe: “Malua” më ndryshoi emrin por më zgjati jetën

Skënderbegasi Arqile Lipe, i vlerësuar me titullin e lartë “Artist i Merituar” është një nga aktorët e njohur shqiptar të estradës.

Arqile Lipe u lind, më 17 shkurt të vitit 1949, në Fier dhe banon në këtë qytet. Ai është një nga nxënësit e Shkollës së Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej” që ka arritur të bëj emër si aktor, kryesisht në fushën e humorit.

I ardhur nga ushtria, filloi punë në prapavijën e teatrit si hidraulik, kaldajist dhe më pas si magazinier, kur një ditë në zyrën e magazinierit dëgjon pa dashur një bisedë që bënte shefi i muzikës Isuf Maloku (që sot nuk jeton më), pasi i thotë: “Ky kaldajisti më duket djalë me humor, ta provojmë një herë, ne marrim amatorë, ta provojmë dhe këtë”. Kështu, u çel rruga, dhe filloi si aktor në vitin 1971. Premiera e parë ka qenë “Revista”, e shkruar dhe vënë në skenë nga Pëllumb Kulla. Rolet që ai ka interpretuar janë të shumtë dhe kanë lënë mbresa jo vetëm tek shikuesit e kohës, por dhe për brezat më vonë. Arqile Lipe, pasi mbaroi shkollën fillore dhe atë shtatëvjeçare në vendlindje, i del e drejta e studimit për në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”. Këtë shkollë ai e nis në shtator të vitit 1963 dhe e përfundon në vitin 1967. Por ndryshe nga pjesa më e madhe e shokëve të tij të klasës që vazhduan arsimimin e mëtejshëm në shkolla të ndryshme ushtarake dhe iu përkushtuan karrierës në këtë fushë, jeta e Arqile Lipes pati tjetër udhë. Ai u shkollua dhe ia kushtoi jetën artit. Ai spikati qysh në lëvizjen amatore të qytetit, por profilin e tij artistik e konsolidoi në Estradën e Fierit, qysh kur u emërua aty si aktor profesionist në vitin 1971.

Ka një mimikë shprehëse, të planit komik. Gjestikulimi i tij është i shkathët. Përdor formë burleske, me zmadhimin e një tipari komik. Po ashtu, në aktrimin e tij bie në sy bufonada, karikaturizimi i tipave, zhërvjelltësia plastike. Fatmiri është një nga kupletistët dhe parodistët e hijshëm të teatrit të estradës. Ai është bërë i njohur posaçërisht në një nga interpretimet e tij më të spikatura bashkë me aktorin Todi Llupi, në parodinë “Do martojmë Malon”, më 1982. Të shumta janë rolet e tij, kryesisht në komedi me një akt, në skeçe, parodi, kuplete, monologë, pantomima, dialogë etj. Ndër rolet kryesore të tij mund të përmendim: Fshatarin tek “Një shkrimtar në kullë”; zëvendësministrin tek “Bashkëfshatarët”, kryeplakun tek “Anekdotat e humorit popullor”; brigadierin tek “Kontakte dhe Izolatorë” (1984); punëtorin tek “Kënga e Gjyles” (1985), Llazi tek “Rexha ka thirrur rojet” (1987); fshesaxhiu tek “Plakemi me hallet e botës”; shkrimtari tek “Çobua me shkrimtarin” (1989) etj.

Gjithashtu, Arqileja ka luajtur role në komedi të plota, si Mirashi tek “Flokë dëbore” në prill 1982; avokati tek “Një budalla e gjysmë” (1995); fshatari tek “Lamtumirë fukarallëk” (1996); çalamani tek “Me trap drejt Europës”; polici tek “Pazari” (2004). Në vitin 1989 i është dhënë titulli “Artist i merituar”. Teksa autori pyetet mbi rolet e tij, menjëherë dallon atë të personazhit të “Malos”. “Edhe miqtë sot më shumë më flasin ‘Malo’ sesa Arqile. Më pëlqen llagapi ‘Malo’. Kam shumë histori me këtë emër të skeçit. Kudo që shkoj, kuqo që rri, kudo që diskutoj më thonë: ‘Hë mo Malo?’. Por çudia më e madhe ka qenë kur jam martuar. Në atë kohë, ‘Malo’ kishte një apo dy vjet që kishte dalë. Gruan e kam vlonjate, pra jam dhëndër në Vlorë. Kur do bënim fotografitë e



fejesës, siç i kërkonte koha, aty pranë fotografëve njerëzit na shihnin me kureshtje. Na shihnin dhe i çuqurisnin njeri-tjetrit në vesh. E di çfarë thoshin: ‘Uaaaa, Malua i Fierit po merr një gocë nga Vlora. Bravo Malo!’. Kështu që pas atij roli dhe deri më sot, pjesa dërrmuese e njerëzve më thërrasin ‘Malo’. Kur më thërrasin me emër, ndonjëherë as kthej kokën. Kjo pasi njëherë kur ishim në një darkë me miq, ishte dhe një shok me emrin tim. Dikush foli: ‘O Arqile’ dhe unë thashë urdhëro! Ai që foli ma priti menjëherë: ‘Rri o Malo se nuk e kam me ty’. Që atëherë, kur më flasin në emrin e nënës shikoj mos ka të tjerë përqark që të kthej përgjigje se do më thonë ‘rri Malo!’ Kështu që emri ‘Malo’ më ka mbetur për 41 vjet... Ne aktorëve na personifikojnë me emrat e personazheve dhe kjo është kënaqësi. Kjo tregon se unë ia kam arritur, me punë e talent dhe e kam zbërthyer atë material saqë ka hyrë dhe është bërë popullor në çdo shtëpi, pak nga ekrani dhe pak nga skena. Nëse doli ‘Lipe Shtogu’, Fuati nuk e kishte më emrin Fuat, pasi njerëzit i thoshin: ‘U Lipe, hajde të të jap një kafe’, ose ‘Lipe si je’. Doli edhe një ‘Çobo Rrapushi’ dhe Luftëtarit i thërrisnin me këtë emër. ‘Malua’ më ndërroi emrin, por më shtoi jetën...”.



MUZETË, KUJTESA JONË HISTORIKE

Shumica e njerëzve, kur shkojnë në Pogradec kanë disa imazhe të ngulitura në mendje, të cilat u regjistrojnë që nga çasti që vendosin të marrin rrugën për në Juglindje të vendit. Dhe kjo nuk ka të bëjë me etno-kulturën. Madje dhe nëse mendohet, ajo është e fundit në radhë. Sepse fillimisht gjithkujt në parafytyrim u del liqeni i magjishëm, dhe fill pas kësaj një tavolinë e shtruar me prodhime të trevës ku padyshim nuk do mungojë peshku koran apo belushkat. Dhe një tryezë të tillë e gjen në mes të Pogradecit, në lokalet e shumta të plazhit përballë liqenit, por sidomos merr vlerë andej nga Tushemishti, ku njerëzit gazmorë duan të kujtojnë teto Ollgën e të bëjnë dhe ndonjë foto me shtatoren bronz të saj. Por shumë pak prej tyre e dinë që në Pogradec ka dhe një muze, i cili në brendësinë e tij ka plot artefakte që rrëfejnë për qytetërimin e lashtë të zonës. Dhe kohët e fundit këtë gjë më së shumti e kanë zbuluar turistët e huaj se sa ata vendas. Ndaj muzeu nuk është asnjëherë bosh. Muzeu i Pogradecit ndodhet në qendër të qytetit një godinë dykatëshe, por sërish është e vogël për të shfaqur objektet e ruajtura brenda. Që në oborrin e muzeut janë vendosur gjetje arkeologjike, të cilat i bien në sy çdo kalimtar i tërëshës. Dhe më kureshtari nuk nguron të futet brenda. Muzeu ka një koleksion të pasur me artefakte. Këto objekte përfaqësojnë historinë e rajonit, që nga parahistoria deri në ditët e sotme. Dhe kjo mbart në vetvete një vlerë të jashtëzakonshme, sepse janë pjesë e kujtesës tonë historike. Ky Muze përbëhet nga 3

pavijone kryesore të dedikuara Arkeologjisë që zë pjesën më të madhe të muzeut dhe për shkak të objekteve të shumta, Etnografisë dhe Historisë. Pothuajse tre të katërtat e hapësirës së godinës është e përdorur për ekspozimin e artefakteve, ndërsa pjesa tjetër përdoret për të ruajtur, restauruar dhe mbrojtur objektet e ekspozuara, si dhe për zyrat e administratës së muzeut.

Antikiteti

Artefaktet dhe dokumentet historike janë vendosur në mënyrë kronologjike dhe tipologjike që vizitorët të kenë mundësinë të ndjekin evolucionin e objekteve në ekspozitë; mjetet e punës, qeramikat, mjetet e luftës, bizhuteritë, monedhat dhe veshjet. Materialet e vëna në dispozicion na bëjnë të ditur se vendbanimet më të vjetra në zonën e Pogradecit gjenden përgjatë brigjeve të liqenit. Që nga kohët e lashta, kur kjo zonë filloi të popullohej nga njerëzit, nuk është braktisur asnjëherë, prandaj janë gjetur shumë gjurmë të vendbanimeve në këto zona. Për shembull, objektet që janë zbuluar në Lin i përkasin Epokës së Bronzit, Epokës së Hekurit dhe antikitetit të vonë.

Ndërkohë në zonën Memelishtit janë zbuluar gjetje nga periudha romake. Në Pogradec janë zbuluar objekte nga fillimi i Neolitit deri në Mesjetë. Starova i përket periudhës ilire. Gështenjasi ka një histori të përfaqësuar nga një kompleks i objekteve personale që i përkasin një aristokrati ilir që ka jetuar gjatë periudhës romake. Tushemishti ka artefakte nga qytetërimi ilir dhe antikiteti i vonë.



Armët

Në stenda ka armë që përfaqësojnë periudha të ndryshme, por që bëhet fjalë për të paktën 3000 vjet më parë. Janë maja shigjetash dhe heshtash që i përkasin fundit të periudhës së bronzit dhe fillimit të periudhës së hekurit. Ato janë gjetur në fshatin e Peshkëpisë, një pjesë tjetër vijnë nga Selca dhe nga Kalaja e Pogradecit.



Përkrenaret

Dy përkrenaret ilire janë dhe krenaria e muzeut pasi konsiderohen të rralla në llojin e tyre. Në të gjitha trevat ku janë shtrirë ilirët nuk janë gjetur më shumë se 500 përkrenare, ndërsa nga ky lloj janë rreth 20 – 30 nga të cilat 2 ndodhen në Muzeun e Pogradecit. Një është gjetur në fshatin Petrushë dhe tjetra në fshatin Starovë. Por në muze ruhet si artefakt edhe një përkrenare kelte, e cila edhe pse është fort e dëmtuar përbën një kuriozitet të madh.

Mesjeta

Gjithashtu në stenda do të ndeshësh dhe një grup monedhash të periudhës ilire por dhe të periudhës Bizantine në shekujt V dhe VI pas Krishtit, kryesisht të Perandorëve Justin dhe Justinian.

Gjithashtu ka mjete zbukurimi dhe pafta që përdorshin nga gratë në ceremoni të veçanta. Janë pafta që vendosen poshtë gjoksit në të cilat kanë edhe disa monedha të cilat mbanin ritmin kur gratë ngriheshin në valle. Këto janë gjetur përgjithësisht në Mokren e Poshtme.

Por janë gjetur objekte që i përkasin aspektit fetar. Ka kryqe të punuara me filigramë por edhe në dru ose dhe me të dyja bashkë, dru të përzierë me filigramë.



Gjithashtu ka dhe objekte të përdorimit të përditshëm: një sofër ngrënieje, enë balte që përdorshin për të mbajtur ushqimin. Enë prej bakri dhe argjendi.

Dokumentacioni

Muzeu është i pasur dhe me dëshmi të Periudhës së Rilindjes Kombëtare, Pavarësisë, Luftës së Parë Botërore, periudhat mes dy luftërave botërore dhe mbyllet me çlirimin e qytetit nga forcat naziste si dhe një listë me dëshmorët e këtij qyteti.



Një vend të veçantë zë dhe dokumentacioni për hapjen e parë të shkollës shqipe në Pogradec, e cila është hapur fill një javë pas asaj të Korçës, duke qenë kështu shkolla e dytë shqipe e hapur në trojet shqiptare.

Arkeologia Froseda Tola na informon se disa artefakte arkeologjike datojnë nga neoliti, rreth 8000 vjet më parë, apo 6000 vjet para Krishtit, ndërsa të tjerë i përkasin mesjetës së vonë. Objektet etnografike datojnë nga fundi i mesjetës deri në fillim të shekullit XX, ndërsa dokumentet dhe fotografitë i përkasin periudhës nga shek. XVII deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Muzeu shërben edhe si vend për organizimin e aktiviteteve dhe konferencave me natyrë të trashëgimisë historike dhe natyrore.

Epilogu

Vlera e objekteve të këtij Muzeu është shumë e rëndësishme, sepse rajoni i Pogradecit ka patur një histori ndryshe nga vendet e tjera të Shqipërisë. Për këtë arsye shumica e objekteve janë nga një kontekst i veçantë historik lokal dhe janë unike në krahasim me ato të pjesëve të tjera të territorit shqiptar. Në fakt kjo trashëgimi unike, duhet t'u kalojë brezave të ardhshëm, pasi rajoni i Pogradecit është shumë i pasur në histori dhe në kulturë.

Gjuha, guri i themelit të shoqërisë njerëzore

Gjuha jeton duke u folur, por kur mungojnë dokumentet e shkruara dimë pak për origjinën e gjuhëve. Njohuritë e grumbulluara mund të humbasin shpejt, për shembull për shkak të metodave të vjetruara të regjistrimit, që nuk i përdor më sot askush. Informacioni në një disketë apo në një disk mbetet i padobishëm, kur mungojnë pajisjet përkatëse për t'i dëgjuar. Kësaj i shtohet edhe fakti që gjuha dhe shkrimi zhvillohen vazhdimisht, saqë edhe informacioni i një libri, që gjithsesi mund të hapet, bëhet i pakuptueshëm. Është gati e pamundur të arrish në informacione, që nuk janë të shkruara askund dhe të jenë ruajtur për pasardhësit.

Kush shkruan, mbetet

Prandaj është aq e vështirë t'i përgjigjesh pyetjes se, cila është gjuha më e vjetër e botës. Gjuhët mund të transmetohen nga brezi në brez me shekuj, por bien në harresë, nëse nuk kanë lënë gjurmë me shkrim. Vetëm gjuha e shkruar lë gjurmë që dokumentohen. Dhe vetëm kur është shkruar mbi një material, që i ka rezistuar kohës. Shkrimet mbi materiale organike, si për shembull lëvore, kryesisht kanë humbur, ndërsa tekstet mbi gurë ose argjilë ndonjëherë janë ruajtur për mijëra vjet. Nëse ne jemi sot në gjendje edhe t'i lexojmë dhe t'i kuptojmë, është diçka tjetër.

Dëshmitë më të vjetra të shkruara

Si dokumentet më të vjetra të gjuhës së shkruar cilësohen shkrimet kuneiforme, ku shenjat në formë pyke janë shtypur mbi pllaka të buta argjile. Shkrimet më të vjetra të njohura kuneiforme rrjedhin nga sumerët, që u zhvilluan prej shekullit të katërt p.e.s. në Mesopotami, në territorin ndërmjet lumenjve, Eufrat dhe Tigër (në Irakun e sotëm).

Tekstet datojnë nga periudha rreth vitit 3.200 p.e.s.. Eposi i Gilgameshit është vepra më e njohur e gjuhës sumere. Gjuhët kuneiforme kanë qenë vendimtare edhe për zhvillimin e mëvonshëm të shkrimeve evropiane.

Pothuajse aq të vjetra janë edhe hieroglifët egjiptianë, që janë shkruar në varrin e faraonit Seth-Peribsen, 2775-2650 p.e.s., duke u ruajtur kështu për pasardhësit. Fjalja e gjetur aty është: "Ai ka bashkuar të dy vendet për djalin e tij, mbretin e dyfishtë Peribsen", konsiderohet nga ekspertët si fjalja më e hershme e shkruar plotësisht.

Shkrimi është ruajtur, por ne vetëm mund të imagjinojmë, se si kanë tingëlluar gjuhët më të vjetra të shkruara, sumerishtja, akadishtja dhe gjuha e Egjiptit të lashtë. Sepse të tria gjuhët janë zhdukur, ato nuk përdoren më dhe nuk kanë pasardhës të gjallë.

A ka pasur një gjuhë të parë të përbashkët?

Edhe pse nuk mund të gjenden prova të shkruara, njerëzit kanë pasur sisteme komplekse komunikimi, që i kanë lejuar ata të komunikojnë për mijëra vjet. Ekzistojnë teori të ndryshme gjuhësore për origjinën e gjuhës njerëzore, por asnjëra prej tyre nuk është e vërtetuar plotësisht.

Gjuha njerëzore mund të ketë lindur nga një kombinim faktorësh, duke përfshirë zhvillimin kompleks të trurit, ndërveprimin social dhe nevojën për bashkëpunim në gjueti dhe mbledhjen e ushqimit.



Gjuha mund të ketë dalë me kalimin e kohës nga kombinimi i gjesteve të duarve dhe lëvizjeve të trupit.

Ekziston edhe teoria se dikur ka ekzistuar një e ashtuquajtur "protogjuhë", një gjuhë e përbashkët parahistorike, nga e cila kanë rrjedhur të gjitha gjuhët moderne me kalimin e kohës. Megjithatë nuk ka prova të mjaftueshme se një gjuhë e tillë e përbashkët universale ka ekzistuar ndonjëherë.

Diversiteti përmes izolimit dhe emigrimit

Ka më shumë gjasa që shoqëritë parahistorike të kenë pasur shumë gjuhë dhe dialekte të ndryshme rajonale, të ngjashme me sot. Diversiteti i gjuhëve njerëzore u zhvillua me kalimin e kohës përmes izolimit gjeografik, shkëmbimit kulturor dhe migrimit. Kur grupet e njerëzve u ndanë dhe u ekspozuan në mjedise të ndryshme, gjuhët e tyre u zhvilluan në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra. Kjo çoi në krijimin e morisë së gjuhëve që kemi sot.

Gjuha baske

Gjuha Baske ose Euskara siç njihet nga folësit e saj, është vërtetë një gjuhë e mahnitshme dhe unike në Evropë. Ajo flitet sot në rajonin Bask në Spanjë nga rreth 750.000 folës amtarë dhe rreth 1.185.000 folës të tjerë, që nuk e kanë gjuhën e tyre të origjinës. Rajoni Bask është shtëpia e popullit bask, një zonë që shtrihet midis kufirit mes Spanjës dhe Francës, e përqendruar rreth Gjirit të Biskajës. Gjuha baske nuk ka asnjë lidhje me gjuhët fqinje. Një teori interesante, e lidh baskishten me gjuhët e maleve të Kaukazit, siç janë gjuha çeçene dhe ajo gjeorgjiane, që janë gjithashtu unike.

Gjuhët kartveliane

Banorët autoktonë të rajonit të Maleve të Kaukazit Jugor, gjuhët kartveliane janë padyshim ndër më të vjetrat në botë, dhe që fliten ende. Këtu futen gjuha gjeorgjiane, svan, zan, mingrelia dhe laz. Izolimi gjeografik i fiseve që jetonin këtu, lejoi zhvillimin e pa shqetësuar të shoqërive unike, që më vonë do të sundonin rajonin. Gjuha gjeorgjiane, ka formën e saj më të hershme të shkruar që daton në vitin 430 Pas Krishtit. Por vetë gjuha, është sigurisht shumë më e vjetër. Kjo familje gjuhësore, nuk është e lidhur me asnjë tjetër në botë, dhe ka rreth 5.2 milionë folës në të gjithë botën.



Gjuha tamile

Gjuha tamile është një pjesë e gjuhëve dravidiane, dhe flitet nga komuniteti etnik Tamil, që banon në pjesën më jugore të nën kontinentit Indian. Ajo është gjithashtu një nga gjuhët më të vjetra në botë që fliten ende sot.

Në shtetin indian Nadu, gjuha tamile është gjuha zyrtare. Ajo nuk ka asnjë lidhje “gjenetike” me gjuhën dominuese hindu në Indi. Ajo flitet nga rreth 75 milionë tamilë, të shpërndarë në të gjithë botën. Forma e saj më e hershme e shkruar, daton në vitin 300 Para Krishtit.

Gjuhët paleo-siberiane

Ato u përkasin fiseve të largëta të Siberisë dhe Lindjes së Largët në Rusi. Këtu përfshihen gjuhët ket, çukotko-kamçatkane, nivk dhe hukagir. Nga ana tjetër, ato përbëhen nga shumë forma dhe dialekte rajonale. Është e sigurt, që këto gjuhë i paraprijnë gjuhëve që janë sot dominuese në Siberinë e sotme, si gjuhët ruse, tunguze dhe turke. Këto fise nomade, nuk zhvilluan kurrë një sistem të shkruar të gjuhëve të tyre.

Gjuha ainu

Është gjuha e komunitetit etnik Ainu në Japoninë Veriore, dhe që i paraprin popullit modern japonez, që u vendos në këto ishujt. Ainu është një gjuhë e izoluar, pa asnjë lidhje me japonishten. Ekzistojnë disa lidhje të vogla të saj me gjuhët paleo-siberiane. Njerëzit e komunitetit ainu dhe gjuha e tyre janë sot të rrezikuar, teksa shfaqin tipare të dallueshme gjenetike dhe kulturore në krahasim me japonezët.

Gjuha arabe

I përket grupit të gjuhëve semite, dhe është ndër më të vjetrat ende në përdorim. Disa mbishkrime në arabisht, datojnë që nga viti 125 pas Krishtit. dhe është një shembull i shkëlqyer sesi gjuha e një kombi të fuqishëm pushtues, mund të vendoset në një zonë të gjerë, dhe të mbijetojë për shekuj në formën e saj origjinale.

Gjuha aramaike

Kjo gjuhë mburret me afro 3.100 vjet histori të shkruar. Ajo ishte në fillim gjuha e fisit aramean, që u përhap në rajonet e Levantit, Sirisë dhe Mesopotamisë në Lindjen e Mesme, dhe që kishte krijuar një mbretëri që rreth vitit 1000 para Krishtit. Edhe në kohërat antike, ajo u përdor si një gjuhë mbretërore në disa nga oborret më të vjetra të botës.

Gjuha kineze

Gjuha kineze është shumë e vjetër, dhe një ndër më uniket në botë. Ajo është shumë komplekse si në të shkruar, ashtu edhe në të folur. Sistemi i saj i shkrimit mund të përbëhet deri në 100 mijë simbole të ndryshme. Forma më e hershme e shkruar e kinezishtes, daton që nga viti 1250 para Krishtit.

Gjuha perse

Persishtja, e njohur edhe si farsi, është një gjuhë shumë e vjetër indo-evropiane, që i përket nëndarjes indo-iraniene. Ajo flitet nga rreth 70 milionë njerëz në të gjithë botën. Është e gjurmuar në formë të shkruar që në shekullin VI Para Krishtit, por historia e saj është më e vjetër. Persishtja e vjetër, ishte gjuha e Perandorisë Akamenidiane, e cila ekzistoi gjatë viteve 550-330 para Krishtit, dhe më vonë edhe në Perandorinë Sasaniane. Shkrimi më i vjetër daton nga sundimi i Darit I.

Gjuha gaelike irlandeze

Është dega irlandeze e gjuhëve goidelike, një pjesë e familjes keltike të gjuhëve indo-evropiane. Shkrimet më të hershme në këtë gjuhë në Irlandë, datojnë nga shekulli IV Pas Krishtit. Pas disa shekujsh shtypje brutale nga pushtuesit anglezë, kjo gjuhë po përjeton sot një ringjallje.



Arsimi, arma më e fuqishme për të ndryshuar botën

Që nga viti 2012, 31 milionë nxënës të shkollave fillore në mbarë botën e braktisën shkollën, ndërsa 32 milion tjerë përsëritën një vit. Në Afrikën Sub-Sahariane, 11.07 milionë fëmijë lënë shkollën përpara se të përfundojnë arsimin e tyre fillor. Në Azinë Jugore dhe Perëndimore, ky numër arrin në 13.54 milionë.

Sipas UNESCO-s, 61 milionë fëmijë të moshës së shkollës fillore nuk u regjistruan në shkollë në vitin 2010. Nga këta fëmijë, 47% nuk pritej të hynin kurrë në shkollë, 26% ndoqën shkollën por u larguan dhe 27% e mbetur pritet të ndjekin shkollën në të ardhmen.

Fëmijët që jetojnë në një mjedis rural kanë dy herë më shumë gjasa të jenë jashtë shkollës sesa fëmijët e qytetit. Përveç kësaj, fëmijët nga 20 përqindëshi i më të pasurve të popullsisë kanë 4 herë më shumë gjasa të shkojnë në shkollë sesa 20 përqindëshi i më të varfërve.

Në vendet në zhvillim, me të ardhura të ulëta, çdo vit shtesë arsimimi mund të rrisë të ardhurat e ardhshme të një personi mesatarisht me 10%.

Gratë që janë më pak të arsimuara kanë më shumë fëmijë, mesatarisht 2-5 fëmijë, gjatë gjithë jetës së tyre në krahasim me gratë më të arsimuara, mesatarisht 1-7 fëmijë. 9.53% e fëmijëve jashtë shkollës në botë janë vajza dhe 2/3 e njerëzve analfabetë në botë janë gra.

Në Korenë e Jugut, nxënësit e shkollave të mesme kanë dy turne çdo ditë që bëjnë rreth 12-13 orë në shkollë.

Për studentët në Korenë e Jugut, në përgjithësi është një ditë e gjatë në shkollë. Ata fillojnë shkollën në 8 të mëngjesit dhe vazhdojnë deri në orën 16:00. Ata kthehen në shtëpi për të ngrënë dhe më pas kthehen për turnin e dytë nga ora 18:00 deri në 9-22:00.

Shkollat japoneze mësojnë Edukimin Moral në të njëjtin nivel me lëndët e tjera si Matematika.

Në Iran, të gjitha shkollat janë të ndara në gjini. Vajzat dhe djemtë shkollohen veçmas deri në momentin që arrijnë në kolegji. Në fakt, vetëm mësueset femra marrin mësim për vajzat dhe mësuesit



SIPAS UNESCO-s, 61 MILIONË FËMIJË TË MOSHËS SË SHKOLLËS FILLORE NUK U REGJISTRUAN NË SHKOLLË NË VITIN 2010. NGA KËTA FËMIJË, 47% NUK PRITEJ TË HYNIN KURRË NË SHKOLLË, 26% NDOQËN SHKOLLËN POR U LARGUAN DHE 27% E MBETUR PRITET TË NDJEKIN SHKOLLËN NË TË ARDHMEN.

meshkuj për djemtë.

Shkollat në Francë planifikojnë dreka 1 deri 2-orëshe të përgatitura plotësisht për t'i mësuar nxënësit për përgatitjen dhe rëndësinë e ushqimit.

Arsimi në Danimarkë ofrohet pa pagesë në të gjitha nivelet dhe ka nëntë vjet arsim të detyrueshëm. Shpenzimet publike për arsimin dhe trajnimin korrespondojnë me 7% të PBB-së së vendit dhe rreth 13% të totalit të shpenzimeve publike. Mësimi i të rriturve luan një rol të konsiderueshëm në sistemin arsimor dhe shumë danezë marrin pjesë në një lloj mësimi formal ose joformal. Danimarka është gjithashtu e njohur për shoqatat dhe organizatat e saj të shumta lokale në nivel bazë.

Shkollat e hershme publike në Shtetet e Bashkuara nuk u fokusuan në studime akademike si matematika apo leximi. Në vend të kësaj ata mësuan virtytet e familjes, fesë dhe komunitetit.

Vajzat zakonisht mësoheshin si të lexonin, por jo si të shkruanin në Amerikën e hershme.

Në Amerikë ideja e një edukimi progresiv, duke edukuar fëmijën për të arritur potencialin e tij të plotë dhe duke promovuar dhe marrë pjesë në mënyrë aktive në një shoqëri demokratike, filloi në fund të viteve 1800 dhe u përhap gjerësisht në vitet 1930. John Dewey ishte themeluesi i kësaj lëvizjeje.

Gjatë viteve 1960, Shtetet e Bashkuara kishin një sistem shkollash të ndara sipas racave. Kjo ishte pavarësisht vendimit të Gjykatës së Lartë të Brown kundër Bordit të vitit 1954. Nga fundi i viteve 1970,

shkollimi i veçuar në Shtetet e Bashkuara u eliminua.

Arsimi në Singapor është i detyrueshëm. Që nga viti 2003, të gjithë fëmijët duhet të regjistrohen në shkollë. Kjo fillon që në moshë të re e deri në arsimin fillor dhe të mesëm. Rregulli i arsimit të detyrueshëm vlen si për shtetasit ashtu edhe për të huajt. Nëse prindërit nuk arrijnë t'i mbajnë fëmijët e tyre në shkollë ose në shtëpi, ata mund të përballen me gjoba të konsiderueshme. Madje, ata mund të shkojnë në burg deri në 12 muaj.

Qytetarët e Singaporit marrin arsim fillor falas. Arsimi i mesëm kushton rreth 5 dollarë në muaj. Ndërsa ka kosto të tjera që lidhen me arsimin, të cilat nuk i kalojnë 30 dollarë në muaj në të dyja rastet (arsimi fillor ose i mesëm). Kështu, arsimi është ende i përballueshëm për të gjithë singaporianët.

Singapori është lider në shkencë dhe lexim. Vitet e fundit, Singapori ka qenë në gjendje të kryesojë të gjitha vendet në vlerësimin PISA në lidhje me aftësinë shkencore dhe leximin.

Shkolla fillore në Pumaçangtang të Tibetit, mendohet të jetë shkolla më e lartë në botë, 5.373 metra mbi nivelin e detit.

Në Brazil, ngrënia me familjen është një pjesë e rëndësishme e kulturës, kjo është arsyeja pse shkollat fillojnë në orën 7 të mëngjesit dhe mbarojnë në mesditë, në mënyrë që fëmijët të hanë drekë me prindërit e tyre.

Në Australi, Shkolla Ajrore ua transmeton leksionet nëpërmjet sinjaleve të radios nxënësve që jetojnë në zonat më të largëta.



Nga të gjitha shkollat në botë, më e madhja gjendet në Indi, quhet “City Montessori School” dhe në të mësojnë mbi 32 000 nxënës.

Kina është vendi ku fëmijët marrin më shumë detyra shtëpie. Adoleshentët në Shanghai, kalojnë plotë 14 orë në javë duke bërë detyrat në tryezën e kuzhinës. Fëmijët që jetojnë në Pakistan nuk kanë asnjë të drejtë ligjore për arsimimin falas, dhe arsimi i detyrueshëm është i vlefshëm për fëmijët nga mosha 5-9 vjeç.

Në Kili, pushimet verore zgjasin nga mesi i dhjetorit deri në fillim të marsit.

Vendi me vitin më të shkurtër shkollor dhe ditën më të gjatë shkollore është Franca. Fëmijëve në Gjermani u jepet një kon i veçantë i quajtur “Schultüte” plot me stilolapsa, lapsa, libërtha, ushqime dhe dhurata të tjera, të cilat mund të hapen vetëm kur ata fillojnë shkollën.

Fëmijët kanadezë marrin shumë leksione në frëngjisht dhe anglisht.

Fëmijët në Holandë e fillojnë shkollën në ditëlindjen e tyre të katërt, kështu që në klasë ka gjithmonë një nxënës të ri.

Anglia është shtëpia e shkollës me konviktin më të vjetër në botë – Shkolla e Mbretit në Kanterbëri, pavarësisht se është themeluar në vitin 1567, ofron një edukim të plotë modern, dhe është e pajisur më të gjithë mjetet e duhura.

Pavarësisht nëse rastis fundjavë apo

pushim, fëmijët në Rusi e fillojnë gjithnjë shkollën në “Ditën e Njohurive”, që është 1 shtatori.

Shkolla më e vogël në botë ndodhet në Torino të Italisë, dhe në të shkon vetëm 1 nxënës.

Finlanda ka moshën më të lartë të nisjes së shkollës nga fëmijët, dhe njëherazi një nga sistemet më të suksesshme të arsimit. Aty fëmijët ulen për herë të parë në bankat e shkollës në moshën 7-vjeç.

Në Kenia, fëmijët nuk janë ligjërisht të detyruar të shkojnë në shkollë, por shumica e tyre e bëjnë këtë.

Për shkak të problemeve periodike me përmytjet me të cilat përballlet vendi, Bangladeshi ka mbi 100 shkolla lundruese. Secila prej tyre ka qasje në internet, bibliotekë dhe furnizohet me energji me anë të paneleve diellore. Në SHBA gjendet mësuesja më e moshuar në botë. Ajo është Anjez Zhelesnik, 101-vjeçe.

Një nga lëndët që mësohet në shkolla islandeze është thurja e trikovë.

Nuk ka shkolla private në Finlandë. Diskriminimi është i keq dhe në Finlandë ndoshta nuk do ta shihni askund, veçanërisht kur bëhet fjalë për shkollat.

Rreth 60% e studentëve ndërkombëtarë që studiojnë në Kanada, aplikojnë për qëndrim të përhershëm.

Pavarësisht progresit, pabarazia gjinore në arsimimin e të rinjve mbetet e vazh-

dueshme në pothuajse një në pesë vende.

Azia Jugore është shtëpia e më shumë se gjysmës së popullsisë globale analfabete (51%).

91% e amerikanëve besojnë se artet janë jetësore për të siguruar një arsimim të mirëfilltë.

Shumica e fëmijëve në mbarë botën marrin një arsimim bazë – të mësuarit për të lexuar, shkruar dhe për të bërë matematikë të thjeshtë.

Në Nigeri, rreth 10.5 milionë fëmijë nuk janë në shkollë dhe pse arsimi fillor është zyrtarisht falas dhe i detyrueshëm.

Në Meksikë shumica e fëmijëve të vegjël ndjekin shkollën fillore, por vetëm 62% arrijnë shkollën e mesme. Në nivelin e mesëm rreth gjysma e studentëve braktisin shkollën dhe vetëm një e katërta arrijnë arsimin e lartë, sipas organizatës joqeveritare “Mexicanos Primero”, e cila po shtyn për reformën e sistemit.

UNICEF-i ka ndihmuar masivisht në sistemin e arsimit të Irakut. Ka qenë ndihmesë e madhe në Irak për përmirësime të ndryshme si ndërtimi i shkollave, rregullimi i sistemeve të ujit/sanitare në shkollat ekzistuese, duke ndihmuar në trajnimin e mbi 50000 mësuesve në sjelljen miqësore ndaj fëmijëve dhe furnizimin e miliona fëmijëve me materiale jetike shkollore.

Takimi i Ministrave të Jashtëm të NATO-s, Sekretari i Përgjithshëm: Ukraina është më afër NATO-s se kurrë më parë

Ministrat e Jashtëm të NATO-s përfunduan dy ditë takime në Bruksel, të mërkurën (29 nëntor 2023), duke adresuar mbështetjen për Ukrainën, përgatitjet për Samitin e Uashingtonit dhe sfidat e ngutshme të sigurisë, duke përfshirë Ballkanin Perëndimor dhe fqinjësinë jugore të NATO-s.

Këshilli NATO-Ukrainë u takua për herë të parë në nivelin e Ministrave të Jashtëm, të cilit iu bashkua edhe Ministri i Jashtëm i Ukrainës Dmytro Kuleba. Duke folur pas takimit, Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg njoftoi se aleatët kishin miratuar një program ambicioz pune për vitin e ardhshëm, që mbulon sigurinë energjetike, inovacionin dhe ndërveprueshmërinë. Ai shtoi: “Tani po e transformojmë paketën gjithëpërfshirëse të ndihmës së NATO-s në një program shumëvjeçar ndihme, duke ndihmuar Ukrainën të kalojë nga pajisjet dhe standardet e epokës sovjetike në NATO dhe t’i bëjë forcat e saj plotësisht të ndërveprueshme me tonat”.

Ministrat e Jashtëm diskutuan gjithashtu rrugën e Ukrainës drejt anëtarësimit në Aleancë dhe dhanë rekomandime për reformat prioritare të Ukrainës, duke përfshirë luftën kundër korrupsionit, forcimin e shtetit të së drejtës dhe mbështetjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave. Sekretari i Përgjithshëm tha se: “Vitin e kaluar, Ukraina fitoi betejat për Kievin, Kharkivin dhe Khersonin. Këtë vit ata vazhdojnë t’i shkaktojnë humbje të rënda Rusisë... Më e rëndësishmja, Ukraina ka mbizotëruar si një komb sovran, i pavarur dhe demokratik. Kjo është një arritje e madhe – një fitore e madhe.” Ai theksoi se: “Ukraina është më afër NATO-s



se kurrë më parë, - duke shtuar se, - ne do të vazhdojmë t’i mbështesim ata në rrugën e anëtarësimit”.

Duke iu kthyer situatës në terren, Stoltenberg nënvizoi përparimin thelbësor të bërë nga Ukraina këtë vit, si në tokë ashtu edhe në Detin e Zi. Ndërkohë, ai tha se Rusia po humbet ndikimin politik në pjesën e saj të afërt jashtë vendit, ka shkaktuar më shumë se 300,000 viktima dhe ka humbur një pjesë të konsiderueshme të forcave të saj konvencionale dhe është nën presion ekonomik. “Rusia tani është më e dobët politikisht, ushtarakisht dhe ekonomikisht... vit pas viti, Moska po i hipotekon të ardhmen e saj Pekinit”, - tha ai, duke përfunduar se e gjithë kjo nënvizon gabimin strategjik të Putinit në pushtimin e Ukrainës.

Deklarata e Këshillit NATO-Ukrainë në nivel të Ministrave të Jashtëm

Këshilli NATO-Ukrainë (NUC) u takua për herë të parë në nivelin e Ministrave të Jashtëm, ndërsa Rusia vazhdon luftën e saj brutale të agresionit, për të vepruar së bashku për të thelluar më tej marrëdhëniet NATO-Ukrainë. Aleatët mbeten të palëkundur në angazhimin e tyre për të rritur më tej mbështetjen politike dhe praktike për Ukrainën ndërsa ajo vazhdon të mbrojë pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht dhe do të vazhdojnë mbështetjen e tyre për aq kohë sa të duhet. Një Ukrainë e fortë dhe e pavarur është jetike për stabilitetin e zonës euroatlantike. Ministrat vlerësuan zbatimin e paketës së zgjeruar të mbështetjes politike dhe praktike për Ukrainën, të rënë dakord në Samitin e Vilniusit. Ministrat miratuan nënstrukturën e NUC-së dhe një program pune ambicioz për vitin 2024. Në këtë kontekst, NATO dhe Ukraina tashmë po punojnë dhe marrin vendime së bashku, si të barabartë, për një gamë të gjerë çështjesh, duke përfshirë ndërveprimin, sigurinë energjetike, inovacionin, mbrojtjen kibernetike dhe qëndrueshmërinë. Ne do t’i zhvillojmë më tej këto fije pune. NUC është dëshmuar gjithashtu se është një mekanizëm i besueshëm konsultimi për krizën. NATO vazhdon t’i ofrojë Ukrainës ndihmën e nevojshme urgjente jo vdekjeprurëse. Së bashku ne po e transformojmë Paketën Gjithëpërfshirëse të Asistencës në një program shumëvjeçar për të ndihmuar në rindërtimin e sektorit të sigurisë dhe mbrojtjes të Ukrainës dhe për të mbështetur parandalimin dhe mbrojtjen e Ukrainës në afat të gjatë. Si pjesë e këtyre përpjekjeve, ne po zhvillojmë një udhërrëfyes për kalimin e Ukrainës në ndërveprim të plotë me NATO-n. Ne po zhvillojmë gjithashtu projekte të reja për çiminimin humanitar, rehabilitimin mjekësor për ushtarët e plagosur ukrainas dhe kapacitetin industrial të mbrojtjes së Ukrainës në bazë të rishikimit strategjik të prokurimit të mbrojtjes.

Ukraina ripohoi angazhimin e saj për reformat e vazhdueshme demokratike dhe të sektorit të sigurisë. Aleatët i kanë dhënë Ukrainës rekomandime për reforma prioritare. Këshilli NATO-Ukrainë mirëpret prezantimin nga Ukraina të Programit të saj Kombëtar Vjetor të përshtatur për vitin 2024 dhe pret me padurim zbatimin e tij. Ministrat e Jashtëm të NATO-s do të vlerësojnë rregullisht progresin përmes Programit Kombëtar Vjetor të përshtatur. Aleanca do të mbështesë Ukrainën në kryerjen e këtyre reformave në rrugën e saj drejt anëtarësimit të ardhshëm në NATO.

Këshilli NATO-Ukrainë është organi i përbashkët ku Aleatët dhe Ukraina ulen si pjesëmarrës të barabartë për të çuar përpara dialogun politik, angazhimin, bashkëpunimin dhe aspiratat e Ukrainës për anëtarësim në NATO. Ai parashikon konsultime, vendimmarrje dhe aktivitete të përbashkëta. Ai shërben gjithashtu si një mekanizëm konsultimi për krizën midis NATO-s dhe Ukrainës.

Këshilli NATO-Ukrainë u lançua në Samitin e NATO-s 2023 në Vilnius, si pjesë e një pakete tre-pjesëshe të mbështetjes që e afron Ukrainën me NATO-n. Paketa përfshin gjithashtu një program shumëvjeçar ndihme për të ndihmuar forcat e armatosura ukrainase të bëhen plotësisht të ndërveprueshme me forcat aleate dhe një rrafshim se Ukraina do të bëhet anëtare e NATO-s kur Aleatët të bien dakord dhe të plotësohen kushtet. Aleatët individualë dhe Ukraina takohen si pjesëmarrës të barabartë në Këshill. Këshilli mund të mblidhet në nivel të krerëve të shteteve dhe qeverive, ministrave të jashtëm dhe të mbrojtjes, ambasadorëve ose në nivel ushtarak, duke përfshirë shefat e mbrojtjes. Takimi inaugurues i Këshillit NATO-Ukrainë u zhvillua më 12 korrik 2023 në Samitin e Vilniusit. Këshilli u takua në nivel të krerëve të shteteve dhe qeverive, duke përfshirë pjesëmarrjen e presidentit ukrainas Volodymyr Zelenskyy.

Ministrat e Jashtëm të NATO-s trajtojnë parandalimin dhe mbrojtjen, mbështetjen për Ukrainën dhe partneritetet

Të martën (28 nëntor 2023), ministrat e jashtëm të NATO-s diskutuan çështje të ngutshme të sigurisë, duke përfshirë parandalimin dhe mbrojtjen e NATO-s, mbështetjen për Ukrainën dhe mënyrën se si të punohet më ngushtë me vendet partnere. Duke folur pas takimit, Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg tha se aleatët shprehën gjithashtu shqetësimin për luftën në Lindjen e Mesme. Ai përshëndeti zgjatjen e pauzës në armiqësitë midis Izraelit dhe Hamasit, e cila ka lejuar lehtësimin shumë të nevojshëm për njerëzit në Gaza, lirin e më shumë pengjeve dhe dërgimin e më shumë ndihmave humanitare.

Z. Stoltenberg tha se aleatët përsëritën vendosmërinë e tyre për të mbështetur rrugën e Ukrainës drejt NATO-s dhe për t'i mbështetur ata ndërsa mbrojnë vendin e tyre. Duke iu referuar premtimeve të reja financiare nga aleatët, një qendër e re trajnimi për pilotët ukrainas dhe ofrimit të më shumë mbrojtjeve ajrore dhe municioneve, ai tha se kjo ndihmon për të shpëtuar jetët e Ukrainës dhe i dërgon një mesazh Rusisë “që mbështetja jonë nuk do të lëkundet”. Ministrat e Jashtëm trajtuan gjithashtu sfidat që Kina paraqet për sigurinë euroatlantike. Duke theksuar se “Kina nuk është kundërshtari ynë”, Sekretari i Përgjithshëm tha se “ne duhet të jemi të qartë për ndikimin e politikave shtrënguese të Kinës në sigurinë tonë” dhe mirëpriti që aleatët po angazhohen në dialog me Pekinin për çështjet me interes të përbashkët. Duke theksuar se “sfidat me të cilat përballemi janë globale”, ai theksoi nevojën për të punuar më ngushtë me partnerët, përfshirë në Indo-Paqësorin, “për të mbrojtur vlerat dhe interesat tona”. Për fqinjësinë jugore të NATO-s, z. Stoltenberg tha se kishte caktuar një grup të pavarur ekspertësh për të shqyrtuar sfidat që burojnë nga rajoni dhe se ata do të paraqesin rekomandime deri në

pranverën e ardhshme. Sekretari i Përgjithshëm njoftoi gjithashtu se Ministrat e Jashtëm të NATO-s kishin miratuar strategjinë e parë kuantike të Aleancës dhe se Aleatët ranë dakord së fundmi të përmirësonin flotën e avionëve AWACS të NATO-s, një nga blerjet më të mëdha të aftësive të Aleancës. Ai tha se kjo “dëshmon se si NATO shton vlerë duke bashkuar burimet për të ofruar aftësi të reja të mëdha për sigurinë tonë”.

Po të martën (28 nëntor 2023), Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg mirëpriti Sekretarin e Shtetit të SHBA-së Antony Blinken në selinë e NATO-s në fillim të një takimi dy-ditor të Ministrave të Jashtëm Aleat.

Sekretari i Përgjithshëm falënderoi Shtetet e Bashkuara për udhëheqjen dhe mbështetjen e vendosur ndaj Ukrainës dhe përshëndeti angazhimin e fortë personal të Sekretarit Blinken ndaj NATO-s dhe Aleancës Transatlantike.

Ministrat e Jashtëm të NATO-s trajtuan gjithashtu situatën në Ballkanin Perëndimor, së bashku me Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit Evropian. Në ditën e dytë të samitit (29 nëntor 2023) Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg mirëpriti Ministrin e Jashtëm Dmytro Kuleba në selinë e NATO-s, për takimin e parë të Këshillit NATO-Ukrainë në nivel të ministrave e jashtëm. Stoltenberg u shpreh për mbështetjen ndaj Ukrainës në rrugën drejt anëtarësimit në NATO, duke përfshirë zbatimin e reformave. Takimi trajtoi gjithashtu nevojat urgjente të Ukrainës dhe situatën në fushën e betejës. Sekretari i Përgjithshëm përshëndeti njoftimet nga Aleatët e NATO-s për mbështetje shtesë financiare, më shumë mbrojtje ajrore dhe municione; dhe një qendër trajnimi për pilotët ukrainas. “Këto janë veprime konkrete, kështu që ne kemi nevojë për më shumë prej tyre”, tha ai.





Ora 11, e datës 11, e muajit të 11-të, të vitit 1918, bota mori frymë

Në orën 11, në ditën e 11-të, të muajit të 11-të, të vitit 1918, përfundon zyrtarisht Lufta e Madhe, lufta e cila ndryshoi hartën e botës. Me një forcë shkatërruese të paparë ndonjëherë, ajo shkaktoi miliona viktima. Me fundin e saj mbaroi vetëm pjesërisht vuajtja njerëzore. Europa nuk shpëtoi nga fatkeqësia.

“Finie la guerre?”, “A ka përfunduar lufta?”. Makina e negociatorit gjerman, i cili më 6 nëntor kalonte kufirin nga Belgjika për të hyrë në Gjermani, i entuziazmoi ushtarët francezë. Ende ushtritë ishin përballë njëra-tjetrës, por luftës, që zgjati mbi katër vjet, tani dukej se po i afrohej fundi. Ndoshta politikanët e ardhur nga Berlioni sillnin si për të shijuar paqen ndonjë cigare me vete? Por Mathias Erzberger, drejtuesi i delegacionit gjerman, i duhet të refuzojë. “Si dikush që nuk e pi duhanin”, shkruan ai në kujtimet e veta, “nuk mund t’ua përmbushja dëshirën.”

Por shumë më e rëndësishme është, që ai dhe homologu francez përballë tij, mareshali Ferdinand Foch, ua përmbushën ëndrrën miliona europianëve, kur mëngjesin e 11 nëntorit 1918, në një tren në pyllin e Compiègne, rreth 90 km në verilindje të Parisit, nënshkruan armëpushimin e sapo negociuar mes Gjermanisë dhe Aleatëve. Gjermania kishte kapitulluar. Disa muaj më pas, në sallën e famshme me pasqyra në kështjellën e Versajës, të dyja palët nënshkruan zyrtarisht Marrëveshjen e Paqes.

Ofensiva e fundit gjermane

Deri në verën e vitit 1918 ushtria gjermane kishte depërtuar thellë në frontin e perëndimit, e pjesërisht kishte fituar territore të mëdha, ndonëse fuqia e ushtrisë vetëm në periudhën mars – korrik ishte zvogëluar nga 5,1 në 4,2 milionë forca. Megjithatë perandoria mundi t’i plotësojë boshllëqet e krijuara deri në verën e vitit 1918, edhe pse duke dërguar ushtarë të shëruar që dikur kishin qenë të plagosur. Këtyre u shtohen edhe rekrutët e parë të datëlindjes 1900.

Por gjermanët e shohin tani veten përballë një armiku të ri: Amerikanëve. Pasi presidenti i SHBA-së, Wilson i shpalli luftën Gjermanisë, në prill 1917, ata depërtuan përmes Atlantikut. Në fillim të vjeshtës 1918 mbërrijnë rreth 10.000 ushtarë në ditë. Amerikanët e rinj vërtetë ishin pa përvojë në luftë, pranon historiani John Keegan. “Megjithatë vendimtar ishte efekti që kishte mbërritja e tyre ndaj kundërshtarit mjaft deprimues.” Më në fund janë njësitë e armatosura mirë të SHBA-së, që e vendosin luftën në favorin e aleatëve. Shtabi drejtues i ushtrisë gjermane në vjeshtë e kuptoi, që lufta nuk mund të fitohet më, që shpartallimi i plotë i frontit gjerman mund të shmangej vetëm me një marrëveshje armëpushimi.

“Një rrënojë pasonte tjetrën”

Armëpushimit të 11 nëntorit i kishin paraprirë katër vjet gjakderdhje

e tmerrshme dhe një shkatërrim i paparë ndonjëherë në Europë. Këto shkatërrime arriti t'i shohë nga afër Erzberger gjatë udhëtimit përmes Belgjikës dhe Francës: "Asnjë shtëpi nuk qëndronte më mbi themel; një rrënojë pasonte tjetrën", - shënon ai në kujtimet e tij. "Nga drita e Hënës këto rrënoja dukeshin si fantazma dhe asnjë frymë njeriu nuk dukej gjëkund."

Makineria e Luftës së Parë Botërore: një tank francez. Erzberger nxori një bilanc të një lufte, që kishte qenë më vrastare se çdo luftë tjetër e mëparshme. Përparimi teknik dhe industrializimi kishin prodhuar një arsenal armësh, që linte në hije për nga cilësia dhe sasia armatimet e mëparshme: Tanke në dukje të pa shkatërrueshëm, nëndetëse manovruese nën ujë, artileri me rreze gjigante veprimi, gazra vdekjeprurës.

6000 të vdekur në ditë

Nga viti 1916 gjermanët vunë në përdorim "Langen Max", topat prej 300 kilogram, tytat e të cilëve me gjatësinë 35 metra i hidhnin predhat deri në largësinë 48 kilometra. Me armë të tilla gjermanët, më 23 mars 1918, goditën Parisin. Një granatë ra në kishën Saint-Gervais, pikërisht në kohën që po mbahej një meshë. 88 vetë u vranë dhe rreth 100 u plagosën.

Historianët ushtarakë llogarisin, që në Luftën e Parë Botërore janë hedhur rreth 850 milionë granata artilerie. Vrasjet në këtë luftë masive u industrializuan, nën breshërinë e të shtënave të topave dhe nën zjarrin e automatikëve gjetën vdekjen gati njëmbëdhjetë milionë ushtarë. Gati 56 milionë rekrutë ishin grumbulluar në shërbimin e detyruar ushtarak në të gjitha kombet e përfshira në luftë. Mesatarisht në çdo ditë të luftës kanë gjetur vdekjen 6000 ushtarë. Këtyre u shtohen edhe mbi 21 milionë ushtarë të plagosur, njerëz që humbën gjymtyrët ose u plagosën rëndë, u paralizuan, apo iu desh të vinin proteza, mbetën të verbër ose të shurdhër.

"I gjithë trupi mori fund"

Po ashtu tronditëse ishin edhe përvojat nga fronti: "Është e tmerrshme, kur copëzat e granatave depërtojnë me dhunë në pjesë të buta", - kujton ushtari gjerman Karl Bainier, i lindur në vitin 1898. "Dy komandantët tanë korrierë natën u prekën direkt nga predha. Tërë kraharori i njeriut dhe i gjithë torsi i tjetrit fluturuan në ajër. Njeri vdiq në vend. Tjetri vazhdoi të bërtiste". Ai dhe trupa e tij ishin strehuar në një llogore, tregon Johannes

Götzmann. "Ne ishim ulur poshtë, kur granatat goditën. Pati shumë të plagosur. Njeri nuk kishte më këmbë. Ato i ishin prerë. Ai ishte përgjakur aty".

Ndaj nuk është e habitshme, që në radhë të parë ishin ushtarët ata që mezi prisnin fundin e luftës. "Asgjë nuk është më e pazakontë", - shënonte drejtuesi i ushtrisë princi Rupprecht von Bayern, në maj të vitit 1918, - që deri në 20 nga njëqind njësi u larguan pa leje, gjë për të cilën, ata nëse do të ishin kapur i priste një dënim me dy deri në katër muaj burg. Por kjo është ajo që disa e duan duke iu shmangur njëërës apo tjetrës betejë." Në muajt pasues fronti bëhet gjithnjë e më i thyeshëm: shumë ushtarë refuzojnë luftimin, të tjerë nisen me kokën e tyre për në shtëpi. "Ti je në shtrat dhe je një sëmundje. Je një kafkë e thyer, një bark i shpuar, një frakturë e legenit", - përshkruan Alfred Döblin në romanin e tij "Nëntor 1918, një revolucion gjerman" jetën e rekrutëve.

Lindja e "legjendës së thikës pas shpine"

Radhët e gjermanëve nisin të shpërbëhen. Komanda supreme e ushtrisë i tërhiqet përgjegjësisë. Më 19 shtator 1918, administratori i kuartierit të përgjithshëm Erich Ludendorff shënonte: "Unë i jam lutur madhërisë së tij, që tani të sjellë në qeveri edhe ato qarqe, të cilave ne u jemi mirënjohës në çështjen thelbësore, që kemi arritur deri këtu. Këta zotërinj ne do t'i tërheqim tani nëpër ministri. Ata duhet të vendosin paqen, që duhet realizuar tani. Ata duhet të hanë tani çorbën, që na e gatuan neve."

I përfshirë në "legjendën e thikës pas shpine"

Me "këta zotërinj" Ludendorff kishte parasysh ata politikanë të grupeve parlamentare në Rajshtag, që në verën e vitit 1917 kishin bërë thirrje për një marrëveshje paqeje me socialdemokratët, liberalët e majtë dhe partia katolike e qendrës.

Supozimi i tradhtisë prej atdheut të lodhur nga lufta përfshiu edhe mareshalin Paul von Hindenburg, ushtaraku i nivelit më të lartë të perandorisë gjermane. Ai citoi fjalinë e një "gjenerali anglez", i cili me gjasë nuk e ka thënë asnjëherë atë: "Ushtria gjermane ka pësuar thikë pas shpine." Gjenerali i nënkuptuar ta ketë thënë këtë shprehje, Frederick Maurice, e ka përgënjeshtruar me insistim ta ketë përdorur ndonjëherë një shprehje të tillë. Por deklarimi i tij nuk pati efekt: kësisoj lindi "Legjenda e thikës pas shpine", supozimi, se lufta është humbur vetëm

prej tradhtisë nga brenda. Kjo ndikoi qenësisht që më pas të dështonte Republika e Vajmarit.

"Mllef, mllef e aspak arsye"

Fillimisht 11 nëntori 1918 solli fundin e shumë dëshiruar të luftës. Por ai nuk solli fundin e dhimbjes. Privimet, varfëria dhe hidhërimi vazhdojnë t'u zënë frymën njerëzve. Këtyre u shtohet edhe një ndjenjë që po përhapej gjithnjë e më shumë, se ishte luftuar më kot dhe e gjithë vuajtja ishte më kot. "Absurditeti ka arritur në pikën më të lartë, është mllef, mllef, por ende aspak arsye". Kryesisht gjermanët i mbërthen kjo ndjenjë helmuese. Kjo u kthye në terrenin ushqyes të ngjitjes politike të një ish-ushtari në front me emrin Adolf Hitler.



74 vite art, botime, shtyp periodik, rrugëtimi në dekada i QKMBMMFA

Shtëpia e Ushtarakëve është e lidhur ngushtësisht me ndryshimet dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura. Ajo nisi rrugëtimin e saj në një ndërtesë krejt të veçantë në Rrugën e Kavajës, e projektuar dhe e zbatuar nga inxhinieri i Armës së Xhenios të Ushtrisë Mbretërore Shqiptare, major Dhimitër Dhespoti.

Shefi i parë i “Shtëpisë së Oficerëve ishte kapiteni i Klasit I, Fehmi Poshi, oficer intendençe i Komandës së Mbrojtjes Kombëtare.

Pas lirimit në të njëjtën ndërtesë, më 14 nëntor 1947, u përrua “Shtëpia Qendrore e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare”. Ajo, së bashku me hotel “Internacional”, që shërbente për ngrënien e fjetjen e oficerëve beqarë, lulishten në qendër dhe me sallën 300 vendesh e kino-teatrit dhe më pas “Estradës së Ushtarit” (1952), përbënin një kompleks të plotë shërbimesh për kohën, për të gjithë ushtarakët e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare.

Pararendës i strukturës së “Shtëpisë Qendrore” ishte seksioni i Artit, në të cilin bënte pjesë Kori i Ushtrisë, Banda Frymore dhe Teatri, të cilët kishin kohë që kishin filluar aktivitetin e tyre artistik, e më pas seksioni për “Shkollat dhe arsimimin”, seksioni i “Prapavijës”, Klubi Sportiv “Partizani” dhe Laboratori Fotografik. Kjo organikë e miratuar përbëhej nga rreth 130 veta, numër ky që herë-herë rritej, sepse në korin e ushtrisë përfshiheshin edhe ushtarë të shërbimit të detyrueshëm ushtarak.

Pjesë e misionit të këtij institucioni, për gati një dekadë rresht, krahas gjallërimit të jetës artistike në Ushtrinë Shqiptare nga grupet artistike, ishte edhe dhënia e ndihmës së domosdoshme, të kualifikuar e konkrete nga të gjithë sektorët kundër analfabetizmit, që gati mbretëronte në radhët e Ushtrisë Shqiptare, si dhe arsimimi, kulturimi e mësimi i gjuhëve të huaja nga ana e oficerëve të sapa dalë nga lufta.

I vetmi grup artistik i këtyre viteve, “Kori i Ushtrisë”, jepte koncerte e shfaqje jo vetëm në “Shtëpinë e Oficerëve”, por edhe kinematë qytetëse “Kosova” e “Nacional”, duke plotësuar kërkesat e shumta nga i gjithë populli i Tiranës, për të arritur në koncertin kulmues me këngë partizane, patriotike e popullore

dhe në fund me “Castadivën” e kënduar nga Tefta Tashko Koço.

Turnetë artistike vijuan edhe në aksionet e rinisë, në rrugën Kukës-Peshkopi, hekurudhën Durrës-Tiranë, në kantierin e tharjes së kënetës në Maliq, në kanalin “Naum Panxhi”, por edhe në qytetin e Ohrit e më pas në atë të Shkupit, për shqiptarët me banim në këto qytete së bashku me Grupin e Valleve (‘47).

Banda e Ushtrisë, përveç se ishte një aset i çmuar, në krijimtarinë dhe ekzekutimin e muzikës shqiptare, ishte prezente në koncertet e saj, në ceremoni e manifestime të panumërta, në përkujtimin e ngjarjeve historike kryesore, në parada apo edhe në pritjet protokollare të Shtetit Shqiptar. Kjo trupë artistike profesioniste u kthye në furnizuese e të gjitha institucioneve të tjera artistike shtetërore.

Klubi Sportiv “Partizani”, pjesë e “Shtëpisë Qendrore të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare” dha një ndihmesë të rëndësishme në organizimin dhe zhvillimin e lëvizjes fiskulturore e sportive në Garnizonin e Tiranës dhe në reparte të tjera të Ushtrisë Shqiptare.

Laboratori Fotografik, si pjesë e propagandës figurative me vlera dokumentare artistike dhe edukuese për ushtrinë, filloi menjëherë aktivitetin me pasion e këmbëngulje, duke grumbulluar negativët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe të jetës partizane, duke hedhur themelet e fondit arkivor.

Në dhjetor të vitit 1949, “Shtëpia Qendrore e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare” përbëhej nga Ansambli i Këngëve dhe i Valles, Kori e Grupi i valleve; Seksioni i muzikës, Banda e Orkestra Simfonike; Teatri, Kinemaja, Seksioni i Arsimimit, Biblioteka, Seksioni i Fizkulturës, skuadra e futbollit, basketbollit, volejbollit, atletikës së lehtë dhe të rëndë, shahu, noti e motoçiklizmi; Seksioni i shërbimeve, e në përmbyllje e plotësonte ai i ushqimit social, pra Bufeja, e cila nga viti 1968, nuk u bë pjesë e kësaj strukture. E gjithë kjo strukturë përbëhej nga një efektiv prej 253 vetash, të cilët 13 ishin oficerë dhe 240 nëpunës civilë.

Tërësia e trupave, artistike, sportive, qendrat lëvizëse të agjitacionit në reparte e njësitë, por edhe në stërvitjet e mëdha



me trupa për kohën, shtypi, shfaqjet e filmave kinematografikë, propaganda figurative dhe botimet albumeve e fletëpalosjeve, të përgatitura nga “Shtëpia Qendrore e Ushtrisë Popullore” (SHQUP), luajtën rol të rëndësishëm në edukimin ideo-artistik e sportiv, jo vetëm për repartet e garnizonit të Tiranës, të Ushtrisë Shqiptare, por edhe në skenat e ambientet, ku qytetarë të shumtë ndiqnin aktivitetet, në kushtet e realitetit shqiptar të kohës.

Nga kjo punë me strukturë komplekse, për nga funksionet që kryente, e organizuar dhe intensive në radhët e të rinjve, që kryenin e përfundonin shërbimet ushtarake, dolën mjaft artistë, këngëtarë, kompozitorë të shquar dhe sportistë të talentuar, në sferat e ndryshme të jetës e të mjeshtërisë fiskullore e sportive. Në vitet '50-'60 të shek. XX, pati ndryshime të ndjeshme në organizatën e SHQUP-it, në vitin 1958 u suprimua Teatri i Ushtrisë e një vit më pas, Klubi Sportiv “Partizani”, Ansambli i Ushtrisë dhe Banda e Ushtrisë u shkëputën nga ky institucion, për t'u rikthyer përsëri, këto dy të fundit në vitin 1966.

Në vitet 1962-1964, SHQUP-i u vendos në godinën e korpusit parlamentar të Akademisë së Shkencave, të cilat shërbyen për zhvillimin e veprimtarive të shumta të organizuara nga ky institucion. Në këto ambiente ndodhej edhe Biblioteka me rreth 20.000 tituj librash. Më pas SHQUP-i u vendos përkohësisht në ambientet ku sot është Banka Kombëtare Shqiptare dhe si sallë për koncerte shërbeu godina që ndodhej mbas Komandës së Gardës.

Në vitet '60, në SHQUP ndërvepronin Sektori Metodik, i Kulturës, i Propagandës, i Krijimtarisë, Biblioteka dhe Dega e Mbështetjes. Në tërësi këta sektorë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zbatimin e misionit që përçonte ky institucion nëpërmjet formave të ndryshme, për t'i bërë sa më efektive krijimtaritë në sferën

e gjerë të propagandës, ndihmës metodike nëpër reparte, diafilmat me pamje nga stërvitjet e ndryshme, gatishmërisë, jetës ushtarake, përgjithësimet e përvojës së përparuar me botimet që prodhonte SHQUP-i etj. Një vend të rëndësishëm zinte organizimi nga drejtuesit e edukimit, të vizitave e të ekskursioneve në fshatrat ku bëhej kolektivizimi, në aksionet ku ndërtoheshin hekurudhat, në hidrocentrale, takimet me shkrimtarë të ndryshëm, por edhe me të dalluarit në ushtri.

Më 10 korrik 1968, u përrua godina e re pranë Urës së Lanës, tek rruga e Elbasanit, në të cilën u vendosën dy drejtori ndërvepruese, SHQUP-i në katin e dytë dhe në katin e parë Drejtoria e Ushqimit Social, që në zhargonin përditshëm njihet “Restoranti i SHQUP-it”.

Në këtë qendër të re ndodheshin dy salla, njëra me 204 vende uljeje dhe skenë dhe tjetra me 50 vende, holli kryesor për vendosje ekspozitash tipologjike, si dhe për organizimin e homazheve për ushtarakë dhe personalitete të tjerë shtetërorë. “Shtëpia Qendrore e Oficerëve” mbante peshën kryesore të aktiviteteve të natyrave të ndryshme në shkallë ushtrie por edhe për aktivitetet e argëtimit me familjet dhe fëmijët e ushtarakëve, sidomos ditëve të shtuna, të diela dhe ditët festive.

Vitet '70-'80, u shoqëruan me ndryshime strukturore të SHQUP-it, u suprimua sektori i krijimtarisë dhe sektori i prodhimit kinematografik, krijuar në vitin 1976, i cili iu kalua Kinostudios “Shqipëria e Re”, u formua sektori metodik, u bënë spastrime e seleksionime në fondin e bibliotekës.

Në këtë periudhë, me rastin e përvjetorëve të shumtë të festave të ndryshme historike, aktivitetet e Orkestrës Frymore, Ansambllit të Ushtrisë, dhe Estradës së Ushtrisë ishin të shumta. Krahas tyre SHQUP-i organizonte shpërndarjen e shtypit, aktivitete kulturore, artistike, shfaqje filmash me pjesëmarrësit e paradave, stimuj

moral, propagandimi i të dalluarve, fletëpalosje të ndryshme, shfaqje të përbashkëta me institucionet artistike të Shtetit, të cilat rezultuan në 100 koncerte e shfaqje artistike, disa ekspozita fotografike, 60 shfaqje kinematografike në njësitë e repartet e Ushtrisë. SHQUP-i organizoi edhe festivalin e filmit me tematikë për mbrojtjen, ekspozita fotografike me tematika: “Për mbrojtjen”, emisione muziko-letrare e artistike, ligjërata “Pasqyrimi i mbrojtjes së atdheut në letërsinë artistike”, diskutime krijuese “Aktivitetet kulturore-artistike dhe lidhja e tyre me jetën, stërvitjen, disiplinën dhe gatishmërinë në Ushtrinë Shqiptare”, etj.

Gjatë vitit 1985, trupat artistike u shkëputën nga drejtimi i SHQUP-it dhe formuan komandë më vete dhe pas dy vitesh edhe Shkolla e Lirë Ushtarake e Kinostudios “Shqipëria e Re”, me përjashtim të Komandës së Batalionit Artistik, që vijoi të qëndronte në vartësi të SHQUP-it.

Trupat artistike të SHQUP-it, Ansambli i Ushtrisë, Orkestra Frymore dhe Estrada e Ushtrisë, si shkolla të para profesioniste të artit shqiptar, kryen një veprimtari të gjatë artistike në 50 vite (1944-1994), duke dhënë 6000 koncerte, si brenda dhe jashtë Shqipërisë, ndërsa Sektori i prodhimit kinematografik, 1967-1974, prodhoi rreth 50 filma dokumentarë ushtarakë, propagandistikë dhe mësimorë.

Që nga viti i krijimit të SHQUP-it e në vijimësi, ndryshimet që ajo ka pësuar në strukturën e saj, janë të lidhura ngushtë me

domosdoshmërinë e realizimit sa më të mirë të misionit të këtij institucionit. Struktura organizative dhe organika që ka patur kjo Pasuri e Rëndësishme Kombëtare, mesatarisht ndër vite ka rezultuar me një personel prej rreth 200 vetash.

Reformave të shumta në Forcat e Armatosura, në vitet '90 e më pas, përfshinë institucionin e Shtëpisë Qendrore të Ushtrisë, e cila qysh në fillim, me rikonceptimin e misionit të saj, pësoi ndryshime jo vetëm në riemërtimet e saj të herëpashershme por u shoqëruan edhe me shkurtime në strukturë e personel. Ndërkohë u rivendosën gradat ushtarake, u hoq funksioni i komisarit politik dhe i sekretarit të partisë dhe u vendos ligji i depolitizimit dhe i departizimit të institucionit.


Pas kalimit në “Qendër të Kulturës të Ushtrisë” ('92), u rikonceptua “Ansambli i Ushtrisë” dhe “Estrada e Ushtarit” ('93), e në vend të tyre u ringrit Grupi artistik, që së bashku me Orkestrën Frymore të Ushtrisë, vijuan aktivitetet e tyre nëpër repartet e ndryshme të Ushtrisë Shqiptare, por edhe në stërvitjet e përbashkëta të zhvilluara në kuadrin e Marrëveshjes për Partneritetin për Paqe, koncerte për forcat shumëkombëshe që erdhën në Shqipëri në 1997 etj.

Në përbërje të këtij institucioni (administrata, biblioteka, grupi artistik, orkestra frymore: 86 veta) u përfshi edhe Qendra e Foto-Filmit të Ushtrisë ('97), e cila u fuqizua me aparatura televizive ('93), duke prodhuar rreth 20 filma dokumentarë dhe një numër të madh kronikash televizive, duke konkurruar edhe në Festivalin Ndërkombëtar të filmit ushtarak në Rumani, i vlerësuar e “Çmim Special”.

Në dekadën e parë të “Shekullit të Ri”, të përgatitjes dhe futjes në NATO, Institucioni, tashmë me emrin “Qendra e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes”, ashtu si dhe FASH-i pësuan ndryshime thelbësore, qysh nga misioni i saj, i cili përcaktonte: “Informimi i qytetarëve dhe efektivave të Forcave të Armatosura të RSH-së, mbi aktivitetin që zhvillojnë këto forca, operacionet e tyre në kohë paqe, në konflikt apo luftë, edukimi i efektivave të FA-së e ndjenjat e patriotizmit, virtytet qytetare dhe vlerat e lirisë e demokracisë”.

Bashkëpunimi e përafrimi me Strukturat e NATO-s ndikuan edhe në riorganizimin e “Qendrës së Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes”, i cili u ngrit në nivel drejtorie, si: Marrëdhënie me Publikun dhe informim, Drejtoria e Publikimeve, Drejtoria e Aktiviteteve dhe Marrëdhënieve me Komunitetin, Drejtoria e Aktiviteteve Sportive, që rroknin rreth 129 veta.

Me kalimin në strukturën e re organizative dhe vendosjen në planin e përhapjes së FARSH-së (2014), ky institucion me urdhër nr. 615, datë 23.07.2014, mori emërtimin “Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes; Muzeu dhe Shtëpitë e Pushimit të Ushtarakëve”, me përbërje: Drejtoria e Kulturës, Medias dhe Botimeve, Drejtoria e administratës dhe shërbimeve, Muzeu i FA-së dhe Shtëpitë e Pushimit të Ushtarakëve, me personel rreth 157 veta. Mbështetur në urdhrin nr. 1217, dt. 09.10.2016, ky institucion u emërtua “Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes, Muzeut të FA-së”, i cili vijon aktivitetin për realizimin e misionit të saj.



28 - 29 Nëntori, domethënia e historisë së shqiptonjës me dy krerë, por me një trup të vetëm, atë shqiptar

28 Nëntori, dita më e rëndësishme për çdo shqiptar, pasi përtej një 24-orëshi të veçantë që ajo simbolizon mbi pavarësinë e marrë nga Shqipëria, në 1912-ën, me ngritjen e flamurit në Vlorë nga Ismail Qemali, kjo ditë është e veçantë edhe për një sërë detajesh të tjera me rëndësi të madhe historike dhe kombëtare.

Vetë data, simbolizohet nga një sërë rrethanash të paracaktuara ose jo, mbi çaste kyçe të një kombi të tërë.

Gjithçka filloi më 28 Nëntor 1443

Ishte viti shumë i largët 1443, kur në këtë ditë të shënuar, heroi kombëtar i Shqipërisë, Gjergj Kastrioti, ngriti flamurin e shqiptonjës dykrenore mbi kalanë e Krujës, duke e çliruar atë nga pushtimi osman.

Plot çerek shekulli, me një ushtri të përbërë nga 10 mijë ushtarë, ai qëndroi i palëkundur ndaj forcave osmane. Kështu, duke u bërë një qëndrestar i vërtetë, i cili e mbajti larg Evropës pushtuesin Osman, deri në çastin kur vdiq, më 17 janar 1468. Do të duhet të kalonin 469 vite, për ta riparë Shqipërinë sërish larg zgjedhës osmane, të lirë.

Nëntori i dytë

Nëntori më i rëndësishëm për shqiptarët mbetet pa diskutim



ai i vitit 1912 – edhe pse i dytë. Nën gjurmët e historisë, duke ndjekur Skënderbeun, Ismail Qemali, nisi rrugëtimin e tij drejt qytetit bregdetar të Vlorës, ku dhe nga ballkoni i shtëpisë së tij, ngriti flamurin, sërish me shqiptonjën dykrenore, të qëndisur nga Marigoja, dhe e shpalli Shqipërinë të pavarur nga Perandoria Osmane. Kuvendi Kombëtar i Vlorës, ishte organi i cili e shpalli mëvetësinë. Ky akt shpalljeje përbën një ndër ngjarjet më të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar. Kjo ditë, përkujtohet si fryti i përpjekjeve dhe i luftërave shekullore





të shqiptarëve, për të mbrojtur tërësinë tokësore të atdheut dhe për të formuar shtetin e pavarur shqiptar.

Dalja nga zgjedhja pesëshekullore e osmanëve, ishte një aspekt. Por aspekti tjetër, edhe më i rëndësishëm, ishte ai i krijimit të një Shqipërie me zhvillim ekonomik. Kjo, si thirrje për daljen nga prapambetja e pushtimit.

Me pushkë dhe me penë, Shqipëria ishte e pavarur dhe historia moderne e saj, do të merrte jetë.

Një tjetër 28 Nëntor me shumë rëndësi, këtë herë për kushtetutshmërinë e vendit, ishte ai i vitit 1998, kur me dekret të presidentit të asaj kohe, Rexhep Meidani, ajo u dekretua dhe hyri në fuqi, duke vendosur kështu gurthemelin e shtetit ligjor shqiptar të pas diktaturës.

28 Nëntori i Adem Jasharit

Kjo datë, jo më kot quhet e veçantë për shqiptarinë, pasi ajo nuk njeh kufij. Përtej festës kombëtare të pavarësisë, ka edhe një sërë ngjarjesh të tjera, të cilat përkujtohen në ditën e shenjtë të flamurit.

Në këtë datë të vitit 1955, në Prekaz të Skënderajt, do të lindte edhe komandanti legjendar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari.

Në vitin 1991, Jashari mori pjesë në disa sulme kundër xhandarmërisë serbe. Më pas, ai erdhi në Shqipëri për të marrë trajnim ushtarak. Do të ishte viti 1993, kur Jashari do të rikthehej në Kosovë, nga ku edhe vijoi sulmet kundër establismentit jugosllav.

Në korrik 1997, një gjykatë jugosllave do ta dënonte Jasharin për veprën e "terrorizmit në mungesë".

Por, ai nuk do të mund të kapej asnjëherë nga regjimi serb. Ishte viti 1998, kur Policia serbe, ndërmoi një sulm kundrejt banesës së Jasharit. Një betejë e vërtetë u zhvillua, ku 57 familjarë të Jasharëve, përfshi Ademin, gruan, djalin dhe vëllain e tij, mbetën të vrarë.

28 Nëntori i shqiptarëve të Kosovës

Vetë populli i Kosovës, e përkujton datën jo vetëm për ngritjen e flamurit në Shqipëri. Më 1969-ën, për herë të parë në Kosovë, u lejua përdorimi i simbolit kombëtar. Pra, ai i flamurit kuqez.

Ngritja e flamurit për të tretën herë do të vinte edhe jashtë kufirit faktik shqiptar, por brenda kufirit natyral.

Më 28 Nëntor 1997, UÇK-ja do të paraqitej për herë të parë në skenë si entitet, për lirinë e Kosovës.

Me miratimin pikërisht të Adem Jasharit, në rastin e varrimit të mësuesit dëshmor, Halit Geci, në fshatin Llaushë, tre luftëtarë të lirisë, Mujë Krasniqi, Rexhep Selimi dhe Daut Haradinaj, dolën publikisht të maskuar, por me uniformë të UÇK-së.

Ndërsa, një arsye tjetër, simbolike këtë herë, për të kremtuar 28 Nëntorin, është ajo e ngritjes së përmendores së Skënderbeut, në vitin 2001, në Prishtinë.

Për një arsye, ose për disa, 28 Nëntori është një datë, e cila e ka shoqëruar Shqipërinë në çdo etapë të historisë së saj.

Mbi këtë ditë, kultura dhe tradita e një kombi, shëmbëllojnë domethënien e tyre.

Domethënia e historisë së vjetër së një shqiponje me dy krerë, por me një trup të vetëm, atë shqiptar.





Kapiten (P) VERI TALUSHLLARI

"ASSOCIATION of SKËNDERBEJ USA"

në NY feston
Shqiptarisht festat
e bekuara të pavarësisë

E diel, 26 nëntor 2023.

Një sallë e madhe e mbushur me dritë dhe e veshur me ngjyrat e Flamurit Kuq e Zi në Restorant "Pine" në Bronx, në mesditë fillon të mbushet me shqiptarë të veshur për festë. Vijnë nga çdo qytet i Metropolit të Madh, New York-ut dhe nga New Jersey, Yonkers, Westchester e gjer nga Waterberry, Conecticat.

Tingujt e Himnit Amerikan dhe Himnit tonë të Flamurit jehojnë madhërishtëm dhe më pas, ndërsa nga mikrofoni ushtojnë vargjet e mrekullueshme të Nolit:

*...Me Skënderbenë u lavdërove,
Dhe në furtunë i fundmi u shove,
Me Malon prapë lart vrapove,
Yll i pavdekur për Liri!...*

Dy vogëlushë, motër e vëlla, Serena e Noah, fëmijët e kolegut tonë dhe pedagogut ushtarak, Kol. (R) Edmond Doda, vijnë rreth sallës duke valëvitur Flamurin, duke merituar duartrokitjet e festuesve.

Presidenti i Shoqatës, prof. asoc. dr. kolonel (R) Gëzim Mustafaj përshëndet të pranishmit dhe vë në dukje rëndësinë e 28 Nëntorit, si një produkt kompleks shumëdimensional, shumë-faktorial, pasi u arrit pas përpjekjesh, ngjarjesh politike, luftarake, kulturore e arsimore të shumta për vite e dekada me radhë, ku morën pjesë shqiptarët e të gjitha trojeve, nga Çamëria në Kosovë e nga

Durrësi në Luginën e Preshevës.

Më tej ai vë në dukje se 28 Nëntori na kujton dhe ngjarje të tjera të mëdha në historinë e Kombit, Nëntorin e Parë të Skënderbeut më 1443, datëlindjen e Heroit Legjendar Adem Jashari, më 1955, dhe daljen publike të UÇK-së, më 1997.

Duke folur për Luftën Antifashiste NÇ dhe koalicionin e madh Antifashist Botëror, folësi vuri në dukje kontributin e popullit shqiptar në L2B.

Fjalë të mira për Shoqatën "Skënderbej" dhe bashkëpunimin e frytshëm me të tha dhe Kryetari i Organizatës së Veteranëve të UÇK-së për SHBA-në, kolonel (L) Astrit Huskaj, dhe nga të pranishmit u prit me duartrokitje përshëndetja që ai solli nga eprorët e UÇK-së, Hashim Thaçi dhe shokët e tij që mbahen padrejtësisht në Hagë.

Salla mbushet me tingujt e këngëve e valleve tona të bukura, që luhen nga të rinj e të moshuar, por padyshim, stolia e gjerdanit të vallëzuesve janë zonjat dhe zonjushat me veshjet e bukura shumëngjyrëshe, ku mbizotëron e kuqja. Por ka momente kur duhet pak qetësi. Kamerierët vendosin në tavolinë një tortë me pesë qirinj. Shoqja dhe mikja jonë, Blerta, një nga anëtarët aktive dhe pjesë e Bordit drejtues të Shoqatës, vajza e një ushtaraku shumë të nderuar të FARSH-së, të ndjerit koloneli Qazim

Gjevari, befasohet dhe i mbushen sytë me lot kur e ftojmë të bëjë traditën nën duartrokitjet tona dhe tingujt e "Shumë urime...".

E më pas edhe një urim tjetër: Kejsi, vajza bukuroshe e Presidentit të Nderit të Shoqatës, Kapiten i Rangut të Parë (P) Bujar Hasani, ka ardhur në festë me të fejuarin e saj, Keny-n, një simpatik amerikano-aziatik që i luan lirshëm vallet tona. Janë njohur në Universitet, dhe të dy janë diplomuar shkëlqyeshëm.

Vështirë t'i sjellësh në këto radhë gjithë momentet e bukura që kaluam, por po sjell premtimin e një çifti të ri, Kelit dhe Monës, se nuk do të mungojnë në festat tona, madje do sjellim edhe djemtë. Apo falënderimin e kolonelit (L) Isuf Karaj, që ka ardhur nga Tirana për vizitë në NY, në festë i ftuar nga Dirka e Astrit Xhakolli. Gjithçka i bëri përshtypje mikut tonë, Isufit, ekzekutimi i Himneve, muzika, vallet, interpretimi nga të gjithë festuesit i "Mora Fjalë" dhe "Xhamadani vija-vija", trokitja e gotave me kolegë që vinin dhe e takonin, fotot... "Faleminderit që më bëtë pjesë të gëzimit tuaj! - thotë, - Nuk do ta harroj! Do t'u tregoj miqve tanë kur të kthehem në Atdhe!".

Mbi New York po binte mbrëmja dhe ish koha për t'u ndarë. Fotot e fundit, përshëndetjet dhe premtimi për t'u takuar në gëzime të tjera.



Një fundjavë ndryshe me një ambasador ndryshe

Veri Talushllari

Në prag të festave të Nëntorit

Mbresa nga një takim me Ambasadorin e RSH-së në SHBA i Shoqatës së Ushtarakëve Shqiptarë “Association of SKËNDERBEJ USA” në NY-NJ. Një pasdite e bukur fillim nëntori, e ngrohtë e plot diell, një pamje e bukur nga tarraca e një ndërtese të lartë në qendër të Manhattan-it, ku është dhe një lokal i vëllëzërve Myzafer e Zamir Vejuka, skënderbegas dhe ushtarakë, e tashmë biznesmenë të suksesshëm, ku syri kap të famshmin “Empire

State Building” e më në horizont “Freedom Tower”, në perëndim Hudson River që rrjedh i qetë, madhështor i ndritshëm me New Jersey-in në sfond e më në veri të bukurin e të zhurmshmin “Time Square”. Jemi disa anëtarë të Shoqatës ‘SKËNDERBEJ’ që ndërsa presim mikun, bisedojmë me kamerierët, djem të bukur e të shkathët, e për kënaqësinë tonë, të gjithë shqiptarë.

Ja dhe Ambasadori, z. Ervin Bushati, i shoqëruar nga Këshilltari i Ambasadës, z. Helidon Bendo. Një Ambasador ndryshe. Miqësor. Jo formal. I qeshur dhe bashkëbisedues i këndshëm. (Është takimi ynë i parë me një Ambasador. Në të vërtetë është i pari Ambasador që megjithëse vetëm pak kohë ka që ka marrë këtë



detyrë, nuk rri i mbyllur në zyrën e tij në Washington D.C., por vjen në takime me komunitetin shqiptar). Dëgjues i vëmendshëm, por dhe i mprehtë në përgjigjet. Nuk i thotë “jo” një gote vere pas një dite të lodhshme e një takimi të gjatë me përfaqësues të shoqatave të shumta shqiptare në New York, për ta bërë bisedën më të lirshme dhe më intime. Madje ende pa u ulur mirë, me Nadiren, Gëzimin apo Fluturën u zbuluan disa lidhje të hershme familjare e shoqërore, që e bënë bisedën edhe më të këndshme e të natyrshme. Presidenti i “Association of SKËNDERBEJ”, prof. asoc. dr. kolonel (R) Gëzim Mustafaj i bën një përshkrim të jetës dhe veprimtarisë së Shoqatës, e cila mbledh në radhët e saj ushtarakë shqiptarë të liruar ose në pension tashmë me banim në SHBA, familjarë të tyre dhe miq e simpatizantë. Në gjashtë vitet e veprimtarisë së saj, Shoqata ka bërë shumë veprimtari atdhetare, kulturore e humanitare, në përmbushje të misionit që i kemi vënë vetes për ruajtjen e traditave e zakoneve më të mira të popullit e Ushtrisë Shqiptare, por edhe për t’iu gjendur njeri-tjetrit, për të festuar së bashku, për të dalë nga rutina e përditshme e nga


stresi i të qenit larg Atdheut. Përmend veprimtaritë shkencore si për 100-vjetorin e Kongresit të Lushnjës apo promovime librash të anëtarëve të Shoqatës, mbledhje fondesh për raste fatkeqësish, si në rastin e ndarjes nga jeta të legjendës së portës së “Partizanit” Bashkim Myhedini, apo të Dëshmorit të Atdheut Saimir Hoxha etj.

- Po shumë bukur! Se kur dëgjon ‘Shoqatë ushtarakësh’ të vete mendja te ndonjë përgatitje për luftë. - thotë duke qeshur Ambasadori. - Por më vjen mirë që siparin e festave po e hapim me ju. Jam rritur me histori të luftës dhe ushtrisë, kam pas gjyshin partizan dhe oficer.

- Po nëse na bëhet thirrje, edhe atë e bëjmë, - ia kthejnë Agimi e Milto. - Ja e biseda shkon te domosdoshmëria e rritjes së investimeve të qeverisë shqiptare për mbrojtjen se ...ja, grekët, serbët, po armatosen... i themi. Ambasadori na tregon për disa hapa që janë bërë e disa investime sidomos në planin strategjik e të mbrojtjes, jo vetëm konvencionale por edhe në fusha të tjera ku jemi vlerësuar nga Komanda e NATO-s si “më të mirët në klasë”. Dhe shpjegon thjesht e qartë vlerat dhe rëndësinë e drejtimit të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara e tani të Këshillit të Drejtave të Njeriut nga Shqipëria. Dhe një kompliment e vlerësim me fjalët më të mira për kolegun e vet, Ambasadorin tonë në OKB, z. Ferit Hoxha, mbase më i miri në shërbimin diplomatik thotë, por që sot ka dhe detyrën më të vështirë. Doemos, flasim edhe për votën e emigrantëve, edhe për kujdesin që dy qeveritë shqiptare duhet të bëjnë për shkollat shqipe dhe Ambasadori na kujton se këtë muaj do të bëhet Samiti i Tretë i Diasporës, e, nëse dikush nga ju do të ndodhet në Shqipëri, duhet të jetë atje.

- Do të jem unë, - thotë Petriti, - e patjetër do të shkoj. Por meqë Ambasadori na zbulon se është financier dhe në Parlament ka punuar për investimet, Zamiri e “kritikon” se disa investime duheshin bërë më mirë, e përmend -doemos si shkodran e biznesmen, që me siguri ia di vlerën e mbase një ditë do të hedhë para atje- Velipojën, një pasuri e jashtëzakonshme. Me një gjuhë të kuptueshme dhe argumente, z. Ervin tregon prioritetet e investimeve dhe bumin që pritet në vitet e ardhshme jo të largët e ne doemos do të donim me zemër që ta shohim Atdheun tonë edhe më të bukur e më të zhvilluar. Ambasadori kërkon të dijë më shumë për shpërndarjen e emigrantëve në NY, NJ dhe Conecticat, për organizimin e tyre dhe së bashku biem në një mëndje që Shoqata “Bijtë e Shqipes” në Filadelfia është më e mirë organizuara në SHBA. I tregojmë edhe për një nismë për sjelljen në Shqipëri të eshtrave të Nolit, pasi atje e kanë vendin. Biem dakord që ka disa vështirësi të natyrave të ndryshme, por mbetet për t’u parë. Si pa u vënë re ikin dy orët dhe miqtë që do të duhet të udhëtojnë për në Washington D.C., ngrihen, e, pasi bëjmë disa foto, ndahemi miqësisht dhe me premtimin për të mos qenë ky takimi i fundit.

- Patjetër, - thotë Ambasadori, - madje që këtë muaj kur do të ngremë Flamurin tonë në City Hall, (Bashkinë e NY), më 27 Nëntor! Mirupafshim atje dhe Gëzuar Festat!



ARTUR LEKBELLO,
portier i shquar i futbollit shqiptar

Historia e pa treguar e Artur Lekbellos: Nga kitara e kënga në shkollën “Skënderbej”, për t’u bërë oficer madhor. Pastaj, portier te Partizani, në Kombëtare dhe hero në Barcelonë. “Inati” me Zubizarretën, zbulimi nga “Sportski”, duetet e famshme me Lamen e Starovën apo Tahon, te telegramet që i ndryshuan jetën. Nga oficer i lartë në Brigadën e Tankeve, te ndërhyrja e Muho Asllanit për ta sjellë në Durrës dhe “Happy end” në Rotterdam në moshën 36-vjeçare ndaj “Fejnordit”. Cili ishte njeriu që frenoi Barcelonën në “Camp Nou”?

Çiçiku zbulon Lekbellon, Mustën e Ahmetajn

Një fillim shumë i ndryshëm nga të tjerët. I vendosur familjarisht në Durrës, pa asnjë traditë sportive, në vitin 1971-72 regjistrohet në shkollën “Skënderbej” me qëllim për t’u bërë një ushtarak i mirë. Ishte Sherif Çiçiku, me profesion shofer i shkollës, por me pasion trajner futbollit që e zbulon edhe e merr me nxënësit e ekipit të shkollës. Pak më vonë edhe Mustën e Arjan Ahmetajn do t’i kishte shokë, miq dhe për shumë vite bashkë te klubi i famshëm shqiptar. Por, ata që i hapën derën ishin Refik Resmja e Iljaz Dingu, të cilët e vendosën në portë me të rinjtë e Partizanit. Pikërisht këtu fillon karriera, për të cilën Lekbello nuk e kishte menduar asnjëherë se do të ishte shumë e veçantë.

Jemi në vitet ’70-’80. Në portën e Partizanit është B. Muhedini dhe J. Kaçi. Pas ndëshkimit të ushtarakëve, pozicioni i Muhedinit, si dhëndër i Ballukut, vështirësohet dhe Partizani kërkon të ketë një portier të dytë pas Kaçit. Alternativa e parë dhe e mundshme, pa kërkuar dhe marrë nga ekipet e tjera, është Artur Lekbello, portieri i skuadrës së të rinjve, i dalluar dhe me perspektivë. Është vetëm 17 vjeç dhe bashkë me Perlat Mustën që do të vijë, do të qëndrojë gjatë te Partizani. Për qëndrimin në Tiranë, merr emërimin nga Ministria e Mbrojtjes që e cakton oficer në Brigadën e Tankeve në Sauk.

1986, Muho Asllani e ktheu në Durrës

Nuk janë të rralla rastet kur sportistët janë marrë apo kanë ndryshuar skuadër e klube nga dëshira, urdhrat apo aksionet e pushtetarëve të kohës. Janë raste si ato të Bizit dhe Zhegës, që Mehmet Shehu i kujtoi për inxhinierë dhe i riktheu në Shkodër (luanin me Partizanin e Dinamon), për të “përfunduar” hidrocentralin e Vaut të Dejës.

Sezoni 1984-85 është mbyllur dhe Lekbello është 27 vjeç, ndërkohë që një kërkesë e bërë nga klubi i “Lokomotivës” dhe me interesimin e Muho Asllanit, ish-Sekretar i Parë i Rrethit, Artur Lekbello transferohet në Durrës për të luajtur me ekipin durrsak, por për të qenë edhe afër familjes, tashmë i sapofejuar. Dhe te “Lokomotiva” do të bashkohet me Ajazin, Nar Kokën e Shtamën, Filjarin, N. Janin, Himën, Çelën, Kokën, Engjëllin, Hadon, Abazin, dy Ballgjinët, dy Manushët, Metën, Mihon, Markun, Sejdinin, Sulejmanin, Ketën, Sukaj, Bishën, Çekën.

Njoftimi surprizë

Nuk ka pasur asnjë lidhje me Vlorën, por skuadra vlonjate do të ishte vendimtare për jetën dhe karrierën e tij. Ishte i grumbulluar me skuadrën në hotel “Kruja” në plazh, kur paraditen e së mërkurës, duke qëndruar në dhomë me Niko

Janin, informohet nën zë se në klub për të kishte ardhur një telegram nga federata. Dhe informacioni kishte qenë i saktë dhe “bombë”. Në mesditë, pas stërvitjes, sekretari i klubit, Zeneli, e njofton se të hënën në orën pesë duhet të ishte në Vlorë në klubin “Flamurtari”. Motivi nuk shkruhej në telegram, por kuptohej se kërkohej për përforsim në prag të takimit me Barcelonën. E kishin propozuar pikërisht atë pasi një problem e pengonte portierin Birçe të shkonte jashtë shtetit dhe portieri i dytë, Arapi, ishte i ri dhe pa eksperiencë. Duke parë që Lekbello ishte në formë, futbollistët biseduan me klubin që t’i kërkonte FSHF-së emrin e tij.

Udhëtimi drejt Vlorës me “Vollga”

As nisja për Barcelonë, asnjë nisje tjetër për ndeshje apo diku tjetër nuk ishte e tillë si ajo e asaj të hënë të datës 8 shtator. Nuk kishte mjete udhëtimi si sot, vetëm treni me orare të caktuar ishte ai më i sigurti dhe i garantuar për popullatën. “Do të çojmë ne”, - i thanë dy miqtë e tij, mjeku kirurg Roland Katroshti dhe Niko Gjiri, drejtor i Parkut në Durrës. E lanë të takohen tek Ura e Dajlanit dhe me veturën “Vollga” u nisën për në Vlorë, ku para stadiumit po e prisnin shefi i Klubit, Skënder Ibrahim, Taho, Çipi, Iljadh e Zijai. Pastaj sistemimi në hotel “Adriatik” në një dhomë me Vasil Rucin. Ishte zgjedhje e Vasilit, pasi kishin njohje më parë kur ishin bashkë në Kombëtare.

Grumbullimi, prag ndeshja

Nuk luajti ndeshjen e radhës me “Lokomotivën” në kampionat pasi ishte i regjistruar dhe figuronte si portier i Flamurtarit. Dy javë stërvitje pastaj ndeshja. Një analizë e shkurtër me shumë thjeshtësi nga trajneri Çuri paraditen e takimit, ora 10:00 në hollin e “Adriatikut”, ku ishin prezentë M. Bushati, M. Papadhopudhi dhe E. Halili, ish-sekretar i Parë i Rrethit. Asnjë informacion për “Barçën”, vetëm Hjujh, Linekër dhe trajneri i “Vejebnillës” ishin të njohur. I dhanë nga 30 copë bileta, nga të cilat Lekbello mbajti vetëm dhjetë, të tjerat ua shpërndau tifozerisë. Kishte ankth e frikë për një goleadë, pasi ndiente përgjegjësi ndaj ekipit dhe tifozëve vlonjatë. Por, çuditërisht, shikonte siguri te lojtarët kur i thoshin: “Mos e çaj kokën, do të fitojmë”. Pastaj ndeshja, e parë 1-1 surprizë dhe pas dy javëve sfida e kthimit.

Nga Vlora në Han të Hotit, Titograd, Beograd, Romë dhe Barcelonë

Kjo ka qenë linja e avionit që skuadra mori nga nisja deri në zbritje. Shumë e gjatë, por e këndshme dhe argëtuese. Nuk kishte linja direkt dhe duhet t’i “bije nga Kina” për të mbërritur në Barcelonë. Të shtunën nisja me një autobus të Shkodrës deri në Han të Hotit, pastaj avioni Titograd-Beograd. Një natë fjetje, të nesërmen drejt Romës, një natë qëndrim dhe vizita në ambasadën tonë atje për të vijuar në Barcelonë dhe të hënën, rreth orës 14.00, avioni hap rrotat dhe ulet në aeroportin “El Prado”. Bashkë me pasagjerët zbresin shkallët edhe futbollistët. Është një pritje zyrtare, nuk ka autografe, pasi nuk i njohin, nuk kanë kostumet zyrtare të klubit dhe si futbollistë kanë vetëm çantat e sportit në duar. Pastaj me autobusin e caktuar nisja drejt hotel “President” për t’u sistemuar në katin e tetë, dhoma



804, si gjithmonë me Vasil Rucin. Tashmë ditët katalanase kanë filluar për të mos u harruar kurrë...

Mosnjohja dhe gota me verë që habiti gazetarët

Barazimi në Vlorë kishte shtangur spanjollët. E panjohur aspak për ta, Shqipëria papritur ishte bërë nga një objekt misterioz në një vend shumë që ngjall kuriozitet. Asnjë lidhje diplomatike, asnjë shkëmbim kulturor, sportiv apo artistik në vite, madje një mbyllje hermetike me ta dhe direkt Flamurtari-Barcelona 1-1. As ambasadë nuk kishte në Spanjë (sapo ishte vendosur ato ditë) dhe për të shoqëruar skuadrën kishte mbërritur konsulli shqiptar nga Franca. Ndeshja do të luhej në orën 21:15 të mbrëmjes dhe transmetimi radiofonik i ndeshjes nga Shqarri ishte krejt i veçantë për shqiptarët. Por ajo që habiti më pas spanjollët, ishte një gotë verë e pirë nga skuadra në drekën e së mërkurës, një detaj që nuk i shpëtoi medias: “Si ka mundësi që ekipi të pijë verë para ndeshjes e të arrijnë atë rezultat?”, - ishte një nga pyetjet që bënte shtypi post’ sfide.

Filozofia dhe karakteri në “Camp Nou”

Si e kujton Lekbello: “Vetëm një stërvitje në “Camp Nou”, pak mendohej dhe flitej për ndeshjen nga futbollistët e Flamurtarit. Kjo ia shtonte pasigurinë kur shikonte që lojtarët ishin të lirë, lëviznin të qetë në mjediset e hotelit, me humor, por asnjë fjalë për takimin. Frika për një ndëshkim me shumë gola e kishte çoroditur Lekbellon, por ishin Ruci dhe Taho që i thoshin në vazhdimësi: “Na njeh neve ti apo jo?”. Një analizë e shkurtër dhjetë minuta nga trajneri Çuri, e organizuar në hotel dhe mbyllur me konkluzionin tipik vlonjat: “I dimë vetë të gjitha, mos na thuaj asgjë, ne do të nderojmë”, pas të cilës skuadra mori rrugën drejt “Camp Nou”-t. Gjatë 90 minutave kujton disa detaje: “Linekerin që pas çdo rasti të humbur bërtiste ‘Oh my

God””. Apo fund-ndeshjen: “E frikësuar, Barcelona u tërhoq në mesfushën e saj, madje e luante aty topin dhe Ferko e Bubeqi mund të shënonin. Nuk e mendoja kurrë një Barcelonë që në pesë minuta të mos kalonte mesfushën në ruajtje të rezultatit dhe në pritje të vërsëllimës së portugezit Da Silva”, - thotë Lekbello. Të nesërmen, pas barazimit të madh, gazetat një pjesë të meritës do t’ia dedikonin edhe portierit: “Este senor tan simpatico ed Letbello, ‘el Capo de Albania’ (Ky zotëria simpatik është Lekbello, shefi i Shqipërisë)”, - ishte një ndër titujt që do të kishin në faqet e tyre.

Kasetat me këngët e Iglesias

E ka pasur të veçantë dëshirën për të qëndruar në autobus pas shoferit. Kështu edhe në Barcelonë. Shumë shpejt u bë mik me Marcion, drejtuesin e autobusit: “Kishte pak flokë si unë, pëlqente muzikën dhe kishte luajtur portier në moshë të re”. I mahnitur për paraqitjen e Lekbellos dhe për miqësinë që krijoi, në ndarje i kishte përgatitur një pako të vogël, që fshehurazi ia dha duke i thënë: “Janë dy kasete të Hulo Iglesiasit. Edhe ai ka qenë portier në rininë e tij”. Kasetat u ruajtën dhe u dëgjuan për shumë vite deri në konsumim të plotë të tyre. Ndërkohë, i premtoi se në rastin më të parë do të takoheshin sërish. Lekbello u kthye pas një viti në Spanjë, në Sevilje, por takimi me Marcion nuk u realizua.

“Inati” me Zubizarretën

Nuk ishte i tillë, por u krijua nga ndeshja e parë, në Vlorë. Pas takimit, si shumë të tjerë futbollistë tentuan të marrin gjithçka të mundshme nga Barcelona, edhe Lekbello vrapoi te Zubizarreta kur po futej në dhomë. Por, ai reagoi ftohtë, një lëvizje mohuese me kokë, pastaj dy fjalë nëpër dhëmbë dhe iu drejtua dusheve. I zhgënjyer nga kjo sjellje, e mori inat “atë çun mami”. Por kishte

gabuar, pasi në “Camp Nou”, pas ndeshjes, ai i kishte përgatitur një çantë të madhe me materiale sportive. Dhe, mbi të gjitha, një kravatë të kostumit zyrtar të Barcelonës që Lekbelllo e ruan edhe sot. Por e veçanta erdhi pas një viti në Sevilje, kur Zubizarreta i kishte përgatitur surprizën e dytë: Kishte rezervuar një lokal nate, një gotë verë dhe muzikë, një mbrëmje e paharruar që zgjati deri në orët e para të mëngjesit.

Ura e Dajlanit-Barcelonë, pse kthimi ishte refuzuar?

Tek Ura e Dajlanit, aty ky e nisi dhe mbylli aventurën spanjolle. Por, si asnjëherë tjetër, para dhe më pas, nuk kishte ndodhur që një skuadër klubi ta braktiste avionin dhe të refuzonte kthimin në Shqipëri pas ndeshjes. Nuk kishte ndodhur dhe as që mund të ndodhte për shumë arsye. Vetëm me “Flamurtarin” është regjistruar një rast i tillë. Të entuziazmuar pas barazimit, të nesërmen ishte kthimi me avionin e linjës. Dhe, ndërsa në orën 12:00 autobusi dhe policia prisnin para hotelit lojtarët, vetëm Lekbelllo ishte ulur në sediljen e parë. “Ishte një vendimmarrje kolektive e skuadrës”, -thotë Lekbelllo. - Lojtarët donin të qëndronin edhe një ditë më shumë, për të shijuar barazimin e për të soditur Barcelonën”. Përrashtim u bë vetëm për Lekbellon: “Je ushtarak dhe ke ardhur si përforsim, mirë është që të shkosh tek autobusi sa për t’u justifikuar që të mos kesh pasoja”, - i thanë. Ndërkohë skuadra nuk mund të qëndronte më në hotelin “President”. Pa financa, pa hotel, Flamurtarit do t’i vinte në ndihmë presidenti i Barcelonës, i cili i sistemoi në hotelin e tij “Christal”, duke u garantuar gjithçka deri në largim. Më pas, kthimi dhe pritja festive në hotel “Rozafa” në Shkodër. Këtu janë dy momente që Lekbelllo nuk i harron: “Kur po udhëtonim nga Titograd për në Han të Hotit, papritmas pamë një makinë policie shqiptare që po na shoqëronte. Frika për mosardhjen e skuadrës në kohë, kontrolli në doganë krijoi panik dhe ankth në skuadër. Mirëpo, urdhri ishte krejt ndryshe: “Asnjë kontroll, vetëm pritje festive”. Autobusi do të ndalonte tek Ura e Dajlanit dhe Lekbelllo zbriti duke marrë rrugën për në shtëpi. “Çfarë kombinimi, - kujton ai, - nga Barcelona tek Ura e Dajlanit! Atje e fillova udhëtimin dhe tek ajo urë e vjetër e mbylla”. E lutën të udhëtonte me skuadrën në Vlorë, por e prisnin në familje. Në Vlorë u rikthye në mes javë, për të festuar në Pallatin e Sportit, por edhe pas një viti në një tjetër sfidë, këtë herë me Kombëtaren.

Kur e zbulon “Sportski”

Luante si titullar i “Lokomotivës”, por figuronte edhe si portier i “Flamurtarit”, ndërkohë që në prag-ndeshjen kundër “Partizanit” të Beogradit, një sezon pas Barcelonës, ndërsa ishte në projekt për t’u grumbulluar, FSHF-ja u informua se një gazetë (“Sportski” në Beograd) shkruante të “fshehtë”, ku thuhej se Lekbelllo ishte portier i “Lokomotivës” së Durrësit, por njëkohësisht luante edhe me “Flamurtarin”. Serbët nuk ishin Barcelona, na njihnin deri në detaj. Pra, ishte i pamundur aktivizimi i tij, sepse rrezikohej skualifikimi nga UEFA, nëse ankesa e tyre do të merrej në konsideratë, siç erdhi rasti, kur “Flamurtari” u kualifikua. Më pas me Kombëtaren, në 1987-ën, do të kishte dy takime radhazi: u rikthye në Vlorë më 28 tetor ndaj Rumanisë (1-0 për rumunët) dhe pas një muaji në Spanjë 0-5 (dy gola i pësoi me penallti).

Për Lekbellon do të ishte hera e dytë që në harkun e një viti do të kthehej në Spanjë. Dhe ka një koincidençë të madhe: Nëse Kombëtarja luajti në Sevilje, më 18 nëntor, pas një jave (më 25 nëntor), “Flamurtari” do të përballej me “Barcelonën” (1-0 në Vlorë, gol i Kushtës, dhe 1-4 në “Camp Nou” realizoi V. Ruci me penallti). Megjithatë, në portë ishte Anesti Arapi. Për Lekbellon ishte një periudhë pritjeje, sepse së shpejti do të bëhej edhe baba.

Telegrami i fshehur dhe takimi në hotel “Dajti”

Ky është një ndër paradokset më të mëdha në karrierën e Lekbellos. Viti 1991 e ka larguar nga “Lokomotiva”, ka ndierë dëshpërim, pasi e konsideron të mbyllur përfundimisht portën. Por, jo. Si një rrufe në qiell, një telegram i nisur nga klubi “Partizani” do t’i jepte sërish një tjetër surprizë, madje edhe më të këndshme se ajo e Barcelonës. Në prag të takimit me “Fejnordin” në Kupën e Kampionëve, Musta ishte larguar në Rumani te “Dinamo” dhe drejtuesit e klubit, Starova dhe Lika kujtohen për Lekbellon. Një telegram urgjent klubit durrsak, por nuk ka asnjë reagim. Kalojnë ditë dhe pas dy javësh, krejt papritur, ndërsa ndodhej në Tiranë dhe po ngjiste shkallët e hotel “Dajti” takoi Starovën dhe Likën. “Pse nuk ke ardhur në grumbullim, po të presim, të kemi dërguar një telegram?”, - e pyesin ata. Pa ditur asgjë për ftesën, Lekbelllo kupton se telegrami i ardhur në klub ishte fshehur qëllimisht dhe ai nuk ishte njoftuar. Ishte mbipeshë dhe pa stërvitje. Pastaj, dy ndeshjet spektakolare me “Fejnordin”, 0-0 në Tiranë dhe 0-1 në Rotterdam: “Kanë qenë takimet më të bukura të jetës sime”, -thotë Lekbelllo. Dhe këtu, fund karriere, në moshën 36-vjeçare: “E filluar dhe e përfunduar me Partizanin”.

Pasioni për muzikën, miqësia me Mulën

Nuk është vetëm ai portieri që habiti Barcelonën dhe Roterdamin, por edhe diçka tjetër: Një pasion të pa treguar shpeshherë akoma më të madh. Prindërit nuk i kultivuan Lekbellos sportin, por i lanë trashëgim muzikën. Babai dhe e gjithë familja këndonin bukur dhe ishin orkestrues të njohur, sidomos në kitarë dhe mandolinë. Edhe Lekbelllo këndon e luan bukur në kitarë (në shtëpi ka dy kitara, njëra e markës amerikane “Gipson”). Kur ishte te “Partizani”, treshja Lekbelllo-Lame-Starova mbante gjallë gjithë ekipin. Po kështu edhe te “Flamurtari”, me Tahon kanë qenë një duet i paparë si zë i parë dhe i dytë. Ndërsa te “Lokomotiva” me Niko Janin mbetën protagonistë në çdo eveniment festiv. Ka nostalgji për zërat e B. Alibalit, Sh. Merdanit, T. Tërshanës, ndërsa i pëlqejnë Eli Fara, Aurela Gaçe dhe Kastriot Tusha. Megjithatë, ajo që është e veçantë, mbetet miqësia me të njohurin Osman Mula. Kanë të njëjtin shpirt muzikor, këndojnë dhe u bien instrumenteve, Osmani saksit, Lekbelllo kitarës. Kanë luajtur futboll, madje në të njëjtin rol, pra portierë, dikush me karrierë të shkurtër te “Vllaznia”, tjetri shumë të gjatë dhe të suksesshme. Po sa i ngjajnë njëri-tjetrit: Kur i sheh në foto, i kujton vëllezër dhe lehtë mund të gabosh.

Figura që kanë lënë gjurmë të thella në historinë e sportit shqiptar, por që u kultivuan mjeshtërisht nga profesionistë të vërtetë të dalë nga ‘Fidanishtja Skënderbej’.

GJAKU I ANTIFASHISTËVE SHQIPTARË NË VENAT E SPANJËS



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Në përkujtim të heroit dhe dëshmorit Asim Vokshi (1909-4.10.1937) dhe 14 dëshmorëve të tjerë, si dhe 70 luftëtarëve vullnetarë nga trojet shqiptare pjesëmarrës në përballjen me diktaturën e egër europiane në Spanjë të Francisko Frankos. Asim Ali Vokshi është shpallur me titullin e lartë “Hero i Popullit”, më 10.07.1949, nga Kuvendi Popullor, ndërsa me vendim nr. 02, datë 18.01.1983, të Komisionit Qendror të statusit “Dëshmor i Atdheut” i është akorduar titulli sublim për të rënë të kombit, “Dëshmor”.

Kushtrimi luftarak i elitës intelektuale për rrezikun fashist

Lufta në Spanjë, më 1936, përbashkoi 53 kombe nga e gjithë bota me armatën e madhe të antifashistëve të globit me rreth 60 000 vullnetarë ndërkombëtarë. Edhe shqiptarët nuk kishin si të mungonin në luftën antifashiste në tokën spanjolle. Përbashkimi i më se 70 luftëtarëve shqiptarë në luftën e përgjakshme kundër diktaturës së Frankos, ku u vranë më se dy milionë njerëz nga më shumë se 50 vende të botës, është një ngjarje kulmore e shekullit XX. Janë me dhjetëra e qindra publikime në mbarë botën që i kushtohen kësaj lufte që, edhe pse u zhvillua në Spanjë, mori përmasa të përbotshme sepse luftohej kundër ideologjive totalitare, të nazizmit dhe fashizmit. Fashizmi që ishte si “trend europian” i mendjelehtësisë fillimisht, u shndërrua në tmerr i njerëzimit. Prandaj antifashizmi dhe antifashistët ishin vizionarët e vërtetë që dinin ta lexonin të ardhmen dhe rrezikun që i kanosej njerëzimit. Kushtrimi luftarak i elitës intelektuale, dhe jo vetëm, lexohej në sytë e rinisë dhe intelektualizmit të kohës që nga të katër anët e globit i erdhën në ndihmë popullit spanjoll, për të përballuar të keqen e madhe, të reve të zeza që sillleshin si fantazmë përmbi Europë dhe jo vetëm. Vullnetarët ndërkombëtarë dhe ata shqiptarë, pjesë e Brigadave Ndërkombëtare në Spanjë kishin një devizë sublimë të solidaritetit ndërkombëtar të popujve, që do të thotë se, “Të mbrosh lirinë e tjetrit, do të thotë, të mos pranosh pushtimin tënd”, pushtim që për shqiptarët po përgatitej në “kuzhinën” e Romës, sikurse ndodhi në fakt më 7 prillin e 1939-ës.

Marrëdhëniet historike të shqiptarëve e spanjollëve dhe sfida ndaj fashizmit

Konteksti historik i marrëdhënieve të popullit spanjoll e atij shqiptar vlerësohet që në bashkëpunimin e hershëm të mbretit spanjoll Alfonsi V (1396-1458) me Princin e Epirit Gjergj Arianitin e më pas me Gjergj Kastriotin - Skënderbeun (1405-1468) në luftën kundër pushtuesit osman gjatë mesit të shekullit XV. Studiuesit e historisë, shqiptarë e të huaj, kanë vlerësuar kontributin e Alfonsit

V me drithëra buke, municion dhe fuqi ushtarake njerëzore, shumë prej të cilëve ranë heroikisht krah shqiptarëve në Krujë, në betejën e Beratit etj. Fan S. Noli shkruante: “Alfonsi V ishte miku më i ngushtë dhe mbrojtësi më besnik i Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, të cilin e kishte ndihmuar me dorë të hapur në disa raste kritike...” dhe “Gjergj Kastrioti Skënderbeu e ndihmoi të birin e Alfonsit XV, Ferdinandin, në momentet më të vështira, që të ruante kurorën atërore të Mbretërisë së Napolit dhe “ai i qëndroi mirënjohës tërë jetën Skënderbeut”, duke e quajtur si “baba”. Vlera e miqësisë së Gjergj Kastriotit ishte veçanërisht në mbrojtje të lirisë dhe të qytetërimit europian. Aspekti tjetër ku shqiptarët i treguan fuqishëm vlerat e tyre kombëtare të solidaritetit ishte vëllazërimi i popujve në Spanjë, që u kthye në një sfidë ndaj fashizmit. Periudha e dytë e kontakteve historike midis dy popujve i takon pragut të Luftës së Dytë Botërore kur koalicioni nazi-fashist, pasi kreu puçin ushtarak në Marokun spanjoll, më 18 korrik 1936, nisi agresionin ushtarak kundër qeverisë legjitime spanjolle, duke shkaktuar tragjedinë më të madhe kombëtare, luftën e përgjakshme civile. Kështu që thirrjes së spanjollëve të ndershëm: “Popuj të botës, ndihmomëni! Fashizmi po na mbyti!” iu përgjigjën të gjitha shtresat përparimtare të popujve anembanë botës, të vullnetarëve nga 53 vende, dhe mbi 70 luftëtarë vullnetarë nga trojet shqiptare. Ishin antifashistë shqiptarë që shtrënguan duart e zemrat në “ombrellën e vëllazërimit të popujve dhe kombeve të botës”. Betimi i antifashistëve: “Vdekje fashizmit! – Liri Popullit!”, lindi pikërisht në zjarrin e luftës për lirinë e popullit spanjoll por dhe e popujve të tjerë të botës që u kërcënuan seriozisht gjatë Luftës së Dytë Botërore. Për herë të parë në historinë e njerëzimit popujt nga e tërë bota, u solidarizuan në luftën kundër rrezikut të përbashkët fashist, që po kërcënonte planetin tonë.

Brigadat luftarake Ndërkombëtare, bashkë në frontin e madh antifashist

Tre muaj pas fillimit të rebelionit fashist, një delegacion vullnetarësh të huaj i përfaqësuar nga italianii Luigji Longo/Gallo, polaku Stefan



Wisniewski e francezi Pierre Rebier, i ofruan qeverisë spanjolle ndihmë pa kushte. Ata deklaruan, se: “Ne dëshirojmë vetëm që Brigadat Internacionale të konsiderohen si njësi të varura nga qeveria dhe autoritetet ushtarake spanjolle”, ndërkohë që më 22 tetor 1936, qeveria e Republikës Spanjolle vendosi të miratonte krijimin e brigadave ndërkombëtare. Në deklaratë pjesëtarët e tyre shpreheshin: “...gjendem këtu se jam një vullnetar për të dhënë dhe pikën e fundit të gjakut tim, për mbrojtjen e Spanjës, Lirisë dhe Botës mbarë!”. Pesë ditë pas thirrjes, më datën 27 tetor 1936, batalioni i parë ndërkombëtar “Edgar Andre” nisët nga Albacete në frontin për mbrojtjen e Madridit dhe më tej pas disa ditësh atij iu gjend në krah batalioni francez “Komuna e Parisit” dhe batalioni polak “Dombrovski”; që përbënin edhe të parën brigadë vullnetare ndërkombëtare, të emërtuar “Brigada XI”. Komandant i saj ishte gjeneral Kleber dhe komisar Hans Beimler që u pasua shpejt nga të tjera batalione e brigada si “Telman”, “Marsejeze”, “Garibaldi”, “Linkoln”, etj. Kur Gjenerali Lukash, i paraqiti popullit të Madridit, Brigadën e Dytë deklaroi: “Kjo Brigadë do ta mbrojë qytetin tuaj sikur të ishte qyteti i lindjes së cilitdo luftëtar vullnetar të saj. Nderi juaj është nderi ynë! Lufta juaj është lufta jonë! Salud Camaradas!”. Kështu në këtë luftë për jetë e vdekje me fashizmin, kombi shqiptar u përfaqësua që në muajt e parë në këtë përgjakje të përbashkët të “vëllazërimit të popujve” me ushtarakë, infermierë, gazetarë, intelektualë, me burra e gra sikurse ishte edhe gruaja shqiptare infermierja Justina Shkupi, shoqe e ngushtë Gonxhe Bojaxhiut, (Nënë Terezës), e cila u shqua si asistente në krah të mjekëve të famshëm antifashistë, por dhe poeti i ri Petro Marko që nxitonte drejt Madridit të

Lirisë, e thurte vargjet “Salud Madrid”. Edhe shtypi shqiptar i kohës u shndërrua në armë mbështetëse të djemve që luftonin krah popullit spanjoll. Kështu gazeta “Përpara” e Korçës, në tetor 1938, shkruante: “...djem të popullit shqiptar lanë vëllezër e motra, prindër e fëmijë, i lanë nën terrorin e regjimit të urisë dhe ikën plot vullnet, plot zjarr, duke kaluar kufij shtetesh fashiste dhe erdhën këtu në truallin e përpjekjeve për lirinë e Spanjës dhe të botës nga rreziku i fashizmit ndërkombëtar”, një solidaritet mbarëkombëtar në të gjithë shtrirjen administrative shqiptare brenda dhe jashtë Shqipërisë. Fakt është që edhe pjesë e emigrantëve shqiptarë nëpër botë iu bashkuan thirrjes së spanjollëve për mbrojtje. Lufta e Spanjës ishte luftë e përgjakshme, pasi Spanja luftoi e bllokuar dhe e rrethuar, e tradhtuar dhe e çarmatosur, luftoi gjer në fund. Lufta i kushtoi popullit spanjoll rreth dy milionë të vrarë (edhe pse shifra është e ndryshueshme si në arkiva ashtu edhe në publikimet e shumta). Vullnetarët që shkuan në Spanjë për të luftuar kundër fashizmit u quajtën nga populli spanjoll: “Vullnetarë të Lirisë”, një titull nderues kuptimplotë. Ata ishin vullnetarë për të mbrojtur lirinë e popullit spanjoll dhe lirinë e popujve të vetë të Europës dhe të botës. Fakt është se ata nuk kërkuar asnjë konditë për të luftuar në radhët e Ushtrisë popullore të Spanjës, luftuan jashtë interesave personale, luftuan vullnetarisht dhe me bindje të plotë se fashizmi duhet të luftohet që në embrion. Të gjitha kombet e botës kishin një ideal të përbashkët që i shtyu ata të shkonin vullnetarë në zjarrin e luftës, ishte ndjenja e dashurisë dhe e lirisë për popujt, ndjenja e mbrojtjes së interesave të popujve nga agresioni dhe bisha fashiste, sepse ishin të bindur se pas Spanjës Hitleri e Musolini do t’u vërsuleshin edhe vendeve të tyre, pasi kjo u vërtetua plotësisht. Në këtë aspekt lufta e Spanjës ishte parathënia e Luftës së Dytë Botërore, ndërkohë që Shqipëria, Dardania dhe Çamëria shkoi me koshiençë të plotë drejt Spanjës që po mbytej në gjak, për lirinë e popullit spanjoll.

Nëpër faqet e shtypit dhe enciklopedive të kohës

Shtypi, jo vetëm shqiptar por mbarëkombëtar dhe ai europian, kishte një vëmendje të shtuar në kohën kur retë e zeza të fashizmit kishin shënjestruar jo vetëm Spanjën por fashizmi ishte një ideologji në rritje dhe po bëhej gati të shpërthente një luftë të re botërore sikurse ndodhi në të vërtetë. Në Fjalorin enciklopedik shqiptar të ASH-së i vitit 1985, jepet informacion konciz rreth një ngjarje luftarake që tronditi botën në vitin 1936: “Vullnetarë shqiptarë që shkuan në ndihmë të popullit spanjoll dhe të forcave republikane që luftonin kundër fashizmit. Mundën të kapërcejnë me vështirësi të madhe pengesat e qeverisë zogiste dhe të përballojnë rreziqet e udhëtimit ilegal. Në Spanjë u rreshtuan në radhët e brigadave ndërkombëtare e kryesisht në radhët e Brigadës XI) ndërkombëtare “Garibaldi”, që përbëhej në pjesën më të madhe nga vullnetarë italianë. Disa prej tyre si Asim Vokshi, Ramiz Varvarica u ngarkuan me përgjegjësi ushtarake dhe politike. Vullnetarët shqiptarë u përleshën me fashistët në beteja të ashpra e me rëndësi në frontin e Madridit, të Barcelonës, të Aragonës e gjetkë; shumë prej tyre, midis të cilëve Asim Vokshi, Ramiz Varvarica, Musa Fratari, Zef Hoti, Thimio Gogozoto, Teni Konomi dhanë jetën për të mbrojtur lirinë e pavarësinë e popullit spanjoll. Në zjarrin e luftës në Madrid ata botuan organin e tyre “Vullnetari i lirisë”, i cili u shpërnda ilegalisht në Shqipëri. Lufta e vullnetarëve shqiptarë është shfaqje e solidaritetit revolucionar me lëvizjen antifashiste ndërkombëtare dhe një ndihmesë për çështjen e lirisë së popujve dhe të mbrojtjes së tyre nga agresioni fashist”. Nga ana tjetër botimi i “Vullnetarit të Lirisë”, organ i shqiptarëve

të Brigadave Internacionale, erdhi si një nevojë për të informuar në gjuhën shqipe, për atë që ndodhte në Spanjë. Imazhi më i njohur i vullnetarëve shqiptarë në luftën e Spanjës që u rreshtuan si ushtarakë në radhët e Brigadave Internacionale në më shumë se tetë dekada është shpalosur edhe nga fotot e njohura për luftëtarë internacionalistë si Petro Marko, Skënder Luarasi, Emrush Myftari, Mehmet Shehu, Iljaz Pashaj, Asim Vokshi, Justina Shkupi e shumë të tjerë. Fakt është se, më 1936, aleanca "Fronti Popullor", i përbërë nga socialistë, republikanë dhe komunistët, fituan zgjedhjet në Spanjë, por këtyre iu vu përballë grupi i djathtë i quajtur "Fallanga Spanjolle" me në krye gjeneralin Franko. Franko u nis nga Afrika Veriore me një numër të madh ushtarësh për të përmbysur qeverinë majtiste të Spanjës dhe kështu filloi një konflikt civil spanjoll, por edhe që u përfshinë 53 vende të botës, të cilët u nisën në Spanjë, duke përfshirë edhe luftëtarët vullnetarë shqiptarë. Lufta u zhvillua midis muajit korrik të 1936 dhe prill 1939, por që përfundoi me humbjen e çështjes republikane, e ndjekur më pas nga diktatura e Frankos. Pjesëmarrësit e renditur sipas alfabetit nuk janë plotësisht të identifikuar: Asim Vokshi, komandant i batalionit "Garibaldi", Daut Muço (Podgorani), Dhimitër Kosta, Emrush Myftari, Faik Dardha, Hulusi Spahiu, Ibrahim Kurani, Iljaz Pashaj, Justina Shkupi, Kostë Kolombo, Mane Nishova, Mehmet Shehu luftëtarë 24 vjeçar-komandant batalioni në brigadën "Garibaldi", Musa Kame (Fratar), Petro Marko, Qamil Sherifi, Ramiz Varvarica, Sabri Lumani kryeredaktor i revistës "Vullnetari i Lirisë" Spanjë, 1937, Skënder Luarasi, Stefan Duni, Stivens Thanasi, Teni Konomi, Thimio Gogozoto, Urfi Agolli, Veli Deda, Xhafer Miraka, Xhelal Abaz Bajrami (Çami), Xhemal Kada, Zef Hoti, Zef Prela, Zihni Muço, etj. Luftëtarë i Spanjës Skënder Luarasi shkruante: "Asnjë popull tjetër nuk e ka kokën e tij më afër hanxharit të fashizmit se sa e ka populli shqiptar". Duke luftuar në frontin e Madridit, luftohet edhe në të gjithë frontin e Shqipërisë sonë. Aty po i përgatitet varri fashizmit italian, i cili është edhe kuçedra e popullit të Shqipërisë". Këto pikëpamje ai i shpreh më qartë, si përgjegjësi i vullnetarëve shqiptarë, në artikullin programatik "25-vjet independencë" në revistën "Vullnetari i Lirisë", në nëntor 1937: "Përsëri po shkojmë drejt humbjes së plotë të pavarësisë së Kombit tonë; përsëri po ngrysemi në natën e robërisë e në ankthin e kohëve të errëta që ia ka përgatitur botës fashizmi barbar. Mbi kurrizin e popullit shqiptar Musolini po sheshon udhën e penetracionit romak në Ballkan. Shqipëria është në kthetrat e kuçedrës fashiste". Ky nuk ishte një shkrim i thjeshtë për një testament, një kampanë alarmi për shqiptarët, pasi parashikimi vërtetonte atë që Konti Ciano shkruante në ditarin e tij dy vjet më vonë: 14.2.1939: "Duçja thotë se, për pushtimin e Shqipërisë duhet të priten dy ngjarje: mbyllja e çështjes spanjolle dhe nënshkrimi i aleancës me Gjermaninë". Ndërsa "më 28.3.1939, Manifestime në Piazza "Venezia" për rënien e Madridit: Duçja shkëlqen, duke treguar atlasin gjeografik të hapur në faqen e Spanjës, thotë: 'Ka mbetur hapur për afro tre vjet, tani mjaft! Tani duhet hapur në një faqe tjetër. Ai ka në zemër Shqipërinë'. Por përvoja që luftëtarët e lirisë fituan në Spanjë, bënë të krijonin frontin antifashist shqiptar "pa dallim feje, krahine, ideje" dhe të shkruanin edhe në Shqipëri faqen më të ndritur për lirinë e Shqipërisë, lirinë që erdhi vetëm me grykën e pushkës kundër bishës nazifashiste italiane dhe gjermane.

Gjaku shqiptar për lirinë e kombit spanjoll

Tashmë janë të dokumentuara dhe të shkruara, të cilat besojmë se do të trashëgohen në breza, bëmat shqiptare në interes të lirisë, vëllazërisë dhe përbashkimit të kombeve. Kështu në një dokument që historia nuk ka si ta harrojë është pikërisht letra që i dërgojnë

vëllait të Asim Vokshit, shokët e tij nga fronti i llogoreve të luftës, këto llogore ku Asim Vokshi nuk kurseu as gjënë më sublime, gjakun e tij për lirinë e popullit spanjoll.

Letër vëllait të Asim Vokshit! Albacete, 2 dhjetor 1937:

"I dashur Myftar! Nga shqiptarët që kanë ardhur vullnetarë në Spanjë, marrim për shembull dy karaktere të kundërta: njëri syresh, i trembur nga rreziqet e luftës, u kthye prapa, u shpall dezertor, dhe sot rron, as që duam ta dimë se ku, i përbuzur nga të gjithë ata që e kanë njohur. Tjetri, përherë edhe më i fortë, sa më e rreptë që të ishte lufta, qëndroi i patundur në krye të batalionit të vet, luftoi si hero i vërtetë, dhe, i pari ndër të parët, ra dëshmor.

I dashur Myftar, prej këtyre të dyve, duke zgjedhur midis të gjallit dezertor dhe të vdekurit dëshmor, cilin do të dëshiroje të kishe pasur për vëlla? Të çmojmë për mbi të gjitha të tjerat se je vëllai i Asimit. I paharruari, si shqiptar që ishte, që bashkëluftëtar i ynë, por në zjarrin e përpjekjeve u bëmë ca më tepër, u bëmë miq e shokë. Dhe tani ai që ishte më i riu, ka qenë më i miri ndër të gjithë. Mbaje humbi jetën që në fillim të luftës më i riu, më i miri, më i dashuri ndër ne të gjithë, që ta kuptojnë të tjerë të rinj shqiptarë, që ç' therori e madhe u dashka që të shpëtojë nga mynxyrat e jetës faqezezë, që po durojnë kafshërisht. Në këtë kuptim, Asimi nuk ka vdekur. Në kujtimin e shokëve italianë garibaldinas, që dëshmojnë për vdekjen heroike të tij, në kujtimin e shokëve shqiptarë, që e dinë se djaloshi kosovar ka ditur jo vetëm të vdesë, por edhe të rrojë heroikisht, fytyra e tij fisnike do të mbetet e paharruar. Janë të dyja, bukuria e jetës dhe bukuria e vdekjes së tij, që na bëjnë t'i jemi më pranë kësaj figure, që ta mbajmë të skalitur në mendje në të gjithë madhështinë e saj. Kjo vetëdije na mbushi me mburrje që heroi, vëllai yt Asimi, ishte edhe bashkatdhetari ynë, miku dhe shoku ynë, vëllai ynë. Të shkruaj ty, nxënësit tim të njëhershëm, se ty të kam njohur, përndryshe këtë letër ngushëllimi ua kam detyrë të gjithë anëtarëve të familjes së Asimit, e, në radhë të parë, me të vërtetë, asaj që i dhuroi jetën heroit tonë të ri. Ajo vetë është e dashur dhe trime, por, natyrisht, zemra e nënës, sado e madhe, preket gjithnjë e më tepër prej humbjes së djalit të saj. E ke detyrë t'i japësh ngushëllimin e duhur. Në këtë mes, të shoqërojmë me simpatinë më të thellë, ne, shokët e tu e t'Asimit".

Asim Vokshi ra për të ngelur i përjetshëm në altarin e kombit tonë dhe kombit spanjoll, por edhe të mbarë kombeve europiane, pasi ra për lirinë. Historia ndodh një herë dhe tregohet me qindra mijëra herë, por të vërtetat e shqiptarëve në Spanjë për lirinë e popullit spanjoll janë ngjarje madhore edhe për kombin tonë që kërkon të jetojë i lirë në hisen e diellit që i takon i lirë dhe i barabartë në vatrën e përbashkët euroatlantike. Për gjakun e derdhur dhe për dëshmorët që i ka dhënë Europës, meriton nderimin më të madh dhe respektin e popujve të Bashkimit Europian.

Një jetë dinjitoze e birit të Kosovës kreshnike

Asim Vokshi është rasti tipik që duhet nderuar sepse ai ra për nderin dhe lavdinë e popullit shqiptar, dhe ngeli dëshmor i Shqipërisë dhe i Spanjës, dëshmor për drejtësi e vëllazëri midis popujve, ngeli dëshmor në përjetësi të të gjithë qytetarëve europianë. Asim Vokshi ishte lindur në qytetin e Gjakovës, në vitin 1909 dhe ishte i biri i Sabrije Vokshit, një grua trimëreshë e Kosovës që rrënjët i kishte nga oxhaku i Sylejman Vokshit, komandantit ushtarak të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Mësimet fillore i nisi në Gjakovë, më 1916-1919 dhe i mbaroi në Kolgecaj. Fakt është se gjatë pushtimit austro-hungarez, u hapën shkolla në gjuhën shqipe. Në shtëpinë e Asim Vokshit, në shkollën e hapur, u mblodhën 925 fëmijë. Mësuesi i parë ishte Ibrahim Fehmiu. Shqiptari kishte luftuar fort për dritën e arsimit, të mësonte gjuhën e tij, të bëhej më i ditur. Në Gjakovën e Asimit u hapën dy shkolla fillore me 6 klasa. Njëri u vu emri i Heroit Kombëtar, “Gjergj Kastrioti Skënderbej”. Ishte viti 1916. Kjo ngjarje e madhe pati ndikim të fortë, si në çdo vatër kosovare, edhe në oxhakun Vokshi të Gjakovës. Më 17 tetor 1922, u hap shkolla e parë shqipe 6-vjeçare dhe me konvikt, nën kujdesin e Bajram Currit e patriotë të tjerë. Konvikti i shkollës ishte në Kolgecaj dhe më pas në Krumë. Asimi në vitin shkollor 1926-1927 shkoi në një shkollë më të lartë, në gjimnazin shtetëror të qytetit të Shkodrës dhe u sistemuan në konvikti “Malet tona”. Në vitin 1929, Asimi fitoi një bursë shtetërore për të studiuar në auditorët e Akademisë Ushtarake të Këmbësorisë, Kavalërisë dhe Shkollës së Aplikacionit të Këmbësorisë në Modena të Italisë. Studimet zgjatën për dy vjet, në harkun kohor 1929-1930 dhe 1930-1931. Së bashku me Asim Vokshin, në kursin e tij, studionin dhe 37 djelmoha të tjerë nga zona të ndryshme të Shqipërisë. Mes studentëve dhe oficerëve të Akademisë, ekzistonin dy rryma, njëra monarkiste dhe tjetra fashiste. Asim Vokshi arriti t'i njohë dhe i shfrytëzoi këto për të kuptuar drejt dhe thellë të vërtetën e shkollës që përgatiste ushtarakë të molepsur nga ideologjia fashiste, shtypës për popullin italian dhe mish për top për pushtimin e Shqipërisë e të popujve të tjerë. Ai ndoqi Akademinë Ushtarake në Itali prej nga u kthye më 1931 me gradën ushtarake “nëntoger”. Bashkëpunoi me Ali Kelmendin dhe me pjesëtarë të rinisë përparimtare të kohës. Më 1.9.1931 Asimi, me gradën “nëntoger”, u emërua në Pogradec zëvendëskomandant i xhandarmërisë së rrethit. Brenda vitit Asimi u transferua përkohësisht adjutant i qarkut të xhandarmërisë në Gjirokastrë dhe më tej shërbeu në Delvinë. Në korrik të vitit 1934, Asimi mori njoftimin për një transferim në Tiranë, por midis Shqipërisë dhe Italisë fashiste, gjatë vitit 1934, marrëdhëniet u acaruan shumë. Italia më 22 qershor dërgoi pa asnjë paralajmërim dhe leje 22 luftanije në portin e Durrësit, si vizitë “miqësore”. Në rrethet përparimtare, që në pranverë të vitit 1934, u shtrua si detyrë e ditës organizimi i një kryengritjeje të armatosur kundër regjimit. Në vitin 1935 vendoset në Tiranë edhe nëna e Asimit, Sabrije Vokshi e njohur edhe si Bije Vokshi, e cila mbante lidhje me lëvizjen komuniste shqiptare të kohës. Duke qenë e edukuar në frymën e pastër atdhetare e revolucionare, Bije Vokshi shtëpinë e saj në Tiranë e kishte vënë në shërbim të Lëvizjes përparimtare, antizogiste. Në vitet 30-të të shek. XX Asim Vokshi zhvilloi veprimtari të gjerë aktive, revolucionare dhe mori pjesë në përgatitjen e kryengritjes antizogiste të Fierit më 1935. Në Tiranë ai krijoi dhe kryesonte një organizatë të njohur në historinë e Shqipërisë me emrin “Grupi Komunist i Oficerëve”. Në këtë grup bënë pjesë shumë ushtarakë shqiptarë, mes tyre disa shumë të njohur si

Bedri Spahiu, Tahir Kadare, Hulusi Spahiu, Dali Ndreu, Prenk Uli, Veli Dedi etj. Asim Vokshi ishte ndër organizatorët e Kryengritjes së Fierit të vitit 1935, në prag të së cilës u arrestua dhe u dënua me burgim. Në bashkëpunim me Vasil Shanton e të tjerë më 1936 nxori një revistë me përmbajtje demokratike. Asim Vokshi, i takonte plejadës së të rinjve revolucionarë, rini kjo e cila shquhej për trimëri e mençuri dhe vigjilencë kombëtare. Asim Vokshi ishte një i ri me ideale përparimtare. Veprimtaria e tij u ndoq nga spiunët dhe rrjetet e agjentëve të mbretërisë, që e burgosi Asimin, mandej e mbajti syrgjyn në disa vende të Shqipërisë, duke e transferuar kohë pas kohe. Edhe pse në kushte të vështira, Asimi mban kontakte me Ali Kelmendin, Vasil Shanton, Zylyftar Veleshnjën, etj. Një njeri i afërt i Musa Jukës, Hilmi Juka, protokollist i Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërhyri që Asim Vokshi të pajishej me pasaportë, për të shkuar vullnetar në Luftën e Spanjës, ku u nis nga Marseja me Teni Konomin, por rrugës anija u bombardua, dhe shoku i tij Teni u vra ndërsa Asimi doli gjallë në bregdetin spanjoll majin e vitit 1937. Asimi, sapo shkeli në tokën e Spanjës, u inkuadrua në divizionin e internacionalistëve italianë që mbante emrin e heroit kombëtar të Italisë, Xhuzep Garibaldit dhe ku në saje të zgjuarsisë se tij arrin të bëhet komandant i një kompanie garibaldiane më 120 luftëtarë internacionalë. Asim Vokshi ishte shquar në cilësitë e komunikimit me njerëzit, me shokët, për t'ua fituar atyre besimin e dashurinë, në fushën e betejës, me shokët e luftës. Ai i deshi luftëtarët e kombësive të ndryshme, të cilët po aq e deshën, si vëlla, si luftëtar, si komandant. Te komandanti shqiptar ata kishin besim të pakufi, sepse ai ishte i sakrificës, jepte gjithçka për shokun e luftës. Ku ishte rreziku më i madh, aty gjendej më parë komandanti. Asim Vokshi, si ushtarak i talentuar, kishte bërë emër në brigadën “Garibaldi”. Duke njohur aftësitë e tij organizuese dhe përgatitjen e lartë si ushtarak, u thirr në shtatmadhori, e cila e caktoi në shtabin e Brigadës “Garibaldi” oficer të shtabit, për të dhënë edhe ai mendime e për të marrë pjesë në diskutimin e çështjeve të ndryshme të organizimit të trupave e të luftimit. Në mendimin e komandës së Brigadës, Asim Vokshi ishte tashmë një ushtarak i pjekur, luftëtar i vendosur e besnik dhe kishte perspektivë për një detyrë më të rëndësishme, komandant kompanie në batalionin e tretë të BrXII “Garibaldi”. Zotësia që tregonte Asimi në fushën e betejës, përfundimet që nxirrte nga veprimi edhe i ushtarit të thjeshtë, këshillat dhe ndihma për shokët, shumë shpejt i bindën luftëtarët e batalionit të tretë, të Brigadës “Garibaldi” se kishin të bënë me një njeri që njihnte luftën dhe armët e saj, njeri që kishte të bashkuara mirë shpirtin e papërkulur me mjeshtërinë e përdorimit të armëve. Ata kishin vënë re se Asimi hidhej në zjarrin e betejave i papërmbajtur, dhe kjo ua rriste moralin shokëve, që të mos i lëshonin llogoret e luftës. Asimi fliste rrallë dhe ashtu i heshtur, më tepër dëgjonte. Shembulli i tij personal në sulm u bë mjet edukues për të tjerët dhe lavdi për popullin shqiptar, që e përfaqësonte denjësisht në arenën luftarake ndërkombëtare. Ai u tregua i pjekur, luftëtar i papërkulur kundër fashizmit dhe mjeshtër i armës. Kur nisnin betejat, komandanti i ngarkonte Asim Vokshit detyrat më të vështira. Ata dhe shokët e tij kishin besim te ai, se ishte ushtar me disiplinë të hekurt i asaj ushtrie, ku merrnin pjesë luftëtarë nga pesëdhjetë e tre kombe, zbatonte urdhrat dhe e plotësonte detyrën deri në fund. Asim Vokshi i kryente detyrat, mbasi njihnte artin e luftës, dinte të përdorte me mjeshtëri armët, kishte guxim dhe ishte gjakftohtë. Asimi, i cili kishte kryer edhe akademinë ushtarake, ishte në mesin e komandove më të

njohur sidomos në vendin e quajtur Fuente del Ebro, ku ishin zhvilluar betejat të përgjakshme në mes të internacionalistëve dhe fashistëve të Frankos, të përkrahur nga Gjermania e Hitlerit dhe Italia e Musolinit. Asimi ngeli përjetësisht në Fuente del Ebro, pasi ai bie heroikisht në Fuente del Ebro, më 4 tetor të vitit 1937, kur ishte vetëm 28 vjeçar, duke luftuar ballë për ballë forcave mercenare frankiste në Frontin e Ebros. Eshtrat e tij u treten në ujërat e rrëmbyeshme të Ebros, në ato ditë të përgjakshme lufte. Ra heroikisht duke luftuar në Frontin e Ebros, në krye të repartit garibaldin që komandonte. Por fashistët nuk ndalen. Në korrik 1943, vëllai i dytë i Asimit, Derguti, u pushkatua nga fashistët italianë, në Landrovicë të Gjakovës. Biqe Vokshi i tregon të vërtetën të vëllait, Aliut, babait të Asimit duke i thënë “Të rrosh vetë vëlla, Dergutin e vranë sot fashistët italianë, ndërsa Asimin e kanë vra para gjashtë vjetësh në Spanjë!”, duke ngelur në memorie shqiptarëve të Shqipërisë dhe Kosovës, por dhe të popullit spanjoll. Asim Vokshi është nderuar me titullin e lartë “Heroi i Popullit”, por nuk ka varr. Ai ka një emër të madh, memorial monument bronzi, këngë, shkolla dhe rrugë mbajnë emrin e tij, libra, monografi, përjetësi. Asim Ali Vokshi është shpallur me titullin e lartë “Hero i Popullit”, më 10.07.1949 nga Kuvendi Popullor, ndërsa me vendim nr. 02 datë 18.01.1983 të Komisionit Qendror të statusit “Dëshmor i Atdheut”, duke i akorduar titullin sublim për të rënë e kombit “Dëshmor”. Është vlerësuar me “Urdhrin e Skënderbeut të Klasit II”, si dhe është dekoruar nga shteti spanjoll në nderim të veprës së tij si dëshmor. Monumente janë ngritur në brigjet e Ebros së përgjakur në tokën spanjolle, sepse ai ishte dhe ka ngelur simboli i antifashizmit që e shkroi lirinë europiane në betejat e Madridit, Haramës, Aragonit, Ebros, Katalonjës etj., bashkë me luftëtarët e tjerë vullnetarë nga gjithë trualli arbëror. Prandaj dhe populli spanjoll nuk i harron luftëtarët ndërkombëtarë që u vranë për lirinë e tij. 70-të e ca luftëtarët nga Shqipëria, Kosova, Çamëria, Arbëreshët e Greqisë e Kalabrisë në Itali, por dhe shqiptarë të tjerë nga fabrikat, uzinat e minierat e Francës, Gjermanisë e Amerikës, u bënë yjet e lirisë të gjithë kombit shqiptar që e përfaqësuan denjësisht gjithë shtresat e kombit tonë në përballjen e parë të përgjakshme me fashizmin.

Për shqiptarët që i lartësuan nderin dhe krenarinë mbarë shqiptarizëm

Ata janë pesëmbëdhjetë shqiptarë që dhanë jetën në Spanjë për lirinë si pjesë e antifashizmit botëror. Vullnetarët shqiptarë i tregonin armikut gjoksin, sepse ishin bij të trimërisë shqiptare dhe me gjakun e tyre shkruan pavdekësinë. Ata anë për lavdinë e popullit shqiptar, pasi të frymëzuar nga ndjenjat e internacionalizmit proletar, shkuan vullnetarë në Spanjë dhe ranë dëshmorë në sheshin e luftës si: 1). Asim Ali Vokshi, hero dhe dëshmor që ra në heroikisht në Fuente del Ebro, më 4 tetor të vitit 1937, kur ishte vetëm 28 vjeçar; oficer i karrierës. 2). Zef Preng Hoti, 30 vjeç, nga Malësia e Shkodrës, ish-emigrant në Francë në vitin 1930, më 1936, shkoi vullnetar në repartet internacionale të garibaldinëve, dhe ra në frontin për mbrojtjen e Madridit në janar 1937; 3). Urfi Ali Agolli, 23 vjeç, nga Dibra e Madhe, ish-nxënës në shkollën ushtarake, që shkoi në Spanjë nga fundi i 1936, në repartet internacionale të garibaldinëve, ra në frontin për mbrojtjen e Madridit në muajin janar 1937; 4). Teni Diamant Konomi, nga Korça, 26 vjeç, u nis për në Spanjë bashkë me Asim Vokshin por pa arritur në tokën spanjolle, vaporit me të cilin udhëtonte u godit nga fashistët dhe ai u vra

në ujërat e Barcelonës, më 1.5.1937; 5). Ramiz Maliq Varvarica, nga Peshkopia, 38 vjeç, ish-nënoficer në ushtrinë shqiptare, pjesëmarrës në revolucionin e 1924-ës, emigrant në Francë si punëtor, në Spanjë ka shkuar në fund të vitit 1936, në repartet internacionale e në fund në Brigadën “Garibaldi”, me gradën ‘kapiten’ dhe ka rënë në frontin e Kaspes në muajin prill 1938. Është shpallur “Hero i Popullit”; 6). Musa Ali Kami (Fratari), nga Përmeti, 27 vjeç, ka qenë oficer i karrierës, i pushuar si armik i regjimit, shkoi në Spanjë në maj 1938, në radhët e Brigadës Internacionale – “Garibaldi”, si përgjegjës i skuadrës së mitraljerëve dhe ra në frontin e Ebros në muajin shtator 1938, një nga betejat më të ashpra të Luftës së Spanjës, është shpallur ‘Hero i Popullit’; 7). Thimjo Nasho Gogozoto, nga Çamëria, fshatrat e Pargës, 24 vjeç, ish-nxënës i shkollës Normale të Elbasanit, shkoi në Spanjë në qershor 1938 në repartet e Brigadave internacionale dhe ka rënë në frontin e Ebros më 28.9.1938, në një nga betejat më të ashpra të Luftës së Spanjës; 8). Xhemal Osman Kada, nga Peja, 26 vjeç, oficer i karrierës, ka shkuar në Spanjë nga fundi i 1936 dhe ka marrë pjesë në radhët e reparteve të Brigadave Internacionale “Garibaldi” si oficer, ka rënë në frontin e Ebros në shtator 1938, një nga betejat më të ashpra të Luftës së Spanjës, është shpallur ‘Hero i Popullit’; 9). Kosta Dhimitër Lito, nga Leskoviku, 41 vjeç, punëtor i emigruar në Francë, nga ku ka shkuar në Spanjë nga fundi i 1936-ës dhe ka marrë pjesë në radhët e reparteve të Brigadave Internacionale me gradën nënoficer, ka qenë i plagosur rëndë në frontin e Madridit si dhe është marrë nga kampet e përqendrimit të Francës nga Gestapoja, nga ku është zhdukur në kampet e shfarosjes së Gjermanisë naziste; 10). Daut Muço Podgorani, nga Përmeti, 25 vjeç, punëtor dhe emigrant në Paris, ishte nga vullnetarët e parë që shkoi në Spanjë dhe formuan batalionin “Komunën e Parisit”, u radhit në kolonën italiane “Roseli” dhe pastaj u shkrinë në Brigadën Internacionale “Garibaldi”. Ai ka rënë dëshmor në nëntor 1938 për të mbrojtur Madridin; 11). Hamdi Koja Zagari, nga Kolonja, 30 vjeç, kishte mbaruar akademinë në Francë, shërbente në ushtrinë e Republikës Spanjolle, nga rebelimi së bashku me vullnetarë punëtorë bullgarë, u pushkatua më 27 korrik të vitit 1936; 12). Zihni Murat Çami, nga Çamëria, 29 vjeç, oficer, komandant kompanie, vritet nga një bombardim pa lënë asnjë gjurmë më 4 tetor 1938; 13). Ymer Puka, nga qyteti i Pukës, 50 vjeç, mbaruar Akademinë në Stamboll, komandant me përvojë, major në ushtrinë turke, që mori pjesë në Luftën e Spanjës, si komandant batalioni; ai kaloi kufirin në Francë me të plagosur dhe të sëmurë me përfundimin e luftës, por u kap nga nazistët dhe u zhduk në dhomat me gaz të tyre në vitin 1944; 14). Xhelal Abaz Çami, nga fshati Kurtec, Çamëri, 40 vjeç, punonte si emigrant në Paris, merr pjesë në Luftën e Spanjës, në kompaninë mitraljere, plagoset rëndë, u mjekua, shpëton dhe në vitin 1952 kthehet në Shqipëri, shtrohet në sanatoriumin e Tiranës dhe vdes më 14.4.1953, si pasojë e plagëve të luftës; 15). Novruz Feim Veli Zagari, nga Kolonja, 35 vjeç, kishte mbaruar akademinë në Francë, shërbente në ushtrinë e Republikës Spanjolle, nga rebelimi së bashku me vullnetarë punëtorë bullgarë, u pushkatua më 27.7.1936. Ndërkohë që të dokumentuar janë se krahas të rënëve në krye të detyrës në luftime u plagosën edhe shumë shqiptarë të tjerë si, Qamil Sherifi, Stivens Thanasi, Qamil Sherifi nga SHBA, të ardhur vullnetarisht për në Spanjë, por mendohet se ka edhe të tjerë ende të pa identifikuar dhe të pa evidentuar, megjithëse sakrificat, përpjekjet, gjaku shqiptar atje në tokën spanjolle, është gjak i nderit, lavdisë dhe krenarisë shqiptare.



Kongresi i Manastirit, tempulli i gjuhës shqipe

115-vjetori i Kongresit të Manastirit

Shqipja e shkruar dokumentohet që nga shekulli XIV me alfabetin latin, shkronja cirilike. Po këtë alfabet, të plotësuar me ndonjë shenjë greke, e përdorën edhe shkrimtarët arbëreshë. Duke qenë se greqishtja përdorej si gjuhë e kishës ortodokse, shqipja u shkrua edhe me shkronja greke. Nën tryshninë e islamizmit dhe të pushtuesve osmanë, në shkrimin e shqipes, që nga fillimi i shekullit XVIII, u përdor edhe alfabeti turko-arab. Më të u shkruan krijimet letrare të bejtexhinjve. Me fjalë të tjera, me alfabet latin janë shkruar dokumentet e para në gjuhën shqipe:

Formula e pagëzimit, 1462, (Fjalorthi i Arnold fon Harfit, 1496)

Dëshmia e parë me alfabet grek është “Ungjilli i Pashkëve” ose “Perikopeja e Ungjillit”, i shkruar në dialektin jugor të shqipes, në një fletë karte, të gjetur në një kodik të shekullit XIV.

Ka që thonë se ky shkrim i përket fundit të shekullit XV ose fillimit të shekullit XVI.

Libri i parë në gjuhën shqipe, “Meshari” i Gjon Buzukut i vitit 1555 dhe tekste të tjera të shekullit XVII dhe të gjysmës së parë të shekullit XVIII janë shkruar me alfabet latin, plotësuar me disa shkronja cirilike. Në shekullin XVIII autorët e letërsisë së bejtexhinjve përdorën alfabetin turko-arab.

Për shkrimin e shqipes, për të vënë në pah individualitetin e saj dhe të popullit shqiptar, u ndoq edhe një rrugë tjetër, ajo e krijimit të alfabeteve të veçanta. Nga shekulli XVIII, mbase edhe më parë, u krijuan disa alfabete të tilla. Orvatja më fatlume që ajo e veprimtarit dhe e mësuesit të gjuhës shqipe Teodor Haxhifilipit (rreth vitit 1730-1805), i njohur me emrin Dhaskal Todri, shkrimi i të cilit pati njëfarë përhapjeje.

Në një frymë të re, thellësisht kombëtare, e shtroi dhe e zgjidhi çështjen e alfabetit të shqipes ideologu i parë i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, mendimtari i shquar iluminist dhe veprimtari i shkollës shqipe Naum Veqilharxhi (Naum Bredhi, 1767-1846). Në vitet 1824 dhe 1825 ai e kishte nisur tashmë punën për një alfabet të tij me 33 shkronja. Më 1844 ai shtypi në gjuhën shqipe një abetare prej tetë faqesh. Ky libër i vogël me titull “Fort i shkurtër e i përdorçim ëvetar shqip”, u shpërnda në mbarë Shqipërinë e jugut, nga Korça në Berat. Në vitin 1845, në një botim të dytë, kjo broshurë u zgjerua deri në 48 faqe, me titull “Fare i ri abetor shqip për djelm nismëtores”.

Përpjekje të mëtejshme për caktimin e një alfabeti të përgjithshëm për gjuhën shqipe u bënë në vitet '60 të shekullit XIX si dhe më pas, nga një grup atdhetarësh dhe veprimtarësh të shquar të Rilindjes Kombëtare, siç ishin: Kostandin Kristoforidhi (1872-

1895) lëvrues dhe studiues i dalluar i gjuhës shqipe, Pashko Vasa (1825-1892), veprimtar i arsimit dhe i kulturës, poet dhe publicist patriot, Hasan Tahsini (1811-1881), atdhetar i madh, filozof dhe mendimtar i shquar në fusha të ndryshme të diturisë, Jani Vreto (1822-1900), atdhetar dhe mendimtar i shquar, Sami Frashëri (1850-1904), dijetar i madh, shkrimtar dhe publicist, rilindës i shquar, ideolog kryesor i Lëvizjes kombëtare shqiptare. Përpjekjet e tyre u kurorëzuan me sukses në kohën e Lidhjes së Prizrenit (1878).

Në fillim të vitit 1879 u pranua alfabeti i parashtruar nga Sami Frashëri, i bazuar në parimin “një tingull me një germë dhe një germë për një tingull”. Ky alfabet, i njohur me emrin “alfabeti i Stambollit”, u mbështet në alfabetin latin, duke u plotësuar me disa shkronja greke dhe me shkronja të tjera të veçanta. Me të u bënë shumë botime, u përhap gjerësisht dhe deri në fund të shekullit XIX ishte alfabeti kryesor i Rilindjes Kombëtare.

Nga fundi i shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX një përhapje jo të vogël pati edhe alfabeti i shoqërisë “Bashkimi” të Shkodrës, të cilin me pak ndryshime e përshtati edhe revista “Albania” e Faik Konicës (1875-1942), që botohej në Bruksel në vitet 1897-1902 dhe në Londër në vitet 1903-1909. Me shkrimet e saj, kjo revistë luajti një rol të rëndësishëm për zgjidhjen e alfabetit të përbashkët, të vendosur në Kongresin e Manastirit më 1908.

Kur numri i botimeve shqipe u shtua, ndërsa rrjeti i shtypjes së tyre u zgjerua, kushtet teknike dhe arsye të tjera bënë që të krijohen e të përdoren alfabetë të ndryshme. Gjithnjë e më shumë u përdor alfabeti thjesht latin në variante të ndryshme, duke u plotësuar shkronjat e tij me diagrame (dysshkronjësia) ose me shenja diakritike (ç, ë). Numri i alfabeleve të përdorura në praktikën e botimeve erdhi duke u shtuar.

Shumë nacionalistë shqiptarë ushqyen besim te lëvizja e xhonturqve, e cila do të shpinte në revolucionin e korrikut të vitit 1908 dhe pas një viti, në përmbysjen e Sulltan Abdyl Hamidit II (1842-1918). Edhe shqiptarët luajtën një rol me rëndësi në revolucionin e xhonturqve, i cili e përshpejtoi fundin e kësaj periudhe të stagnimit të përgjithshëm, e që më 23.07.1908 i dha Perandorisë kushtetutë, ndërsa qytetarëve barazi. Por shpresat që shqiptarët kishin mbështetur te xhonturqit, u shuan shpejt. U bë e qartë se administrata e re ishte po aq centraliste sa edhe e vjetra, në mos dhe më shumë. Shqiptarët nuk do të bënin pjesë në atë valë nacionalizmi mbarëturk që po përhapej nëpër Evropë. Veprimtari dhe publicisti i Rilindjes Dervish Hima (Ibrahim Naxhi, 1875), thoshte se “shqiptarët nuk janë tjetër veçse shqiptarë dhe nuk do ta ndojnë veten të kënaqur veçse kur të jenë të lirë në një Shqipëri të lirë, si një pjesë e një konfederate shtetesh të pavarura ballkanike nën suzerenitetin e Sulltanit.

Po në këtë kohë, prej 14 deri më 22 nëntor 1908, u mbledh Kongresi i Manastirit, për të shqyrtuar në atë fazë disa çështje të rëndësishme të Lëvizjes Kombëtare, në radhë të parë për të zgjidhur çështjen e alfabetit të gjuhës shqipe, njësimi i të cilit ishte bërë një problem i mprehtë politik, arsimor dhe kulturor dhe një kërkesë e ngutshme e Lëvizjes Kombëtare.

Për ta përmbushur këtë kërkesë, atdhetarët shqiptarë shpejtuan ta shfrytëzonin gjendjen e krijuar pas shpalljes së Kushtetutës në Perandorinë Osmane.

Nismëtar i thirrjes së këtij kongresi kombëtar, që ka hyrë në histori si Kongresi i Manastirit, ishte klubi “Bashkimi” i Manastirit. Organizimi i kongresit të alfabetit u propagandua nga veprimtari politik, shkrimtari, publicisti dhe përkthyesi, i njohur edhe me pseudonimin Lumo Skëndo dhe Mali Kokojka Mit’hat Frashëri në

revistën e tij “Liria”. Në një artikull të botuar në të, midis tjerash ai shkruan: “...ardhi një ditë e pëlqyer për istorinë tonë, që të nisim liruari’ e pa pengim të punojmë për mbrodhësin’ e lumturin’ e kombit tonë, jo me barut edhe me armë, po me kartë e pëndë, andaj kjo çështje e Abecesë lipsetë të jetë fillim, që pa atë nuk do mundim të arrijmë qëllimetë tona të lartëra për mbrodhësi të gjuhësë”.

Kongresi u mbajt në shtëpinë e veprimtarit të lëvizjes kombëtare, të lindur në Zavalan të Dangëllisë (rrethi i Përmetit) Fehim Zavalanit (1859-1935). Nën drejtimin e tij, pranë klubit “Bashkimi” të Manastirit, në vitin 1908, u formua një komitet i fshehtë që luftonte për autonominë e Shqipërisë. Fehim Zavalani ishte drejtues i gazetës “Bashkimi i Kombit” që doli në Manastir në vitet 1909-1910. Në vitet 1911-1912 gazeta doli me emrin “Drita”, si organ i klubit “Bashkimi” të Manastirit. Femi Zavalani ishte ndër organizatorët kryesorë të thirrjes së Kongresit të Manastirit për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe. Si kryetar i klubit “Bashkimi” të Manastirit, Fehim Zavalani bashkërendoi veprimtarinë e të gjitha klubeve shqiptare për mbrojtjen e alfabetit shqip, të kulturës dhe të të drejtave kombëtare të shqiptarëve kundër reaksionit xhonturk. Në Kongresin e Dibrës (1909), kundërshtoi përpjekjet e përkrahësve të xhonturqve për t’u imponuar shqiptarëve alfabetin arab.

Në Kongres morën pjesë 50 delegatë. Prej tyre, 32 delegatë ishin me të drejtë vote, ndërsa 18 delegatë, pa të drejtë vote. Delegatët vinin nga të katër vilajetet e tokave shqiptare: i Shkodrës, i Janinës, i Manastirit dhe i Kosovës, delegatë të shoqërive, të klubeve dhe të organeve kombëtare të pjesës më të madhe të trevave shqiptare, si dhe të kolonive shqiptare në Stamboll, në Bukuresht, në Sofje, në Egjipt, në SHBA, midis tyre shkrimtarë e gazetarë, lëvrues të gjuhës dhe mësues të shqipes, veprimtarë të njohur të lëvizjes kulturore dhe politike kombëtare.

Për të studiuar çështjen e alfabetit dhe për të dalë me propozime, Kongresi zgjodhi një komision prej 11 anëtarësh, të përbërë nga përfaqësues të tre alfabeleve kryesore që ishin në përdorim.

Në komision bënin pjesë: Poeti, dramaturgu, prozatori, esteti, publicisti, kleriku i lartë dhe politikani Gjergj Fishta; Veprimtari i lëvizjes kombëtare dhe demokratike shqiptare, poeti e publicisti Luigj Gurakuqi; Botuesi i të përjavshmes shqiptaro-amerikane “Kombi” në Boston Sotir Peci; Veprimtari politik, shkrimtari, publicisti dhe përkthyesi Mit’hat Frashëri; Njëri ndër figurat udhëheqëse të lëvizjes kombëtare në Sofje Shahin Kolonja; Deputeti i Elbasanit në Kongres ishte farmacisti Dhimitër Buda (Taqi Buda), i cili e mbështeti Kongresin edhe financiarisht. Më vonë mbështeti financiarisht edhe Normalen e Elbasanit. Është baba i historianit Aleks Buda; Poeti klasik dhe veprimtari atdhetar Ndre Mjeda; Veprimtari i Rilindjes Kombëtare, publicisti, drejtuesi i shkollës së vashave në Korçë, Gjergj Qiriazi; Veprimtari i Rilindjes Kombëtare, organizator dhe drejtues i çetave të armatosura për pavarësi në vitet 1906-1908 Bajo Topulli; Veprimtari i lëvizjes kombëtare, publicist i cili iu përkushtua përhapjes së mësimi dhe shkrimit të gjuhës shqipe, si dhe ideve kombëtare në Berat, Nyzhet Vroni (Nyz-het Vroni). Në Kongres mori pjesë si delegat i klubit “Bashkimi” të Beratit dhe u caktua anëtar i Komisionit të alfabetit; Veprimtari i Rilindjes Kombëtare, mësuesi i Shkollës së Vashave në Korçë, i cili lindi në Vithkuq të Korçës dhe u shpërngul në Manastir, Grigor Cilka, gruaja e tij, Katerina Cilka ishte mësuese e shkollës së parë fillore për vajza në Korçë.

Ndër pjesëmarrësit e shquar ishin edhe:

Veprimtari i Rilindjes Kombëtare dhe i shkollës shqipe, publicisti

Petro Nini Luarasi. Për veprimtarinë patriotike, arsimore, shoqërore dhe propaganduese, u përndodh nga xhonturqit dhe Patrikana e Stambollit. Vdiq i helmuar prej tyre në Ersekë; Veprimtari i shkollës shqipe, studiuesi dhe publicisti nga Shkodra, Mati Logoreci; Poeti dhe publicisti nga Shkodra Hilë Mosi; Veprimtari i Rilindjes Kombëtare, i shkollës shqipe dhe i shtypit shqiptar, i lindur në Vodicë të Kolonjës Thoma Avrami; Veprimtari i kulturës dhe i arsimit kombëtar, gjuhëtari Simon Shuteriqi; Veprimtarja e Lëvizjes Kombëtare, gazetaria dhe publicistja Parashqevi Qiriazi, e cila punoi për emancipimin e femrës shqiptare. Familja patriote kolonjare Qiriazi ishte vendosur në fshatin Tërnovë të Manastirit. Sevasti Qiriazi (Dako) (1871-1949), Gjerasim Qiriazi (1858-1894), Gjergj Qiriazi dhe Parashqevi Qiriazi (1880-1970) janë motra e vëllezër. Qenë veprimtarë të Lëvizjes Kombëtare. Vepruan për arsimimin dhe për emancipimin e popullit shqiptar, sidomos të femrës shqiptare.

Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, Mati Logoreci, Luigj Gurakuqi dhe Hilë Mosi vinin nga Shkodra. Shahin Kolonja dhe Petro Nini Luarasi nga Kolonja. Thoma Avrami nga Korça. Bajo Topulli dhe familja Qiriazi nga Manastiri. Sotir Peci nga Bostoni. Kryetar i Kongresit u zgjodh Mit'hat Frashëri, biri i Abdyl Frashërit. Ai u caktua edhe në Komisionin e alfabetit. Komisioni njëmbëdhjetë anëtarësh kryesohej nga Gjergj Fishta. Komisioni kishte për detyrë të studionte çështjen e alfabetit dhe të dilte me propozime.

U arrit menjëherë mendimi i përbashkët që, pavarësisht nga alfabeti që do të përcaktohej, kryesorja ishte të ruhej uniteti kombëtar. Këtë ide Gjergj Fishta e shprehu duke thënë: "... sado që jam dërguarë prej shoqërisë Bashkim, s'kam ardhurë për të mprojtur atë abece, po për të gjeturë një mënyrë që të bashkohemi të tërë".

Tre alfabetet kryesore që u morën në shqyrtim

Alfabeti i "Agimit", i shoqërisë letrare "Agimi" të Shkodrës, i propozuar nga Ndre Mjeda, alfabeti i Bashkimit, i shoqërisë letrare "Bashkimi" të Shkodrës, i hartuar nga poeti dhe kleriku, i lindur në Bulgër të Mirditës, Preng Doçi dhe alfabeti i Stambollit, i hartuar nga Sami Frashëri.

Kishte shqiptarë, kryesisht të jugut, të cilët parapëlqenin alfabetin tradicional të Stambollit. Shqiptarët e veriut ndërkaq, pëlqenin alfabetin e "Bashkimit" të Shkodrës, i cili ishte më praktik për botime, ngase nuk kishte shkronja jo-latine.

Në kongres u shqyrtuan gjithashtu edhe dy alfabetë të tjera: alfabeti grek, i përhapur për përdorim të shqipes nga lëvruesi dhe studiuesi i gjuhës shqipe, veprimtari i Rilindjes Kombëtare në fushën e arsimit dhe të kulturës Konstandin Kristoforidhi dhe alfabeti arab, të cilin një numër i caktuar i myslimanëve, sidomos në Maqedoni dhe në Kosovë, vazhduan ta shohin si të vetmen zgjidhje edhe për një kohë të caktuar pas kongresit. Një prej tyre që përkrahu alfabetin arab ishte edhe veprimtari i lëvizjes kombëtare, kleriku Rexhep Voka. Ai u përfshi në lëvizjen për çlirim kombëtar dhe për mbrojtjen e trojeve etnike shqiptare, për mësimin e shqipes dhe për përhapjen e diturisë, si rrugë e emancipimit kombëtar të shqiptarëve. Në vitin 1903 ishte myfti i vilajetit të Manastirit. Përkrahu idenë e shkrimit të shqipes me alfabet arab, gjë që u kundërshtua nga veprimtarët e Rilindjes. Me këtë alfabet botoi dhe një abetare ("Elifbaja shqipe", 1910).

Pas disa ditësh të përshkuara me diskutime dhe duke marrë gjatë kësaj kohe edhe telegrame nga mbarë Shqipëria, me

kërkesën që të vendosej njëri apo tjetri alfabet, Komisioni vendosi t'i pranojë variantet e modifikuara të alfabetit të "Bashkimit"; dhe të alfabetit të Stambollit.

Tani, në shkolla dhe në botime mund të përdoreshin të dy alfabetet. Megjithatë, pranimi nga të gjithë, i vendimit të Komisionit do të donte ende kohë. Pra, pas mjaft diskutimesh u krijua një alfabet i ri, i mbështetur i tëri në alfabetin latin, shkronjat e të cilit plotësoheshin me nëntë dyshkronjës (dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh, zh) dhe me dy shkronja me shenja diakritike (ç, ë). Në fund Komisioni dhe Kongresi vendosën që të lejohej përdorimi, si i alfabetit të Stambollit, që kishte një përhapje të gjerë ndër shqiptarë, ashtu edhe i alfabetit të ri. Dy alfabetet ndryshonin vetëm në shtatë shkronja.

Vendimet e kongresit që ishin kurorëzim i përpjekjeve të shumë brezave lëvruesish të shqipes për afrim e njësim, u mirëpritën nga rrethet kulturore shqiptare brenda dhe jashtë vendit dhe u vunë menjëherë në zbatim. Brenda pak vitesh, alfabeti i shoqërisë letrare "Bashkimi" të Shkodrës i miratuar nga Kongresi i Manastirit, fitoi epërsi dhe u bë shpejt alfabeti i vetëm i shqipes. Njësimi i alfabetit ishte një hap i rëndësishëm për njësimin e drejtshkrimit dhe të gjuhës letrare shqipe.

Kongresi i Manastirit pati rëndësi të madhe jo vetëm për alfabetin dhe për gjuhën letrare kombëtare, për arsimin dhe për kulturën, por edhe për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në përgjithësi. Gjatë ditëve të kongresit u organizuan takime të veçanta dhe mbledhje të mbyllura me delegatët, ku u rrahën çështje të mprehta politike. Bisedimet e zhvilluara shërbyen për të afruar pikëpamjet, për të përcaktuar platformën politike të përbashkët të organizatave kombëtare dhe për të bashkërenduar më mirë veprimtarinë e tyre.

U hartua edhe një program kërkesash politike, kulturore dhe ekonomike prej 18 pikash, që iu dha deputetit të Korçës, Shahin Kolonjës, për ta paraqitur në emër të shqiptarëve në parlamentin osman. Shahin Kolonja ishte një ndër figurat udhëheqëse të lëvizjes kombëtare në Sofje.

Kongresi i Manastirit e ngriti lëvizjen kombëtare në një shkallë më të lartë. Për të janë bërë botime të posaçme, si përmblidhja "Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit" (1972) dhe studimi "Kongresi i Manastirit" (2004) nga gjuhëtari Shaban Demiraj dhe nga historiani Kristaq Prifti.

Përcaktimi i kombit shqiptar për alfabetin latin kishte për të një rëndësi politike të jashtëzakonshme. Një përcaktim i tillë ishte i natyrshëm. Kjo dëshmoi qartë se shqiptarët janë një popull evropian pjesë e pandarë e qytetërimit perëndimor.

Kongresi i Manastirit i priu shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, gjë që ndodhi katër vjet më vonë.

Çështja e alfabetit qe një temë politike e diskutuar gjatë Rilindjes, e kështu do të mbetej edhe për disa vjet me radhë, përkatësisht deri në vitin 1908. Me vendimin për të mbështetur një zgjidhje kompromisi, Kongresi shtroi rrugën për një kalim shkallëzor nga alfabeti i Stambollit te alfabeti i tanishëm i shqipes, i bazuar në shkronja latine, si dhe arriti të mënjanonjë mjaft polemika dhe kundërshtime në vitet e mëvonshme.

Ndonëse një gjuhë letrare, me një drejtshkrim përfundimtar për të gjithë leksikon, u vendos jo më parë se në vitin 1972, në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe të mbajtur në Tiranë prej 20 deri më 25 nëntor 1972, vendimet e miratuara 64 vjet më herët në Kongresin e Manastirit, e lehtësuan mjaft formimin e disa normave gjuhësore në fushën e botimeve dhe ndihmuan në ecjen përpara të një letërsie shqiptare më të njësuar.

